






TITULLI ORIGINAL
HAK DOSLARINDAN
HËKMETLER


PËRKTHEU
Albert Halili

REDAKTOI
Ilir Hoxha

FAQOSJA
Bledar Xama

BOTIMI I
Prill 2021, Shkodër

PROGRESI BOTIME
Sheshi "2 Prilli", Rr: Studenti
Shkodër, Shqipëri
Mob: +355 67 340 6182



Urtësi

NGA TË DASHURIT E
ALLAHUT

- 1 -

Osman Nuri TOPBASH





PARATHËNIE

Falënderime të pafundme qofshin për Allahun, i Cili na ka nderuar me dhuntinë e Islamit dhe besimit, që na ka privilegjuar duke na bërë bashkëbisedues të Kuranit Famëlartë dhe që na ka mundësuar fatin që të jemi pjesë e umetit të Muhamedit a.s i cili është komentuesi konkret i Kuranit dhe udhërrëfyesi ynë.

Në këtë botë kemi si drejtim istikametin, kurse në ahiret kemi shpresë në ndërmjetësimin e Krenarisë së Gjithësisë, Muhamed Mustafasë a.s. Salate dhe selame të pafundme për familjen e tij të pastër dhe shokët e tij besnikë!..

Lumturia e njeriut në këtë botë dhe botën tjetër është e lidhur me ekuilibrin midis turpit dhe shpirtit. Ashtu si trupi ka nevojë fiziologjike për ushqim edhe shpirti ka nevojë për ushqim shpirtëror. Një ndër ushqimet më të mira të shpirtit është urtësia. Meditimi dhe reflektimi mbi fjalët e urta i gjallëron zemrat por si shiu që gjallëron tokën me bimë.

Aliu (r.a.) e shpreh në këtë mënyrë këtë të vërtetë:

“Qetësojini shpirtrat tuaj me fjalë dhe vepra të urta, sepse



siç lodhet dhe dobësohet trupi, ashtu lodhet edhe shpirti.”

“Njerëzve tërhiquni vërejtjen me fjalë të urta që i bëjnë të mendojnë, me qëllim që t’u qetësohen zemrat.”

Fjalët bosh dhe padobi e largojnë njeriun nga atmosfera shpirtërore. Kurse fjalët e urta e freskojnë dhe qetësojnë shpirtin. Fjalët e urta e zgjojnë dhe e qetësojnë shpirtin gjatë aktiviteteve ditore dhe ulje-ngritjeve të jetës së përditshme.

Allahu thotë në Kuran:

Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të dërguar nga gjiri i tyre, i cili ua lexon shpalljet e Tij, i pastron nga gjynahet dhe u mëson Librin (Kuranin) e urtësinë (diturinë e thellë fetare), edhe pse më parë, me të vërtetë, ata ishin në rrugë krejt të gabuar. (Ali Imran, 164)

Siç kuptohet edhe nga ajeti kuranor pejgamberët në përgjithësi kanë tre detyra kryesore:

1. Predikimin dhe zbatimin e ajeteve hyjnore, shpjegimi dhe zbatimi i rregullave hyjnore.
2. Pastrimi i zemrave dhe botës së brendshme të njerëzve nga ndotjet shpirtërore.
3. Mësimi i librit dhe urtësisë.

Kur’ani është poetika e plotë dhe e përkryer e të gjitha të vërtetave të gjithësisë, të gjitha të vërtetat ndodhen tek ai në formë embrionale. Kjo situatë si rrjedhojë e domosdoshme e karakterit mrekullor të Kur’anit, mund të kuptohet e ndriçohet në raport me zhvillimin e ngjarjeve dhe zhvillimin në shkencat njerëzore.

Pra nëse thellohemi mbi Kuranin do të vërejmë se ai është

një shfaqje e plotë e urtësive hyjnore. Urtësia shpreh tërësinë e mesazhit hyjnore të të vërtetave të fshehura në dukuri dhe sende. Burimi i vërtetë i urtësisë është Allahu. Fjalët dhe sjelljet e Profetit (a.s.) janë shpjegim i urtësive kuranore të shpallura nga Allahu.

Njerëzit më afër urtësive kanë qenë sahabët. Profeti (a.s.) thotë:

Sahabët e mi janë si yje...”

Nëse i qasemi nga urtësia yjet në Kuran kanë tre veçori:

1. Zbukurimin e qiellit. Çdo sahab është një zbukurim për qiellin e islamit dhe shpirtit të besimtarit. Allahu ka shprehur konsiderata në Kuran për ensarët dhe muhaxhirët.

2. Goditjen e Shejtanit. Për ne është e panjohur se si ndodh kjo, natyrën e saj e di vetëm Allahu. Por sahabët duke qenë dëshmitarët e Allahut në tokë dhe ndjekësit më të mirë të Kuranit dhe Sunetit vazhdimisht godasin shejtanin me gurë.

3. Orientojnë njerëzit. Yjet shërbejnë për të orientuar njerëzit gjatë udhëtimeve të tyre drejt destinacionit të tyre. Edhe sahabët do të jetë në rolin e yjeve udhëzues deri në ditën e gjykimit. Ata me shembujt e tyre do të shërbejnë gjithmonë për të udhëzuar ymetin drejt rrugës së drejtë.

Urtësitë janë transmetuar nga Profeti tek sahabët dhe nga sahabët tek brezat pasardhës. Dijetarët që janë trashëgimtarë të profetëve kanë shërbyer si pasqyra që kanë pasqyruar urtësinë profetike në kohën dhe vendin e tyre. Njerëzit e urtë janë robër të zgjedhur të cilët kanë këshilluar dhe udhëhequr njerëzit në rrugë të drejtë në çdo periudhë. Urtësitë janë si një oqean i pamatë prej të cilit, njerëzit përfitojnë sipas aftësive të tyre.

Allahu i ka krijuar njerëzit me aftësi dhe veçori të ndryshme fizike, po ashtu edhe aftësitë shpirtërore janë të ndryshme për njerëz të ndryshëm. Prandaj në këtë botë nuk gjenden dy njerëz të njëjtë me ngjashmëri të plotë. Sepse krijimi dy krijesave krejtësisht të njëjta dhe të ngjashme e bën të padobishëm një-rën prej tyre. Por Allahu e ka krijuar çdo gjë sipas një urtësie të caktuar. Njerëzit sa do që ngjajnë nga ana fizike, ata ndryshojnë kryekëput nga aftësia dhe prirja shpirtërore.

Ashtu edhe të dashurit e Allahut të cilët ushqehen të gjithë prej një burimi, pra prej Kuranit dhe Sunetit shfaqin që të gjithë nuanca të ndryshme.

Allahu disa robërve të vet i ka bërë të pashoq në njohjen e botës shpirtërore si Shah Nakshibendi, dikë tjetër e ka bërë bilbil të dashurisë hyjnore si Junus Emre, dikë tjetër e ka bërë zëdhënës të gjithë evlijave duke i dhënë urtësi në fjalë siç është Mevlana.

Evlijatë përveç predikimit me gjuhën e gjendjes kanë qenë të ngarkuar edhe me shpjegimin e fjalës. Prandaj të dashurit e Allahut vazhdojnë sot e kësaj ditë të udhëzojnë njerëzit me veprat dhe fjalët e urta që kanë lënë pas.

Të dashur lexues!

Po botojmë pjesën e parë të librit urtësi nga të dashurit e Allahut duke shpresuar të shërbejë si një shëtitje në urtësitë e botës shpirtërore. Dëshirojmë të mburjmë zemrat me urtësi dhe këshilla nga njerëzit e dashur të Allahut për një rrugëtim më të lehtë dhe të sigurtë në këtë botë të përkohshme dhe të mbushur me sprova. Duke medituar dhe reflektuar mbi këto urtësi bota e jonë shpirtërore mund të bëhet një pasqyrë që pasqyron bukuritë e botës së tyre shpirtërore. E lusim Allahut të përfitojmë nga bukuritë e botës shpirtërore të tyre.

E lusim Allahun të na bëjë prej atyre që bëjnë vepra të mira dhe prej atyre me të cilët Allahut është i kënaqur. E lusim Allahun të na ringjallë në ditën e gjykimit së bashku me të dashurit tanë.

Amin...

Osman Nuri TOPBASH

Qershor 2013

Üsküdar





LUKMAN

HAKIMI

عليه السلام

-1-

Të synosh qëllime të tjera përveç vullnetit të Allahut në adhurim dhe vepra të mirë, zhduk sinqeritetin dhe bie në batakun e hipokrizisë dhe shirkut. Të synosh përfitime tokësore në veprat e mira dhe adhurime është shkak për pavlefshmërinë e tyre. Të mëkat dhe faj i madh të synosh diçka tjetër përveç Allahut në vepra dhe adhurim.





LUKMAN HAKIMI - 1

Lukman Hakimi është bërë i famshëm përmes urtësive të shumtë. Sipas transmetimeve prejardhjen e largët e ka prej Ejubit (a.s.). Lukman Hakimi ka qenë bashkohës me shumë Pejgabmerë. Lukman Hakimi mund të ketë qenë peygamber ose evlija, shumica e dijetarëve islam janë të mendimit se ai nuk ka qenë një peygamber por një njeri i mirë. Në lidhje me urtësinë e tij Kurani thotë:

Ne i dhamë Lukmanit urtësinë (duke i thënë): “Falënderoje Allahun! Kush është falënderues, e bën për të mirën e vet dhe, kush mohon, ta dijë se vërtet Allahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Denjë për lavdërim”. (Lukman,12)

Urtësia është aftësia për të kuptuar thelbin e gjërave.

Urtësia është të njohësh paaftësinë e mendjes për të kuptuar dhe njohur disa të vërteta. Ka shumë të vërteta dhe të fshehta të cilat nuk njihen përmes mendjes por përmes urtësisë. Të gjitha shfaqjet hyjnore në univers duhet të vlerësohen me syrin e urtësisë.



Nëse nuk do të ishte urtësia shumë të fshehta do të mbetnin të pazbuluara. Pa urtësi nuk do të ishin shumë personalitete shpirtërore.

Lumenjtë e urtësisë rrjedhin vetëm në zemrat që janë pastruar. Besimtari e arrin pastërtinë e zemës në raport të drejtë me dashurinë dhe bindjen ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij.

Qëllimi përfundimtar i diturisë është thellimi në urtësi. Urtësia është të zgjidhësh enigmat e pafundme që Allahu ka shfaqur në Kuran, Univers dhe tek njeriu. Urtësia është të vetëdijeshohesh për madhësitë e Allahut që shfaqet në çdo grimcë të vogël.

Mjekësia studion rregullat që Allahu ka vendosur në trupin e njeriut. Botanika studion rregullat që Allah ka vendosur tek bima, kurse urtësia angazhohet totalisht në të gjitha ligjet dhe rregullat e të gjitha shkencave. Dituria merret vetëm me anën e jashtme të objektit të studimit kurse dituria depërton përtej anës së jashtme. Kjo është e mundur vetëm me dritën që Allahu hedh në zemrën e njerëzve të Tij.

Ai ia jep urtësinë (të kuptuarit e Kuranit) kujt të dojë. Cilitdo që i është dhënë urtësia, vërtet që i është dhënë një mirësi e madhe. Por këtë nuk e kupton tjetërkush, përveç njerëzve të mençur. (Bekare, 269)

Kuptimi i fjalës “urtësi”, është niveli i pjekurisë shpirtërore, e cila fitohet me ngritje shpirtërore pasi janë zotëruar dijet e tjera të natyrës. Pra, aftësia për të vepruar gjithmonë të drejtën, si në fjalë, ashtu edhe në vepra.

“Urtësi”, do të thotë të mund të perceptosh të vërtetën dhe enigmën e materies. Dhe kjo, është e mundur me anë të shfaqjes në zemër të dritës hyjnore. Zemahshëri, si shembull të urtësisë së Lukman Hekimit, na përcjell këtë ndodhi:

Një ditë, Daudi (a.s.), kërkoi nga Lukman Hekimi (a.s.), të priste një dele e t'i sillte dy copa mishi nga vendi më i mirë. Lukman Hekimi (a.s.), e theri delen dhe i çoi Daudit (a.s.), gjuhën dhe zemrën. Pasi kaluan ca ditë, Daudi (a.s.), i kërkoi t'i sillte dy copa nga vendi më i keq. Lukman Hekimi (a.s.), i çoi përsëri gjuhën dhe zemrën. Kur Daudi (a.s.), kërkoi të dinte shkahun, ai iu përgjigj kështu:

“Po të jenë të mira këto të dyja, nuk mund të ketë të tjera më të mira se këto; por, nëse këto të dyja janë të këqija, as të tjerat nuk mund të jenë më të këqija se këto!..” (Zemahsheri, Keshshaf, V, 18.)

Zemra dhe pasqyra e saj gjuha janë dy organet që e çojnë njeriun në fitore ose humbje. Kushti për të qenë Imani i vlefshëm është shqiptimi me gojë dhe pranimi me zemër.

Profeti (a.s.) thotë:

“...Në trup ndodhet një copë mishi, e cila nëse është e mirë, i gjithë trupi është mirë. Por, nëse ajo është e prishur, i gjithë trupi priset. Bëni kujdes! Ajo (copë mishi) është zemra!” (Buhari, Iman, 39)

Njërit prej sahabëve të tij më të zgjedhur, Muadhit (r.a.), i Dërguari i Allahut (a.s.), i tha disa herë me radhë: “Edhe kjo nuk mjafton!”, duke e këshilluar atë që të bënte më shumë. E më në fund i tha:

“A të tregoj për atë që është më e rëndësishme në të gjitha këto?”

“Po, më trego o i Dërguar i Allahut!”, - tha Muadhi (r.a.). Më pas, Profeti (a.s.), kapi gjuhën dhe tha:

“Ruaj gjuhën!” Muadhi (r.a.), pyeti:

“A do të merremi në llogari edhe për ato që flasim?” Ndërsa i Dërguari i Allahut u përgjigj:

“Allahu të dhëntë mirësi o Muadh! Por ajo që i zvarrit (më së shumti) njerëzit me fytyrë përtokë në Xhehenem, është vetëm ajo që del prej gjuhës!¹

Prandaj duhet të kemi shumë kujdes dhe të përgjegjshëm për atë që themi.

Përsëri në lidhje me këtë Profeti (a.s.) thotë:

“Po qe se robi thotë aty për aty një fjalë pa e menduar dhe peshuar mirë, për pasojë, bie në vendin më të largët në mes lindjes dhe perëndimit të xhehennemit!” (Buhari, Rikak, 23)

“Robi thotë një fjalë e cila i pëlqen Allahut, por nuk i shkon ndërmend se me të do të fitojë pëlqimin e Allahut. Kurse Allahu, për shkak të asaj fjale, mbetet i kënaqur prej tij gjer ditën e kiametit, kur robi do të takohet me të! Gjithashtu, robi thotë një fjalë që duhet ndëshkuar nga Allahu, por nuk mendon se ajo fjalë ka për të bërë që ta godasë ndëshkimi i Allahut. Kurse Allahu, për shkak të asaj fjale, e ndëshkon robin gjer ditën e kiametit, kur robi do të takohet me të!” (Tirmidhi, Zuhd, 12; Ibn-i Maxhe, Fitn, 12)

Pra është shumë e rëndësishme të jetë nën kontroll zemra që është vatra e ndjenjave dhe gjuha që është pasqyra e saj.

Në lidhje me këshilla të tilla të shumta, Lukman Hakimi është bërë i njohur dhe urtësitë e tij kanë mbërritur deri tek ne. Urtësitë e tij përmenden në Kuran, hadithe dhe nëpër shumë libra të tjerë historikë.

Në Kuran bëhen të ditura fjalët e urta të Lukmanit dhe këshillat që i ka dhënë të birit:

1. Shih. Tirmidhi, Iman, 8; Ibn-i Maxhe, Fitn, 12.



“(Kujtoje) kur Lukmani i tha të birit, duke e këshilluar: «O djali im, mos i shoqëro Allahut asgjë (në adhurim)! Pa dyshim, idhujtaria është një padrejtësi shumë e madhe!»”

(Lukman, 13)

Padrejtësia, është e kundërta e drejtësisë. Ndërsa drejtësi, do të thotë t'i japësh një qenieje vlerën që meriton dhe ta vendosësh atë në vendin që meriton. T'i bësh ortak Allahut, i Cili është Krijuesit i gjithësisë dhe Pronari i vetëm i gjithçkaje, do të thotë të mos ia japësh Atij vlerën që meriton. Për këtë arsye, rezultati i shirkut (ortakërisë) ndaj Allahut, është qëndrimi përjetësisht në xhehenem.

Besimtari duhet t'i besojë Allahut pa asnjë mëdyshje, besimtari duhet të besojë që gjithçka që ekziston është nën sundimin e Allahut. Teuhidi nuk pranon asnjë lloj shirku.

Ka disa njerëz që thonë: “Besojmë në Allahun dhe në Ditën e Gjykimit!”, por në të vërtetë ata nuk janë besimtarë. Ata përpiqen të mashtrojnë Allahun dhe besimtarët, por në të vërtetë mashtrojnë vetëm vetveten, megjithëse nuk e ndiejnë. (Bekare, 8-9)

Në të vërtetë, Allahu nuk u bën njerëzve asnjë të keqe, por njerëzit i bëjnë keq vetvetes. (Junus, 44)

Në një hadith kudsî thuhet:

“Unë jam larg (më i Larti) prej çdo gjëje që më bëhet shirk (më shoqërohet). Kushdo që bën një vepër dhe bashkë me Mua bën ortak dikë tjetër në atë (vepër), unë do ta lë vetëm për vetëm me shirkun e tij.” (Muslim, Zuhd, 46.)

Profeti (a.s.) i këshillon kështu sahabët:

“Më shumë, në lidhje me umetin tim, më frikëson shirku.

Me fjalën shirk nuk nënkuptoj adhurimin e hënës, të diellit apo adhurimin e idhujve, por kam parasysh çdo vepër që bëhet për çdo qëllim tjetër përveçse për të fituar kënaqësinë e Allahut, dhe egon e fshehtë (dëshira për t'u shfaqur e dukur).” (Ibn Maxhe, Zuhd, 21)

Hipokrizia është një sjellje që nuk mund të përputhet kurrë me besimin. Njeriu që beson, duhet të jetë i sinqertë dhe i drejtë si në marrëdhëniet me Allahun, ashtu edhe në marrëdhëniet me njerëzit. Përndryshe, ai përballlet me rrezikun e ngjasimit me hipokritët. Në Kuranin Fisnik, hipokritët qortohen në mënyrë serioze për shkak se ata i kryejnë vetëm për t'u dukur adhurimet si namazin, zekatin dhe sadakanë. Ato adhurime që nuk kryen me sinqeritet të pastër vetëm për Allahun janë të pavlera.

“Ditën e Kiametit, personi i parë që do të japë llogari, do të jetë dëshmori (shehidi, martiri). Ai do të sillet para Zotit, i Cili do t'i kujtojë dhuntitë që i ka dhënë. Dëshmorit do t'i kujtohen dhe do t'i pohojë. Atëherë Allahu do ta pyes:

«Mirë, por çfarë bëre në këmbim të këtyre?»

«Luftova në rrugën tënde gjersa rashë dëshmor në rrugën Tënde!» - I përgjigjet personi. Allahu i thotë:

«Po gënjen! Ti luftove që njerëzit të të përmendin për hero dhe ashtu ndodhi!»

Pastaj jepet urdhër dhe ai person hidhet me fytyrë në Xhehenem. Pas tij, para Allahut sillet një person që ka marrë dituri, që u ka dhënë mësim të tjerëve dhe ka kënduar Kuran. Allahu i kujton atij dhuntitë që i ka dhënë dhe i dituri i kujton e i pohon ato. Më pas Allahu e pyet:

«Mirë, por çfarë bëre në këmbim të këtyre të mirave?»

«Mësova dituri, ua mësova edhe të tjerëve dhe këndova Kuran për kënaqësinë Tënde!» - I përgjigjet personi. Allahu i thotë:

«Po gënjen! Ti mësove dituri që të thonë për ty se sa i ditur je, dhe këndove Kuran që të thonë se sa bukur këndon. Dhe, të gjitha këto u thanë!»

Edhe për të jepet urdhër, dhe ai hidhet me fytyrë në Xhehenem. Pastaj sillet një person të cilit Allahu i kishte dhënë çdo mundësi materiale dhe pasuri. Allahu ia kujton dhuntitë dhe ai i kujton e i pohon. Më pas Allahu e pyet:

«Mirë, por çfarë bërë në këmbim të këtyre të mirave që të janë dhënë?»

«Nuk u kurseva të jap nga pasuria në të gjitha ato vende që ti i pëlqen, dhe shpenzova vetëm për të fituar kënaqësinë Tënde!» - I përgjigjet personi. Allahu i thotë:

«Po gënjen! Ti i bërë të gjitha këto që të thonë se sa bujar je!». Dhe, kjo u tha!»

Edhe për të jepet urdhër, dhe ai hidhet me fytyrë në Xhehenem.” (Muslim, Imare, 152)

Pra shirku i fshehtë edhe veprat më të vyera i bën të pavlera duke u bërë shkak për të përfunduar në Xhehenem. Prandaj besimtari duhet të jetojë gjithmonë me vetëdijen e ajetit kuranor:

Thuaj: “Unë jam vetëm një vdekatar si ju, që më është shpallur se Zoti juaj është një Zot i Vetëm. Kështu, kush shpreson takimin me Zotin e vet, le të bëjë vepra të mira dhe të mos i shoqërojë askënd në adhurim Zotit të vet!” (Kehf, 110)

Lukmani thotë:

“O djali im! Allahu do ta nxjerrë në shesh edhe veprën që peshon sa kokrra e sinapit që ndodhet në shkëmb, në qiej apo në tokë. Me të vërtetë, Allahu njuh mirë çdo imtësi dhe i di të gjitha fshehtësitë. O djali im! Kryeje namazin, urdhëroje të mirën, pengoje të keqen dhe bëhu i durueshëm për çfarëdo që të godet! Me të vërtetë, ky është thelbi i patundur i të gjitha punëve!” (Lukman, 16-17)

Në ajete të tjera Kurani thotë:

O Zoti ynë, Ti e di vërtet çfarë fshehim e çfarë shfaqim haptazi. Allahut nuk i fshihet asgjë, as në Tokë, as në qiell.

(Ibrahim, 38)

Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë, 8. e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë. (Zelzele, 7-8)

Allahu në mënyrë që të veprojmë vetëm punë të mira e ka fshehur se në cilën vepër të mirë është dashuria dhe falja. Ndonjë herë dashuria dhe mëshira e Allahut është në një vepër shumë të madhe, ndonjëherë në një vepër mesatare dhe ndonjëherë është e fshehur në një vepër në dukje shumë e parëndësishme. Prandaj asnjë vepër e vogël nuk është e parëndësishme. Allahu nuk e humb asnjë vepër të mirë e bërë haptas ose fshehurazi. Besimtari duhet të tregojë kujdes të jetë gjithmonë i gatshëm për vepra të mira dhe të bëjë përpjekje të qëndrojnë sa më larg veprave të këqija.

Po ashtu në mënyrë që të mbrohemi nga të gjitha veprat e këqija e ka fshehur se në cilën ndodhet zemërimi i Tij. Nganjëherë zemërimi hyjnor ndodhet në një mëkat të madh, nganjëherë në një mëkat mesatar dhe nganjëherë në një mëkat të vogël. Prandaj Neglizhimi i mëkateve të është një mashtrim i madh.

Profeti (a.s.) ka thënë:

“Ruhuni prej gjynaheve që duken të vogla, sepse ato mbliidhen tek dikush dhe në fund e shkatërrojnë atë!” (Ahmed, I, 402-403; V, 331)

Një i urtë ka thënë:

Nëse nuk hiqet dorë prej mëkateve të vogla por vazhdohet me kryerjen e tyre ato nuk mbesin më të vogla për shndërrohen të mëdha.

Bilal bin Sa'd ka thënë:

“Mos shih vogëlsinë e gjynahut, por kundër kujt e bën atë gjynah!”

Lukmani thotë:

“Unë urtësinë e mësova nga të verbrit. Sepse ata nuk hedhin asnjë hap pa e kontrolluar më parë vendin me bastunët e tyre.

Nëse me mëkatet me të cilat përballemi gjatë gjithë jetës nuk bëhet kujdes në këtë botë, në ditën u gjykimit ato janë si një bombë për ne. Çdo veprim dhe sjellje që bëhet pa menduar nëse është haram apo hallall është si një bombë me saat ditën e gjykimit.

Besimtari në çdo punë që bën duhet të shikojë a është e përshtatshme me kriteret hyjnore apo jo. Nëse është e dobishme për këtë botë dhe botën tjetër e vepron në të kundër heq me njëherë dorë prej saj. Besimtari nuk merr asnjë ushqim pa u siguruar nëse është hallall apo haram.

Rrumiu thotë:

“Edhe qeni madje nuk e ha një kockë apo ushqim pa e nuhatur.”

Pra vrapimi pas interesit pa bërë asnjë dallim midis haramit, hallallit, të mirë, të keqes, të drejtës dhe të shtrembrës, e çon njeriun në një nivel më të ultë se kafsha.

Përsëri Rrumiu thotë:

“Edhe një verbër e kupton që ka lindur dielli nga nxehtësia”.

Pra ai që nuk tregon kujdes dhe ndjeshmëri ndaj kritereve hyjnore është i verbër shpirtërisht. Zemra e tij është përfshirë nga një neglizhencë e tillë që e ka bërë atë si të vdekur.

Omer ibn Abdulazizi thotë:

“Haramet janë një zjarr! Atyre u zgjasin dorën vetëm ata që janë (me zemër) të vdekur. Nëse ata që u zgjasin dorën do të ishin të gjallë, do ta ndjenin djegien e atij zjarri.”

Besimtari duhet të eci në këto botë sprovash si në një parcelë të minuar. Duhet të ketë shumë kujdes se ku e hedh hapin. Sepse Allahu kërkon prej nesh të bëjmë një jetë plot devocion.

Ky përshkrim i Omerit (r.a.) e tregon shumë bukur natyrën e devocionit.

Një ditë, Omeri (r.a.), e pyet Ubej bin Ka'bin (r.a.), se “Ç’është devotshmëria?” Ubej (r.a.) i tha:

“O Omer! A ke ecur ndonjëherë në një rrugë me gjemba?”

Omeri (r.a.) u përgjigj:

“Po, kam ecur.” Atëherë Ubej (r.a.), e pyet përsëri:

“Po mirë, çfarë bëre?” Omeri (r.a.) u përgjigj kështu:

“Përvesha rrobën time dhe bëra shumë kujdes për t’u ruajtur nga gjembat.” Atëherë Ubej (r.a.) thotë:

“Ja pra, kjo është devotshmëria!”

Shfaqja më domethënëse e devotshmërisë është largimi prej shirkut, mosbesimit dhe hipokrizisë siç largohemi prej zjarrit dhe zbatimi me përpikëri i urdhëresave hyjnore.

Lukmani thotë:

O bir! Mos e preokupo zemrën me mendime negative dhe shqetësime të ndryshme! Qëndro larg babëzisë! Kënaqu me caktimin! Ji i kënaqur me atë që të ka dhënë Allahu në mënyrë që të zbukurohet jeta, të mbushet zemra me gëzim dhe të shijosh lumturinë e kësaj jete.”

Allahut thotë në Kuran:

Për sa i përket njeriut, kur Zoti i tij e sprovon atë, duke e ngritur lart dhe duke i dhënë mirësi, ai thotë: “Zoti im më ka nderuar.” Por, kur e sprovon atë, duke ia ngushtuar mjetet e jetesës, ai thotë: “Zoti im më ka poshtëruar”. (Fexhr, 15-16)

Në peshoren hyjnore në ahiret, do të bëhet e qartë se çfarë ka qenë më e mirë për njeriun, mirësitë e pakta apo të shumta. Kjo, sepse mirësia e paktë, ka më pak përgjegjësi, ndërsa mirësitë e shumta kanë më tepër. Në fakt, për njeriun i cili nuk mund t'i kuptojë siç duhet urtësitë dhe të fshehtat e caktimit hyjnor, është më mirë që t'i dorëzohet caktimit të Allahut.

Të pranosh me kënaqësi ngjarjet dhe ndodhitë të që japin gëzim dhe të refuzosh me përbuzje ngjarjet dhe ndodhitë që të shkaktojnë shqetësime dhe dhimbje nuk i përshtatet edukatës së adhurimit. Pa arritur një pjekuri shpirtërore është shumë e vështirë për të shpëtuar prej kësaj. Kur shpirti arrin gradën Radije, njeriu tregon dorëzim të plotë përballë çdo verdikti që ka dhënë Allahu për të. Ai në asnjë mënyrë nuk ankohet për gjendjen e tij. Në lidhje me këtë Allahu thotë në Kuran:

O ti shpirt i qetësuar! Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai kënaqur me ty! Bashkohu me robërit e Mi dhe hyr në Xhenetin Tim! (Fexhr, 27-30)


Kushti kryesor i lumturisë është ta vendosësh mendjen nën udhëzimin e shpalljes, ta zbukurosh zemrën me moral të bukur dhe të jesh i kënaqur me caktimin e Allahut. Të tregohet durim dhe të bëhet përpjekje për të gjitha ndodhitë dhe fatkeqësitë me të cilat mund të përballemi në jetë. Gjithmonë duhet të jemi optimistë edhe në situatat e vështira të mendojmë mirësitë e fshehura në të. Të gjitha këto arrihen duke iu mbështetur plotësisht Allahut.

Rrumiu thotë:

“Bota jote e brendshme është si një strehë mysafirësh. Gëzimet e hidhërimet hyjnë e dalin. Mos u mashtro nga gëzimet, e as mos u mërzit nga hidhërimet! Mos u mërzit nëse pikëllimet pengojnë lumturinë tënde! Sepse nëse duron pikëllimet sot, ata janë lajmëtarë të gëzimit dhe lumturisë së të ardhmes”.

Na bëftë Allahu prej atyre që dorëzohen Atij plotësisht dhe që qëndrojnë larg kurtheve të egos dhe shejtanit. I lutemi Allahut të na bëjë prej atyre që janë të kënaqur me caktimin e Tij qoftë mirësi qoftë vështirësi.

Amin...



LUKMAN

HAKIMI

عليه السلام

-2-

Për arsye se njerëzit e devotshëm të Allahut e shohin çdo krijesë me syrin e urtësisë, tek ata nuk gjendet “shikimi” i rëndomtë ndaj mrekullive të gjithësisë, ashtu siç gjendet tek njerëzit e tjerë indiferentë.

Ata shohin gjethet dhe lulet shumëngjyrëshe të bimëve që dalin nga e njëjta tokë, natyrën e tyre, frutat e ndryshme në ngjyrë, aromë, shije e formë dhe dizajnin e mrekullueshëm në krahëve e fluturave. Po ashtu, ata u vënë veshin “hu-hu”-ve që lëshojnë kumritë, vërejnë detajet e mrekullueshme në krijimin e njeriut dhe mahniten pas mrekullive hyjnore siç janë shikimi i syrit dhe perceptimi i trurit. Ata thellohen në meditimën e këtyre veprave hyjnore njësoj siç shohin me ëndje horizontin e pafund.



LUKMAN HAKIMI - 2

Lukmani thotë:

Biri im! Urtësia i ul njerëzit përkrah mbretërve. (Ahmed, ez-Zuhd, fq. 87, nr: 537)

Urtësia është ushqim për shpirtin. Ashtu si trupi ka nevojë për ushqim edhe shpirti kanë nevojë për urtësinë në mënyrë që të gjejë qetësi dhe të arrijë pjekurinë e duhur.

Zbrazëtinë shpirtërore të krijuar nga mungesa e urtësisë nuk mund ta mbushë asnjë lloj mirësie dhe mirëqenieje materiale edhe sikur të zotërosh gjithë pasurinë e botës. Në fakt ata që kanë pozitë, përgjegjësi dhe pasuri të madhe kanë shumë nevojë më shumë se të gjithë për urtësinë e njerëzve të urtë për të ruajtur ekuilibrin dhe drejtimin në rrugën drejt adhurimit të Allahut. Sepse rrethi shoqërorë që i rrethon ata për shkak të frikës së humbjes së përfitimeve dhe interesit material nuk guxojnë të thonë të vërtetën. Kurse njerëzit e urtë kujdesen të jenë mirë me Allahun. Ata janë të mbrojtur nga kurthet e pasurisë dhe pozitës tokësore. Prandaj ata nuk hezitojnë të thonë të vërtetën



përballë drejtuesve. Sepse ata mendojnë të ruajnë botën tjetër, ata janë si një doktor që për të shëruar një të sëmurë nëse është e nevojshme jep edhe ilaçe shumë të forta.

Sipas një transmetimi, Harun Rashidi një ditë i thotë një miku të ngushtë:

Më është ngushtuar zemra nga angazhimet shtetërore, më dërgo tek një person, pranë të cilit të gjejë qetësi.

Edhe ai e dërgoi Kalifin me sugjerim të Sufjan ibn Ujejnit tek Fudaj ibn Ijad. Kur mbërritën tek shtëpia e Faudjalit trokitën derën, Fudajli nga brenda thirri:

Kush është? ata thanë

Është prijësi i besimtarëve

Fudajli tha:

Çfarë kërkon tek unë prijësi kur ka gjithë ato punë shtetërore dhe publike për të kryer?

Miku i ngushtë i Fudajlit tha:

Bindja ndaj prijësit është detyrim. Tani na thuaj të hyjmë me lejen tënde apo me urdhrin e prijësit?

Fudajli tha:

Leje nuk ka nëse hyni me urdhër atëherë ju e dini...

Kalifi hyri brenda dhe kërkoi këshillë prej Fudajlit. Fudajli i tha:

Gjyshi jot i cili ishte xhaxhai i Profetit (a.s.) i kërkoi Profetit (a.s.) ta bënte prijës në një vend. Profeti (a.s.) i tha:

“Të kam emëruar prijës të vetes tënde.” Me këtë donte të thoshte se: një frymë jetë në bindje të Allahut është më mirë



se të jesh një mijë vjet një prijës neglizhent dhe indiferent ndaj mësimëve hyjnore.

Harun Rashidi tha: Më këshillo më tepër!

Fudajli në vijim tha:

Omer ibn Abdulazizi kur u zgjodh kalif i shkroi nga një letër dijetarëve të kohës si Muhamed ibn Kab, Rexha ibn Hajje dhe Salim ibn Abdullah. Në letër shkruhej:

“Siç e dini jam nën një përgjegjësi shumë të madhe dhe i sprovuar me këtë pozitë shumë të vështirë. Ju lutem më ndihmoni! Më këshilloni për gjithçka!”

Muhamed ibn Kab i shkroi këtë këshillë:

“Halife! Nëse dëshiron që në ditën e kijametit të shpëtosh nga kjo përgjegjësi, të moshuarit pranoji si prind, të rinjtë si vëllezër kurse të vegjlit si fëmijët tuaj. Prindit jepi mirësi, vëllait mëshirë dhe fëmijës dhembshuri. Atëherë je sjell me të gjithë muslimanët siç sillet një person me prindin, vëllain dhe fëmijën e tij në shtëpi.”

Harun Rashidi i kërkoi të vazhdonte me këshilla.

Fudajli tha:

Bota islame është shtëpia jote, të gjithë njerëzit në këtë vend janë pjesëtarë të familjes tënde. Ashtu si sillesh me babain, vëllain dhe fëmijët tuaj ashtu sillu me të gjithë njerëzit. Vizito ata që janë si babai jot, bëji mirësi atyre që janë si vëllezërit tuaj dhe tregohu bujarë ndaj atyre që janë si fëmijët tuaj.

Pastaj vazhdoi kështu:

O prijës! Kam frikë se kjo fytyrë e bukur ka për t’u djegur në zjarrin e xhehenemit. Sa shumë fytyra të bukura në këtë botë



do të digjen në zjarrin e xhehenemit. Sa shumë prej tyre që janë prijës këtu do të jenë sklevër atje!

Harun Rashidi i kërkoi përsëri këshillë.

Tha: Ki frikë Allahun!.. sepse në ditën e gjykimit do të japësh llogari para Allahut për çdo musliman që ke nën sundim. Atje do të kërkohet prej teje t'i japësh hakun. Nëse, qoftë edhe një natë të vetme, një e moshuar bien gjumë e uritur në ditën e gjykimit do të jesh në pozitën e të pandehurit.

Harun Rashidi para se të ndahej prej aty e pyeti Fudajlin nëse kishte borxhe apo jo.

Fadua jli iu përgjigj:

Po, kam shumë borxhe falënderimi dhe dhikri kundrejt Allahut që më ka dhënë kaq shumë mirësi. Ai më ka udhëzuar dhe detyra ime është ta falënderoj. Mjerë unë nëse tregohem neglizhent në kthimin e këtij borxhi.

Harun Rashidi i tha: Nuk po të pyes për borxhin ndaj Krijuesit por për borxhin ndaj njerëzve.

Fudajli tha:

Falënderoj Allahun, por unë noto j në mirësi nuk kam asnjë kërkesë nga njerëzit.

Me këtë fjalë Fudajli sikur donte të thoshte: jam i lumtur dhe i kënaqur me caktimin hyjnor. Çdo gjë që vjen prej Allahut është e mirë për mua. unë kam turp të anko hem tek njerëzit për atë që më ka caktuar Allahu.

Haruni nxorri një gese me flori dhe ia vendosi para duke i thënë: Këto janë trashëgim nga nëna, janë hallall.

Fudajli tha:



Harun! Unë dëshiroj shpëtimin tënd kurse ti më ngarko më një barrë të rëndë. Unë të them ke detyrime mbi njerëzit që ke nën sundim, janë të tjerë që kanë të drejta më shumë se unë mbi ato para siç janë të varfrit, jetimët, të dobëtit dhe të vobektët kurse të drejtën e tyre kërkon të ma japësh mua.

Pas kësaj Harun Rashidi doli jashtë dhe tha:

Fudajli është me të vërtetë një prijës Xheneti.

Këta njerëz të urtë që nuk kanë vendosur asgjë para ahiretit, Allahu i ka dhuruar urtësi dhe i ka bërë që shumë sundimtarë të shkojnë pas tyre.

Të parët tanë i kanë vendosur në pedestal dijetarët dhe të urtët. Dhe për sa kohë sundimtarët kanë përfituar prej tyre është shënuar vetëm zhvillim dhe përparim. Mos të harrojmë që pranë Osman Gazit ishte Sheh Edebali, pranë Sulltan Fatihut Akshemsedini dhe pranë Sulltan Ahmedit Aziz Mahmud Hydaji. Ata kanë luajtur një rol të madh në ruajtjen e ekuilibrit midis materiales dhe shpirtërores midis kësaj bote dhe botës tjetër.

Kjo ngjarje është shembull tipik i kësaj që përmendëm:

Sulltan Selimi i Rreptë ishte një sundimtar jashtëzakonisht i ashpër e i rreptë ndaj veprimeve të gabuara dhe indiferente. Vetëm se si rreptësia, ashtu dhe bukuria e tij shkriheshin e zhdukeshin brenda kornizës së sheriatit. Një herë, për shkak të vjedhjeve të kryera në thesar si pasojë e nënvleftësimeve, kishte urdhëruar ekzekutimin me vdekje të afro dyzet vetëve. Ndërkaq, shejhulislami Zenbil'li Ali Efendiu i cili e kishte mësuar situatën, me qëllim për ta penguar zbatimin e vendimit, hyri tek sulltani me nxitim dhe pa marrë leje. Ai iu lut sulltanit t'ia tregonte vetë se si qëndronte puna. Sulltani i tha me të ashpër:

“Hirësia juaj! Eshtë ashtu siç e keni dëgjuar, por ju s’keni të drejtë të përziheni në punët e shtetit!”

Atëherë, shehulislami Zenbil’li Ali Efendi ia ktheu sulltanit me të njëjtën ashpërsi:

“Sulltani im! Unë erdha t’jua bëj të ditur vendimet ligjore të sheriatit, sepse detyra jonë është ta mbrojmë të ardhmen tuaj shpirtërore...”

I qetësuar përballë maturisë më të hollë se qimja e më të mprehtë se shpata, të sheriatit, Selimi i Rreptë e pyeti:

“A nuk lejohet që, për hir të përmirësimit të gjendjes së përgjithshme, të vriten një pakicë prej disa vetash?”

Zenbil’li Ali Efendiu iu përgjigj:

“Mes vrasjes së këtyre dhe interesit të përgjithshëm nuk ka ndonjë lidhje! Atyre u duhet dhënë dënimi sipas fajit që kanë bërë!”

Sovrani i cili kishte përgjunjur ushtri të mëdha, përkuli kokën dhe e mori prapë vendimin. Ndërsa shejhulislami i kënaqur shumë prej kësaj, po bënte për të dalë, u kthye përsëri dhe i tha kështu Selimit të Rreptë që po e vështronte me kureshtje:

“Sulltani im! Kërkesa ime e parë ishte t’ju tregoja sheriatin. Kam edhe një kërkesë tjetër e cila është thjesht një lutje...”

Dhe vazhdoi:

“Sulltani im! Faji i këtyre mëkatarëve u përket vetëm atyre, prandaj, sa kohë që të ndodhen në burg, kush do t’ua shohë familjet? Prandaj, lutja ime për ju është t’u lidhni nafaka familjeve të tyre gjersa ta kryejnë dënimin që do t’u jepet!”

Selimi i Rreptë që e çoi në vend edhe këtë kërkesë, pa



dyshim që zbatonte domosdoshmërinë e përgjegjësisë hyjnore për të cilën ishte i vetëdijshëm!

Durimi dhe nënshtrimi i treguar ndaj një personi dijetar dhe shpirtëror prej një trimi të çartur si Selimi i Rreptë, i papërmbajtur në zemërim, i cili kurrë nuk njihte përjashtime ndjenjash e respekti në punët e shtetit, ishin një virtyt i lartë dhe i veçantë i tij! Një shembull tjetër i ngjashëm është edhe ky:

Sulltan Selimi i Rreptë dhe ushtria e tij të rrethuar nga ndihma dhe mëshira hyjnore, në rrethinat e qytetit Adana i zuri një shi i furishëm. Gjithandej vendi u kthye në det balte. Sulltan Selimi i Rreptë me Kemal Pashazadenë, njërin prej dijetarëve të njohur të kohës, po ecnin mbi kuaj pranë e pranë duke kuvenduar. Papritmas, kali i Kemal Pashazadesë u tremb dhe balta e spërkatur nga këmba e kalit të trembur e përleu sulltanin kokë e këmbë!

Kemal Pashazade u dëshpërua shumë. Fytyra iu zbeh. Kurse Selimi i Rreptë, duke u kthyer nga ai, i tha me fytyrë të qeshur:

“Balta e spërkatur mbi trupin tonë nga këmba e kalit të dijetarit, është nder për ne! Është e bekuar! Kur të vdes, këtë kaftan të përbaltur të ma shtroni siç është mbi sëndukun (tabutin) tim!”

Selimin e Rreptë e shohim një luan në shkretëtirën e frikshme të Sinait, një besimtar kokulur, sy përlotur dhe falënderues duke hyrë në Egjipt, i kredhur në kënaqësi hyjnore dhe shpirtërore që e orientojnë për larje llogarish me vetveten, në Yskydar!

Sulltan Javuz Selimi, kuptimin e sundimit të vërtetë e shpreh me këto fjalë:

Të jesh mbreti i botës, qenka një luftë e pavlerë;

Të jesh shërbëtor i një evlijaje, qenka më mirë se gjithçka...

Pa dyshim, ashtu si shumë sulltanë të tjerë, edhe sulltan Selimi i Rreptë i cili tregonte një respekt dhe besnikëri të lartë ndaj evlijave, ishte një rob i thjeshtë i Allahut! Ai ishte një sultan që preferonte një evlija që ta orientonte në jetë se sa gjithë mirësitë e kësaj bote.

Rrumiu thotë:

Të jesh skllav i një miku të Allahut është më mirë se të jesh mbret i mbretërve.

Sepse sa do mbret i famshëm dhe madh të jesh në përfundim është i përkohshëm, kurse lumturia që arrihet nga këshillat dhe frymëzimet e evlijave arrihet lumturia e përhershme.

Kënaqësia shpirtërore në jetën Osmane e cila përfshinte të gjithë shoqërinë që nga një njeri i thjeshtë deri te padishahu. Kur shkonin dhe vinin nga ceremonia e së premtes, Sulltanët Osmanë, duke i urdhëruar ushtarët e tyre me pagesë që t'u thoshin:

“Mos ji mendjemadh o padishah, Allahu është më i madh se ti!..”, e kishin sjellë në një gjendje tradite zyrtare këtë qortim që u bëhej.

Lukmani thotë:

“Biri im! Qëndro me të diturit dhe përpiku të mos ndahesh prej tyre! Dëgjoji fjalët e të urtëve, sepse Allahu i Madhëruar i ringjall zemrat me dritën e urtësisë, ashtu siç e ringjall tokën me begatinë e shiut.” (Hejthemi, I, 125.)

Çdo njeri kanë nevojë për një dritë udhëzuese që do të orientojë dhe drejtojë drejt mirësisë dhe të vërtetës. Kjo është e nevojshme më shumë se kurrë sot kur ideologjike materialiste e nxit njeriun të vrapojë pas kënaqësive të kësaj bote duke rrezikuar në këtë mënyrë gjithë botën shpirtërore. Shumë njerëz janë duke e humbur drejtimin për shkak se nuk gjejnë dot një njeri që t'i këshillojë për mirësi. Shumë njerëz janë të zhytur në batakun e materializmit për shkak se nuk janë orientuar në burimet e pastra.

Rrumiu e përshkruan kështu gjendjen e rëndë të atyre që mashtrohen nga kënaqësitë e kësaj bote:

“Allahu na sprovon me pasurinë e kësaj bote; ajo na deh dhe na mashtron. Për këtë arsye njerëzit që janë të dhënë pas kësaj bote janë të verbër. Ato pinë ujin e kripur e të ndotur të kënetës.”

Hapja e syrit të zemër së atyre që janë mashtruar nga kënaqësitë e kësaj bote duke u zhytur në këtë mënyrë në batakun e mëkateve, është e mundur vetëm përmes qëndrimit me njerëz të mirë dhe besimtarë të devotshëm.

Rrumiu e shpreh kështu këtë të vërtetë:

Kush dëshiron të jetë afër me Allahun të qëndrojë afër njerëzve të mirë. Nëse qëndron larg njerëzve të mirë je i destinuar të rrënohesh.

Urtësia që është një mjet për ringjalljen shpirtërore duke depërtuar thelle në urtësinë e shkaqeve të ekzistencës, i bën të mundur njeriut të kalojë nga vepra tek krijuesi dhe nga arti tek artisti. Urtësia është të marrësh mesazhe nga çdo gjë në ekzistencë dhe t'i deshifrosh ato në botën e zemrës. Çdo mendje dhe arsyeje që nuk të çon tek Krijuesi është e mangët.





Prandaj është e domosdoshme të reflektojmë dhe të thellohem në fjalët dhe sjelljet e urta. Në këtë mënyrë besimtari e mban gjallë vetëdijen e adhurimit. Kjo është arsyeja që pejgamberët përveç detyrës së predikimit dhe pastrimit kanë pasur edhe detyrën e mësimi të urtësisë dhe librit.

Burimi absolut i urtësisë është Allahu. Kalimi i urtësisë në zemër është i mundur në saje të veprave të mira dhe një jete me devocion. Profeti (a.s.) në një hadith kudsî thotë:

“Kush armiqësohet me një prej robërve të Mi të dashur, unë do t’i shpall luftë atij. Robi Im, nuk mund të më afrohet me asnjë gjë tjetër më të dashur se punët që ia kam bërë farz/të detyrueshme. Robi Im (përveç farzeve) mundohet të më afrohet vazhdimisht me adhurime vullnetare. Më në fund, Unë e dua atë. Kur Unë e dua robin Tim, bëhem veshi që dëgjon, syri që shikon, dora me të cilën mban, këmba me të cilën ecën, zemra me të cilën kupton dhe gjuha me të cilën flet. Çfarëdo që të kërkoj prej Meje, ia jap patjetër. Nëse strehohet tek unë, e mbroj atë.” (Shih. Buhari, Rikak, 38; Ahmed, VI, 256; Hejthemî, II, 248)

Përsëri në një hadith tjetër thotë:

Kush i drejtohet Allahut dyzet ditë me sinqeritet, prej gojës dhe zemrës së tij fillon të rrjedhë burim urtësie. (Sujuti, Xhamiu’ s-Sagîr, II, 137/8361)

Bota shpirtërore e njerëzve të tillë për shkak të afrisë me Allahun është një pasqyrë.

Për arsye se njerëzit e devotshëm të Allahut e shohin çdo krijesë me syrin e urtësisë, tek ata nuk gjendet “shikimi” i rëndomtë ndaj mrekullive të gjithësisë, ashtu siç gjendet tek njerëzit e tjerë indiferentë.



Çdo grimcë në këtë gjithësi, i flet njeriut me zemër të gjallë. Të gjitha qeniet flasin vazhdimisht me gjuhë e tyre. Në gjithësi s'ka asnjë grimcë që s'e njeh Krijuesin e vet. I gjithë krijimi bart vullën e fuqisë së Krijuesit të Madhëruar, i Cili i krijoi nga asgjëja. Detyra e njeriut është të thellohet në meditimin e manifestimit të fuqisë dhe madhështisë hyjnore dhe të shohë këto vula hyjnore me syrin e urtësisë për të marrë mësim.

Të dashurit e Allahut, të cilët kanë një botë të gjerë zemre, veprat e artit hyjnor në gjithësi, nuk i shohin në mënyrë sipërfaqësore, por sikur shohin një oqean të thellë. Dhe, duke vërejtur oqeanet e fshehtë në një pikë, ata përparojnë në atmosferën shpirtërore. Diellin që lind, si manifestim i fuqisë hyjnore dhe tablotë shumëngjyrëshe që pikturojnë rrezet e diellit në perëndim, ata i vështrojnë me habi e admirim. Dhe, duke shfletuar fletët e gjithësisë, ata magjepsen pas njëmijenjë mistereve dhe urtësive.

Ata shohin gjethet dhe lulet shumëngjyrëshe të bimëve që dalin nga e njëjta tokë, natyrën e tyre, frutat e ndryshme në ngjyrë, aromë, shije e formë dhe dizajnin e mrekullueshëm në krahëve e fluturave. Po ashtu, ata u vënë veshin “hu-hu”-ve që lëshojnë kumritë, vërejnë detajet e mrekullueshme në krijimin e njeriut dhe mahniten pas mrekullive hyjnore siç janë shikimi i syrit dhe perceptimi i trurit. Ata thellohen në meditimin e këtyre veprave hyjnore njësoj siç shohin me ëndje horizontin e pafund.

Për të dashurit e Allahut universi është si një libër që duhet lexuar. Ata e kanë tejkualuar diturinë e librit duke arritur në diturinë e zemrës. Prandaj meditimi dhe reflektimi mbi fjalët e tyre i jep njeriut një gjallëri shpirtërore.

Lukmani thotë:

Biri im! Kam mbartur gurë dhe hekur por nuk kam parë gjë më të rëndë se fqinji i keq.” (Ahmed, Zuhd, fq.86, nr 533)

Fytyra e vërtetë e njeriut shfaqet në situata të vështira. Kur Omerit (r.a.) një person i lëvdoi dikënd i tha:

A e ke fqinjë, a ke bërë udhëtim me të, a ke bërë tregti bashkë me të?

Kur personi tha nuk kam bërë asnjërën,

Omeri (r.a.) i tha:

Ti e ke parë atë në xhami duke lexuar Kuran prandaj e lëvdon. Po tha personi.

Atëherë mos e lëvdo shumë sepse sinjeriteti i njeriut nuk është në tundjen e kokës gjatë leximit të Kuranit.

Omeri në këtë rast vendos si kriter për të dhënë një gjykim mbi një person, veprat dhe marrëdhëniet sociale të tij. Të japësh një vlerësim pozitiv për një person që nuk ka kaluar nga sprova e interesit është një veprim i gabuar.

Fqinjësia është një nga ato që e nxjerr në pah natyrën e vërtetë të njeriut. Njeriu mund të largohet nga personi i keq por largimi nga komshiu nuk është i lehtë. Prandaj është shumë e rëndësishme të zgjidhet një komshi i mirë. Proverbi thotë mos merr shtëpi por merr komshi.

Profeti (a.s.) thotë:

Kërkoni mbrojtje tek Allahu nga komshiu i keq në vendbanimin e përhershëm! Nëse jeni endacakë çështja është më e lehtë sepse pas një kohe komshiu largohet. (Nesai, Istiadhe, 44)

Ebu Bekri (r.a.) thotë: Mos u grind me Komshiun, sepse mysafiri ikën kurse ai qëndron.



Të gjithë njerëzit dëshirojnë të kenë fqinjë të mirë prandaj është e rëndësishme që fillimisht ne të jemi komshinjtë të mirë, pastaj të përpiqemi të gjejmë komshinjtë të mirë.

Profeti (a.s.) në lidhje me të drejtat e komshiut thotë:

“Xhebraili më porositi aq shumë për t’i bërë të mirë komshiut, saqë pandeha se ka për ta bërë komshiun trashëgimtar të komshiut!” (Buhari, Edeb, 28; Muslim, Birr, 140-141)

Të shqetësosh fqinjin është një dobësi e madhe në iman. Komshinjtë duhet të jenë të kujdesshëm në marrëdhënie me njëri-tjetrin.

Sipas një hadithi profetik të transmetuar nga Ebu Hurejre (r.a.), një ditë, Profeti (a.s.) pati përsëritur tri herë:

“Vallahi, nuk beson! Vallahi, nuk beson! Vallahi nuk beson!”

Sahabet e pyetën:

“Kush nuk beson, o i Dërguari i Allahut?”

“Personi, fqinji i të cilit nuk ka siguri se është i mbrojtur nga të këqijat që mund t’i bëjë ai!” - U përgjigj i Dërguari i Allahut. (Buhari, Edeb, 29)

Kurse sipas një rrëfimi tjetër, Profeti ka thënë:

“Personi, fqinji i të cilit nuk ka siguri se është i mbrojtur nga të këqijat që mund t’i bëjë ai, nuk hyn në xhennet!” (Muslim, Iman, 73)

Çështja e fqinjit është aq e rëndësishme sa që nuk mbetet e kufizuar vetëm në këtë botë. Ashtu si në jetë është e rëndësishme të qëndrosh pranë njerëzve të mirë, edhe në varr të jesh fqinjë me njerëz të mirë është shumë e rëndësishme.

Profeti (a.s.) thotë: “Të vdekurit tuaj varroseni pranë njerëzve të mirë.” (Dejlemi, I, 102)

Të parët tanë duke ndjekur këtë këshillë varrezat ku janë varros njerëz si Ejub Sulltani janë bërë si qytete për nga madhësia.

Muslimani është përgjegjës për komshiun. Prandaj në jetën shoqërore duhet të tregojmë durim ndaj disa gjërave që nuk mund të na pëlqejnë. Një nga njerëzit që do Allahu është edhe ai që duron vështirësitë që nxjerr komshiu. Mos të harrojmë që një nga njerëzit që Allahu i do është edhe ai që bën durim ndaj vështirësive që i shkakton komshiu. Nuk duhet ta harrojmë rregullin: “ Njeriun e mund mirësia” Mirësia ndaj tij do ta zbusë dhe do ta bëjë më të sjellshëm atë.

Ajeti kuranor thotë:

Nuk barazohet e mira me të keqen! Të keqen ktheje me të mirë e atëherë armiku yt do të të bëhet menjëherë mik i ngushtë. (Fussilet, 34)

Njeriu duhet të kritikojë edhe vetën që nuk mundet të përmisojë sjelljen e fqinjit. Siç bëri Adbullah ibn Mubarek.

I urti dhe dijetari Abdullah ibn Mubarek, kishte udhëtuar me një person me vese të këqija. Kur ata u ndanë në fund të udhëtimit, Abdullah ibn Mubareku nisi të qajë me dënësë. Miqtë e tij që u çuditën me këtë, e pyetën se përse po qante. Ai mik i Zotit me shpirt të butë, mori frymë thellë dhe me sy të lagur tha:

“Edhe pse udhëtova për një kohë të gjatë me bashkudhëtarin tim, nuk arrita t’ia ndreqë dot veset e tij të këqija dhe nuk e zbukurova dot moralin e tij! Mendoj; a mos vallë për shkak të të metave të mia nuk i bëra dobi atij? Nëse ai nuk u drejtua për

shkak të gabimeve dhe të metave të mia, si do të vejë halli im nesër (para Allahut)?” Dhe vazhdoi të qajë !

Allahu në mundësoftë të thellohem i në reflektimin e urtësisë dhe na bëftë prej atyre që janë të sjellshëm, të dashur dhe miqësor.

Amin!..





LUKMAN HAKIMI

عليه السلام

-3-

Të gjithë besimtarët e sinqertë që kanë arritur një farë pjekurie shpirtërore, nuk mjaftohen vetëm me shpëtimin e vetes, por kërkojnë të shpëtojnë edhe shpirtra të tjerë. Kjo, sepse ata jetojnë gjithmonë me vetëdijen, se shpëtimi i tyre varet prej përpjekjeve që bëjnë ata për shpëtimin e të tjerëve. Këtë detyrë, e konsiderojnë si përgjegjësinë më të natyrshme të besimit.





LUKMAN HAKIMI - 3

Lukmani (a.s.), ka thënë:

“Biri im, kryeje namazin, urdhëroje të mirën, pengoje të keqen dhe bëhu i durueshëm për çfarëdo që të godet! Me të vërtetë, ky është thelbi i patundur i të gjitha punëve!”

(Lukman, 17)

Me këtë këshillë, Lukmani na tërheq vëmendjen në disa punë shumë të rëndësishme, të cilat Allahu i ka bërë farz, si: namazi, këshillimi në të mirë, pengimi i së keqes dhe durimi.

Namazi është shtylla e fesë dhe miraxhi i besimtarit. Ai është një përgjegjësi e pazëvendësueshme për robin dhe nuk braktiset as në luftë.

Përveç vazhdimit të tij, rëndësi të madhe ka edhe respektimi i të gjitha rregullave të namazit në mënyrën më të përsosur dhe falja e tij me përqendrim të lartë shpirtëror. Kjo, sepse namazi i pranuar, është ai që falet me ndjenja të thella dhe në harmoni mes zemrës dhe trupit. Allahu Teala ka urdhëruar:

“Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët, të cilët janë të përlurur në namazin e tyre” (Mu`minun, 1-2.)

Njëri prej sahabëve, Abdullah bin Sihir (r.a.), na e tregon kështu gjendjen e përqendrimit të Profetit (a.s.), në namaz:

“Njëherë, kur shkova tek Rasulallahu (a.s.) e gjeta duke falur namaz. Prej të qarave, nga kraharori i tij vinte një zë që ngjante me vlimin e ujit në kazan.” (Ebu Daud, Salat, 158)

Namazi u bë farz gjatë ndodhisë së Miraxhit. Dhe, namazi i Rasulullahut (a.s.), ishte gjithmonë në gjendjen e miraxhit. Pra, ishte gjithmonë në një lidhje të papërshkrueshme me Allahun Teala. “Falen i namazin ashtu siç më shihni mua...” (Buhari, Ezan, 18) Me këto fjalë Profeti (a.s.) urdhëron të gjithë umetin e tij që ta falë namazin sikur është i tëri në miraxh.

Profeti ynë (a.s.), e ka përkufizuar namazin me këto fjalë: “...Namazi është përqendrim shpirtëror, modesti dhe përlurje...” (Tirmidhi, Salat, 166.) Pra, besimtari duhet të jetë i vetëdijshëm se në namaz ndodhet në prani të Zotit të botëve. Ai duhet të shkëpusë lidhjet me çdo gjë tjetër përveç Tij, të kuptojë se është “asgjë” dhe të sillet me modesti, përlurje, respekt, dhe përqendrim të lartë. Në sexhde duhet të shkojë me ndjenjat e dobësisë, përlulësisë dhe pamundësisë, duke pranuar me gjithë shpirt se çdo gjë që ka, është mirësi e Allahut Teala. Në sexhde të takohet me Zotin e vet duke e bërë egon e tij njësh me tokën. Namazin duhet ta përfundojë me dëshirën për t’u nderuar me daljen përpara Allahut dhe për të arritur ëmbëlsitë shpirtërore.

Përveç këtyre, duhet që të përkushtohemi me gjithë shpirt në namaz, të përpiqemi të hyjmë në atmosferën e tekbirëve, dhikrit, ajeteve e duave që lexohen. Në këtë mënyrë, do të arrijmë të kryejmë këtë adhurim kaq të rëndësishëm me ndjenja të thella dhe me emocionet e miraxhit.



Es'ad Erbili (Allahu e mëshiroftë), në lidhje me mënyrën e këndimit të Tahijatit në namaz, shprehet:

“Lavdet dhe falënderimet që Profeti ynë (a.s.), ia shfaqti Allahut Teala në Miraxh, pra Tahijatin, çdo njeri duhet ta shfaqë për hesap të vet. Tahijati nuk duhet të lexohet si fjala e dikujt tjetër (duke e përjashtuar veten), ose sikur po tregon ndonjë ngjarje. Por duhet lexuar duke u shkrirë me kuptimin e tij dhe me të njëjtat ndjenja, sikur të ishe duke e përjetuar vetë mreku-llinë madhështore të Miraxhit. Selamin që Allahu Teala ia dha Pejgamberit (a.s.), marrja e selamit nga ana e Pejgamberit (a.s.) dhe Formula e Teuhidit, që shqiptoi Xhebraili (a.s.), gjithmonë duhen lexuar sikur lutësi të jetë vetë duke e marrë selamin.” (M. Es'ad Efendi, Mektubat, Fq. 33, Nr: 10)

Ndërsa Mevlana i nderuar, në lidhje me të dashurit e Allahut, që falin namazin me përkushtim të madh dhe marrin kënaqësinë shpirtërore prej tij, shprehet:

“Merr një abdest të tillë, që të mos priset kurrë. Fal një namaz të tillë, që të mos mbarojë kurrë. Ashikut nuk i mjaftojnë pesë vakte namaz, ai dëshiron pesëqind të tillë. A thua dëshiron ashiku i vërtetë që takimi me Allahun të mbarojë?”

Allahu Teala, e ka krijuar trupin e njeriut në formën më të përshtatshme për të rënë në sexhde, duke i dhënë mundësi atij që të përfitojë sa më shumë prej shijes së takimit me Të. Prandaj, Allahu i Lartmadhëruar, na ka urdhëruar të bëjmë sexhde me qëllim që t'i afrohemi sa më shumë.

Allahu Teala, në lidhje me namazin, i cili falet në mënyrën e duhur, shprehet:

“...dhe fale namazin! Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar. Vërtet që përmendja e Allahut është më e madhe!..” (Ankebut, 45)

Për këtë arsye, namazi i falur me përpikmëri dhe i pranuar, është namazi i atij që ruhet nga gjynahet dhe paturpësitë. Kurse efekti i mbrojtjes nga gjynahet që ka namazi, varet nga vetëdija e devotshmërisë, e cila përjetohet konkretisht gjatë këtij adhurimi dhe vazhdimësisë së kësaj vetëdije edhe pas namazit.

Nëse dikush fal namazin, por vazhdon të bëjë padrejtësi e gjynahe të cilat e zemërojnë Allahun, do të thotë, se ai, në të vërtetë nuk po fal namaz. Në lidhje me ata që e falin namazin në këtë gjendje, Allahu Teala urdhëron:

“Mjerë për ata, të cilët kur falen, janë të pakujdesshëm ndaj namazeve.” (Ma'un, 4-5.)

Çështja e dytë që na tërheq vëmendjen në këshillat e Lukmanit, është EMR BI'L-MA'RUF, NEHJ ANI'L-MUNKER, pra, këshillimi i gjërave të mira e të dobishme në përputhje me islamin dhe përpjekja në pengimin e të këqijave, gjynaheve dhe punëve të kota. Këto janë edhe dy prej detyrave kryesore të besimtarit.

Të gjithë besimtarët e sinqertë që kanë arritur një farë pjekurie shpirtërore, nuk mjaftohen vetëm me shpëtimin e vetes, por kërkojnë të shpëtojnë edhe shpirtra të tjerë. Kjo, sepse ata jetojnë gjithmonë me vetëdijen, se shpëtimi i tyre varet prej përpjekjeve që bëjnë ata për shpëtimin e të tjerëve. Këtë detyrë, e konsiderojnë si përgjegjësinë më të natyrshme të besimit.

Nga ana tjetër, puna dhe përpjekja e robit, që besimi dhe Kurani që i janë dhuruar atij prej Allahut Teala, t'i arrijë edhe atyre që ende nuk i kanë shijuar këto mirësi, është shprehja më e bukur e falënderimit të tij ndaj Zotit.

Ashtu siç shprehet edhe i nderuari Es'ad Erbili:



“Falënderimi, nuk duhet të bëhet thjesht me fjalët: “O Zot, falënderimet të takojnë vetëm Ty!”. Falënderimi më i bukur, është kur robi i përdor në përputhje me qëllimin e krijimit të tyre dhe në rrugë të Allahut mirësitë (si syri, veshi, gjuha, zemra, mendja, shëndeti, jeta etj.) që ia ka falur Ai. Përveç kësaj, falënderimi më i pranuar është ajo punë, e cila ka dobi edhe për vëllezërit besimtarë.” (M. Es'ad Efendi, Mektubat, fq. 67, nr: 38.)

Këshillimi në të mirë, ndalimi nga e keqja dhe e kota, janë nga adhurimet më të rëndësishme me dobi shoqërore. Mirëpo, besimtarët që do ta realizojnë këtë detyrë, duhet të shfaqin personalitet, karakter dhe sjellje të cilat përfaqësojnë islamin. Me një fjalë, është kusht që më parë ata të tregojnë islamin me mënyrën e tyre të jetesës. Mevlana i nderuar shprehet:

“Ai që këshillon me vepër, është më i mirë se ai që këshillon me fjalë.” Me këtë shprehje, ai ka përmbledhur të fshehtën e begatisë së ndikimit në çështjen e thirrjes islame.

Në këshillën tjetër, Lukmani na tërheq vërejtjen në lidhje me durimin, i cili është edhe një nga temat më të prekura në Kuranin Kerim. Durimi, është ruajtja e ekuilibrit shpirtëror, përballë kush-teve të ëmbla apo të hidhura të jetës dhe ruajtja e harmonisë së devotshmërisë dhe përpjekjes. Durimi ndaj sëmundjeve, varfërisë, fatkeqësive, katastrofave dhe në veçanti ndaj vështirësive dhe vuajtjeve me të cilat njeriu përballet gjatë përpjekjeve për të përhapur fenë e Allahut, e bëjnë atë të fitojë kënaqësinë e Atij, i Cili ia dha këto prova. Në të tilla raste, besimtari duhet të mundohet ta ruajë ekuilibrin shpirtëror, duke menduar gjithmonë provat dhe vuajtjet që kanë kaluar profetët e Allahut.

Mevlana i nderuar, në lidhje me durimin e madh që kërkojnë dy punët më të rëndësishme të profetëve, kumtimi dhe udhëzimi, shprehet:

“Shumica e fatkeqësive u kanë ardhur profetëve. Madje edhe udhëzimi në rrugë të drejtë i njerëzve të pagdhendur, është një vështirësi më vete.”

Përsëri, Mevlana i nderuar, në lidhje me gradat e larta që fiton njeriu kur toleron dhe duron, thotë:

“Durimi që tregoi trëndafili ndaj gjembave, i fali atij aromën e këndshme.”

Trëndafili edukohet dhe pastrohet, në sajë të durimit dhe tolerancës ndaj gjembave. Kushti më i rëndësishëm i përparimit shpirtëror të besimtarit, është kalimi nga sita e durimit. Pra, të durojë vuajtjet dhe vështirësitë me të cilat përballlet në rrugë të Allahut, duke menduar për shpërblimin që do të marrë në botën tjetër dhe duke i braktisur ankimet, revoltimet dhe qarjet.

Sa i rëndësishëm është durimi ndaj varfërisë, skamjes dhe fatkeqësive që e sfilisin njeriun, po aq i rëndësishëm është edhe durimi ndaj pasurisë, rinisë, shëndetit dhe rehatisë, të cilat mund ta përkëdhelin nefsin (egon) dhe ta çojnë njeriun në kryeneçësi dhe arrogancë. Madje në këto raste, për shkak se nefsi është më i fuqishëm, është më e vështirë t'i pengosh lakmitë e tij të egra dhe ta frenosh atë përballë joshjes së gjynaheve në krahasim me rastet kur nefsi është i dobët në kohët e varfërisë, sëmundjes dhe pleqërisë. Prandaj, në çfarëdo lloj kushtesh që të ndodhet, besimtari duhet ta ruajë me durim të madh vullnetin për të bërë një jetë të pastër fetare.

Lukmani ka thënë:

“Nëse stomaku mbushet (tepër), meditimi bie në gjumë. Kurse gjymtyrët largohen nga adhurimi!”

Në tasavuf, tre parimet kryesore në edukimin e nefsit dhe futjen e shpirtit në rrugën e të fshehtave, janë:



- 1- Të hash pak,
- 2- Të flesh pak,
- 3- Të flasësh pak.

Ngrënia e pakët me të cilën Lukmani na këshillon, është simboli i të gjithë profetëve, sahabëve, të dashurve të Allahut dhe robërve të devotshëm. Sot, grykësia përbën shkakun kryesor të shumë sëmundjeve dhe u hap rrugën shumë çrregullimeve dhe devijimeve. Shpërdorimi në ngrënie e pirje dhe konsumimi i çdo gjëje që ta do “shpirti”, është një lloj jete, të cilën robërit e devotshëm e të singertë nuk e kanë njohur kurrë.

Ushqimi i tepërt i trupit, ngurtëson botën shpirtërore të njeriut, ngathtëson zemrën, egjëron nefsën (egon), cenon shpirtin dhe dobëson mendimin. Për këtë arsye, Profeti ynë (a.s.), ka thënë:

“...Ne jemi një popull që nuk hamë pa na marrë uria. Dhe kur hamë, nuk hamë aq sa të ngopemi.” (Halebi, Insanu'l-Ujun, III, 299.)

“Askush nuk mbush ndonjë enë më të rrezikshme se stomaku i vet. Njeriut i mjaftojnë disa kafshata që ta mbajnë në këmbë. Por nëse dikush duhet patjetër të hajë shumë, një të tretën e stomakut le ta ndajë për ushqimin, një të tretën për pijen dhe një të tretën për ajrin!” (Tirmidhi, Zuhd, 47.)

“Besimtari pi me një zorrë, kurse mohuesi me shtatë zorra.”
(Muslim, Eshribe, 186.)

Të gjitha këto, na tregojnë se mos teprimi në ngrënie dhe pirje, është i domosdoshëm për një jetë të devotshme. Kjo, sepse me një stomak të tej mbushur, nuk është e mundur të kuptohen ashtu siç duhet dobësia, nevoja, përlujta dhe skamja, të cilat përbëjnë thelbin e devotshmërisë ndaj Allahut. Gjithashtu, nuk

është i mundur as kthimi nga dera hyjnore duke bartur ndjenjat e modestisë dhe përulësisë e as të drithërohesh e të derdhësh lot prej frikë-respektit dhe dashurisë ndaj Allahut Teala.

Sado adhurime të bëhen, me një stomak të tej mbushur, ato gjithmonë kanë për të qenë të mangëta në përqendrim dhe në përfitim shpirtëror. Dhe kjo bëhet shkak që adhurimet të cilat në dukje janë të shumta, të jenë të zbrazëta dhe të mangëta prej së vërtetës. Në bazë të kësaj, me qëllim që adhurimet të kryhen me përqendrim të thellë, duke u zhytur në meditime dhe të përfitohet shpirtërisht prej urtësive dhe mësimëve hyjnore, është kusht që të mjaftohesh me ushqim të pakët dhe hallall.

Sa bukur e ka shprehur Mevlana i nderuar këtë fakt:

“Mos u mundo ta zbukurosh lëkurën duke e ushqyer së tepërmi, sepse në fund të fundit, ajo është një kurban që do t'i jepet tokës. Më mirë mundohu të ushqesh zemrën, sepse ajo do të shkojë e do të nderohet në përjetësi.”

“Mos i jep trupit shumë yndyra dhe ëmbëlsira, sepse kush e ushqen më shumë se sa duhet, në fund do të bëhet rob i dëshirave të nefsit dhe do të përfundojë i poshtëruar.”

Lukmani ka thënë:

“Biri im! Mos lejo që gjeli të jetë më i zgjuar se ti! Ai çdo mëngjes përkujton Allahun, ndërsa ti fle!”

Kjo këshillë e Lukmanit na tërheq vëmendjen në parimin e fjetjes së pakët.

Sa i mahnitshëm dhe mësimdhënës është fakti se Allahu Teala ka krijuar shumë kafshë të cilat, na zgjojnë në orët e natës që janë më të dobishmet për shpirtin tonë! Por sa i hidhur është fakti që njeriu, i cili është krijuar si më fisniku ndër të gjitha kri-



jesat, është kaq i pakujdesshëm ndaj kësaj pjese të rëndësishme kohe!

Koha para agimit të ditës, është një kohë e veçantë, e cila ndikon shumë në pastërtinë e mendjes dhe zemrës, në mprehtësinë e kuptimit dhe shprehjes, në forcën e kujtesës dhe në përparimin e shpejtë në rrugën shpirtërore.

Allahu Teala, i jep më shumë vlerë dhikrit në kohën para agimit se sa dhikrit gjatë kohëve të tjera. Kjo, sepse të merresh me adhurime në një kohë kur shtrati e tërheq njeriun si me magnet, është më e vështirë në krahasim me kryerjen e adhurimeve në kohët e tjera. Prandaj mund të themi, se gjallërimi i kohës para agimit, është punë “burrash” dhe jo njerëzish të thjeshtë. Koha para agimit, është koha kur dilet në audiencën hyjnore duke e braktisur gjumin e ëmbël vetëm për hir të kënaqësisë së Allahut dhe dashurisë ndaj Tij. Kjo shpreh qartë ndjenjat e singerta të robit ndaj Zotit të tij, sepse nuk është e mundur të mendohet një besimtar, që e do Zotin e tij me gjithë kuptimin e fjalës, por fle derisa të lindë dielli, i zhytur në një shkujdesje të thellë.

Namazi, dua,ja, kërkimi i faljes, përsëritja e formulës së teuhidit, salavatet për Profetin (a.s.), meditimi rreth vdekjes dhe adhurimet e tjera që bëhen në kohën e para agimit, janë ushqimet më të dobishme për shpirtin e njeriut. Për ta ruajtur veten tonë nga shkujdesja, është e rëndësishme që çdo ditë të re ta fillojmë me këtë energji shpirtërore.

Padyshim se praktikimi i namazeve dhe dhikrit të natës, është në përpjesëtim të drejtë me nivelin e dashurisë për Allahun.

Një njeri, i thotë Ibrahim Bin Et’hemit:

“Nuk arrij të çohem në namazin e natës. Më jep një zgjidhje.”

Ibrahim bin Et'hemi, i thotë:

“Mos u trego i pakujdesshëm ndaj Allahut gjatë ditës, që Ai të të marrë në audiencën e Vet gjatë natës. Të gjendesh në audiencën e Tij gjatë natës, është një nder shumë i madh. Dhe gjynahqarët nuk e meritojnë këtë nder!”

Robërit e devotshëm të cilët kanë arritur ta shijojnë ëmbël-sinë shpirtërore të adhurimit të natës, në sajë të ndjenjave që u ka dhënë thellimi në meditimin rreth vdekjes, kanë thënë: “Unë nuk kam frikë nga vdekja, por kam frikë se ajo më gjen para se ta fali namazin e natës”.

Vërtetë, që të merresh me adhurime kur të gjithë janë në gjumë, do të thotë të bëhesh prej robërve të zgjedhur, të cilët hyjnë në rrethin intim të dashurisë dhe njohjes shpirtërore të Zotit. Prandaj dhe për robërit e mirë të Allahut, nuk ka kohë më të vlefshme për shpirtin se sa koha para agimit. Në lidhje me këtë çështje, Allahu Teala shprehet:

“Në një pjesë të natës bëji sexhde Atij dhe, natën falju gjatë Atij. Vërtet që jobesimtarët e duan jetën e këtushme dhe nuk e përfillin Ditën e vështirë, që do t’u vijë.” (Insan, 26-27.)

“Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë dhe japin nga ajo që iu kemi dhënë Ne.” (Sexhde, 16.)

“Ata flinin pak natën, ndërsa në agim kërkonin falje (nga Allahu).” (Dharijat, 17-18.)

Ndërsa Profeti ynë (a.s.), me qëllim që të mos privohemi prej ëmbëlsisë shpirtërore të kohës para agimit, na ka këshilluar me këto fjalë:

“Kujdesuni për adhurimin e natës! Sepse ai është tradita e njerëzve të sinqertë që kanë jetuar para jush. Padyshim se



ngritja për të kryer adhurimet e natës, është shkak i afrimit me Allahun. Ai ju ruan prej gjynaheve, ju fshin gabimet dhe ju largon problemet e trupit.” (Tirmidhi, Deauat, 101.)

Të mos merresh me adhurime gjatë kohës së para agimit, është një humbje shumë e madhe. Sa bukur e shpreh kjo ndodhi këtë fakt:

Abdullah bin Omeri (r.a.), ka thënë:

“Kur Profeti ishte ende gjallë, nëse dikush shihte ndonjë ëndërr, shkonte dhe ia tregonte atij. Edhe unë dëshiroja shumë të shihja ndonjë ëndërr dhe t’ia tregoja. Atë kohë isha një djalë beqar dhe flija në mesxhid.

Njëherë, pashë në ëndërr sikur dy melekë po më çonin në xhehenem. Vura re se ai (xhehenemi) ishte i ndërtuar me gurë si ndonjë pus uji dhe kishte dy shtylla njësoj si pusi. U habita shumë. Aty ndodheshin edhe disa njerëz, të cilët i njihja.

“Strehohem tek Allahu prej xhehenemit! Strehohem tek Allahu prej xhehenemit!”, bërtita unë. Pastaj erdhi një melek dhe më tha:

“Mos ki frikë, ty nuk do të të ndodhë gjë!”

Ëndrrën ia tregova motrës sime Hafsës, kurse ajo ia kishte treguar Rasulallahut (a.s.), i cili i kishte thënë:

“Sa njeri i mirë është Abdullahu! Sikur të falte edhe namaz nate, do të ishte më i mirë!..”

Që prej asaj dite, Abdullahu (r.a.), e kalonte një pjesë të madhe të natës me adhurime dhe flinte shumë pak. (Buhari, Ashabu'n-Nebi, 19.)

Nëse besimtari e kalon natën duke pasur parasysht këshi-

llat dhe mësimet Allahut dhe të të Dërguarit të Tij, nata do t'i ndriçohet më shumë se dita. Një nga robërit e mirë të Allahut, Bajezid Bistami (Allahu e mëshiroftë), ka thënë: “Nuk më është zbuluar asnjë e fshehtë pa m'u bërë netët si ditë”.

Lukmani ka thënë:

“Biri im! Nuk jam penduar kurrë prej heshtjes. Nëse fjala është argjend, heshtja është flori.” (Ahmed, ez-Zühed, s. 44, no: 272.)

“Heshtja është urtësi, por janë të pakët ata që e praktikojnë.” (Ahmed, ez-Zühed, s. 88, no: 545.)

Me këtë këshillë, Lukmani na tërheq vëmendjen në parimin e heshtjes.

Heshtja, është stolia e dijetarëve dhe mbulesa e të paditurve. Njeriu i cili futet nën strehën e heshtjes, është i ruajtur nga shumë rreziqe dhe në veçanti prej shikimeve të helmëta të smirëzinjve. Për këtë arsye, në vend që të flasë shumë, njeriu duhet të merret me vepra të mira duke bërë gjëra të bukura e të dobishme. Përndryshe nëse flet shumë, nuk do të ketë kohë për të bërë vepra të mira dhe do të zhytet në shkujdesje.

Heshtja, e cila arrihet duke frenuar nefsën, ndonjëherë është përgjigjja më e qartë që mund t'u jepet injorantëve. Dhe jo më kot, dijetarët e mëdhenj islamë kanë thënë: “Heshtja është përgjigjja më e mirë që mund t'i jepet mendjecekëtit”. Kjo ndodhi, e shpreh më së miri këtë fakt:

Një ditë, kur Rasulallahu (a.s.), gjendej në mes të sahabëve fisnikë, erdhi një njeri dhe ofendoi Ebu Bekrin (r.a.). Ebu Bekri, heshti dhe nuk iu përgjigj. Por ai përsëri e ofendoi në të njëjtën mënyrë. Ebu Bekri përsëri heshti. Dhe kur njeriu e ofendoi për herë të tretë, Ebu Bekri (r.a.), nuk duroi dot më dhe i dha për-



gjigjen që meritonte. Pas kësaj ndodhie, Rasulallahu (a.s.), u çua dhe filloi të largohej. Ebu Bekri (r.a.), i shkoi pas dhe e pyeti:

“O Rasulallah! A mos u mërzitët me mua?” Rasulallahu (a.s.), tha:

“Jo, nuk u mërzita me ty. Por pashë se një melek kishte zbritur nga qielli dhe po i përgënjeshtronte fjalët që po të thoshte ai njeri duke iu përgjigjur në vendin tënd. Kur ti iu përgjigje dhe more hakun, meleku iku dhe në vend të tij erdhi shejtani. Dhe unë nuk qëndroj në një vend ku ndodhet shejtani!”. (Ebu Daud, Edeb, 41/4896.)

E megjithatë, ka raste kur nuk duhet heshtur, sepse të hesh-tësh kur duhet të flasësh, është një gabim po aq i madh sa të flasësh kur duhet të heshtësh. Të mos ndërhysh dhe të heshtësh atëherë kur bëhet padrejtësi, bëhet shkak i ngarkimit tënd me gjynahe. Ebu Ali ed-Dekak, është shprehur:

“Ai që hesht kur duhet të thotë të vërtetën, është si një shejtan memec.”

Si besimtarë që jemi, kriteri ynë kryesor që duhet të për-vetësojmë në lidhje me të folurin dhe të heshturin, është kjo urdhëresë e Profetit tonë (a.s.):

“Ai që i beson Allahut dhe botës tjetër, ose të flasë mirë ose të heshtë!” (Buhârî, Edeb, 31, 85; Müslim, Îman, 74)

Nëse njeriut i duhet të flasë patjetër, duhet që fjalët e tij të kenë urtësi më të vlefshme se heshtja, të qetësojnë zemrat dhe të çlodhin shpirtat. Dhe për të folur me fjalë të tilla, më parë duhet të jetosh duke e brumosur shpirtin me ato fjalë. Allahu Teala, me qëllim që njeriu të dëgjojë shumë e të flasë pak, i ka dhënë atij dy veshë e një gojë. Nëse nuk bëhet kujdes ndaj këtyre

të vërtetave do të vuajmë shumë prej fjalëve tona. Siç shprehet edhe Shejh Sadi Shirazi:

“Fjalët e atij që flet pa menduar, në të shumtën e rasteve janë të gabuara.”


Për këtë arsye, Ebu Bekri (r.a.), ka thënë:

“Mendo mirë se çfarë po thua, kujt po ia thua dhe kur po e thua!”

Për më tepër, zgjatja e fjalës më shumë se sa duhet, ia ul vlerën njeriut për një kohë shumë të shkurtër. Siç shprehet edhe Mevlana i nderuar: “Fjalën e zgjat ai që nuk arrin të shpjegojë qëllimin.” Dhe ai që flet kaq gjatë, duhet dëgjuar shkurt.

Allahu Teala, e bëftë heshtjen tonë meditim, shikimin tonë mësim, dhe fjalën tonë urtësi. Gjithashtu na dhëntë urtësinë e duhur që ta përdorim jetën tonë në rrugën e Tij dhe në mënyrën më të dobishme.

Amin!..



LUKMAN

HAKIMI



-4-

Në fakt zemrat e fëmijë janë të pastra sepse ata lindin me natyrë të pastër. Por ecuria e tyre e mëtejshme është e varur shumë nga roli i prindërve në kultivimin dhe zhvillimin e virtyte të larta.

Sëpari prindërit duhet të jenë një shembull model për fëmijët. Edukimi i fëmijës fillon në prehrin e prindërve. Çdo fjalë që del prej prindërit është një tullë e vendosur në formimin e murit të personalitetit të fëmijës. Sidomos sot që bota është ndotur dhe pushtuar nga kultura globale është shumë i rëndësishëm pozicioni i prindërit.





LUKMAN HAKIMI - 4

Mos i trajto njerëzit me nënçmim dhe mos ec në tokë me mendjemadhësi, se Allahu nuk i do mendjemëdhenjtë e mburracakët! Ec me kujdes e i përmbajtur dhe fol me zë të ulët; se zëri më i vrazhdë është zëri i gomarit”! (Lukman, 18-19)

Mburra, mendjemadhësia dhe pëlqimi i vetes, janë si degët e një peme, rrënjët e së cilës zgjaten deri në xhehenem. Atributi i Madhështisë, është i posaçëm vetëm për Allahun. Kështu, shkaku që shejtani mori përsipër t'i devijojë njerëzit nga rruga e drejtë, është se ai u mburr para Ademit (a.s.) dhe kundërshtoi urdhrin e Allahut. Po ashtu, edhe Karuni, të cilit megjithëse i qenë dhënë dituri shpirtërore, u shkatërrua për shkak se ushqeu zili e smirë ndaj Harunit (a.s.).

Në suren Isra thotë: Mos ec nëpër tokë me mendjemadhësi, se ti, në të vërtetë, nuk mund ta çash tokën e as të arrish lartësinë e maleve. (Isra, 34)

Imam Bursevi në interpretimin e këtij ajeti thotë:

“Kur të takosh apo të përshëndetësh ndonjë person tre-



gothu modest dhe i thjeshtë, mos u trego mendjemadhësi dhe mburrje siç bëjnë disa. Në syrin tënd të gjithë njerëzit le të jenë të barabartë.”

Këto ajete fisnike, japin kriteret e mirësjelljes dhe edukatës së të folurit dhe të vepruarit të besimtarit. Këtu, njoftohet se, mirësjellja, e cila në këtë botë duket e pavlerë dhe e parëndësishme, në botën tjetër, ka për të fituar një rëndësi shumë të madhe.

Prandaj besimtari nuk duhet të përfshihet kurrë nga ndjenjat e mendjemadhësisë, mburrjes dhe egoizmit. Besimtari mirësinë duhet ta konsiderojë prej Allahut kurse gabimet dhe mangësitë prej vetes. Në të gjitha veprat dhe sjelljet duhet të pasqyrohet morali dhe edukata islame. Besimtari duhet të heqë dora nga ecja me mburrje mbi tokë. Ai duhet të shoqërohet në çdo sjellje nga thjeshtësia dhe modestia.

Është shumë domethënëse përngjasimi me zërin e gomarit. Sepse zëri i gomarit simbolizon ashpërsinë dhe zërin që ngrihet në mënyrë të tepruar dhe pa qenë nevoja. Zëri i gomarit përfaqëson mungesën e delikatesës. Një gjë e tillë nuk mund të përputhet kurrë me sjelljet dhe veprimet e një besimtarit. Një zë i tillë mund të dalë vetëm prej një njeriu me zëmër të ngurtësuar.

Hasan Basriu thotë:

Idhujtarët lëvdoheshin me zërin e lartë. Zoti tha në adresë të tyre: Po qe se zëri i lartë do të ishte një gjë e dobishme, gomarin, që e ka zërin të lartë, do ta kisha bërë epror mbi ta.”

Lukmani thotë:

“Nëse je sillësh me edukatë kur je i vogël do t’i shohësh dobinë kur të rritesh”

“Mos i nënvlerëso punët e vogla! Sepse e vogla nesër kthehet e madhe.”

Fëmijëria është stina e duhur për nga aspekti i formësimit të cilësive kryesore dhe orientimeve edukative. Një devijim i vogël nga e vërteta dhe e drejta, që mund të ndodhë në këtë stinë, bën që në vitet në vijim të hasen vështirësi në daljen prej luginave të devijimit. Për të shprehur këtë, populli ynë ka thënë: “Dega përthyeret sa është e njomë”.

Mëshira dhe dashuria ndaj fëmijëve nuk tregohet thjesht duke i plotësuar dëshirat dhe nevojat e kësaj bote, duke i veshur me rroba të bukura dhe lodra argëtuese. Mëshira dhe dashuria e vërtetë tregohet kur i përgatit ata për ardhmen në botën tjetër duke i siguruar atyre lumturinë e përhershme. Dhe kjo arrihet duke i pajisur ata me moral dhe vlera shpirtërore. Për këtë duhet seriozitet dhe sakrificë nga të rriturit.

Hadithi e shpreh kështu rëndësinë e pjekurisë shpirtërore të fëmijëve:

“Allahu i Madhëruar e do të riun e pjekur, që nuk silllet si fëmijë, që është drejtuar kah e mira dhe ka braktisur dëshirat e kënaqësitë (e ulëta të egos).” (Ahmed, IV, 151)

Përgjegjësia kryesor për të rritur fëmijë të tillë fisnikë dhe me edukatë është sëpari e prindërve.

Për një shoqëri të shëndoshë dhe të paqte duhet nëna të devotshme të cilat do të edukojnë dhe rritin pasardhës shembullor. Qëllimi jonë duhet të jetë të edukojmë njerëz të mirë, të ndershme dhe shembullor për shoqërinë. Vetëm në këtë mënyrë mund të ndërtohet një shoqëri e qetë dhe e paqme.

Profeti (a.s.) thotë:

“Të gjithë jeni barinj dhe të gjithë jeni përgjegjës për tufën tuaj. Burri është bariu i familjes së tij dhe përgjegjës për të.

Ndërsa gruaja është baresha e shtëpisë së burrit të vet dhe po ashtu edhe ajo është përgjegjëse për tufën e vet.” (Buhari, Vesaja, 9; Muslim, Imare, 20)

Një bari i mirë nuk e dërgon tufën e vete në vende të mjera dhe të shkreta por në kullota të gjelbëra. Pra prindi duhet ta ushqejë fëmijë me fitim hallall dhe duhet t'i japë një edukatë të mirë qysh në moshë të vogël. Krahas ushqimit të trupit duhet t'i japë shumë rëndësi edhe ushqimit shpirtëror të fëmijës.

Gratë sahabije, kur fëmijët e tyre qëndronin gjatë pa e parë Profetin (a.s.) i qortonin fëmijët e tyre. Ato tregonin përpjekje të madhe për të ushqyr fëmijët shpirtërisht.

Një çoban i mirë delen e sëmure nuk e le në mëshirë të fatit por e ndihmon që të arrijë kopenë. Po ashtu edhe prindërit gjatë rritjes së fëmijës duhet të përballojnë disa vështirë.

Një çoban i mirë e ruan tufën nga rreziqet e ndryshme. Në ditët tona fatkeqësisht televizioni, rrjetet sociale dhe në përgjithësi media është duke i orientuar fëmijët në rrugë dhe vende të gabuara. Ata janë duke u shndërruar në një burim i rrezikshëm i helmimit shpirtëror. Rinia nën presionin e vazhdueshëm të këtyre faktorëve fillon të humbasë personalitetin dhe identitetin e vet. Në këtë mënyrë rolin e edukimit e merr televizioni duke e mënjanuar prindin, afërsia e prindit me fëmijën reduktohet vetëm në lidhje biologjike.

Është e domosdoshme që prindërit të tregojnë kujdes të veçantë në mbrojtjen e fëmijëve nga rreziqet e shumta dhe për të duhet më tepër afrimet shpirtëror.

Një çoban i mirë e orienton tufën drejt drejtimit të duhur. Po ashtu edhe një prind duhet të orientojë fëmijët drejt mirësisë



dhe drejtësisë. Është detyrë e prindërve pajisja e fëmijës, e këtij amaneti hyjnor me identitet dhe kulturë islame.

Pothuajse të gjithë pejgamberët kanë ushtruar detyrën e çobanit. Sepse në këtë detyrë njeriu mëson konceptet e drejtimit dhe mëshirës që duhet treguar ndaj gjithë krijesave. Prandaj prindërit duhet të jenë të vetëdijshëm për rëndësinë e detyrës që kanë.

Në fakt zemrat e fëmijë janë të pastra sepse ata lindin me natyrë të pastër. Por ecuria e tyre e mëtejshme është e varur shumë nga roli i prindërve në kultivimin dhe zhvillimin e virtyte të larta.

Sëpari prindërit duhet të jenë një shembull model për fëmijët. Edukimi i fëmijës fillon në prehrin e prindërve. Çdo fjalë që del prej prindërit është një tullë e vendosur në formimin e murit të personalitetit të fëmijës.

Sidomos sot që bota është ndotur dhe pushtuar nga kultura globale është shumë i rëndësishëm pozicioni i prindërit. Për të rritur një fëmijë shembull duhet një prind shembull. Të arrish diçka pa paguar koston e saj është e pamundur.

Nëse prindi nuk bën përpjekje për ta edukuar dhe rritur fëmijën në një atmosferë fetare dhe shpirtërore në ditën e kijametit do të dalë përpara përgjegjësisë.

Lukmani thotë:

Bir! Si nuk frikësohen njerëzit nga dënimi i xhehenemit në një kohë kur i neglizhojnë kaq shumë adhurimet dhe bindjen.”

Indiferentizmi është një lloj verbërimi shpirtëror, është si një perde që pengon shikimin e zemrës. Gafleti e bën njeriun të ecë drejt vendeve të mbushura me mina.



Dy armiqtë e përbetuar të njeriut ego dhe shejtani nxjerrin lloj-lloj preteksti për të penguar njeriun në realizmin e adhurimeve dhe detyrave. Këto dy armiq e mpijnë zemrën mendjen dhe arsyen duke i krijuar një gjendje përhumbe dhe pavetëdije.

Një nga kurthet e gafletit është edhe neglizhimi i veprave të mira me shpresën se Allahu me mëshirën e tij i fal mëkatet. Por kjo është vetëmashtrim dhe neglizhencë e dënimit hyjnor.

Prandaj Allahu në Kuran i tërheq vëmendjen njerëzve në këtë mënyrë:

O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj dhe frikësojuni Ditës, kur prindi nuk do të mund ta ndihmojë aspak fëmijën e vet, e as fëmija nuk do të mund ta ndihmojë sado pak prindin e vet! Premtimi i Allahut është vërtet i sigurt, prandaj mos e lini jetën e kësaj bote t'ju mashtrojë dhe as djallin mos e lini t'ju mashtrojë për Allahun. (Lukman,33)

Njeriu duhet të tregohet i matur dhe të përpiqet në maksimum për të kryer detyrat e veta. Ai nuk duhet të harrojë që Allahu përveç faljes dhe mëshirës shfaq edhe dënimin kur duhet. Është kusht i domosdoshëm pendimi i shoqëruar me vepra të mira para se të jetë tepër vonë.

Lukmani i thotë të birit:

Biri im i dashur! Mos e vono pendimin sepse vdekja mund të jetë e menjëhershme. (Bejhaki, ez-zuhdu'l-kebir, f. 227, nr:590)

Mansur bin Ammar tregon:

Një natë dola jashtë, duke menduar se u bë mëngjes, por pashë se nuk kishte gdhirë ende. Kur po kaloja përpara një shtëpie, dëgjova një hallexhi që lutej duke qarë:

“O Zoti im, unë kam bërë shumë mëkate. E kam turpëruar



veten. Qëllimi im nuk ishte për të provuar fjalën Tënde. Unë u munda nga vetja ime dhe pashë se për çfarëdo që bëj, Ti nuk më ndëshkon. E kuptova se Ti je mbulues i Mëkateve. Mëkatet që kam bërë i kam bërë për shkak të padijes sime. Tani e kuptova se kam gabuar. Nëse më ndëshkon, puna ime bëhet shumë e vështirë. Vaj medet për mua, vaj medet për mua! O Zoti im! Ditën kur do t'i urdhëroshë robërit e Tu për të kaluar Siratin, dikush do të bie në xhehennem dhe dikush do të hyjë në xhennet. Vallë nga cili grup do të jetë ky rob i varfër?!”

Në ato çaste u dëgjua një ajet që flet për xhehennemin. Djali, i cili po lutej brenda, tha vetëm një herë “Ah!” dhe nuk rënkoi më.

U bëra merak dhe thashë: “Çfarë ndodhi vallë që iu ndërpre zëri?” Pasi e mbajta mend mirë vendin e shtëpisë së tij, u ktheva në shtëpinë time. Kur kalova aty në mëngjes, përpara asaj dere kishte një xhenaze. Kur pyeta se çfarë kish ngjarë, nëna e tij më tha:

“Ky është djali im i vdekur. Është nga soji i Pejgamberit tonë të Nderuar. Kur bëhej natë, qante deri në mëngjes në dhomën ku falej. Ata që i fitonte ditën ua jepte të varfërve. Kur dëgjoi njërin prej ajeteve të xhehennemit, nuk mundi të rezistojë më dhe duke qarë ia dorëzoi shpirtin Zotit.”

Unë i thashë asaj:

“-O zonjë! Biri juaj ka hyrë në xhennet, sepse ai që qan prej frikës ndaj Allahut, nuk hyn në xhehennem. A hyn në xhehennem ai që e dorëzon shpirtin në këtë mënyrë? Falënderojë Allahun!”

Në lidhje me ata që pendohen dhe derdhin lot të singertë nga frika e dënimit të Allahut, Profeti (a.s.) thotë:

“Çdo besimtari që nxjerr lot qoftë edhe sa koka e mizës prej frikës së Allahut, dhe ai lot i rrjedh nga faqet, Allahu ia bën haram zjarrin (e përhershëm)!” (Ibn Maxhe, Zuhd, 19)

“Ai që qan për shkak të frikës që ka prej Allahut, nuk do të hyjë në xhehennem derisa të kthehet qumështi te gjiri. Pluhuri që ngrihet në rrugë të Allahut, kurrë nuk krahasohet me tymin e Xhehennemit.” (Tirmidhi, Zuhd, 8/2311)

Por këto hadithe nuk duhet keqkuptuar sepse hadithi përfshin ata që bëjnë një jetë sipas Kuranit dhe Syneetit dhe përsëri kanë frikë nga dënimi i Allahut në botën tjetër dhe jo ata që nuk respektojnë urdhëresat dhe ndalesat hyjnore por për një çast i frikësohen Allahut dhe derdhin lot pendimi të shkaktuar nga një vdekje apo fatkeqësi tjetër e përhershme.

Normalisht Allahu mund ta falë për krijesën e vet por ajo që i ka hije besimtarit është respektimi dhe zbatimi i urdhëresave dhe ndalesave hyjnore dhe shpresa tek mëshira e Allahut duke kërkuar falje dhe mëshirë. Prandaj është shumë e këshillueshme që gjendja e besimtarit të jetë midis shpresës dhe frikës.

Lukmani thotë:

Bir! Kur të bësh një mëkat me vetëdije apo pavetëdije menjëherë pas tij pendohu dhe bëj bamirësi.

Pendimi është keqardhja për gabimin e bërë dhe heqja dorë përfundimisht nga përsërtija e tij. Për një pendim sa më efikas është shumë e rëndësishme të shoqërohet me vepra të mira siç është bamirësia.

Profeti (a.s.) thotë:

Kudo që të jesh, kij frikën e Allahut, dhe pas çdo veprë të shëmtuar bën mirësi, kjo e shlyen atë. Sillu ndaj njerëzve në mënyrën sa më të bukur!” (Tirmidhi, Birr, 55/1987)



Lukmani thotë:

Bir! Merr pjesë në xhenaze! Sepse xhenazja të kujton botën tjetër. Kurse haramet dhe mëkatet të nxitin drejt kësaj bote.

Për një udhëtar drejt ahiretit vdekja është këshilla më e mirë. Çështja më e rëndësishme e njeriut është të zgjidhë enigmën e jetës dhe vdekjes nën dritën hyjnore. Sepse jeta është një e vërtetë madhore përtej lindjes dhe vdekjes së njeriut. Njerëzve kur u bëhet pyetja se çfarë është jeta? Marrin si përgjigje vetëm proceset jetësore të kësaj bote sepse sipas tyre jeta është vetëm koha midis lindjes dhe vdekjes.

Por jeta e vërtetë është jeta e përtejme e cila arrihet me besim dhe vepra të mira. Për të mbajtur të gjallë jetën pas vdekjes duhet të marrim pjesë herë pas herë në ceremoni mortore, të vizitojmë varret dhe të reflektojmë mbi vdekjen.

Lukmani thotë:

Bir! Nëse ke bërë mirë do të gesh mirë në të kundërt mos ki asnjë pikë dyshimi se do të përballesh me të keqen.

Domethënë njeriu do të korri çfarë të mbjellë. Njeriu çfarë të mbjellë për ahiretin në këtë botë do ta gjejë në botën tjetër.

Rrumiu thotë:

A të ka ndodhur ndonjëherë që të mbjellësh grurë dhe të mbijë elb?

Një besimtar i urtë përpiqet gjithë jetës për të mbushur regjistrin e tij të veprave me vepra të mira. Ai e vlerëson çdo moment të jetës për të bërë vepra të mira dhe sipas mësimëve hyjnore.

Ebu Bekri thotë:

Bota është vend pazari i besimtarëve, produkti i tyre janë veprat e mira fitimi prej tyre është Xheneti kurse humbja është xhehenemi.

Në jetën e përditshme edhe një njeri i rëndomtë bën një bilanc të punës së tij dhe për të rritur fitimin përpiqet të gjegjë rrugët më të përshtatshme. Të mos mendosh për veprat e mirë në këtë botë që janë e vetmja kapital për botën tjetër nuk është gjë tjetër përveç se një marrëzi.

Lukmani thotë:

Bir! Jeta e kësaj bote është e shkurtuar kurse jeta jote është edhe më e shkurtër. Prej kësaj jete të shkurtër të ka mbetur vetëm një pjesë.

Çdo ditë shëputet një gjethe nga jeta jonë. Lumi i jetës rrjedh pa ndaluar për asnjë moment. Kurse njeriu indiferent jeton sikur kjo jetë nuk ka fund kurrë por që në fakt është vetëm një periudhë e shkurtër.

Allahu këtë të vërtetë e shpreh kështu në Kuran:

Ditën kur do ta shohin atë, (njerëzve) do t'u duket se kanë qëndruar (në Tokë) veç një mbrëmje apo një mëngjes.

(Naziat, 46)

Jeta e kësaj bote është si një filluskë sapuni krahasuar me botën tjetër. Se kur do të na trokasë vdekja në këtë jetë të shkurtër është e panjohur. Jeta jonë në këtë botë nuk dihet se kur përfundon. Vdekja mund të vijë në çdo moment prandaj nuk duhet të mbesim pas në vepra të mira për asnjë moment.

Imam Gazaliu e këshillon kështu djalën e vet:

“Biri im! Mendo sikur vdiqe dhe u ktheve prapë në këtë botë. Mendo për emocionet e asaj gjendjeje! Që sot e tutje mos iu afro




gjynahut dhe mosbindjes dhe mos e çojmë asnjë çast të kësaj dite, sepse çdo frymë është një mirësi e paçmueshme.”

Pra, çdo ditë e re që na hapet prej kalendarit të jetës, duhet ta vlerësojmë si një afat të ri. Prandaj, pa humbur kohë, të nxi-
tojmë në punë të mira.

O Zot! Na bëj prej atyre që e vlerësojnë siç duhet jetën e kësaj bote. O Zot na bëj të mundur të bëjmë një jetë të mbushur me vepra të mira.

Amin...





LUKMAN

HAKIMI

عليه السلام

5-

Edhe sikur t'i ketë të gjitha një person i vetëm dhe të jetojë qoftë edhe njëmijë vjet, sa vlerë kanë mirësitë e përkohshme!? Vendi ku ai do të përfundojë, a s'është një gropë e kësaj toke të zezë? Kjo botë është e pabesë; çdo gjë që të jep, një ditë do ta marrë patjetër. Ndërsa robit, i ngelet vetëm llogaria dhe dënimi. Nisur nga kjo, jeta e kësaj bote e cila jetohet në mënyrë të pavetëdijshme nga bota tjetër, edhe sikur të kalojë midis luksit dhe lumturisë, në të vërtetë, çfarë është tjetër përveçse falimentimit të përjetshëm!?





LUKMAN HAKIMI - 5

Lukmani (a.s.), ka thënë:

“Biri im! Ato që ka premtuar Allahu, po vijnë drejt jush me shpejtësi. Edhe ju po shkoni me shpejtësi drejt botës tjetër. Kjo botë ju ka kthyer shpinën dhe po largohet prej jush, ndërsa bota tjetër po vjen drejt jush duke vrapuar. Padyshim se vendi (i pafundësisë) drejt së cilit po shkoni, është më afër jush se sa vendi (i përkohshëm), prej të cilit po ndaheni.”

Aventura e jetës së njeriut, është një skenë mësimdhënëse më vete: njeriu vjen në këtë botë pa sjellë asgjë dhe shkon nga kjo botë pa marrë asgjë. Zoti ynë, na sprovon me gjërat më tërheqëse të kësaj bote. Një njeri, i cili nuk është edukuar shpirtërisht, kaplohet në mënyrë ambicioze nga dashuria për këtë botë, në mënyrë të vetëdijshme ndaj kësaj të vërtete të qartë. Ai i shkel kufijtë hyjnorë për gjëra që një ditë do t’u thotë lamtumirë. Ai përpiket vazhdimisht të ndërtojë këtë botë që është vendi i tij i përkohshëm, duke shkatërruar botën tjetër që është vendi i tij i përjetshëm.



Edhe sikur t'i ketë të gjitha një person i vetëm dhe të jetojë qoftë edhe njëmijë vjet, sa vlerë kanë mirësitë e përkohshme!? Vendi ku ai do të përfundojë, a s'është një gropë e kësaj toke të zezë? Kjo botë është e pabesë; çdo gjë që të jep, një ditë do ta marrë patjetër. Ndërsa robit, i ngelet vetëm llogaria dhe dënimi. Nisur nga kjo, jeta e kësaj bote e cila jetohet në mënyrë të pavetëdijshme nga bota tjetër, edhe sikur të kalojë midis luksit dhe lumturisë, në të vërtetë, çfarë është tjetër përveçse falimentimit të përjetshëm!?

Lumturia e vërtetë, është shkuarja në botën e përjetshme me një zemër të pastër duke fituar kënaqësinë, dashurinë dhe miqësinë e Allahut Teala në këtë botë të përkohshme. Njeriu me të vërtetë i mençur, është ai që nuk e harron kurrë vdekjen dhe përgatitet që sot për vendin ku dëshiron të shkojë në botën tjetër. Allahu Teala, urdhëron:

“O besimtarë! Frikësohuni Allahut dhe secili le të shikojë se çka ka përgatitur për nesër. Frikësohuni Allahut! Me të vërtetë All-llahu e di se çfarë punoni.” (Hashr, 18)

Nga ana tjetër, Allahu Teala, urdhëron; **“Pasha muzgun e agimin!”**, duke u betuar në atë moment madhështor kur të gjitha krijesat zgjohen në një ditë të re. Pra, Zoti ynë, dëshiron që ne të bëjmë kujdes ndaj urtësive të këtij momenti dhe të thellohemi në meditimin rreth tij. Kështu që, edhe ne, në kohën para agimit, duhet të hyjmë në atmosferën e një meditimi të tillë:

Allahu Teala, më hapi një fletë të re prej kalendarit të jetës sime. Mirëpo, shumë të tjerëve nuk ia dha këtë mundësi. Dje, shumë njerëz që ishin ende në jetë, sot nuk janë më. Kjo ditë e re, më largoi edhe një ditë më tepër nga kjo botë dhe më afroi edhe një ditë më tepër drejt botës tjetër. Çdo frymëmarrje, më



afron drejt frymës së fundit. Atëherë, si duhet ta përdor këtë ditë, me çfarë duhet ta mbush faqen time të sotme? Sepse, ditari im në të cilin melekët Kiramen Katibin (shkruesit/regjistruesit) shkruajnë (veprat e mia), do të dërgohet në ditën e kiametit si dosje në gjykatën hyjnore...

Nisur nga kjo, nuk duhet ta harroj kurrë, se jeta e vërtetë, është ajo e botës tjetër dhe se në këtë botë, jam dërguar për të fituar botën tjetër. Ditën time të sotme, duhet ta jetoj sikur të ishte dita ime e fundit dhe çdo frymëmarrje duhet ta konsiderojë si të fundit për mua.

“U shkatërruan ata që thanë; E bëj nesër!” thotë Pejgamberi (a.s.). Nesër nuk dihet nëse do jem gjallë apo jo! “Fale namazin si dikush që po ndahet (nga kjo botë)!..”, thotë përsëri Pejgamberi ynë (a.s.). Atëherë, namazin duhet ta fal me frikë-respekt ndaj Allahut, duhet të shlyej borxhet e mia materiale dhe shpirtërore, duhet të hallallohem me ata që kanë haqe dhe të drejta mbi mua, nuk duhet të cenoj askënd dhe nuk duhet të cenojem nga askush dhe përreth meje duhet të përhap gjithmonë mirësi e mëshirë. Shkurtimisht, duhet të zotëroj një zemër të ndjeshme dhe delikate, si ai që po ndahet nga kjo botë...

Lukmani (a.s.), ka thënë:

“Biri im! Bëj tregti me Allahun që të fitosh vazhdimisht pa pasur asnjë kapital!”

Momentet më të fitimprurëse të kësaj bote, janë ato që kalohen duke qenë të nënshtruar ndaj Allahut. Ndërsa tregtia më fitimprurëse në këtë botë, është ajo ku jepet e përkohshmja dhe fitohet e përrjetshmja. Për këtë arsye, fati më i madh i besimtarit, është kur ai i dorëzohet plotësisht urdhrave të Allahut Teala duke u bërë një rob i devotshëm.



Ai që bëhet rob i devotshëm i Allahut, shpëton nga robëria ndaj krijesave të Tij dhe fiton lirinë e vërtetë. Në të kundërt, njeriu nuk mund të shpëtojë nga të qenit skllav i tiranëve, peng i pasurisë dhe rob i dëshirave të egos. Dhe shpagesa e vetme për shpëtimin nga këto lloj robërish, është lidhja me Allahun Teala dhe dorëzimi ndaj urdhrave të Tij. Për besimtarin, në jetën e kësaj bote, nuk ka tregti më fitimprurëse se kjo, sepse ai që ia shet veten Allahut, pra që heq dorë nga dëshirat dhe epshet e egos dhe i dorëzohet plotësisht urdhrave të Allahut, ka dobi nga kjo botë. Në të kundërtën, ai që lidhet fort me këtë botë, privohet nga kënaqësia e Allahut. Në një ajet fisnik, urdhërohet:

“Kush dëshiron shpërblimin e jetës tjetër, Ne do t’ia shtojme atë. Kurse atij që dëshiron fitimin e kësaj bote, Ne do t’i japim një pjesë prej saj, por në botën tjetër nuk do të ketë pjesë (për të).” (Shura, 20)

Për të shkujdesurit që rraskapiten në këtë botë duke u përpjekur për interesat e kësaj bote në vend të kënaqësisë së Allahut, Kurani Fisnik, shprehet: **“që kanë punuar, por janë rraskapitur kot.”** (Gashije, 88/3.) Për të mos rënë në këtë përfundim të hidhur, duhet të bëjmë pjesë në kategorinë e atyre për të cilët Kurani Fisnik, shprehet:

“Në të vërtetë, Allahu ka blerë nga besimtarët jetën dhe pasurinë e tyre në këmbim të xhenetit...” (Teube, 111)

Sipas një transmetimi, ky ajet fisnik është zbritur në lidhje me besën e dhënë në Akabe nga besimtarët e Medinës, të cilët e ftuan në vendin e tyre Pejgamberin (a.s.), i cili po luftonte për teuhidin (njësimin në Allahut) në Mekë mes vuajtjesh të mëdha. Gjatë kësaj besëlidhjeje, Abdullah bin Reuaha (r.a.), u ngrit në këmbë dhe tha:



“-O Rasulallah! Mund të na vësh çdo kusht që të duash, për Zotin dhe për veten tënde.” Pas këtyre fjalëve, Pejgamberi (a.s.), tha:

“-Kushti në lidhje me Zotin tim, është që ta adhuron Atë dhe të mos i shoqëroni Atij asgjë. Ndërsa kushti në lidhje me veten time, është që të më mbron ashtu siç mbron jetët dhe pasuritë tuaja.”

Grupi i sahabëve fisnikë, që kishin ardhur nga Medina, pyetën:

“-Nëse veprojmë kështu, çfarë do të kemi si shpërblim?” Pejgamberi ynë (a.s.), përgjigjet:

“-Do të keni xhenetin!” Me të dëgjuar këtë, të pranishmit thanë:

“-Çfarë tregtie fitimprurëse! As nuk do të kthehemi nga kjo (besa e dhënë) dhe as do ta dëshirojmë kthimin!” (Ibn Kethir, Tefsir, II, 406.)

Allahu Teala, tregtinë më të bukur dhe më fitimprurëse, e përkufizon kështu:

“Padysim, se ata që lexojnë Librin e Allahut, falin nama-zin dhe japin fshehtazi apo haptazi nga ajo që u kemi dhënë Ne, mund të shpresojnë në një fitim që nuk do të humbasë. Allahu do t’ua plotësojë atyre shpërblimin dhe t’ua shtojë mirësitë e Tij...” (Fatir, 29-30)

Në këto ajete, mësojmë se hapi i parë i tregtisë që do të jetë shkak i shpëtimit të përvetshëm, është të lexosh Kuran dhe t’ua mëson atë të tjerëve, të bësh një jetë të bazuar në kriteret e Kuranit dhe të fitosh një shpirt të butë e të thellë në saj të urtësive të Tij.

Ndërsa hapi i dytë, është falja e namazit... Pra, të takohesh me Allahun në namaz. Allahu Teala, na tregon se Ai ndodhet gjithmonë me ne dhe dëshiron që edhe ne të jemi gjithmonë me Të. Kështu që, namazi i cili është edhe miraxhi i shpirtit tonë, është mundësia më e madhe e përjetimit të takimit hyjnor në kushtet e kësaj bote. Për këtë arsye, Allahu Teala, urdhëron: “... **bëj sexhde dhe afroju Zotit tënd!**” (Alak, 19)

Mirza Mazhar (Allahu e mëshiroftë), ka thënë:

“Çdo punë e ka mënyrën e vet të kryerjes. Namazi ka mbledhur në vetvete të gjitha cilësitë. Ai përmban leximin e Kuranit, salavatet për Pejgamberin (a.s.) dhe dritën e istigfarit dhe dhikrit. Nëse namazi kryhet duke pasur kujdes ndaj të gjitha cilësive të tij, në të do të shfaqen gjendjet shpirtërore më të bukura dhe më frymëzuese që i ngajnë atyre të Epokës së Lumturisë.”

Ndërsa hapi i tretë i tregtisë që do të na sigurojë shpëtimin e përjetshëm, është dhurimi fshehtas dhe haptas. Besimtari duhet të zgjedhë dhurimin e fshehtë. Mirëpo, edhe kur të jetë i detyruar të dhurojë në mënyrë të hapur, -për shkak të rrezikut hipokrizisë- duhet të tregojë kujdes më të madh në ruajtjen e sinjeritetit.

Lukmani (a.s.), ka thënë:

“Biri im! Besimtari ka dy zemra; në njërën ushqen shpresën, në tjetrën frikën.”

Në çështjet e kësaj bote, frika dhe dashuria nuk mund të bashkohen në një zemër. Mirëpo, gjendja ndryshon në çështjet shpirtërore. Nëse një besimtar i devotshëm thellohet në meditim e mirësive të panumërta të Allahut, zemra e tij mbushet me dashuri. Duke iu bindur urdhrit të Allahut; “**Lexo, me emrin e Zotit tënd, i Cili krijon** (gjithçka!)”, në sajë të çdo krijese që e



sheh me syrin e dashurisë, takohet shpirtërisht me Krijuesin. Dhe për të mos e humbur këtë afërsi e miqësi, tregon një kujdes të veçantë, sepse shqetësimi ndaj cenimit të dashurisë së Allahut, ia drithëron zemrën.

Jeta e pejgamberëve dhe të dashurve të Allahut, është e mbushur me shfaqje të tilla. Madje edhe Ibrahim (a.s.), i cili ishte Halili/Miku i Allahut, për shkak të këtij shqetësimi, iu lut Zotit; **“(O Zot!) Mos më turpëro në Ditën, kur do të ringjallen njerëzit!”**

“Hauf” dhe “Rexha”, pra frika dhe shpresa, është një ekuilibër që duhet të gjendet gjithmonë në zemrën e besimtarit. Në zemrën e besimtarit, duhet të gjendet gjithmonë në formë të ekuilibruar frika nga privimi i kënaqësisë e dashurisë së Allahut dhe nga dënimi i Tij dhe shpresa për fitimin e mëshirës dhe faljes së Tij të pafundme. E rëndësishme, është që besimtari ta ruajë këtë gjendje ekuilibri deri në frymën e tij të fundit, sepse Kurani Kerim dhe Hadithet fisnike, na bëjnë të ditur se do të ketë prej atyre që, duke qenë një pëllëmbë afër xhenetit, do të meritojnë xhehenemin dhe prej atyre që, duke qenë një pëllëmbë afër xhehenemit, do të meritojnë mëshirën e Allahut Teala.

Me një fjalë, në frymën e fundit, nuk dihet se kush do të shpëtojë me besim. Në lidhje me këtë çështje, përveç pejgamberëve dhe atyre që ata kanë përgëzuar me xhenet, askush tjetër nuk ka garanci. Megjithatë, në një ajet fisnik, urdhërohet:

“O besimtarë, nëse e ndihmoni Allahun, edhe Ai do t’ju ndihmojë dhe do t’ju bëjë të qëndroni fort në këmbët tuaja.”

(Muhammed, 7) Duke u nisur nga kjo, për të shpëtuar me besim në frymën e fundit, besimtari duhet të përpiqet gjatë gjithë jetës edhe në drejtim të kënaqësisë hyjnore, por edhe të lutet e t’i kërkojë

mbrojtje Allahut me shpresën për të arritur mëshirën e Tij. Siç shprehet edhe Jusufi (a.s.):

“...(Zoti im!) Bëj që të vdes si mysliman dhe më fut në mesin e të mirëve (në botën tjetër)!” (Jusuf, 101)

Lukmani (a.s.), ka thënë:

“Biri im! Kjo botë është një det i thellë. (Dijetarë pa urtësi dhe) Shumë njerëz, janë mbytur dhe kanë humbur në këtë det. Anija jote në këtë det, le të jetë besimi (me gjithë zemër) në Allahun. Pajisjet e anijes, le të jenë devotshmëria dhe adhurimet! Ndërsa velat e saj (që e drejtojnë), le të jetë feja! Dhe me një anije të tillë dil për udhë duke u mbështetur në Allahun. (Si përfundim) Mbase shpëton, por mbase edhe nuk shpëton!”

Pajisjet më të rëndësishme që njeriu, i cili është udhëtar i përjetësisë, duhet të marrë në këtë botë, janë padyshim besimi dhe punët e mira. Me gjithë këtë, një besimtar i devotshëm, sado punë të mira të bëjë, kurrë nuk e konsideron të sigurt se do të shpëtojë dhe do të bëhet prej banorëve të xhenetit duke u mbështetur në punët e tij. Edhe pse punët i bën në mënyrën më të bukur, ai nuk shpreson në to, por në mëshirën dhe faljen e Allahut. Kjo gjendje, është një element i rëndësishëm i devotshmërisë që i mbron besimtarët nga sëmundja e mendjelehtësisë, e cila e bën njeriun të mbështetet vetëm në punët e tij. Për këtë arsye, të dashurit e Allahut, megjithëse kanë bërë një jetë jash-tëzakonisht të devotshme, përsëri e konsideronin veten në fund të karvanit njerëzor dhe mundoheshin të shtonin edhe më tepër përprjekjet e tyre për të qenë të devotshëm me frikën se të gjithë do të shpëtonin dhe ata jo.

Halid Bagdadi, i cili për shkak të dijes dhe urtësisë që zotëronte, në kohën e tij njihej edhe si “Dielli i diejve”, në sajë



të ndjenjave që i kishte falur devotshmëria, e këshillon kështu vëllain e tij:

“...Mos shih askënd me nënçmim dhe as veten mos e konsidero të lartë! Të gjithë punën dhe mundin dedikojë adhurimeve shpirtërore dhe fizike! Megjithatë veten konsiderojë si “një të mjerë që nuk ke mundur të bësh asnjë punë të mirë”!.. Betohem në Allahun, se që prej ditës kur më ka lindur nëna, nuk besoj të kem bërë qoftë edhe një punë të mirë... Nëse nuk e sheh veten si të falimentuar në të gjitha punët e mira, ky është kufiri i fundit i injorancës. Edhe kur ta shohësh veten të falimentuar, bëj kujdes; mos e humb shpresën prej mëshirës së Allahut! Sepse për robin, begatia e mirësisë së Allahut, është më e mirë se të gjitha punët e njerëzve dhe xhinëve së bashku...”

Nga një pikëpamje tjetër, sado gjynahe të ketë bërë, asnjë rob nuk duhet t'i humbasë shpresat, duke mos e llogaritur fare mëshirën e Allahut dhe duke e konsideruar veten si banor të xhehenemit. Zoti ynë i Madhëruar, urdhëron:

“Thuaj: “O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti.” (Zumer, 53)

Për të arritur mëshirën hyjnore me të cilën lajmërohem në këtë ajet fisnik, duhet të marrim parasysh edhe këtë ajet që vjen menjëherë pas tij dhe t'i drejtohem Allahut me teube:

“Kthehuni tek Zoti juaj dhe nënshtrojeni Atij, para se t’ju vijë dënimi, sepse atëherë nuk do të mund t’ju ndihmojë kush!” (Zumer, 54)

Po ashtu, edhe Pejgamberi ynë (a.s.), ka thënë:

“Nëse besimtari do ta dinte forcën dhe mënyrën e dënimit të Allahut, nuk do të shpresonte kurrë për xhenetin. Edhe mohuesi, nëse do ta kuptonte mirë mëshirën e Allahut, nuk do t'i priste kurrë shpresat nga xheneti i Tij.” (Muslim, Teube, 23.)

Gjithashtu, edhe sahabët fisnikë, të cilët në lidhje me çështjen e frikës dhe shpresës u edukuan me frymën e Kuranit dhe Sunetit, kishin arritur një gjallëri të lartë shpirtërore dhe një zemërbutësi të jashtëzakonshme. Ibn Ebi Mulejke (Allahu e mëshiroftë), thotë:

“Arrita (të njihesha me) tridhjetë veta prej sahabëve të Rasulullahut (a.s.). Të gjithë ata kishin frikë se mos ishin hipokritë. Asnjë prej tyre, nuk mund të thoshte se kishin arritur një besim (të fortë) si ai i Xhebrilit dhe Mikailit.” (Buhari, Iman, 36.)

Madje edhe një figurë e madhe e islamit, si Omeri (r.a.), nuk e konsideronte veten të shpëtuar nga ky shqetësim. Pejgamberi (a.s.), vetëm Hudhejfeu'l-Jemanit (r.a.), ia kishte treguar personat të cilët bartnin shenja hipokrizie në zemër. Omeri (r.a.), e dinte këtë gjë dhe një ditë gjatë kohës kur ishte Halife, shkoi tek Hudhejfe dhe i rrëfeu për shqetësimin e madh që ia prishte qetësinë e zemrës:

“- O Hudhejfe! Për hir të Allahut, më thuaj; a ka shenja hipokrizie tek unë?”

Hudhejfe (r.a.), i përgjigjet:

“-O Halife! Vetëm ty të jap garanci; në ty nuk ka asnjë shenjë hipokrizie!..”

Pavarësisht të gjitha virtyteve që zotëronte, Omeri (r.a.), për shkak të ekuilibrit midis frikës dhe shpresës që kishte në zemrën e tij, është shprehur:

“Nëse nga qielli do të vinte një zë, e do të thoshte: O njerëz!

Vetëm një person do të hyjë në xhehenem», unë do të kisha frikë se mos vallë jam unë ai. E nëse do të thoshte: «O njerëz! Vetëm një person do të hyjë në xhenet», atëherë unë do të mbushesha me shpresë, se mos vallë jam unë ai.”

Me një fjalë, zemra e besimtarit duhet të jetë gjithmonë në gjendje vigjilente për shkak të frikës dhe e qetë për shkak të shpresës.

Lukmani (a.s.), ka thënë:

“Biri im! Merr nga kjo botë aq sa të mjafton! Mos u zhyt në të aq sa të dëmtosh botën tjetër! Por edhe këtë botë mos e braktis plotësisht, që të mos ngelesh nevojtar ndaj njerëzve (t’u bëhesh barrë). Agjëro aq sa të thyesh epshin. Por mos agjëro aq shumë sa (të dobësohesh e) të të pengojë nga namazi! Sepse tek Allahu, namazi është më i dashur se agjërimi.”

Besimtari duhet të jetë gjithmonë i matur, pra, duhet të ruhet nga rënia në ekstreme, qofshin ato lëshime apo teprime. Në punët e tij në lidhje me këtë botë ose me botën tjetër, madje edhe në jetën e tij të adhurimit, nuk duhet ta teprojë asnjëherë. Ai gjithmonë duhet të qëndrojë brenda kufijve që ka caktuar Allahu dhe i Dërguari i Tij duke bërë një jetë të ekuilibruar. Nga kjo, varet edhe vazhdimësia e devotshmërisë në masën e pranueshme.

Një ditë, Rasulallahu (a.s.), tha:

“- Qëndroni në rrugën e mesme. Ta dini, se askush nuk do të shpëtojë në sajë të punëve të tij.” Sahabët e pranishëm, pyetën me habi:

“- As ju nuk mund të shpëtoni, o i Dërguar i Allahut?” Pejgamberi ynë (a.s.), u përgjigj:

“- Po, as unë nuk mund të shpëtoj. Mirëpo, nëse Allahu

më fal me mëshirën dhe bujarinë e Tij, ndryshon puna!” (Muslim, Munafikin, 76, 78)

Ashtu siç neglizhenca ndaj adhurimeve do ta vërë njeriun në pozitë të vështirë në botën tjetër, po ashtu edhe veprimi me një entuziazëm të tepruar, pas një farë kohe mund të shkaktojë lodhje, mërzitje dhe gabime. Prandaj, si parim duhet marrë gjithmonë rruga e mesme. Kjo ndodhi është një shembull i bukur i këtij fakti:

Një ditë, Rasulullahu (a.s.), po u tregonte sahabëve të tij në lidhje me Kiametin. Ata u prekën shumë dhe filluan të qanin. Më vonë, dhjetë prej tyre u mbledhën në shtëpinë e Osman bin Maz’unit për të biseduar. Në përfundim të bisedës vendosën, se që prej atij momenti, ta braktisnin këtë botë, të agjëronin ditën, të kalonin gjithë natën deri në mëngjes me adhurime, të mos hanin mish, të afroheshin më rrallë tek gratë e tyre, të mos përdornin erë të mirë dhe të mos shëtitnin e të udhëtonin nëpër tokë. Kur Pejgamberi (a.s.), e mori vesh këtë, në fillim i qortoi ata, pastaj i mbledhi sahabët dhe iu drejtua me këto fjalë:

“Çfarë kanë disa, që ia bëjnë vetes haram marrëdhënien me gratë e tyre, ngrënie e pirjen, erën e mirë, gjumin dhe kënaqësitë e lejuara të kësaj bote? Padyshim se unë nuk ju urdhëroj të bëheni murgjër. Në fenë time nuk braktiset ngrënia e mishit dhe nuk ka largim nga gratë. Po ashtu, nuk mund të braktisësh as këtë botë e të mbyllesh në manastir. Udhëtimi (lëvizja nëpër tokë) i popullit tim është agjërim, ndërsa murgjëria (devotshmëria) e tyre, është xhihadi. Adhuroni Allahun, mos i shoqëroni Atij asgjë, bëni umren dhe haxhin, falni namazet, jepni zekatin dhe agjëroni Ramazanin. Bëhuni të drejtë, që edhe të tjerët të bëhen të drejtë si ju. Popujt para jush, u shkatërruan për shkak



të teprimeve. Ata ia vështirësuan fenë vetes dhe Allahu ua vështirësoi atyre. Ata që ndodhen sot në kisha dhe manastire, janë trashëgimia e tyre.”

Në lidhje me këtë, u zbrit edhe ky ajet fisnik:

“O besimtarë! Mos ia ndaloni vetes gjërat e mira, të cilat Allahu jua ka lejuar dhe mos e kaloni kufirin! Vërtet, Allahu nuk i do ata që e kapërcejnë kufirin.” (Maide, 87)

Lukmani (a.s.), ka thënë:

“Biri im! Ki frikë Allahun dhe mos u shtir para njerëzve sikur e ke frikë Allahun, me qëllim që ata të të japin ndonjë gjë, ndërkohë që zemra jote është e mbushur me gjynahe.”

Dyfytyrësia dhe abuzimi me ndjenjat fetare, është një nga cilësitë më të shëmtuara që nuk mund të përputhet kurrë me moralin islam. Të shtiresh si besimtar i devotshëm përpara njerëzve për hir të interesave personale dhe kur ndahesh prej tyre vepron në kundërshtim me besimin, shkakton dënimin e Allahut Teala, i Cili di çdo gjë që ndodhet në zemra. Për këtë arsye, Rasullullahu (a.s.), është shprehur:

“Ajo që kam më shumë frikë për popullin tim, është shirku ndaj Allahut. Me këtë, nuk dua të them, që ata do të adhurojnë Hënën, Diellin apo idhuj (të tjerë). Ajo që më të vërtetë më frikëson, janë punët që bëhen për qëllime të tjera përveç kënaqësisë së Allahut dhe dëshirat/synimet e fshehta (ndjenja e dyfytyrësisë).”

(Ibn Maxhe, Zuhd, 21.)

Ajo që e dallon besimtarin e vërtetë, është dashamirësia, sinqeriteti dhe besnikëria. Siç shprehet edhe Mevlana i nderuar:

“Ose duku siç je, ose bëhu siç dukesh!..”

Allahu Teala na e bëftë të mundur, të bëjmë një jetë të

devotshme të zbukuruar me sinqeritet, dashamirësi, besnikëri e edukatë dhe të mund të shërbejmë me entuziazmin e besimit në rrugën e kënaqësisë së Tij.

Amin!..



EBU'L HASAN HAKAKANI رحمہ اللہ

-1-

Fruti i parë i një besimi të pjekur, është mëshira. Ndërsa mëshira, kërkon që t'i dhurojmë më nevojtarëve prej asaj që posedojmë. Nëse njeriu piqet në besim, me kalimin e kohës bëhet një vend-mëshire që përfshin të gjitha krijesat. Ai që e do Allahun, do edhe krijesat e Tij. Ai që është mik i Allahut, bëhet edhe mik i krijesave të Tij. Ndërsa shikimi i të gjitha krijesave me syrin e dhembshurisë dhe mëshirës së Allahut, është fitorja që sjell pajisja me moralin islam.







EBU'L HASAN HARAKANI - 1

Ebu'l-Hasan Harakani ka thënë:

“Nëse në gishtin e njërit prej vëllezërve të mi të fesë që ndodhen midis Turkistanit dhe Shamit ngulet ndonjë gjemb, është njësoj sikur ai gjemb të ngulet në gishtin tim; guri që godet këmbën e tij, ka goditur këmbën time. Dhimbjen e tij e ndjej edhe unë. Nëse ka zemër të hidhëruar, ajo është zemra ime.”

Kjo shprehje është një shembull konkret e shfaqjes së ndjensjës së vëllazërisë në islam. Kjo shpreh shpirtin e besimtarit larg interesave të kësaj bote dhe dedikimin e plotë ndaj botës tjetër.

Të shqetësohesh me shqetësimin e vëllait të fesë dhe të kërkosht rrugëzgjdhje për të, është një adhurim shoqëror me të cilin fitohet kënaqësia e Allahut. Ndërsa indiferenca ndaj tyre, është egoizëm. Nisur nga kjo, çdo besimtar, është i detyruar ta ndjejë në zemër shqetësimin e vëllait të tij.

Pejgamberi (a.s.), na ka bërë të ditur, se të mendosh vetëm për vetveten dhe të qëndrosh indiferent ndaj vuajtjeve të vëllait të fesë, nuk përputhet me moralin Islam. Më konkretisht ai shprehet:



“Nuk është prej nesh kush nuk shqetësohet me shqetësimet e besimtarëve.” (Shih. Hakim, IV, 352; Hejthemi, I, 87)

Një ditë Ubejdullah Ahrari i cili respektonte dhe donte krijesat për hir të Allahut u sëmurë me ethe, megjithë se ndezi zjarr për t’u ngrohur përsëri dridhej nga ftohti. Pikërisht në atë moment erdhi një ndjekës i tij i cili ishte lagur, menjëherë e morën dhe e thanë për çudi ndërsa thahej ndjeksi edhe Ubejdullah Ahrarit i ikën ethet.

Besimtari duhet të ndjejë dhe të shqetësohet për çdo problem të vëllait të vet në fe. Jeta e Profetit (a.s.) ishte e mbushur me shembuj të tillë të moralit të lartë. Profeti (a.s.) gjithë jetën e kaloi duke u përpjekur për të shpëtuar ymetin.

Xherir bin Abdullah (r.a.) tregon kështu:

“Një ditë, në orët e hershme të ditës, ndodheshim pranë të Dërguarit të Allahut (a.s.). Në atë mes, u shfaq dhe erdhi një grup personash nga fisi Mudar, me rroba me vija të përhime të ngjashme me lëkurën e tigrin dhe me zhgunet e shpuara e të kaluara për qafe, pothuajse lakuriq, me shpatat ngjeshur. Me t’i parë ata si të varfër në atë gradë. Profetit i ndërroi ngjyra e fytyrës. Ai hyri menjëherë në shtëpi. Pastaj doli dhe i dha urdhër Bilalit të këndonte ezan. Pastaj Bilali këndoi ikametin dhe Profeti drejtoi faljen e namazit. Pas namazit ai mbajti një hutbe (ligjëratë), ku këndoi këtë ajet kur’anor:

“O njerëz! Ruhuni nga mungesa e respektit ndaj Zotit tuaj i cili ju ka krijuar nga një vete, ka krijuar prej tij bashkëshorten e tij dhe, pastaj ka krijuar edhe shumë gra e burra prej atyre të dyve! Pa dyshim, Allahu ju sheh dhe ju vëzhgon të gjithëve!”

(Nisa, 4/1)



Pastaj këndoi këtë ajet nga sureja “Hashr”:

“O ju që keni besuar! Kini frikë Allahun dhe secili të shohë se ç’ka përgatitur për nesër!” (Hashr, 59/18)

Pas kësaj, urdhëroi:

“Çdokush nga ju të japë sadaka nga floriri, argjendi, robat, goftë edhe një masë nga gruri dhe hurmat! Le të japë sadaka goftë edhe një hurmë!” Pas këtyre fjalëve, një njeri nga ensarët solli një torbë që mezi e ngrinte, madje që s’e ngrinte dot, aq e rëndë ishte! Banorët ishin vënë në radhë njëri-pas tjetrit. Më në fund pashë se ishin formuar dy grumbuj me ushqime dhe veshmbathje. Kurse fytyra e të Dërguarit të Allahut ndriçonte nga gëzimi!” (Muslim, Zekat, 69)

Ebu Hasan Harakani thotë:

O Zot i im! Nëse gjendet një krijesë tjetër e Jotja më e dhimbsur se unë atëherë mua më vjen turp nga vetja.

Besimtari duhet të mendojë për gjithë krijesat e Allahut në tokë. Sa më e fortë të jetë dashuria për Allahun aq më e fortë bëhet dashuria dhe respekti për edhe për krijesat e tjera. kjo është një dashuri që përhapet si valët e ujit duke përfshirë gjithë hapësirën. Njeriu përveç armiqve të Allahut duhet të ushqejë dashuri për gjithë krijesat mbi tokë. Në këtë mënyrë krijohet një harmoni në gjithë mjedisin kur shpërfaqet kjo dashuri.

Besim, do të thotë të arrish të vërtetën e dashurisë. Ndërsa dashuri, do të thotë t’ia dedikosh atë burimit absolut të tij dhe Atij që e meriton, pra Allahut të Madhëruar. Mirëpo, ai që dashuron, ndjen dashuri edhe ndaj të dashurve të atij që do. Për rrjedhojë, dashuria për Allahun, bën të domosdoshme edhe dashurinë për Profetin r, për familjen dhe shokët e tij, miqtë e Allahut dhe çdo krijesë tjetër sipas vlerës që kanë ato tek Allahu.

Poeti i nderuar, Junus Emre, është shprehur: “I duam krijesat për hir të Krijuesit...”. Ndërkohë që e thoshte këtë, ai bisedonte për zemërsisht me lulen e verdhë dhe, i dehur prej mrekullive mahnitëse, sodiste vulën e fuqisë hyjnore tek krijesat...

Ebu Hasan Harakani thotë:

O Zot! Jam rob i Joti dhe i të Dërguarit Tënd dhe shërbyes i besimtarëve.

Mrekullia më e madhe është t’i shërbesh krijesave të Allahut pa u lodhur.

Fruti i parë i një besimi të pjekur, është mëshira. Ndërsa mëshira, kërkon që t’i dhurojmë më nevojtarëve prej asaj që posedojmë. Nëse njeriu piqet në besim, me kalimin e kohës bëhet një vend-mëshire që përfshin të gjitha krijesat.

Ai që e do Allahun, do edhe krijesat e Tij. Ai që është mik i Allahut, bëhet edhe mik i krijesave të Tij. Ndërsa shikimi i të gjitha krijesave me syrin e dhembshurisë dhe mëshirës së Allahut, është fitorja që sjell pajisja me moralin islam.

Me të vërtetë që, zemra e një besimtari të përsosur, lumturohet me shpëtimin e përjetshëm të një njeriu dhe hidhërohet nëse ai gjendet në një shkatërrim shpirtëror. Kjo, sepse zemra e tij, është një oqean mëshire, që ndjen vuajtje prej humbjes së një njeriu, qoftë ai edhe armiku i tij. Për këtë arsye, ai dëshiron që askush të mos dëmtohet. Përkundrazi, ai dëshiron që të gjithë njerëzit të arrijnë shpëtimin dhe lumturinë.

Një dashuri që nuk testohet me vështirësi dhe nuk provohet me sakrifica materiale dhe shpirtërore mbetet e panjohur. Sakrifica e kësaj dashurie është shërbimi në rrugën e Allahut. Shprehja më e mirë e dashurisë ndaj Allahut është vepra.



Allahu në Kuran na jep shembull Ensarët dhe Muhaxhirët. Ata për t'i shërbyer fesë morën parasysht të gjitha rreziqet dhe vështirësitë. Ata udhëtuan nga Kina në Senarkand pa u lodhur vetëm për të shërbyer në rrugën e Allahut. Dhe Allahu u dha atyre qetësinë dhe ëmbëlsinë e besimit. Allahu për shkak të shërbimit në rrugën e Allahut i dha atyre lumturinë në këtë botë dhe botën tjetër.

Qofshim të vetëdijshëm apo jo, në fakt, ajo çka të gjithë ne kërkojmë është shpëtimi i shpirtit tonë, pra arritja e paqes dhe qetësisë. Ky është një thesar shpirtëror, që mund të fitohet në sajë të shërbimeve që kryhen si adhurime ndaj Allahut. Për këtë arsye, një besimtar i pajisur me vetëdijen e shërbimit, në çdo situatë di të gjejë mënyrën dhe mundësinë e duhur për të shërbyer në rrugë të Allahut. Po ashtu, sakrificat që bën ai për hir të Allahut, janë më të mëdha se përpjekjet dhe ambiciet e atyre që vrapojnë pas interesave të kësaj bote.

Të gjithë shërbimet që realizohen në rrugën e Allahut fshehin në vetvete një mirësi të madhe. Ata që i shërbejnë fesë dhe përpiqen të lehtësojnë problemet e njerëzve shpëtojnë njëkohësisht edhe nga problemet personale kurse ata që tregohen egoistë Allahu i le të përpëliten në problemet dhe hallet e veta.

Hasan Harakani thotë:

Një dijetar që çohet në mëngjes kërkon shtimin e diturisë, një asket kërkon shtimin e asketizmit kurse Hasan Harakani është i shqetësuar për të mbushur zemrën e vëllait besimtarë me gëzim dhe ngazëllim.

Një person erdhi te Pejgamberi (a.s.) dhe e pyeti:

- O Pejgamber! Cili nga njerëzit dhe cilat nga punët janë më të dashura tek Allahu?

Pejgamberi (a.s.), iu përgjigj:

- Njeriu më i dashur tek Allahu , është njeriu më i dobishëm për të tjerët. Ndërsa punët më të dashura tek Allahu janë të lumturosh zemrën e një myslimani, ta gëzosh atë, t'i lehtësosh një vështirësi, t'ia paguash borxhin ose t'ia shuash urinë. Kjo është aq e vërtetë, saqë për mua është më mirë të ecë me një vëlla mysliman dhe t'ia lehtësojë atij një vështirësi, sesa të mbyllem një muaj për itikaf (adhurim) në xhaminë time në Medinë. Kush e përmban veten dhe nuk zemërohet, Allahu , ua mbulon gabimet. Kush e kapërdin zemërimin e tij, edhe pse ka mundësi të kundërpërgjigjet, Allahu , në Ditën e Kijametit ia mbush zemrën me shpresë, paqe e siguri. Kush ecën me vëllain e tij për të parë nevojat e tij dhe ia plotëson ato, Allahu , ia forcon këmbët në ditën kur ato do të rrëshqasin. (Hejthemi, VIII, 191)

“Kur Allahu Y, i dëshiron mirësinë një robi të Tij, i jep atij mundësinë të plotësojë nevojat e njerëzve.” (Sejhati, II 4/3924)

Shërbimet e singerta dhe të vërteta janë një kryevepër e pjekurisë së zemrës. Dhe zemra të tilla janë “vend-shikimi hyjnor”. Shumë shërbime në rrugën e Allahut janë më të vlefshme se shumë adhurime vullnetare.

Junus Emre thotë:

Nëse duhet shko një mijë herë në haxh,

Më e mirë se gjithë këto

Është të fitosh një zemër!”

Islami kërkon tejkalimin e egozimit vetjak dhe kultivimin e altruizmit, mirësisë dhe shërbimit social në gjithë shoqërinë islame. Kujdesi për vëllain besimtar dhe angazhimi në zgjidhjen e problemeve të tij është një nga ibadetet e rëndësishme sociale.

Prandaj besimtari nuk duhet ta harrojë për asnjë moment këtë detyrë shumë të rëndësishme.

Këtë të vërtetë e përshkruan shumë bukur kjo ngjarje e Maruf Kerhit:

Një ditë kur Maruf-i Kerhi ishte agjërueshëm shkon në Pazar. Aty takon një që jepte ujë duke thënë:

Kush pi nga ky ujë e mëshiroftë dhe i dhëntë begati Allahu.

Maruf Kerhi piu nga ky ujë duke e prishur në këtë mënyrë agjërimin.

Kur e pyetën për këtë i tha:

Dëshiroja të përfitoja nga begatia e lutjes.

Pastaj pa në ëndërr sikur kishte vdekur dhe e pyesin për gjendjen atje:

Tha: Më fali Allahu për hir të asaj lutje të singertë të personit që jepte ujë.

Harakani thotë:

“Një besimtar që e kalon kohën nga mëngjesi deri në mbrëmje pa lënduar një vëlla në fe, është sikur atë ditë ka jetuar me të Dërguarin e Allahut (s.a.s.), deri në mbrëmje. Nëse e lëndon një besimtar, Allahu Teala nuk ia pranon atij adhurimin e asaj dite.”

Allahu thotë:

Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët. (Teube, 128)

Profeti (a.s.) ka qenë shumë i mëshirshëm dhe i dashuri ndaj besimtarëve. Profeti (a.s.) interesohej dhe kujdes për gjendjen e gjithë ymetit. Prandaj njerëzit e dashur të Allahut lëndimin e një personi nga ymeti e kanë konsideruar një gabim të rëndë.

Njeriu është krijesa më e nderuar dhe më e përsosur e Allahut të Madhëruar. Ndërsa zemra e tij, është vend-shikimi hyjnor. Nga kjo, kuptohet qartë se sa gjynah i rëndë është t'i thyesh zemrën qenies njerëzore. Myslimani duhet të ketë një zemër delikate e të butë dhe nuk duhet të lëndojë askënd, sepse, besimtari që ka përkufizuar dhe ka dashur Resulullahu (a.s.), është njeriu, i cili shkon mirë me të gjithë dhe të gjithë shkojnë mirë me të.

Hasan Harakani thotë:

O Zot! Njerëzit të cilit i kam lënduar sapo më shikonin ndryshonin rrugë. O Zoti im sa mëshirë madh që je Ti që megjithëse i shkelim urdhëresat tuaja në çdo moment Ti përsëri je me ne!

Allahu me mëshirën e madhe të Tij shumë gabime dhe mëkate që bëjmë i fal. Allahu megjithëse i plotfuqishëm për t'i dënuar, e mban derën e pendimit gjithmonë hapur duke i dhënë njerëzve mundësinë për t'u rikthyer tek Ai.

Midis cilësive dhe attributeve të Allahut që përmenden më shpesh janë mëshira dhe falja. Prandaj Ai kërkon prej nesh që të jemi të mëshirshëm dhe falës kundrejt njerëzve.

Allahu kërkon prej nesh të pajisemi me moralin Kuranor. Në lidhje me këtë moral shembulli ideal është Profeti (a.s.), jeta e tij është e mbushur plot me shembuj të moralit kuranor.

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) i pati falur edhe armiq të tij më të tërbuar. Profeti (a.s.) pati falur falur ata që e goditën me gurë në Taif duke bërë lutje për faljen e tyre. Ai fali Hebbab bin



Esved i cili ia pati rrëzuar të bijën Hz. Zejneb nga deveja dhe, për pasojë që bërë shkaktar për vdekjen e saj, Vahshiun që ia pati vrarë xhaxhain tij të dashur Hz. Hamza, dhe birin e Ebu Xhehlit, Ikrimë (r.a.) i cili pati ushtruar çdo lloj dhune kundër muslimanëve për vite me radhë.

Profeti (a.s.) shpalli amnisti të përgjithshme për gjithë popullin e Mekes kur e çliroi. Shembuj të tillë falje janë pafund në historinë e Profetit (a.s.)

Edhe ne si ndjekës të Profetit (a.s.) duhet të jemi të mëshirshëm dhe falës ndaj gabimeve që bëhen kundrejt nesh. Ne duhet të pajisemi me moralin kuranor dhe çdo vështirësi duhet ta konsiderojmë si një sprovë të kësaj bote. Për të kaluar sprovat e kësaj bote duhet të tregojmë durim.

Kjo ngjarje që ka ndodh në periudhën e lumturisë është shumë domethënëse:

Ebu Bekri, r.a, e ndihmonte me ushqime dhe me çfarë kishte mundësi, një të varfër me emrin Mistah. Kur ai pa se në mesin e atyre që po hidhnin baltë mbi figurën e bijës së tij, Aishes, r.a, ishte edhe Mistahu, u betua se asaj familjeje nuk do t'i bënte më asnjë mirësi. Mirëpo familja e Mistahit ra në një gjendje shumë të keqe, kur Ebu Bekri, r.a, ia ndërpreu ndihmat. Në lidhje me këtë situatë u shpall ky ajet:

“Njerëzit e ndershëm dhe të pasur ndër ju të mos betohen se nuk do t’u japin të afërmeve, të varfërve dhe të mërguarve në rrugën e Allahut; le t’i falin ata dhe të mos ua marrin për keq! Vallë, a nuk doni ju që t’ju falë Allahu? Allahu është Falës e Mëshirëplotë.” (Nur, 22)

“Mos e bëni pengesë betimin në Allahun për kryerjen e

veprave të mira, largimin prej të ligave dhe për pajtimin e njerëzve! Allahu i dëgjon dhe i di të gjitha.” (Bekare, 224)

Pas shpalljes së këtij ajeti, Ebu Bekri, r.a, u shpreh:

- Unë me të vërtetë kërkoj prej Allahut të më falë!

Pastaj dhuroi kefaretin e betimit dhe vazhdoi ta ndihmonte atë familje. (Buhari, Megazi, 34; Muslim, Tevbe, 56)

Të falësh e, të falësh të tjerët për të merituar faljen e Allahut të Lartmadhëruar, është vizioni shpirtëror i çdo besimtari të pjekur.

Përsëri në një ajet tjetër thuhet:

Nxitoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe Xhenetit, hapësira e të cilit është sa qiejt e Toka dhe që është përgatitur për të devotshmit,. të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në mirëqenie, edhe kur janë në vështirësi, e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. Allahu i do bamirësit. (Ali Imran, 133-134)

Pra Allahu kërkon të falim njerëzit në mënyrë që të fitojmë faljen dhe amnistinë hyjnore.

Ka një ngjarje e cila është bërë shkak që Hazreti Mahmud Sami Ramazanogllu, i cili ishte prej miqve të Zotit, t'i drejtohej edukimit shpirtëror përgjatë viteve të rinisë:

Hazreti Sami Efendi e kreu me nota shumë të larta Fakultetin e Juridikut në Daru'l-Funun. Kur po mendonte për t'u kthyer në vendin e tij, Adana, një ditë u takua me një mik të Allahut në sheshin Bejazit. Ky mik i Zotit, pas një prezantimi të shkurtër, i tha:

“A na lejoni t’ju japim një edukim të ri?” – dhe e çoi atë te



teqeja Kelami. Ndërsa po bisedonin përgjatë rrugës, ky mik i Allahut i tha Sami Efendiut:


“Bir! Edukimi ekzoterik që ke marrë, nuk është i mjaftueshëm! Po të sugjeroj edukimin e vërtetë i cili i jep njeriut lumturinë e të dy botëve:

Mësimi i parë i mejtepit të urtësisë që sapo do të fillojmë, është TË MOS LËNDOSH asnjë njeri. Ndërsa mësimi i fundit është TË MOS LËNDOHESH asnjëherë...”

Allahu në bëftë prej atyre që arrijnë një pjekuri të tillë shpirtërore. Allahu na bëftë prej atyre që i duan dhe respektojnë njerëzit për hir të Allahut dhe jo për përfitime të kësaj bote. Allahu na shtoftë dashurinë, mëshirën dhe shërbimin në rrugën e Tij.

Amin...





EBU'L HASAN HAKAKANI رحمہ اللہ

-2-

Edukimi i njëanshëm dhe i privuar nga aspekti shpirtëror është i mangët. Në edukim, ekuilibri fizik dhe metafizik është kusht i domosdoshëm. Përndryshe, njeriu do të bëhet si zogu që mundohet të fluturojë me një krah dhe bie për e një maceje të uritur.





EBU'L HASAN HARAKANI - 2

Ebu'l Hasan Harakani ka thënë:

“Përçarjen dhe dëmin që i shkaktojnë fesë dy persona, nuk e bën as shejtani:

- 1) Dijetari, ambicia e të cilit është kjo botë;
- 2) Sufisti amator!” (Attar, Tezkiretu'l-Evlja, fq. 624.)

Për të bërë një jetë të mbushur me devotshmëri të pranuar tek Allahu, është e domosdoshme të zotërohet dija, vepra dhe devotshmëria, të gjitha së bashku. Pa njohur Kuranin dhe Sunetin, është shumë e vështirë të ruhet rruga e devotshmërisë. Mirëpo edhe vetëm dija nuk mjafton. Prandaj, është e nevojshme të arrihet edhe devotshmëria, duke zbatuar Kuranin dhe Sunetin.

Mburoja shpirtërore me e fortë, e cila e ruan orientimin e zemrës prej hileve dhe kurtheve të egos e të shejtanit, është ndjenja e devotshmërisë. Devotshmëria është ndjenja e besimit që të detyron të ruhesh prej haramëve, madje edhe prej të dyshimtave, me frikën e humbjes së kënaqësisë dhe dashurisë së



Allahut. Në të njëjtën kohë, kjo ndjenjë të bën që edhe hallallet t'i përdorësh më me kujdes, duke u shqetësuar për llogarinë në peshoren hyjnore.

Qëllimi dhe maja e dijes është “marifetullah”; pra, “njohja e Allahut me zemër”. Një rob që e njeh Allahun me zemër, në të njëjtën kohë i frikësohet Atij ashtu siç e meriton. Për rrjedhojë, edhe dijetarët që përmenden në ajetin fisnik, **“...Në të vërtetë, nga robërit e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët...”**, janë dijetarët e devotshëm të cilët e kanë kuptuar “dobësinë” e tyre përballë fuqisë dhe madhësisë hyjnore të Allahut Teala.

Nisur nga kjo, dituria e një dijetari, në gjendjen dhe sjelljen e të cilit nuk vërehen shenja të devotshmërisë, nuk ndryshon aspak nga dituria e Iblisit (shejtanit), sepse edhe ai zotëronte shumë dituri. Mirëpo, me këtë dituri larg devotshmërisë, ai nuk arriti ta ruante pozitën e lartë që gëzonte tek Allahu. Përkundrazi, kjo dije e çoi atë në mendjemadhësi dhe arrogancë, duke e fryrë edhe më shumë egon e tij. Kjo e devijoi atë dhe u bë shkak që ai të meritonte mallkimin e Allahut. Pra, Iblisi e përdori dijen e tij në devijim.

Nga kjo, kuptohet se dija është si një thikë me dy presa, e cila mund të jetë e dobishme apo e dëmshme në varësi të gjendjes shpirtërore të atyre që e përdorin. Ajo mund të përdoret edhe për mirë edhe për keq.

Një njeri, i cili nuk është ngritur shpirtërisht me dashurinë dhe njohjen e Allahut, me sinqeritet dhe devotshmëri, -sado dije të ketë- është i dënuar të ngelet i papjekur e i paformuar. Për shembull, nëse ai arsimohet e bëhet doktor, me këtë pjekuri e formim që ka, në vend që të bëhet shërues për njerëzit, ai mund të bëhet edhe një kasap që merret me trafik organesh për inter-



esa personale. Nëse bëhet jurist, në vend që të mbajë drejtësi, ai mund të bëhet edhe lideri i një organizate kriminale, një tiran apo edhe një xhelat.

Edukimi dhe arsimimi i vërtetë nuk do të thotë vetëm depozitim dijes. Që dija t'i garantojë njeriut dobi në këtë botë dhe në botën tjetër, është e domosdoshme që njeriu të kalojë nga një edukim shpirtëror, si rezultat i të cilit do të ngrihet shpirtërisht dhe do të piqet moralisht.

Qëllimi i tasavvufit është zhvillimi i aftësive shpirtërore duke pastruar egon. Kjo, sepse një ego e cila është skllave e ambicieve, e ka më të lehtë ta përdorë diturinë që zotëron për interesa personale. Të keqen që nuk mund ta bëjë një i paditur me injorancën e tij, egoja mund ta bëjë shumë lehtë me diturinë e saj.

Historitë mësimdhënëse që tregohen në Kuran në lidhje me Karunin, Bel'am bin Baura dhe fatzinj të tjerë si këta, na bëjnë të kuptojmë se ata nuk u shkatërruan për shkak të mungesës së dijes. Ata ishin njerëz shumë të ditur. Mirëpo, nuk ishin “të devotshëm” në lidhje me çështjet që kishin dituri. Një ditë, një prej sahabëve fisnikë, Jezid bin Selem Xhufi (r.a.), shkoi tek Pejgamberi (a.s.) dhe i tha:

“O i Dërguari i Allahut! Unë kam dëgjuar shumë hadithe prej jush. Mirëpo, kam frikë se ato që kam dëgjuar më pas, do të më bëjnë të harroj ato që kam dëgjuar më parë. Prandaj më thoni një fjalë gjithëpërfshirëse (që do të zërë vendin e të gjithave)!”

Pasi e dëgjoi me vëmendje, Pejgamberi (a.s.), i tha:

“Ki frikë (ji i devotshëm) ndaj Allahut në lidhje me ato që di! (Kjo të mjafton)” (Tirmidhi, Ilm, 19/2683.)

Është e pamundur që një rob të dijë gjithçka. Mirëpo, nëse

ai tregohet i devotshëm dhe ka frikë Allahun në lidhje me ato që di, kjo do të bëhet shkak që zemra e atij robi të anojë nga e drejta dhe e dobishmja si një mirësi hyjnore edhe në çështjet ku nuk ka dituri. Gjithashtu, kjo mund të bëhet shkak që ai të mësojë edhe atë që nuk di. Në një ajet fisnik urdhërohet:

“...(o besimtarë), **kini frikë Allahun! Allahu ju mëson ju** (për atë që keni nevojë)...” (Bekare, 282)

Komentuesi i famshëm i Kuranit, Kurtubiu, në komentimin që i ka bërë këtij ajeti shprehet:

“Në këtë ajet gjendet premtimi i Allahut se Ai Vetë personalisht do t’u mësojë dituri atyre që ia kanë frikën Atij. Pra, Allahu i Madhëruar do t’i falë zemrës së robit të devotshëm një dritë me të cilën do të kuptojë të vërtetat në lidhje me Të dhe do të mund ta ndajë të vërtetën nga e kota.” (Kurtubi, III, 406.) Pra, Allahu i Madhëruar do t’u falë fllade frymëzimi prej urtësive dhe të vërtetave hyjnore zemrave të pastra të besimtarëve që jetojnë me devotshmëri në përputhje me ato që kanë mësuar. Mirëpo, ata që largohen prej devotshmërisë dhe i robërojnë zemrat e tyre pas ambicieve të kësaj bote dhe dëshirave të egos, edhe sikur të jenë njerëz të dijes, nuk mund të shpëtojnë nga devijimi në rrugë të gabuara.

Mevlana i nderuar shprehet:

“Ka shumë dijetarë pa urtësi; ata e kanë mësuar dijen përmendsh, por nuk kanë mundur të bëhen miq të dashur të Allahut!”

Pra, në vend që dituria t’i afrojë tek Allahu, ajo është kthyer në një perde moskokëçarjeje që shton largësinë nga Ai.

Na duhet të themi se një nga gabimet që sot po përhapet



gjithnjë e më shumë në shoqëri, është humbja e aspektit shpirtëror të “dijes” në mendjet njerëzore. Dija është një nga atributet thubuti të Allahut të Madhëruar. Ai është zotërues i dijes së plotë dhe absolute. Pra, dija e Tij përfshin gjithçka që ka ndodhur dhe do të ndodhë. Asgjë nuk mbetet jashtë dijes së Tij. Ndërsa të gjitha dijet fizike e metafizike që i janë dhënë birit të njeriut, janë veçse një thërrime prej këtij atributi të Allahut të Madhëruar.

Qëllimi i vërtetë i shfaqjes së këtij atributi të Allahut tek njerëzit, është që robi të arrijë thellësitë e ndjenjave duke e kuptuar drejtë fuqinë dhe madhështinë hyjnore. Si rezultat i kësaj, robi do të fillojë të shikojë çdo gjë me syrin e urtësisë, duke zotëruar edhe aspektin e urtësisë së të gjitha dijeve që lexon e mëson.

Mirëpo, botëkuptimi i sotëm i dijes nuk kalon përtej zbulimit dhe evidentimit të ligjeve fizike të materies që Allahu ka krijuar në gjithësi. Në këtë mënyrë, anashkalohet procesi i njohjes së Allahut, i Cili i ka vendosur këto ligje, pra neglizhohet thelbi i vërtetë i kësaj çështjeje. Shoqërisë nuk i shpjegohen shfaqjet e artit hyjnor dhe ajo nuk edukohet për t'u lidhur shpirtërisht me Allahun, i Cili është edhe Artisti i të gjitha këtyre shfaqjeve. Për rrjedhojë, formohet një botëkuptim diturie i mangët dhe i përgjysmuar, si zogu me një krah. Mirëpo, edukimi i njëanshëm dhe i privuar nga aspekti shpirtëror është i mangët. Në edukim, ekuilibri fizik dhe metafizik është kusht i domosdoshëm. Përndryshe, njeriu do të bëhet si zogu që mundohet të fluturojë me një krah dhe bie pre e një maceje të uritur.

Nisur nga kjo, mund të themi se fëmijët të cilët janë edhe një amanet i rëndësishëm i Allahut, duhet të edukohen me dy krahë. Atyre duhet t'u mësohet kjo botë dhe bota tjetër të dyja së bashku, brenda ekuilibrit fizik dhe metafizik, trup dhe shpirt, mendje dhe zemër.

Së bashku me edukimin e mirë profesional, fëmijët tanë duhet të marrin edhe edukimin shpirtëror. Ata duhet të edukohen si doktorë, inxhinierë, mësues, punëtorë, biznesmenë, nëpunës dhe drejtues të virtytshëm, të devotshëm, të singertë, të sjellshëm, të ndërgjegjshëm dhe të moralshëm.

Shumë prindër të cilët thonë “të shkollojmë fëmijët, të shpëtojnë veten”, për fat të keq nuk tregojnë të njëjtën përpjekje në mësimin e shpëtimit të vërtetë, që është ai i botës tjetër. Madje edhe shumë familje fetare kujtojnë se arsimimi është vetëm fitimi i një diplome në jetën e kësaj bote. Shumë prej tyre i interpretojnë sipas qejfit edhe disa nga të vërtetat dhe parimet islame, të cilat nxisin për mësimin e diturive, siç janë: “Femra e meshkuj, të gjithë e kanë për detyrë të mësojnë dije”, “Diturinë duhet ta marrësh, qoftë ajo edhe në Kinë”, “Vdekja e dijetarit, është si vdekja e botës”, “nuk janë të barabartë ata që dinë me atë që nuk dinë”.

Ajo që kuptojnë ata në lidhje me këto parime, është vetëm në këtë formë; “Djali/vajza ime të studiojë, të mbarojë universitetin, të bëjë masterin dhe doktoraturën, të mësojë ndonjë gjuhë të huaj jashtë shtetit dhe të bëjë karrierë. Pastaj të gjejë një punë me rrogë të mirë, që t’i hapet edhe kështu”. Në vend që përkrah arsimimit në dijet e kësaj bote të kryhet edhe arsimimi në dijet që do ta shpëtojnë atë në botën tjetër, këto të fundit ngelen në plan të dytë, madje ndonjëherë as që mendohet fare në lidhje me to.

Në bisedat që bënte i nderuari Sami Efendiu, shprehej se dituria e vërtetë është të ndjesh në zemër fuqinë dhe madhësinë e Allahut të Madhëruar. Madje, mirësinë e kësaj diturie e shprehte sa herë që kishte mundësi. Një ditë, një person që



kishte ardhur për ta vizituar, dëshironte të merrte edhe duanë e hoxhës së nderuar, por ta njihte atë edhe me nipat e vet. Kur hynë brenda, u përshëndetën me selam dhe duke ia prezantuar nipat e vet, i tha: “I nderuar! Këta djem kanë studiuar në Amerikë dhe janë bërë inxhinierë. Dëshirojmë të marrim edhe duanë tuaj!”. Mirëpo, i nderuari Sami Efendiu, me një buzëqeshje shumë domethënëse, tha:

“Edhe unë i varfri jam diplomuar në Daru'l-Funun/Universitet. Por arsimi i vërtetë është “marifetullahu” (njohja e Allahut)!”

Sot, për shkak se në shoqëri shqetësimi për çështjet e kësaj bote është në plan të parë, nuk reagohej aspak ndaj helmimit të botës shpirtërore të fëmijëve. Në shoqëri nuk vërehet asnjë shqetësim i tipit: “A do të mund të arsimohet djali/vajza ime në një ambient ku fitohet kënaqësia e Allahut, apo në një ambient ku do të cenohen ndjenjat e tij/saj shpirtërore?” Për fat të keq, në ditët tona ekzistojnë shumë familje myslimane të cilat janë përfshirë nga kjo mungesë vetëdijeje, njësoj si trungjet që vihen para nga përrenjtë e rrëmbyer.

Po përse kemi ardhur në këtë botë? Përse do ta braktisim këtë botë pas një farë kohe? Çfarë do të bëhet me ne në varr dhe pas tij? Në përgjithësi, brezat e rinj rriten injorantë në lidhje me këto tema. Mendjet e reja që merren me mësimin e dijeve dhe mendojnë se bëjnë një punë që vlerësohet tek Allahu, lihen në injorancë ndaj dijes së vërtetë që lavdërohet në Kuran. Po, në Kuranin Fisnik, urdhërohet: “**...A janë të barabartë ata që dinë me ata që nuk dinë?..**”, duke na nxitur të bëhemi prej atyre që “dinë”. Mirëpo, në krye të po të njëjtit ajet, përmenden tri cilësi të atyre që janë “dijetarë” në kuptimin e vërtetë të fjalës:

1- Të kryesh adhurime në kohën para agimit duke bërë sexhde dhe qëndruar në këmbë.

2- Të shqetësohesh për botën tjetër. (Të përpiqesh për shpëtimin e përjetshëm. Kjo, sepse përveç pejgamberëve dhe atyre për të cilët na kanë lajmëruar ata, askush tjetër nuk e ka të garantuar se do ta japë frymën e fundit me besim.)

3- Të shpresosh në mëshirën e Zotit. (Të jetosh duke u lutur e kërkuar strehim/mbrojtje tek Allahu, sepse të gjitha veprat tona të mira kanë nevojë për pranimin e Allahut.)

Padyshim se në këtë botë kemi ardhur për të fituar botën tjetër. Ndërsa dijen, Allahu na e ka falur për të njohur Atë dhe për t'u përgatitur për botën tjetër, e cila është jeta e vërtetë. Qëllimi i vërtetë i diturisë që e bën njeriun të fitojë vlerë tek Allahu, është njohja e këtyre të vërtetave dhe jetësimi i tyre në formën e duhur. Pra, qëllimi i vërtetë i dijes nuk është vetëm arritja e pozitave të larta, pasurisë dhe rehatisë në këtë botë. Jeta kalimtare e kësaj bote është vetëm një pjesë e shkurtër e udhëtimit për në botën e përjetshme. Ne, përkrah arritjes së mirësive të kësaj bote, nuk duhet të harrojmë kurrë se në këtë botë ndodhemi për të fituar botën tjetër dhe se nuk duhet të qëndrojmë indiferentë ndaj dijes që do të na sigurojë lumturinë dhe shpëtimin e përjetshëm.

Sot shohim shumë të rinj me dije e kulturë të gjerë që kanë mbaruar universitetin dhe specializimet e larta. Por për fat të keq, ata nuk ia kanë fare haberin kulturës së Kuranit dhe Sunetit. Madje, edhe studimet që kanë kryer kujtojnë se janë prej diturisë që lavdërohet në Kuran. Mirëpo, njohuritë që nuk e shpjen mendjen dhe zemrën e njeriut tek Allahu dhe kuptimi i fuqisë dhe madhësisë hyjnore, mbase në këtë botë mund t'i falin atij grada apo pozita, por ato nuk mund ta shpëtojnë atë nga gjendja e keqe në jetën e përjetshme. Puna dhe përpjekjet që shpenzohen për një arsimim të tillë të njëanshëm, është një



fatkeqësi e hidhur. Është njësoj sikur të hidhje një diamant të çmuar në plehra. Ja pra, kjo e vërtetë duhet kuptuar pa u bërë shumë vonë dhe të punohet për një edukim, i cili do të jetë i pranueshëm tek Allahu.

Veçanërisht në studimin e diturive fetare, më parë duhet kryer edukimi shpirtëror që e ngre nivelin e botës së zemrës, duke u fokusuar në forcimin e devotshmërisë. Kjo, sepse ajo që e bën njeriun të pranuar tek Allahu, nuk është diploma e studimeve fetare, por devotshmëria në zemrën e tij. Studimet fetare të privuara nga devotshmëria, nxjerrin në pah “prishës të fesë” me gradën “dijetar të fesë”, të cilët edhe të vërtetat hyjnore i vlerësojnë në varësi të interesave të kësaj bote dhe egos së tyre. Njerëz të tillë anojnë nga ambiciet e egos së tyre, si dëshira për pasuri, epsh dhe famë. Për rrjedhojë, edhe në fetvatë e tyre do të anojnë nga interesat personale, duke neglizhuar “ndjekjen e Kuranit dhe Sunetit” dhe duke “shpikur në emër të fesë”. Po ashtu, duke përdorur injorancën e popullit, që ka ardhur si rezultat i mangësisë së edukimit fetar, ata mund të shtrembërojnë shumë gjykime fetare duke futur nga një gabim midis dhjetë të saktave. Në emër të shërbimit ndaj dijes, ata shkatërrojnë besimin e shoqërisë.

Gjatë historisë dëshmohet shpesh se si dijetarë të fesë, të privuar nga devotshmëria, nuk kanë ngurruar aspak të interpretojnë gjykimet fetare sipas interesave të veta. Ata janë ulur aq poshtë, sa që kanë preferuar të kënaqin persona të caktuar prej të cilëve shpresonin diçka, në vend që të kërkonin kënaqësinë e Allahut. Nëse i hedhim një sy historisë së feve, shohim se në këtë mënyrë është prishur edhe feja hebraike dhe ajo e krishterë, gjë të cilën tashmë e dinë të gjithë.

Gjithashtu, në histori shohim se ka pasur edhe dijetarë të devotshëm, të cilët e kanë ruajtur maturinë e dijes së tyre, duke mos lëshuar asnjë fije peri në gjykimet hyjnore.

Njërit prej juristëve më të mëdhenj të islamit, imam Ebu Hanifes (Allahu e mëshiroftë), i ishte propozuar posti i gjykatësit të Bagdadit, që ishte edhe posti më i lartë pas Halifes. Mirëpo Ebu Hanife, i cili e dinte mirë se fetvatë e tij do të shtrembë-roheshin dhe do të bëheshin mashë e punëve të pista nga ana e drejtuesve në pushtet, e refuzoi këtë propozim. Për shkak se nuk e pranoi këtë propozim, Imami i nderuar ra në burg dhe u dënua me kërbac. Ebu Hanife preferoi më mirë të hante kërbac në burg, se sa të shtrembëronte gjykimet fetare. Ata që e dënuan dhe e torturuan shkuan siç erdhën, por Ebu Hanife vazhdon të jetojë në zemrat e Ehl-i Sunnet ue'l-Xhematit si Imam Adhami dhe të kujtohet vazhdimisht me dua të mira.

Nisur nga kjo, qëndrimi i fesë dhe botës në paqe e qetësi është i lidhur fort me dijetarët që punojnë me diturinë e tyre, që jetojnë me devotshmëri dhe nuk lëshojnë pe nga e vërteta, qoftë edhe nëse e paguajnë me jetën e tyre. Ndërsa ne duhet të tregohemi jashtëzakonisht të kujdesshëm se nga e marrim fenë, duke u përpjekur të përfitojmë prej frymëzimit shpirtëror të njerëzve me besim të fortë, të singertë dhe të ditur.

I nderuari Kadi Shurajh i shkroi një letër Omerit (r.a.), ku e pyeste se çfarë gjykimi të jepte në lidhje me një çështje. Ndërsa Omeri (r.a.), si përgjigje i shkroi këta rreshta:

“Gjyko me ato që gjenden në Librin e Allahut. Nëse nuk e gjen aty, gjyko me Sunetin e të Dërguarit të Allahut! Por nëse nuk e gjen as në Librin e Allahut dhe as në Sunetin e të Dërguarit të Tij, gjyko me gjykimet që kanë dhënë njerëzit (dijetarët) e mirë (devotshëm)...” (Nesai, Kudat, 11/3.)



Nuk duhet harruar se, nëse tek dikush ka dituri por nuk ka vepra; ose ka dituri dhe vepra, por nuk ka sinjeritetet dhe devotshmëri; në të dyja rastet përfundimi është humbja. Allahu i Madhëruar i përshkruan dijetarët që e përdorin diturinë e tyre për interesat e veta, në Kuranin Fisnik si: **“...gomerë që bar-tin libra...”,** ndërsa në lidhje me ata që punojnë në mënyrë të pavetëdijshme larg sinjeritetit dhe devotshmërisë, thotë: **“Mjerë për ta...”**.

Për sa i përket çështjes së “sufistëve amatorë”, të cilët bëhen shkak për fitne/ngatërresa në fe dhe të cilët i nderuari Ebu'l-Hasan Harakani, i përmendi në fillim, mund të themi:

Pikësëpari duhet të theksojmë se tasavvufi i vërtetë është një edukim shpirtëror, i cili duhet të bëhet për të pastruar zemrën dhe për t'ia kushtuar atë vetëm Allahut. Ai është një xhihad/luftë e madhe që nuk ka paqe kurrë dhe që zhvillohet kundër egos, për t'u pastruar nga të gjitha punët dhe sjelljet që të largojnë prej Allahut të Madhëruar. Gjithashtu, ai është përpjekja për të jetuar sipas parimeve të Kuranit dhe Sunetit.

Sufistët amatorë, që pandehin se jetojnë sipas parimeve të “devotshmërisë” pa e njohur aspak kuptimin e vërtetë të tasavvufit, mund të ndikojnë tek disa njerëz me njohuri fetare të cekëta dhe t'i dëmtojnë ata. Gjatë procesit të pastrimit të egos në rrugën e edukimit shpirtëror, si rezultat i luftës (me egon) dhe disa ushtrimeve shpirtërore, në zemër fillojnë të shfaqen disa perceptime e frymëzime. Mirëpo këto nuk janë synimi i tasavvufit; këto janë vetëm imagjinata dhe iluzione që duhen kapërcyer. Përveç kësaj, për të kuptuar nëse kjo gjendje është apo jo prej Allahut, është i nevojshëm një mësues i përkryer. Ky mësues i analizon këto perceptime e frymëzime nën dritën e Kuranit dhe

Sunetit dhe në fund u jep nxënësve të tij këshillat e duhura, duke i ndihmuar ata të qëndrojnë në rrugë të drejtë.

Mirëpo disa sufistë, të cilët përpallen me gjendje të tilla pa i përvetësuar mirë parimet e rrugës së Kuranit dhe Sunetit ose pa pasur një mësues, i cili do t'i udhëzojë sipas parimeve të Islamit, mund të bien pa e kuptuar fare në kurthin e egos dhe shejtanit. Duke pandehur se kanë arritur përsosmërinë vetëm pse kanë përjetuar disa shenja shpirtërore, ata mund t'u japin njerëzve përreth tyre mendime të drejta apo të gabuara dhe mund të fillojnë të interpretojnë ajetet dhe hadithet sipas dijes së tyre të mangët. Njerëz të tillë të paditur, në mënyrë të pavetëdijshme dhe me mendimin se po i udhëzojnë, mund t'i nxjerrin nga rruga ndjekësit e tyre.

Nisur nga ky fakt, i nderuari Abdulhak Guxhduvani, e këshilloi nxënësin e tij me këto fjalë: “Kurrë mos qëndro larg dijes! Mëso fikhun dhe hadithin! Por qëndro larg sufistëve të paditur, sepse ata janë prishësit e rrugës së fesë dhe armiqtë e islamit.”

Përveç këtyre, disa sufistë të paditur mund të kenë edhe aftësi të jashtëzakonshme. Duke përdorur xhindët, ata mund të mësojnë gjëra të fshehta dhe i bëjnë njerëzit të besojnë se kjo arrihet për shkak të aftësisë së tij shpirtërore. Ndërsa njerëzit e paditur, mendojnë se: “Këtij njeriu i është hapur syri i zemrës, prandaj e diti se çfarë kisha në zemër”. Gjendjet e jashtëzakonshme si, “Hiss-i kable'l-vuku”, pra perceptimi i disa gjërave para se të ndodhin, ose njohja e tyre, është një lloj sprove e Allahut për disa robër të Tij. Këto lloj perceptimesh, mund të dalin të sakta, por edhe të gabuara...

Kurtubiu, në lidhje me çështjen e gajbit (të fshehtës), transmeton një ngjarje:



“Njëherë, një fallxhor shkon tek Haxhaxhi i cili pasi ia lidh sytë, merr në dorë disa gurë, i numëron dhe e pyet:

«Sa gurë ka në dorën time?» Fallxhori e gjen saktë numrin e gurëve. Herën e dytë, Haxhaxhi merr një grusht me gurë pa i numëruar dhe i thotë:

«Pa na thuaj tani, sa gurë ka në dorën time?» Fallxhori përpiket ta gjejë, por kësaj here gabon. Pastaj thotë:

«O prijës! Mendoj se numrin e tyre nuk e dini as ju?!» Ndërsa Haxhaxhi, thotë:

«Jo, nuk e di.»

«Atëherë, atë që nuk e dini ju, nuk e di as unë.»- tha fallxhori. Haxhaxhi e pyeti:

«Ku qëndron dallimi i kësaj me të parën?» Fallxhori u përgjigj:

«Më parë ju i numëruat gurët. Prandaj dhe numri i gurëve doli nga kufijtë e gajbit/të fshehtës. Ndërsa këta nuk i numëruat. Pra ky është edhe gajbi.» Më pas lexon ajetin 65 të sures en-Neml: **«Kudo qoftë, në qiell apo në tokë, përveç Allahut, askush tjetër nuk i di të fshehtat...»**

Kjo ndodhi është një shembull tipik i aftësisë së leximit të mendjes së njerëzve. Pra, këto lloj aftësish, jo patjetër duhen shpjeguar me grada të larta shpirtërore. Kjo, sepse edhe disa indianë, në sajë të disa ushtrimeve shpirtërore, mund të shpalosin aftësi të jashtëzakonshme, si ecja këmbëzbathur mbi zjarr etj. Në lidhje me këtë çështje, i nderuari Xhunejd Bagdadi, thotë:

“Nëse shihni dikë të fluturojë në ajër, por që sjelljet e tij nuk përputhen me Kuranin dhe Sunetin, kjo (nuk është mrekulli) është thjesht istidraxh.”

Për fat të keq, shumica e popullit nuk janë në nivelin e duhur për nga aspekti i kulturës së Kuranit dhe Sunetit. Për rrjedhojë, ata ndikohen lehtë prej njerëzve të tillë. Në këtë mënyrë, pranoen dhe përhapen nga ana e të paditurve si -të ishin detyrimi fetare- të drejta edhe disa mendime, zbatime, besëtytni dhe bid'ate (shpikje në fe), të cilat nga aspekti i legjislacionit islam janë të gabuara e të ndaluara. Kjo është edhe arsyeja që gjatë historisë hasim disa tarikate që janë prishur dhe kanë devijuar rrugën e drejtë.

Nisur nga kjo, nuk duhet t'i harrojmë kurrë këto këshilla të Pejgamberit tonë (a.s.).

“Kush jeton gjatë pas meje, do të shohë shumë kundërshtime. Në atë kohë, detyra juaj është të kapeni fort pas Sunetit tim dhe rrugës së drejtë të Hulefa-i Rashidinëve. Mbahuni fort pas këtyre suneteve dhe ruhuni mirë prej bid'ateve (në fe), sepse çdo bid'at është devijim.” (Ebu Daud, Sunet, 5/4607; Tirmidhi, Ilm, 16.)

Nga këto, kuptojmë se tasavvufi nuk mund të jetohet larg Kuranit dhe Sunetit, sepse një njeri me dije fetare të mangëta, edhe pse pandeh se bën një jetë të devotshme, mund të flasë e të sillet në kundërshtim me Kuranin dhe Sunetin e të japë fetva të gabuara. Dhe kjo, e çon atë bashkë me ata që e ndjekin drejt humbjes së përjetshme. Siç thotë edhe një fjalë e urtë: “Gjysmë doktor të merr jetën, gjysmë hoxhë të nxjerr nga feja.”

Diçka tjetër që duhet ditur mirë, është fakti se edhe gjendjet e jashtëzakonshme apo mrekullitë e të dashurve të Allahut, asnjëherë nuk duhet të shihen si të vërteta njëqind për qind absolute siç janë shpalljet hyjnore. Këto duhen marrë në konsideratë vetëm pasi të kenë kaluar nga sita e Kuranit dhe Sunetit.

Sami Efendiu, në ligjëratat e tij fliste shpesh për “nefsin



mulhime”, i cili është një prej shkallëve të rëndësishme të rrugës së devotshmërisë:

“Nefsi mulhime, është shkalla ku fillon të dallohet e mira nga e keqja. Mirëpo, nuk ka asnjë lloj garancie derisa të arrihet tek “nefsi mutmainne”. Frymëzimet që vijnë në shkallën e nefsit mulhime, ndonjëherë janë prej Allahut e ndonjëherë jo.”

Ndërsa Imam Rabbani, në lidhje me këtë çështje thotë:


“Gjendjet shpirtërore varen nga sheriat; ndërsa sheriat nuk varet nga gjendjet shpirtërore, sepse sheriat është i qëndrueshëm dhe i prerë; saktësia e tij është e argumentuar me shpallje hyjnore. Kurse gjendjet shpirtërore janë hamendje, të cilat argumentohen me perceptim dhe frymëzim.” Për këtë arsye, detyra jonë është të veprojmë sipas ajetit: **“...Qëndro i patundur në udhën e drejtë, ashtu siç je i urdhëruar!..”** (Hud, 112) Gjithashtu, duhet që të paktën në lidhje me çështjet e rëndësishme të fesë, të studiojmë më thellë përmbajtjen e Kuranit dhe Sunetit dhe të përpiqemi të jetojmë në rrugë të drejtë.

Të mos harrojmë se për çdo çështje, shembulli ynë më i bukur është Rasulullahu (a.s.). Atë duhet ta marrim shembull në çdo fushë të jetës sonë. Gjithashtu, duhet t’u vëmë veshin edhe këshillave të njerëzve të devotshëm dhe miqve të Allahut, të cilët ndjekin me përpikëri rrugën e tij të ndritur. Ne duhet të ruhemi prej mendimeve të gabuara dhe fetvave të njerëzve që nuk e njohin Kuranin dhe Sunetin, apo që e njohin por nuk jetojnë sipas tyre. Pra, ne nuk duhet të ndjekim gjurmët e atyre që nuk ndjekin gjurmët e Pejgamberit (a.s.), sahabëve fisnikë, selef-i salihinit dhe miqve të Allahut.

Allahu i Madhëruar na bëftë të gjithëve prej njerëzve të devotshëm, me të cilët Ai është i kënaqur. Gjithashtu, na

**ndihmoftë që edhe mendimet, ndjenjat, punët, gjendjet dhe
sjelljet tona, të jenë në përputhje me kënaqësinë e Tij.**

Amin!..



EBU'L HASAN HAKAKANI رحمہ اللہ

-3-

Sa udhëzuese të mrekullueshme janë për një zemër të ndjeshme, gjendjet e krijesave në tokë e në qiej! Që prej përgjërimeve të zemrave sa një majë gjilpëre të insekteve më të vogla, e deri tek hungërima e kafshëve gjigande e madhështore, gjithçka është shfaqje e fuqisë hyjnore.





EBU'L HASAN HARAKANI - 3

Ebu'l Hasan Harakani thotë:

Gjëja më e vlefshme në këtë botë është një zemër e mbushur me përmendjen e Allahut.

Të gjitha krijesat në tokë dhe në qiell përmendin Allahun në mënyrë e vet specifike. Allahu këtë të vërtetë e shpreh kështu në Kuran:

“Atë e madhërojnë shtatë qiejt, toka dhe gjithçka gjendet në to. dhe nuk ka asgjë që nuk e madhëron atë duke e lavdëruar, por ju (o njerëz) nuk e kuptoni madhërimin që i bëjnë ato...” (Isra, 44)

Sa udhëzuese të mrekullueshme janë për një zemër të ndjeshme, gjendjet e krijesave në tokë e në qiell! Që prej përgjërimeve të zemrave sa një majë gjilpërë të insekteve më të vogla, e deri tek hungërima e kafshëve gjigande e madhështore, gjithçka është shfaqje e fuqisë hyjnore.

Sa dhikër emocionues është për zemrat e ndjeshme, melodia



vajtuese që rrjedh prej zemrave sa një bulëz të bylbylave, “hu-hu”-të që përhapen prej kumrive dhe “lek-lek”-ët e lejlekëve!

Këtë vërtetë Abdulla ibn Mesudi e shpreh kështu: “Ne kishim ardhur në një gjendje të tillë që mund të dëgjonim edhe tesbihët e kafshatave kur kalonin nga fyti!”

Aziz Mahmud Hudaji kur zgjati dorën për të këputur lulet dëgjoi dhikrin e tyre dhe në këtë mënyrë hoqi dorë nga këputja e tyre.

Në univers në momentin që mbaron dhikri mbaron edhe jeta. Jeta e vërtetë është e mundur vetëm përmes dhikrit. Pra nëse një zemër që nuk e përmend Allahun ajo në fakt është e vdekur megjithëse biologjikisht mund ta kryejë funksionin.

Sami efediu ka thënë:

Jetën e vërtetë e jeton vetëm ai që ka zemrën të zgjuar. Sepse zemra është vendi ku shikon Allahu. Nëse në të nuk ka dashuri dhe dhikër ajo zemër është e vdekur. Ilaçi më i mirë i zemrës është dhikri.

Allahu në Kuran thotë: **Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut.** (Rad, 28)

Vetëm shqiptimi është i lehtë por prej nesh kërkohet që zemra të jetë gjithmonë në gjendje dhikri. Pra vetëdija e dhikrit të përfshijë gjithë qenien tonë.

Esad Erbili në lidhje me këtë që përmendëm më lart thotë:

Ashtu siç është e nevojshme të lahet gjithë trupi për të realizuar gusulin ashtu është e nevojshme marrje pjesë e gjithë genia në përmendjen e Allahut.

“Allahu Teala e ndriçoftë syrin tënd shpirtëror! Ashtu si



trëndafili në çdo pikë të vet përmban lëng trëndafili, ashtu edhe trupi yt i çmuar qoftë i mbushur me dashuri dhe adhurim për Allahun!..”

Ai është me ju kudo që të gjendeni; Ai sheh gjithçka që bëni. (Hadid, 4)

Ne e kemi krijuar njeriun dhe, Ne e dimë ç’i pëshpërit atij shpirti i vet. Ne jemi më pranë tij se damari i qafës së vet. (Kaf, 16)

Dhe ta dini se Allahu ndërhyt midis njeriut dhe zemrës së tij dhe se tek Ai do të mblidheni të gjithë! (Enfal, 24)

Të gjithë ajetet e lartpërmendura theksojnë faktin se ne në çdo moment jemi nën mbikëqyrjen hyjnore. Besimtari i vetëdijshëm nuk mundet në asnjë mënyrë të jetë neglizhent përballë kësaj gjendje.

Një vaiz, ishte duke treguar çështjet e botës tjetër, ndërkohë që midis xhematit ndodhej edhe Shejh Shibli.

Vaizi, duke folur për pyetjet që do të bëjë Allahu i Madhëruar në ditën e gjykimit, shprehet:

“Do të pyetet, se ku e ke përdorur diturinë! Do të pyetet, se ku e fituar dhe ku e shpenzuar pasurinë! Do të pyetet, se si e ke kaluar jetën! Adhurimet si i ke pasur? A ke bërë kujdes ndaj haramit dhe hallallit?.. Pas këtyre, do të pyeten këto e ato!..”, duke numëruar edhe disa gjëra të tjera.

Shejh Shibli, i cili po dëgjonte me vëmendje, me një zë të butë, tha:

“O vaiz efendi! Harrove një nga pyetjet më të rëndësishme! Allahu i Madhëruar, shkurt do të pyesë:

«O robi Im! Unë isha me ty, më afër se damari i qafës tënde; po ti me kë ishe?!»

Ja pra, e gjithë çështja në devotshmërinë ndaj Allahut, është të zotërosh këtë vetëdije, botëkuptim, urtësi dhe pjekuri shpirtërore!..

Të jesh me Allahun, do të thotë të jetosh duke e ndjerë Atë në zemër dhe me vetëdije të lartë. Pra, të veprojmë duke e ditur, menduar dhe ndjerë se Allahu i Madhëruar është gjithmonë me ne.

Kjo vetëdije dhe ky botëkuptim, është mirësia më e madhe e Allahut ndaj robit të Tij, sepse kjo, tregon se robi është mik i Zotit të tij. Miqësia, buron prej faktit se i dashuruari sheh veçoritë e veta tek njeriu që dashuron. Pra, për të arritur miqësinë me Allahun e Madhëruar, duhet të kesh një zemër të pastër prej çdo gjëje që të largon nga Ai dhe që zotëron cilësi të bukura si mëshira dhe falja.

Qenia e zemrës bashkë me Allahun, është tregues i suksesit në sprovën e kësaj bote. Në të kundërtën, rezultati i një jete të shkujdesur ndaj Allahut, do të jetë vetëm një humbje dhe pendesë e madhe.

Sa domethënëse janë këto fjalë të Burseviut të nderuar

“Sa i madhëruar është Allahu, i Cili e bën të dëgjojë një copë delli si veshi, e bën të shohë një copë dhjami si kokërdhoku i syrit dhe e bën të flasë një copë mishi si gjuha; që i ka pajisur bimët me fruta e fara, kafshët me mish e me dhjam, tokën me pemë e lumenj dhe qiellin me yje dhe dritën e tyre; që e ka caktuar natën për të pushuar njerëzit dhe që dhuron aq sa dëshiron prej mirësive të panumërta të ditës!..



Megjithëse ti, nuk arrin të bëhesh rob i Tij i merituar, Ai të vlerëson dhe të furnizon materialisht dhe shpirtërisht, sikur nuk ka rob tjetër përveç teje. Ndërsa ti, je aq indiferent ndaj adhurimit të Atij, sikur të kishe ndonjë Zot tjetër. (Sa injorancë e madhe dhe mosnjohje e vetes është kjo!)” (shih. RuHu'l-Bejan Kur'an Meâli ve Tefsiri, I, 94-95)

Një zemër e mbushur me dashurinë për Allahun nuk mund të ketë kurrë prirje ndaj asaj që e ka ndaluar Allahu. Besimtari që jeton me vetëdijen e plotë për mbikëqyrjen e Allahut qëndron vazhdimisht larg ndalesave dhe gjërave që zemërojnë Allahun. Dhikri ka një rol mbrojtës dhe pastrues shpirtëror, ai ruan besimtarin nga rënia në mëkate, nga veset dhe ndjenjat e këqija.

Normalisht që kjo nuk është diçka e lehte sepse është një gjendje që kërkon respektimin e plotë të ndalesave dhe urdhërave të dukshme dhe të padukshme.

Një zemër ndodhet në rrugë të drejtë në raport me vetëdijen e lart të vëzhgimit dhe mbikëqyrjes hyjnore. Dhe e kundra sa më shumë të harrojë hyjnoren aq më larg të vërtetës dhe të drejtës ndodhet. Pra një nga synimet kryesore të besimtarit është arritja e një shkalle të lartë dhikri dhe dashurie hyjnore.

Allahu im! Unë kërkoj dashurinë tënde, dashurinë e atyre që të duan Ty, si dhe aktin që do të më afrojë tek dashuria për Ty! Allahu im! Bëma dashurinë tënde mua më të dashur se vetveten time, se familjen time, se pasurinë time dhe se uji i ftohtë!” (Tirmidhi, Deavat, 72)

Ai që kultivon dashurinë në zemrën e njerëzve është Allahu. Ai i fal dashuri njerëzve të tij të dashur.

Prandaj është shumë e rëndësishme të jemi gjithmonë në



gjendje dhikri, falënderimi dhe adhurimi, vetëm në këtë mënyrë mund të arrijmë të jemi afër Allahut. Çdo moment i harxhuar në fjalë, punë dhe vepra që të largojnë nga Allahu është humbje për këtë botë dhe botën tjetër.

Ebu'l Hasan Harakani:

Miqtë e Allahut janë gjithmonë në një shqetësim të madh për shkak të pamundësisë së tyre për ta përmendur Allahun siç i ka hije Atij.

Njeriu si qenie e dobët e ka të pamundur të realizojë në mënyrë të përsosur adhurimin ndaj Allahut. Në fakt kjo gjë është përtej aftësive të tij.

Prandaj njeriu me gjithë veprat e mira dhe adhurimet gjithmonë duhet t'i shikojë si të pamjaftueshme ato kundrejt mirësive dhe madhësisë së Allahut. Ai duhet t'i lutet Allahut për të gjithë mangësitë e veta.

Profeti Muhamed (a.s.) cili është mëshirë dhe bereqet për të gjithë botërat, i cili lartësoi moralin me cilësi virtyti të panumërta dhe i cili kishte një personalitet që na paraqitet si shembull i përhershëm e i pashoq për njerëzimin, edhe pse atij i ishin falur të gjitha gjynahet e shkuara e të ardhme, ai falte namaz dhe kërkonte falje nga Allahu gjithë natën deri në mëngjes, deri sa i ënjtëshin këmbët, ai madje i kërkonte falje Allahut shtatëdhjetë herë në ditë dhe si pas një transmetimi tjetër njëqind herë në ditë.

Allahu nuk ka vendosur kufi për dhikrin, në lidhje me këtë në Kuran thotë:

O besimtarë, përmendeni shpesh Allahun dhe lavdërojeni Atë në mëngjes dhe në mbrëmje! (Ahzab, 41-42)



Duke morë shkas nga ky ajet njerëzit e dashur të Allahut e kanë pas bërë pjesë të moralit dhe sjelljes së tyre dhikrin e vazhdueshëm. Por përsëri e kanë pas konsideruar dhikrin të pamjaftueshëm për madhësitë e Allahut dhe për këtë vazhdimisht i kërkojnë falje Atij. Në të kundërt, pa dhikër dhe ibadet është shenjë e harresës dhe neglizhencës.

Ebu Hasan Harakani thotë:

Ndërsa ju përmendni fjalën “Allah” mos bisedoni me asnjë person që thotë fjalë tjetër përveç asaj fjale.

Përmendja e Allahut konsiston në një zemër të mbushur me dashurinë për Allahun. Shprehja me gojë nuk është gjë tjetër përveçse shfaqja jashtë e asaj dashurie. Gjatë dhikrit gjuha dhe zemra duhet të jenë harmoni të plotë me njëra-tjetrën. Në këtë mënyrë besimtarët nuk i pengon asgjë nga përmendja e Allahut. Ata edhe gjatë angazhimeve të kësaj botë janë gjithmonë në gjendje dhikri.

Në lidhje me këtë është shumë domethënëse ndodhia e Imam Birgivit i cili ka jetuar në periudhën osmane.

Imam Birgivi një fetva të autoritetit më të lartë të ligjit fetar të asaj kohë nuk e konsideron të përshtatshme. Kur shejhul islam merr vesh e thërret në audience imam Birgivin.

Kur Imam Birgivi hyrë në dhomën e Shejhul islamit e gjeti atë duke falur namazin. Por Imam Birgivi i jep selam atij megjithëse ishte në namaz. Pastaj u ul në një qoshe të dhomës. Shejhul Islam i habitur i thotë:

Mirë që fetavanë që dhashë nuk e pranove por a nuk e di ti se gjatë namazit nuk jepet selam?!

Birgivi në mënyrë të qetë i thotë:

Është e vërtetë ajo që thoni ju. Por unë nuk i dhashë selam atij që po falej.

Si është e mundur kjo? Unë isha duke falur namaz.

Jo, i thotë Imam Birgivi, ju nuk ishit duke falur namaz.

Çfarë isha duke bërë unë atëherë sipas teje nëse nuk isha duke falur namazin?

Imam Birgivi i jep këtë përgjigje:

Ju nuk ishit duke e falur namazin në kuptimin e vërtetë sepse ishit të zënë me mendimin e keni mbyllë dritaren apo jo.

Shejhul Islam mbeti i shtangur përballë kësaj përgjigje sepse me të vërtetë gjatë namazit po mendonte për atë gjë. atëherë e kuptoi thellësinë e Imam Birgivit dhe e falënderoi për mesazhin dhe mësimin që i dha.

Namazi është simbol i komunikimit me Zotin, është dhikri më i lartë. Prandaj gjatë kryerjes së tij duhet të jemi shumë të kujdesshëm. Çdo neglizhencë dhe pakujdesi ndaj tij bëhet shkak për shumë sprova dhe dënime.

Allahu në Kuran thotë:

Mjerë për ata, të cilët kur falen, janë të pakujdesshëm për namazet. (Maun, 4-5)

Allahu kërkon prej nesh të jemi të vëmendshëm në përmendjen e Tij në çdo gjendje, jo vetën gjatë namazit. Edhe nëse jemi duke fjetur zemra jonë duhet të jetë në gjendje dhikri.

Në ajetin kjo gjë theksohet në këtë mënyrë:

...ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjur ose shtrirë... (Ali Imran, 191)



Ata që arrijnë këtë gjendje janë gjithmonë në gjendje dhikri. Çdo lëvizje e tyre është në shkallën e ibadetit dhe dhikrit.

Imam Rabani këtë të vërtetë e shpreh kështu:

“Biri im! Kohën tonë duhet ta shpenzojmë gjithmonë duke përmendur Allahun e Madhëruar. Çdo punë e bërë në përputhje me ligjet e Allahut, konsiderohet dhikr, edhe nëse është thjesht një shitblerje. Prandaj, ne duhet të respektojmë vendimet shariatike në çdo punë dhe sjellje që bëjmë, me qëllim që këto të konsiderohen të gjitha dhikr. Kjo, sepse dhikri e mposht indiferencën. Kur veprat tonat të jenë në përputhje me urdhrat dhe ndalesat Islame, atëherë nuk do të mbetemi indiferentë ndaj urdhrave dhe ndalesave të Atij që i ka vendosur dhe do të konsiderohemi sikur jemi duke e përmendur vazhdimisht Atë.

Për ata që arrijnë këtë gjendje Kurani thotë:

Mjerëz, të cilët shitblerja nuk i pengon për të përmendur Allahut dhe të cilët falin namazin dhe japin zeqatin dhe të cilët kanë frikë nga Dita (e Kiametit), kur zemrat dhe shikimet do të jenë të shqetësuara. (Këta shpresojnë) që Allahu t'i shpërblejë sipas veprave më të mira që kanë bërë e t'ua shtojë dhuntinë e Tij. Allahu i jep kujt të dojë, pa llogari. (Nur, 37-38)

Ebu Hasan Harakani thotë:

Njerëzit në përgjithësi luten kështu:

“ O Zot! Më ndihmo në tre gjëra; ndërsa janë duke dhënë shpirt, në varr dhe në ditën e gjykimit. Unë them o Zot më ndihmo në çdo moment.

Ritet fetare kanë një kohë të caktuar dhe janë të përcaktuara qartë. Kurse ibadeti nuk mbaron me kryerjen e riteve. Ata që janë neglizhentë ndaj kësaj të vërtete e ndjenë vetën të mjaftueshëm

dhe harrojnë t'i luten Zotit për dobësinë e vet. Por ata në këtë mënyrë tejkalojnë kufijtë e tyre dhe përfshihen nga mendjemadhësia. Kur përballen me vështirësinë e vërtetë e kuptojnë dobësinë e vet por atëherë është shumë vonë.

Allahu e shpreh kështu këtë dobësi të njeriut në Kuran:

Kur hipin në anije, ata i luten Allahut me devotshmëri të sinqertë, por kur Ai i sjell në tokë shëndoshë e mirë, menjëherë ata i veshin Atij ortakë (në adhurim). (Ankebutë, 65)

Kur juve ju godet fatkeqësia në det, ata që ju i adhuronit në vend të Atij, zhduken. Por, pasi Ai ju shpëton në tokë, ju i ktheni shpinën. Njeriu është mosmirënjohës. Vallë, a jeni të sigurt, që Ai nuk do t'ju fundosë në tokë ose, që nuk do të dërgojë mbi ju stuhi me rërë, pa pasur mundësi që ju të gjeni dikë, që t'ju mbrojë? (Isra, 67-68)

Njeriu do të ketë gjithmonë nevojë për në fuqi ku të mbështet. Dhe e vetmja fuqi e përhjetshme ku mund të mbështet dhe strehohet është fuqia e Allahut.

Të gjithë ata që janë treguar indiferent ndaj këtij fakti duke i besuar forcës se vet kanë përfunduar në humbje dhe dështim total. Historia është e mbushur plot me shembuj të atyre që kanë përfunduar në dështim sepse janë mbështetur vetëm tek fuqitë e veta.

Në vitin 1912, kur anija gjigande Titanik doli në udhëtimin e saj të parë, me krenari dhe mburrje u tha: "Këtë anije nuk mund ta fundosë asnjë forcë". Por që në udhëtimin e parë, anija u përplas me një ajsberg dhe humbi në thellësitë e oqeanit së bashku me ata që kishte brenda.

Në vitin 1986 anija kozmike "Challenger", që do të thotë



“Sfiduesja”, shpërtheu 73 sekonda pas lëshimit dhe i gjithë ekui-pazhi i saj vdiq.

Në 18 Mars të vitit 1915, luftania e madhe franceze “Inflexible” që do të thotë “e papërthyeshme, e papërkulshme”, u dëmtua rëndë dhe ngeli jashtë luftimi në luftën legjendare të Çanakalesë. Në të njëjtën ditë, edhe luftania “Irresistible” që do të thotë “e papërballueshme”, u përplas dhe u mbyt.

Edhe luftania e madhe e flotës së Shteteve Aleate, e quajtur “Goliat”, emër i frymëzuar nga Xhaluti, i cili u vra nga profeti Daud (a.s.), u fundos në ujërat e Ngushticës së Dardaneleve, më 13 Maj të 1915 nga fregata Muavenet-i Millije, e cila dukej shumë më e vogël dhe më e pafuqishme në krahasim me të.

Ebrehe doli nga Jemeni me mendjemadhësi dhe mburrje. Qëllimi i tij ishte të shkatërronte Qabenë e Shenjtë. Përballë ushtrisë së tij, të cilën e kishte fortifikuar me elefantë që zinin vendet e tankeve në atë kohë, nuk kishte ndonjë ushtri tjetër që të bënte rezistencë. Ndërkohë që po përparonte me mendjemadhësi drejt qëllimit të tij, Allahu i Lartësuar e shndërroi atë dhe ushtrinë e tij në gjethë të mbjellash të përtypura. Ata nuk i shkatërroi me luanë, tigra, gjarpërinj dhe akrepa, por me gurë që i hodhën zogjtë harabela shumë të vegjël. Ebrehenë nuk e shkatërroi as në Mekë dhe pranë Qabesë. Për këtë arsye, Ebrehe u kthye i plagosur dhe i nënçmuar në vendin e tij nga e cili kishte ardhur dhe pastaj vdiq pasi u poshtërua ndaj njerëzve të tij.

Historia dëshmon se shembuj të tillë janë të panumërt. Ata që guxuan të sfidojnë Allahun Teala në cilësinë e Madhështisë, zullumqarët që thanë “unë” përpara Hakut, popujt e fuqishëm si Adi dhe Themudi, të cilët u mburrën duke thënë: “Kush është më i fuqishëm se ne?” dhe ata që me mburrje e mendjemadhësi

u mbështetën në mjetet të cilat i ndërtuan me aftësitë mendo-re që u kishte falur Allahu, gjithmonë u bënë shembujt më të këqinj të hakmarrjes hyjnore, duke u shkatërruar nën kamxhikët e dënimit.

Si përfundim, kur besimtari arrin një mirësi, gjithmonë duhet të thotë: “Kjo është nga dhuntitë e Zotit tim” dhe duke ia atribuar atë mirësi pronarit të vërtetë, duhet të falënderojë i përulur. Në vend që të biem pre e nefsit tonë duke thënë: “E fitova me forcat e mia, apo e arrita me dijet dhe aftësitë e mia”, duhet synuar arritja e majës të ndjenjës së “hiç” it, duke thënë: “Të gjitha mirë-sitë janë prej Teje, o Zot!”.

Por, në të kundërtën, kur përballemi me ndonjë vështirësi, në vend që të ankohemi dhe të bëhemi kryeneçë, duhet të për-piqemi të kontrollojmë gjendjen tonë shpirtërore dhe të kom-pensojmë të metat tona, duke menduar se: “Unë jam fajtor për të gjitha! Ose, vallë cili prej gabimeve të mia u bë shkak i kësaj vështirësie që po kaloj?”.

Nëse dëshirojmë që Allahu të na ndihmojë në momentet më të vështira të rrugëtimit të përjetshëm siç është fryma e fundit, varri dhe gjykimi në ditën e Kijametit duhet të respektojmë me përpikëri urdhëresat dhe ndalesat hyjnore. Vetëm duke qenë të devotshëm mund të meritojmë ndihmën hyjnore. Veçanërisht duhet ta përmendim, adhurojmë dhe lutemi Zotit në kohë mirë-qenie dhe rehatie në mënyrë që Allahu të na gjendet pranë me ndihmë e Tij në ditë të vështira.

Allahu na mundësoftë të gjithëve kryerjen e ibadetit siç duhet dhe siç i ka hije Allahut. I lutemi Allahut të na zbukurojë me virtytin e falënderimit dhe durimit. Allahu na bëfte prej atyre që janë të kënaqur me caktimin e Allahut.

Amin...



EBU'L HASAN HARAKANI رحمة الله عليه

-4-

Çdo mundësi dhe kapital që kemi, i takojnë Allahut Teala. Për këtë arsye, në fjalorin e myslimanit nuk duhet të ekzistojë fjala “unë”. Në zemrën e tij nuk duhet të ekzistojë ideali i egos. Nuk duhet të harrojë kurrë se është rob i Allahut. Për gjithçka që ka, duhet t’ia dijë për nder Allahut. Në vend që të thotë, “e bëra unë, e fitova unë”, duhet të thotë, “Ti ma dhurove o Zot; kjo është prej mirësisë së Zotit tim!..”



EBU'L HASAN HAKAKANI - 4

I nderuari Ebu'l Hasan Harakani, ka thënë:

“Allahu ju solli të pastër në këtë botë; prandaj mos dilni të papastër para Tij!”

Kur lind, megjithëse nxirret nga një burim i turbullt, njeriu ka aromën e miskut; u jep dritë syve dhe qetësi zemrave. Kjo është për shkak të bukurisë dhe pastërtisë që sjell pafajësia e tij. Edhe Allahu Teala dëshiron që ne të qëndrojmë të pastër ashtu siç u dërguam në këtë botë, të bëjmë një jetë të pastër dhe të kthehemi sërish tek Ai të pastër, me një libër punësh të panjolllosur. Për këtë arsye, në një ajet fisnik ka urdhëruar:

“Ditën, kur askujt nuk do t’i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët, përveç atij që vjen tek Allahu me zemër të purifikuar!” (Shu’ara, 88-89.)

Me këtë, Allahu na e bën të ditur, se dhurata më e çmuar që do të pranojë prej nesh, robërve të Tij, është “zemra e purifikuar”.



Zemra e purifikuar është zemra e pastruar nga çdo gjynah, e dëlirë dhe e rafinuar... Si do të arrihet kjo? Natyrisht, duke e ruajtur zemrën nga papastërtia e gjynaheve dhe shqetësimet e ambicieve të egos. Ndërsa papastërtinë e gjynaheve, prej të cilave si njerëz që jemi nuk mund ta ruajmë veten, duhet ta lajmë menjëherë me lotët e pendesës dhe veçanërisht, duke e pastruar me teube dhe istigfar në kohën para agimit... Pra, duke u përpjekur për të dalë faqebardhë në audiencën hyjnore, me shpirt dhe ndërgjegje të qetë, si robër të devotshëm...

Allahu Teala, i fton robërit e Tij në xhenet, në vendin e lumturisë dhe shpëtimit. Mirëpo, xheneti është vendi i bukurive dhe atje pranohen vetëm ata që janë pastruar nga ndyrësitë e gjynaheve. Në lidhje me këtë fakt, në një ajet fisnik urdhërohet:

“Ndërsa ata që i janë frikësuar Zotit të tyre, do të çohen grupe-grupe në Xhenet. Kur t’i afrohen atij, dyert e tij do të hapen e rojtarët e tij do t’u thonë atyre: ‘Selamun alejkum (paqja qoftë mbi ju), ishit të pastër, andaj hyni në të, aty do të jeni përgjithmonë.” (Zumer, 73.)

Nisur nga ky fakt, ne jemi të detyruar të pastrohemi nga ndyrësitë e gjynaheve përderisa kemi mundësi. Ta shtysh teuben dhe istigfarin për më vonë, duke i besuar shëndetit të rinisë, bëhet shkak i shkatërrimit në aspektin shpirtëror. Në lidhje me këtë, Muhammed Masum Sirhindi (r.a.), i këshillon nxënësit e tij me këto fjalë:

“Bijtë e mi! Koha më e çmuar e jetës, është rinia. Por kjo kohë, kur njeriu i ka gjymtyrët të forta e të shëndosha, kalon dhe pas saj vjen koha më e dobët e jetës. Sa keq që njerëzit e shtyjnë njohjen e Allahut, që është gjëja më e çmuar, për në kohën e pleqërisë, e cila nuk dihet nëse do të vijë apo jo. Ndërsa kohën



më të çmuar të jetës së tyre, e shpërdorojnë për plotësimin e kënaqësive dhe dëshirave më të ulëta. Mos harro! “U shkatërruan ata që thanë: do ta bëj nesër!””

Për këtë arsye, Allahu Teala na urdhëron shpesh për teube dhe istigfar për aq kohë sa kemi mundësi, sepse çdo gjynah, është një njollë që e nxin zemrën. Kur këto njolla shtohen, në fund zemra varroset në errësirën e depresionit dhe gjynaheve. Për asnjë qenie njerëzore nuk është e mundur të jetë një rob plotësisht pa të meta. Prandaj, është kusht që njeriu të përpiqet vazhdimisht të pastrohet shpirtërisht. Në një ajet fisnik, urdhërohet:

“...Pa dyshim, Allahu i do ata që pendohen fort (për gjynahet) dhe ata që pastrohen.” (Bekare, 222) Pra, Allahu Teala thekson qartë, se i do shumë robërit e Tij, që pastrojnë botën e tyre të brendshme me teube dhe istigfar.

Ebu'l Hasan Harakani, thotë:

“Të dashurit e Allahut, që kanë arritur grada të larta, janë ngritur jo vetëm për shkak të punëve të tyre të sinqerta, por edhe për shkak se kanë pastruar egot e tyre.”

Punët që bëhen me një ego të papjekur, e cila nuk ka marrë edukimin e duhur shpirtëror, me sado sinqeritet të pandehen se bëhen, janë thjesht formale; larg ndjenjës, paqes dhe frymëzimit shpirtëror. Në lidhje me këtë, i nderuari Imam Rabbani, shprehet:

“Adhurimet dhe nënshtrimi që bëhet pa arritur ende tek “nefs-i mutmainne”, janë thjeshtë imitim. Kur arrihet tek “nefs-i mutmainne”, atëherë ato kthehen nga imitimi në vërtetim (pra, arrijnë përsosmërinë).”

Ndërsa i nderuari Mevlana, shprehet:

“Nëse dëshiron të shpërndash rreze dite, duhet të djegësh dëshirat natësore të egos!”

Pra, duhet që dëshirat ekstreme të egos t'i djegim me zjarrin e edukimit shpirtëror dhe përpjekjes, duke e kthyer atë në energjinë e shpirtit. Dhe me të vërtetë, kur egoja të edukohet dhe të vihet nën këmbë, bëhet një mjet që e ngre të zotin e saj në miraxh. Mirëpo, në të kundërtën, nëse egoja lihet ashtu e papjekur dhe i plotësohet çdo dëshirë, bëhet shkak i një falimentimi shpirtëror që e bën njeriun më të ulët në të ulëtëve.

Për sa kohë që egoja nuk pastrohet dhe uni nuk largohet, ka shumë rrezik që në adhurimet, punët dhe shërbimet tona të përzihen mburrja, mendjemadhësia, egoizmi dhe shumë qëllime të tjera të egos. I nderuari Mevlana shprehet se është e padobishme të përpiqesh ta mbushës thesin, pa e mbyllur të çarën në fund të tij. Prandaj, që punët e mira të pranohen tek Allahu Teala, është e domosdoshme që më parë të shpëtohet prej cilësive primitive të egos.

Nisur nga kjo, çdo njeri duhet të përpiqet të edukojë egon e tij për të arritur gradën “mutmainne” dhe gradat e mësipërme. Si rezultat i këtij edukimi, niveli i arritur në besim dhe moral do t'i përgatitë vendin pranimit të adhurimeve. Në lidhje me këtë çështje, i nderuari Sami Efendiu është shprehur:

“Për të hyrë në Islam në kuptimin e vërtetë të fjalës, duhet të eliminohet “nefs-i emmare” dhe të zbatohen urdhrat hyjnore. Në të kundërtën, Islami që del në pah vetëm me pranimin e zemrës, pa arritur ende tek “nefs-i mutmainne”, quhet “islam metaforik”. Ndërsa besimi i cili del në pah pasi arrihet “nefs-i mutmainne”, quhet “besim i vërtetë”.⁸

Nga kjo pikëpamje, edukimi shpirtëror për të pastruar egon nga cilësitë primitive, është kusht për përparimin shpirtëror.



Ebu'l Hasan Harakani, thotë:

“Ashtu siç janë farz, të detyrueshme namazi dhe agjërimi, në të njëjtën mënyrë është i detyrueshëm edhe eliminimi i mendjemadhësisë, smirës dhe ambicies së tepruar nga zemra.”

“Nëse një shkëndijë zjarri bie mbi rrobën tënde, përpiqesh ta shuash menjëherë! Po zjarrin që do të të djegë fenë, pra qëndrimin në zemrën tënde të cilësive të këqija, si mendjemadhësinë, smirën dhe dyfytirësinë, si arrin t'i durosh?!”

Besimtari arrin përsosmërinë si rezultat i respektimit të gjytimeve të hapëta/të dukshme dhe të fshehta/të brendshme. Ashtu siç feja ka farze/detyrime të hapëta/të dukshme, si abdesti, namazi, agjërimi dhe zekati, për të zotëruar një ndërgjegje të pastër, ka edhe farze të fshehta/të brendshme, si mëshira, dhembshuria, sakrifica, singeriteti dhe devotshmëria.

Në të njëjtën mënyrë, ashtu siç ka haramet/ndalesa të hapëta/të dukshme, si alkooli, imoraliteti dhe kamata, ashtu ka edhe haramet të fshehta/të brendshme si mburrja, mendjemadhësia, dyfytirësia, paturpësia, koprracia, smira dhe hamendja e keqe.

Në një ajet fisnik, urdhërohet: **“Largohuni nga gjynahet e hapëta dhe të fshehta!..”** (En'am, 120) Pra, besimtari, ashtu siç është i detyruar të qëndrojë larg harameve të hapëta, ashtu është i detyruar të ruhet edhe prej harameve të fshehta, që e helmojnë shpirtin e tij. Madje, shumë prej harameve të fshehta, -nga aspekti i jetës shpirtërore- janë më të rrezikshme se haramet e hapëta. Si shembull për këtë, po përmendim fjalën e Pejgamberit tonë (a.s.):

“Nuk hyn në xhenet ai që ka qoftë edhe një grimcë mendjemadhësie në zemër...” (Muslim, Iman, 147)

Siç shihet, t'i shkulësh dhe t'i hedhësh prej zemrës gjynahet e fshehta, është po aq e rëndësishme sa edhe ruajtja prej gjynahëve të hapëta. Përveç kësaj, haramet e fshehta, si ambicia e tepërt, smira, mendjemadhësia, paturpësia dhe dyfytirësia, në të shumtën e rasteve bëhen duke u nënvlerësuar. Mirëpo, të ruhesh prej këtyre veseve të këqija, që janë kanceri i jetës shpirtërore, është shumë e domosdoshme.

Ebu'l Hasan Harakani, thotë:

“Qani shumë e qeshni pak; heshtni shumë e flisni pak; dhuroni shumë, hani pak dhe mbajeni kokën larg jastëkut!”

Në edukimin e Tasavufit zbatohen disa metoda për të arritur pjekurinë shpirtërore. Këto janë: “rijazeti”; të heqësh dorë nga gjërat që i pëlqejnë egos dhe “muxhahede”; ta edukosh egon me disa vështirësi që nuk i pëlqejnë. Në të njëjtën kohë, kjo është edhe metoda e edukimit hyjnor dhe pejgamberik. Sahabi i nderuar Abdurrahman bin Auf (r.a.), ka thënë:

“Islami solli disa punë, që nuk i pëlqejnë egos. Por në këto punë që nuk i pëlqenin egos, ne gjetëm më të mirën e të mirave. P.sh., ne dolëm nga Meka me Rasulullahun (a.s.), për të emigruar. Por në sajë të këtij emigrimi, që u duk i vështirë për egon tonë, na u dhurua nder dhe fitore. Njëherë tjetër, siç shprehet edhe Allahu Teala në Kuran: **“Zoti yt të nxori nga shtëpia jote (për të luftuar) për të Vërtetën, edhe pse kjo nuk i pëlqeu një grupi prej besimtarëve. Ata polemizojnë me ty për të vërtetën (luftën), e cila u ishte bërë e qartë, sikur të ishin duke u çuar drejt vdekjes së sigurt.”** (Enfal, 5-6), dolëm së bashku me Rasulullahun (a.s.), në Bedër. Edhe në këtë rast, Allahu Teala na dhuroi nder dhe fitore.

Me një fjalë, mirësitë më të mëdha i arritëm në sajë të punëve të vështira për egon tonë.” (Hejthemi, VII, 26-27)



Çështjet për të cilat na tërheq vëmendjen i nderuari Ebu'l Hasan Harakani, janë metodat e edukimit që aplikohen për arritjen e zhvillimit shpirtëror duke thyer ambiciet e egos. Nëse i trajtojmë shkurtimisht, mund të themi:

Qani shumë e qeshni pak

Të qeshësh e të gëzohesh jashtë mase për shkak të kënaqësive të kësaj bote, e bën njeriun të harrojë gjërat e vështira që e presin përpara, si vdekjen, varrin, ringjalljen, llogarinë dhe urën e siratit. Këto sjellje i fshijnë ndjenjat në zemër dhe e zhdukin frymëzimin shpirtëror. Për këtë arsye, Allahu Teala urdhëron:

“Po qeshni e nuk po qani? Madje, jeni edhe të shkujdesur!” (Nexhm, 60-61)

“Le të qeshin pak (në këtë botë) e të qajnë shumë (në botën tjetër) si dënim për atë që kanë bërë.” (Teube, 82)

Ndërsa Rasulullahu (a.s.), ka thënë:

“Nëse do t'i dinit ato që di unë, do të qeshnit pak e do të qanit shumë.” (Buhari, Tefsir, 12)

Gjithashtu, Pejgamberi (a.s.), një ditë pa disa persona që po qeshnin shumë dhe u tha:

“Po qeshni, ndërkohë që midis jush gjendet Libri që flet për xhenetin dhe xhehenemin!”

Pas kësaj, askush nuk i pa më ata persona të qeshnin, derisa ndërruan jetë. (Hejthemi, X, 307)

I nderuari Mevlana ka thënë:

“Bëj dua dhe teube me shpirt të mbushur me zjarrin e pendesës dhe me sy të lagur! Sepse edhe lulet çelin në vende me diell dhe ujë!..”

Heshtni shumë e flisni pak

Është e domosdoshme të kemi kujdes për çdo fjalë që del nga goja jonë, ashtu siç kemi kujdes për çdo kafshatë që hyn në të. Kjo, sepse njeriu është përgjegjës për çdo gjë që flet.

Një ditë, Muadh bin Xhebeli (r.a.), e pyeti Pejgamberin (a.s.), se cila është puna më e mirë që mund të bëjë, duke numëruar shumë prej tyre. Mirëpo, Hz. Pejgamberi (a.s.), për çdo herë i thoshte:

- Për njerëzit ka më të mirë se kjo.

Muadhi (r.a.), e pyeti:

- T'u bëfshin kurban nëna dhe babai im, cila punë është më e mirë për njerëzit se kjo? Pejgamberi (a.s.), tregoi gojën dhe tha:

- Të heshtësh, nëse nuk flet diçka të dobishme!

Muadhi (r.a.), pyeti përsëri:

- A do të japim llogari edhe për ato që flasim?

Pejgamberi (a.s.), duke i rënë lehtë gjurit të Muadhit, tha:

- Allahu të dhëntë mirësi o Muadh! E çfarë tjetër përveç atyre që flasin gjuhët e tyre, i hedh njerëzit me fytyrë zvarrë në xhehenem? Kush i beson Allahut dhe botës tjetër, ose të flasë diçka të dobishme, ose të heshtë e të mos flasë fjalë të dëmshme! Përfitoni duke thënë fjalë të dobishme; gjeni paqen dhe rehatinë duke mos folur fjalë të dëmshme. (shih. Hakim, IV, 319/7774.)

Njëherë tjetër, Pejgamberi (a.s.), tha: “Zoti im më urdhëroi që heshtja ime të jetë meditim.” Me këtë, ai ka theksuar se edhe heshtja duhet të përjetohet me ndjenjën e adhurimit. Dhe me të vërtetë, kur egoja mbahet nën kontroll dhe shpirti përparon,



fillon të zgjerohet edhe horizonti i zemrës. Tashmë, ai besimtar, çdo gjë e sheh me syrin e urtësisë së ajetit fisnik: **“Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka).”** (Alak, 1.) Dhe në çdo gjë që sheh, vëren shfaqjet e madhështisë hyjnore dhe takohet shpirtërisht me Allahun.

Allahu Teala na krijoi në një shkollë sprove të tillë, saqë çdo gjë na kujton Atë. Por që kjo të arrihet të kuptohet, është e domosdoshme të hiqet perdja e shkujdesjes. Sa mësimdhënëse është kjo ndodhi, e cila flet pikërisht në lidhje me këtë çështje: Një nga personalitetet më të mëdha të brezit të Tabiinëve, Ebu Uail (r.a.), tregon:

“Dolëm për udhë së bashku me Abdullah bin Mes’udin (r.a.). Me ne ishte edhe Rebi bin Hajthem. Kur po kalonim pranë një hekurpunuesi, Abdullahu (r.a.), ndaloi dhe filloi të vëzhgonte hekurin që ndodhej në zjarr. Edhe Rebi pa zjarrin dhe desh ra nga kali. Më pas, Abdullahu (r.a.), u largua prej aty. Kur erdhëm tek një furrë buzë Eufratit, sapo pa zjarrin në furrë Abdullahu (r.a.), lexoi ajetin fisnik:

“Kur ai (zjarri i xhehenemit) t’i vërë re prej së largu, ata do të dëgjojnë vlimin dhe ushtimën e tij. E kur të hidhen në një vend të ngushtë të tij, të lidhur me duar pas qafe, do të luten për shkatërrimin (e vet).” (Furkan, 12-13.)

Pas kësaj, Rebiut (r.a.), i ra të fikët. E bartëm dhe e çuam tek familja e tij. Abdullahu (r.a.), i qëndroi tek koka deri në drekë, por Rebiu nuk u përmend. Ai vazhdoi të qëndronte pranë deri në mbrëmje, kur më në fund Rebiu erdhi në vete...” (Ebu Ubejd, Fedailu'l-Kur'an, fq. 23)

Allahu Teala, na fton shpesh të meditojmë rreth ndodhisë së kiametit. Madje, në tre xhuzet/pjesët e fundit të Kuranit Kerim,

flitet vazhdimisht për kiametin. Çfarë do të ndodhë me tokën, me qiejt dhe me njerëzit?.. Ja pra, duke u fokusuar në meditimin e këtyre të vërtetave, duhet të përpiqemi të përparojmë më shumë në devotshmëri.

Dhuroni shumë e hani pak

Besimtari, duhet të mjaftohet me sasinë e nevojshme, nërsa tepricën duhet ta dhurojë. Po ashtu, kur të caktojë sasinë e mjaftueshme për nevojat e veta, duhet të tregohet i ndërgjegjshëm. Ashtu si në çdo çështje, edhe në këtë duhet marrë shembull Rasullullahu (a.s.), sahabët fisnikë dhe njerëzit e mëdhenj të Islamit. Në vend që të merren kriteret e përgjithshme të shoqërisë, duhet peshuar vetja duke parë shoqërinë e “epokës së lumturisë”. I nderuari Abdullah Dehleviu, në lidhje me ngrënien e pakët, shprehet:

“Jeta e kësaj bote, është një ditë. Por edhe atë ditë duhet të agjërojmë.”

Me një fjalë, egon duhet ta frenojmë nga gjynahet dhe teprimet. Përveç kësaj, treguesi i dashurisë sonë ndaj Allahut është sakrifica në rrugën e Tij. Në një ajet fisnik, në lidhje me sakrificën e vërtetë, urdhërohet:

“Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni...” (Al’ Imran, 92)

Mbajeni kokën larg jastëkut

Me këtë kuptojmë se nuk duhet të bëhemi robër të gjumit dhe ta plogështojmë botën tonë të brendshme. Allahu Teala, në lidhje me robërit fatlumë, të cilët i ka përgëzuar me shpërblime hyjnore, shprehet:



“Ata flinin pak natën, ndërsa në agim kërkonin falje (nga Allahu).” (Dharijat, 17-18)

Ndërsa nëna e Sulejmanit (a.s.), e këshillon kështu të birin:

“Biri im! Mos fli shumë natën! Sepse gjumi i tepërt i natës, e lë njeriun të varfër Ditën e Kiametit!” (Ibn Maxhe, Ikamet, 174)

Ebu'l Hasan Harakani thotë:

“Nuk them, se nuk duhet të punosh! Mirëpo, duhet të dish: vallë atë që bën, e bën vetë, apo është dikush tjetër që të shtyn ta bësh. Në fakt, robi bën tregti me kapitalin e Allahut (me jetën dhe mirësitë e panumërta që i ka falur Allahu). Kur ia jep (kthen) këtë kapital Allahut e ikën (vdes), edhe fillimi, edhe fundi, edhe mesi është Vetë Allahu (vetëm Allahu do të mbetet). (Pra) Tregtia jote, sjell fitime në sajë të kapitalit të Tij, jo në sajën tënd! Ai që i atribuon vetes diçka (që i beson shumë adhurimeve që bën) në këtë treg (botë), nuk do të gjejë rrugë për atje (për ta njohur siç duhet Allahun dhe për të arritur tek Ai)”

Edukata e devotshmërisë kërkon që gabimet dhe të metat t'i shohësh tek vetja, ndërsa sukseset t'ia atribuosh Allahut. Nuk duhet të harrojmë se të gjithë jemi krijuar nga asgjëja. Nuk paguam asnjë çmim për të ekzistuar dhe për të qenë “eshref-i mahlukat/krijesa më fisnike” ndër miliona krijesa të tjera. Zoti ynë na ka dhënë falas dhe bujarisht mirësi të panumërta, për të cilat jemi ose nuk jemi të vetëdijshëm. Madje edhe adhurimet, bindja, shërbimet dhe punët e mira që i bëjmë për të falënderuar Atë, janë nga mirësitë e Tij. Kjo, për shkak se ne arrijmë t'i kryejmë të gjitha këto, në sajë të forcës dhe mundësive që na ka dhënë Ai. Për rrjedhojë, ne nuk kemi asnjë lloj kapitali që na përket. Ne vetëm përpiqemi të kërkojmë kënaqësinë e Allahut me ato



që Ai na ka dhuruar. Të mendojmë pak: Nëse Allahu nuk do të na kishte dhuruar mirësinë e syrit, si do të shihnim? Nëse nuk do t'i kishte dhënë forcë trupit tonë, si do të kryenim punë? Nëse nuk do të na kishte dhënë mendjen, si do të mendonim?.. Me një fjalë, çdo mundësi dhe kapital që kemi, i takojnë Allahut Teala. Për këtë arsye, në fjalorin e myslimanit nuk duhet të ekzistojë fjala “unë”. Në zemrën e tij nuk duhet të ekzistojë ideali i egos. Nuk duhet të harrojë kurrë se është rob i Allahut. Për gjithçka që ka, duhet t’ia dijë për nder Allahut. Në vend që të thotë, “e bëra unë, e fitova unë”, duhet të thotë, “Ti ma dhurove o Zot; kjo është prej mirësisë së Zotit tim!..”

Sipas një transmetimi, kur Allahu Teala e urdhëroi Musain (a.s.): **“Shko te Faraoni! Ai, me të vërtetë, i ka shkelur të gjithë kufijtë”**, (Ta Ha, 24) për shkak se nuk kishte kujt t’ia linte amanet familjen dhe bagëtinë, Musai (a.s.), i thotë Allahut:

“O Zot! Çfarë do të bëhet me familjen dhe bagëtinë time?”
Allahu Teala, iu përgjigj duke thënë:

“O Musa! Çfarë kërkon tjetër, pasi më ke gjetur Mua? Nxito të zbatosh urdhrin Tim! Mbështetu dhe dorëzohu tek Unë! Nëse dëshiroj, ujkun e bëj çoban të bagëtive të tua dhe melekët e Mi mbrojtës të familjes tënde. O Musa! Ç’është kjo që mendon? Kur nëna jote të lëshoi në lumë, kush të shpëtoi? Më pas, kush të bashkoi përsëri me të? Kur ti e vrave dikë pa qëllim dhe Faraoni t’u vu pas për të të vrarë, kush të ruajti prej Tij?..”

Ndërkohë që dëgjonte, në fund të çdo pyetjeje, Musai (a.s.), thoshte: “TI, TI, TI, O ZOTI IM!..”

Ebu’l Hasan Harakani thotë:

“Allahu Teala, i drejtohet robit të Tij në këto katër çështje:



Trup, gjuhë, zemër dhe pasuri. Nuk mjafton që trupin ta vërë në shërbim dhe gjuhën ta përdorë për dhikur! Por duhet të jetë vazhdimisht me Allahun me zemër dhe pasurinë duhet ta shpenzojë bujarisht në rrugën e Tij. Përndryshe, nuk mund të përparojë në rrugën e takimit me Të!”

Ajo që kërkon Allahu Teala prej nesh, robërve të Tij, është një zemër e purifikuar që qëndron gjithmonë me Të. Për këtë arsye, megjithëse është e domosdoshme, nuk mjafton që trupi ynë të jetë në shërbim në rrugën e Allahut dhe gjuha jonë të laget vazhdimisht me dhikur. Por është kusht që edhe zemra jonë të jetë gjithmonë me Allahun, duke hequr dorë nga ideali i egos dhe unit dhe duke u thelluar në faktin se Allahu është pronari i gjithçkaje. Po ashtu, kërkohet që edhe mirësitë që Allahu na i ka dhuruar, t'i sakrifikojmë po për hir të Tij dhe në ndjenjat dhe veprat tona të shfaqim afrimin shpirtëror me Të.

Për shembull, zekati është kriteri më minimal i sakrificës për një besimtar që konsiderohet i pasur në bazë të fesë. Mirëpo, njeriu sakrifikon për të dashurin, aq sa dashuri ndjen për të. Kjo ndodhi mësimdhënëse mjafton si shembull për këtë:

Një fakih, për të provuar Shejh Shibli, e pyet se sa është sasia e mallit që duhet dhuruar si zekat.

I nderuari thotë:

-Si e doni përgjigjen, sipas medhhebit të fakihëve apo sipas moralit të të dashuruarve pas Allahut?

Fakihu tha:

-Sipas të dyve.

Pas kësaj, Shejh Shibli tha:

- Sipas medhhebit të fakihëve, nëse ke dyqind derhemë,

pas një viti duhet të japësh pesë dërhëmë duke llogaritur një të dyzetat. Ndërsa sipas moralit të të dashuruarve pas Allahut, duhet t'i japësh të dyqind dërhëmët dhe të falënderosh duke thënë, “shpëtova”.

Fakihi thotë:

-Ne këtë medhheb e mësuam prej dijetarëve tanë.

Shejh Shibli, ia kthen:

-Edhe ne këtë moral e mësuam prej Ebu Bekir Siddikut. Ai e vuri gjithçka që kishte e nuk kishte përpara Rasulullahut (a.s.)...

Nisur nga kjo, edhe ne, duke medituat gjithmonë rreth mirësive të pafundme të Allahut Teala, mëshirës së Tij të pakufishme dhe madhështisë e bujarisë së Tij, duhet të përpiqemi me sa të kemi mundësi të bëjmë mirësi e të tregohemi bujarë ndaj robërve të Tij. Në një ajet fisnik, urdhërohet: **“...Bëju mirë të tjerëve, ashtu si të ka bërë mirë Allahu ty...”** (Kasas, 77)

Allahu Teala na bëftë të gjithëve prej robërve të Tij, shërbyes, vetëmohues, bujarë dhe që dhurojnë prej dorës, gjuhës, ndjenjës, fjalës dhe të gjitha mundësive që kanë, në rrugën e kënaqësisë hyjnore.

Amin!..



MEVLANA رحمة الله عليه

-1-

*Mevlana thotë: dëgjoji me vëmendje
këshillat e evlijave! Dëgjoji në mënyrë
që të shpëtosh prej brengave dhe frikës,
në mënyrë që të gjesh qetësinë dhe
prehjen.*





MEVLANA - 1

Mevlana e ka shprehur me një gjuhë shumë të bukur urtësinë dhe diturinë që i ka dhuruar Allahu dhe në një mënyrë është bërë burim frymëzimi për shumë poetë dhe njerëz të urtë. Ai në kuptimin e plotë të fjalës ka qenë një përkthyes i zemrës së njeriut.

Në shpjegimin e kriterëve kuranorë dhe profetike thotë:

“Dita e kijametit, për qetë laramanë, pra, për mohuesit dhe dyfytyrëshit me mendime të këqija, është një bajram kurban i tmerrshëm. Ajo ditë, është vdekje për qetë dhe bajram (festë) për besimtarët!”

Për të shndërruar vdekjen në një ditë festë duhet të sakrifikohej jeta dhe pasuria në këtë botë. Ata që nuk janë të gatshëm të sakrifikojnë jetën dhe pasurinë në rrugën e Allahut, ata që nuk i kryejnë si duhet detyrat hyjnore por vrapojnë pas plotësimi të kënaqësive të kësaj bote, vdekja dhe bota tjetër do të jetë një dënim dhe tmerr i vërtetë.

Vdekja është një e vërtetë me të cilën do të përballen të



gjithë. Dhe ajo i shfaqet njeriut në formën e jetës që ka jetuar. Për dikë do të jetë si një festë kurse për dikë tjetër do të jetë një tmerr i vërtetë. Prandaj duhet të përpiqemi që ta kalojmë jetën në gjendje të vazhdueshme adhurimi. Vetëm në këtë mënyrë mund ta shndërrojmë vdekjen në një ditë feste. Festa e vërtetë e besimtarit është kur e kalon me sukses sprovën e kësaj bote.

Prandaj të urtët kanë thënë:

Gëzim nuk është kur vesh një rrobë të re por kur del para Allahut i sigurt nga dënimi.

Rrumiu thotë:

Hëna nga që ka duruar natën shndrit gjithë shkëlqim.

“Trëndafili ka erë dhe bukuri nga që ka duruar shoqërinë me gjembat.”

Vështirësitë e pjekin dhe forcojnë njeriun. Vështirësitë janë pjesë e pandarë e jetës së kësaj bote. Besimtarët e pjekur duhet të jenë të përgatitur për vështirësitë dhe pengesat me të cilat mund të përballen në këtë jetë. Të durosh e të rezistosh për hir të Allahut ndaj padrejtësive dhe vështirësive që të shkaktojnë njerëzit, është një vetëdije e lartë besimi.

Rrumiu thotë mësova prej Shemsit këto fjalë:

“Nuk ke të drejtë të ngrohesh në këtë botë, nëse ka ftohtë goftë edhe një besimtar i vetëm.”

Unë e di që në botë ka myslimanë në vështirësi, andaj unë nuk mund të ngrohem më!”

Të vuajturin e kupton i vuajturi, i vuajturi është mik i të vuajturit. Besimtari duhet të jetë gjithmonë pranë të vuajturve.

Hadithi shprehet kështu në lidhje me këtë:



“Besimtarët në dashurinë, dhembshurinë dhe ruajtjen e njëritjetrit janë si një trup i vetëm. Kur njëri nga organet e trupit sëmuret, atëherë edhe organet e tjera sëmuren dhe digjen flakë nga temperatura.” (Buhari, Edeb, 27; Muslim, Birr 66)

“Nuk është besimtar i vërtetë ai i cili fle i ngopur, gjersa komshiu i tij është i uritur.” (Hakim, II, 15/2166)

Rrumiu thotë:

Vizitoni shpesh miqtë tuaj. Sepse në rrugët që nuk shkel këmba e njeriut mbulohen me ferra dhe barishte.

Enes bin Malik (r.a.), tregon:

“Nëse i Dërguari i Allahut (a.s.), nuk e shihte ndonjë prej vëllezërve të tij besimtar për tre ditë radhazi, pyeste për të. Nëse ndodhej larg lutej për të, nëse ishte në shtëpi i bënte vizitë, e nëse ishte sëmurë shkonte për t’i uruar shërim të shpejtë.” (Hejthemi, II, 295.)

Vizitat tek njëri-tjetri, interesimi për njëri-tjetrin, ndarja e gëzimit me njëri-tjetrin dhe dhuratat e ndërsjellta me njëri-tjetrin janë shkak për të fituar dashurinë e Allahut dhe për të forcuar më tepër marrëdhëniet njerëzore.

Në të kundërt nëse neglizhohen këto marrëdhënie miqësia dhe vëllazëria dobësohet dhe fillon të nxjerrë krye përçarja dhe armiqësia.

Rrumiu thotë:

Në kohë të mirë, qetësia dhe shëndeti të plotë të gjithë janë miq. Por ku janë miqtë përveç Allahut në ditë të vështira dhe sprove?!

Miqësia e vërtetë është miqësia në kohë të vështira. Shumica

e njerëzve janë miq vetëm në ditë të mira. Miku i vërtetë është i gatshëm të ndajë përveç gëzimit edhe hidhërimin dhe vuajtjen me mikun.

Mik i vërtetë është ai që përpiqet të lehtësojë barrën, jo të bëhet barrë për tjetrin. Miqësia në kohë mirëqenie, pa kaluar asnjë sprovë është një miqësi e brishtë. Sepse shumë njerëz janë pre e interesit. Prandaj një miqësi që nuk ka kaluar nëpër sprovat e jetës nuk mund të konsiderohet një miqësi e vërtetë.

Rrumiu thotë:

Bëhu mik me njerëzit. Sepse sa më kallaballëk që të jetë karvani aq më të vështirë do ta kenë kusarët e rrugëve.

Miqësia me njerëz të urtë është një mirësi e madhe kësaj bote. Sepse shejtani e mashtron shumë më shpejt njeriun kur është vetëm kurse kur është nën shoqërinë e njerëzve të mirë është shumë e veshtirë.

Prandaj Profeti (a.s.) ka thënë:

“Në bashkësi ka mëshirë, kurse në ndarje dhe vetmi ka mundim.” (Munavi, III, 470)

Mënyra më e mirë për të mbrojtur shoqërinë nga erozioni është shoqërimi me njerëzit e mirë dhe solidariteti dhe uniteti i të gjithëve. Kurse shoqërimi me njerëzit e këqinjë është si një helm për botën shpirtërore. Imam Gazaliu thotë: Qëndrimi me njerëzit e shthurur me kalimin e kohës shndërrohet në përputhje mendimesh dhe përputhja e mendimeve shndërrohet në përputhje shpirtërore pas në kohe. Kjo e çon në një hap pas hapi në shkatërrim.

Prandaj në një hadith Profeti (a.s.) thotë:

“Vetmia është më e mirë se shoqërimi me njerëz të këqij.”



Ndërsa një shok i singertë, është më i mirë sa vetmia...” (Hakim, III, 343; Bejhaki, Shuab, 256/4993.)

“Këtë mëngjes, m’u ndërpre frymëzimi. Kështu e kuptova se në trupin tim kanë hyrë disa kafshata të dyshimta. Dija, urtësia, dashuria dhe mëshira, lindin nga kafshata e hallallit. Nëse prej një kafshate vjen gafleti/indiferenca, dije se ajo kafshatë është e dyshimtë ose haram!”

Sufjan eth-Theuri, ka thënë:

“Fetaria e njeriut është aq sa ushqimi që ka hallall!”

Një ditë, e pyetën:

“I nderuar! A mund të na tregosh mbi virtytet e faljes së namazit në rresht të parë?”

Ai duke theksuar përsëri rëndësinë e kafshatës hallall, u përgjigj:

“Vëlla i dashur! Ti shiko se nga e fiton bukën tënde! Nëse fitimi yt është hallall, fale namazin në cilindo rresht të kesh dëshirë. Lidhur me këtë s’ke asnjë problem.”

Rrumiu thotë:

“Fjala e urtë pa vepër është si një teshë e bukur e marrë hua...”

Këshilla me vepër është më e mirë se këshilla me fjalë.”

Profeti (a.s.) para se t’i predikonte mesazhin njerëzve i zbatonte vetë të vërtetat hyjnore duke u bërë në këtë mënyrë një shembull konkret dhe model shembullor. Ky lloj predikimi kishte një ndikim të madh në zemrat e njerëzve.

Vetëm fjalët që dalin prej zemre hyjnë dhe ndikojnë në zemër. Fjalët që nuk rrjedhin prej zemre, fjalët e thata të shprehura nga gjuha nuk arrijnë të depërtojnë në zemrat e njerëzve.

Ajeti Kuranor thotë:

O besimtarë, përse thoni atë që nuk e bëni? (Saff, 2)

Rrumiu thotë:

Merr një abdest të tillë që kurrë të mos prishet.

Në këtë botë kemi ardhur për të plotësuar detyrën e ibadetit. Siç dihet leximi i Kuranit dhe namazi nuk realizohen pa abdest. Kurse abdesi që nuk prishet kurrë nënkupton vetëdijen e ibadetit deri në frymën e fundit.

Rrumiu thotë:

Fal një namaz të tillë që kurrë të mos mbarojë.

Koha e faljes së një namazi është afërsisht 10-15 minuta. Pas kryerjes së namazit është e nevojshme të ruhet gjendja e zemrës edhe jashtë namazit. Sepse zemra që nuk ruhet edhe gjatë namazit është e prirur të bjerë në neglizhencë, dhe pas një kohë mund të zhytet në shthurje dhe ligësi. Kurse namazi është një mbrojtje ndaj shthurjes, ligësisë dhe imoralitetit.

Pra shenjë e ibadetit të pranuar është vazhdimi i gjendjes pas ibadetit sikur gjatë ibadetit. Në këtë aspekt namazi është një gjendje e vazhdueshme. Besimtari i devotshëm duhet të jetë vazhdimisht deri në frymën e fundit në gjendje namazi.

Rrumiu thotë:

Ashikut nuk i mjaftojnë pesë kohë të namazit. Atij i duhen pesë qind mijë kohë. A do donte një ashik i vërtetë që malli të mbaronte?”

Kënaqësia më e madhe e namazit është komunikimi dhe afrimiteti me Allahun.

Allahu në një ajet kuranor thotë:



Bëj sexhde dhe afroju Zotit tënd! (Alak, 19)

Kënaqësia shpirtërore e ibadeteve nuk krahasohet me kënaqësinë materiale.

Për robërit që shijojnë ëmbëlsinë e dashurisë hyjnore, duke arritur të vërtetën e ibadetit, të gjitha gjërat e kësaj bote e humbasin vlerën e tyre. Për rrjedhojë, Ibrahim bin Et'hemi, i cili i la mënjanë mirësitë e kësaj bote dhe u zhyt në detin e dashurisë hyjnore, thotë:

“Nëse pasioni dhe zhytja jonë në dashurinë hyjnore do të ishte diçka materiale, mbretërit do të sakrifikonin të gjithë mbretërinë dhe thesaret e tyre për ta marrë atë.”

Në jetën e kësaj bote, kohët e kaluara larg dhikrit, pra, frymëmarrjet e konsumuara në harresë ndaj Allahut, janë fletë prej kalendarit të jetës që kanë shkuar dëm. Njerëzit që shijojnë kënaqësinë shpirtërore nuk kanë të ngopur me adhurime.

Rrumiu thotë:

Ti duhet të jetosh me meditim. Nëse mediton rreth trëndafil, ti je në kopshtin e trëndafil. Pra në xhenetin e tokës. E nëse mendon rreth gjembit, ti je trugu i stufës.”

Mendja dhe zemra janë gjithmonë në një gjendje meditimi. Por e rëndësishme është të jenë në gjendje meditimi në lidhje me çështje që të afrojnë tek Allahu. Meditim është ai që kontribuon në pasurimin e botës shpirtërore.

Meditimi mbi çështje egoiste dhe djallëzore e zhyt njeriun në shturje dhe e bën atë rob të egos dhe kënaqësive. Kurse meditimi mbi çështjet hyjnore e pasturon zemrën dhe rrit nivelin e kënaqësisë shpirtërore, e ruan njeriun nga kurthet e egos dhe i hap atij horizonte të reja urtësie.

Ashtu si motori i një makine prishet nëse i hedhim ujë në vend të benzinës, edhe bota shpirtërore e zemrës ndotet nëse e ushqejmë me gjëra boshe të cilat nuk përmbajnë asnjë urtësi në vetvete. Prandaj është shumë e rëndësishme të bëhet ndarja midis gjërave të dobishme dhe të padobishme. Ajeti kuranor e shpreh kështu faktin e shpëtimit të besimtarëve:

“...të cilët shmangen nga fjalët e kota.” (Muminun, 3)

Kurse Hadithi thotë:

“Prej shenjave të myslimanit të mirë, është braktisja e gjërave të panevojshme për të!” (Tirmidhi, Zuhd, 11)

Rrumiu thotë:

“Edhe sikur të kenë të mirat e të gjithë botës, miu dhe gjarpri sërish dhë hanë, tenja brenda drurit thotë me vete «e kush ka një ëmbëlsirë kaq të mrekullueshme si unë!».”

Nëse gomari do të ishte blerës do të blinte një pjepër të papjekur.

Njeriu vlerësohet sipas synimeve që kërkon të arrijë.

Njeriu e bën jetën në varësi të moralit dhe cilësive që ka përvetësuar. Nëse dikush ka zgjedhur për vete natyrën e miut dhe të gjarprit, është e kotë dhe e pavlerë t’ia servimi atij bukuritë e gjërat e këndshme.

Sepse gjendja në të cilën ai ndodhet nuk ia lejon atij vetëdijesimin për bukuritë dhe veprat e këndshme që ju do t’i servimi. Prej se nuk i vëren ato ai do të vazhdojë sërish të jetojë me të njëjtat gabime e gjynahe.

Është shumë e rëndësishme ajo që kërkojmë. Ajo që kërkojmë është kjo botë apo bota tjetër? Dëshirat tonë janë drejtuar



drejt kënaqësive të kësaj bote apo drejt kënaqësive shpirtërore? Është marrëzi e madhe ta kërkosht lumturinë në batakun e shthurjes dhe dëfrimit material.

Rrumiu thotë:

A mund të quhet e vdekur fara që bie në tokë?

Kur të vdes mos pandeh se kam shqetësim këtë botë! Mos kujto se mërzitem nga ndarja prej kësaj bote.

Mos qaj për mua kur të vdes! Nëse unë gjatë jetës i jam nënshtruar egos dhe shejtanit meritoj përbuzje.

Kur të shikosh xhenazen time mos thuj “ U largua, u largua” sepse ai është momenti i bashkimit për mu jo i ndarjes.

Kur të më vendosin në varr mos më thuaj lamtumirë! Sepse varri është perdja e xhenetit në botën tjetër.

A e ke vështuar perëndimin? Shiko një herë lindjen! Mos pandeh se perëndimi i diellit dhe hënës sjell humbje të dritës së tyre!

Edhe pse ty të duket si zhdukje ajo në fakt është një lindje diku tjetër, është një jetë tjetër në një botë tjetër.

Njeriu për nga përbërja materiale fillimisht ka qenë dhë, pastaj në shtyllën kurrizore të babait, pastaj në mitrën e nënës dhe në fund gjendet në krahët e prindërve. Pastaj vazhdon udhëtimin drejt përjetësisë.

Pra vdekja nuk është një zhdukje por është hapi i parë për një ringjallje në një botë tjetër. Ashtu si fëmija pret lidhjet me barkun e nënës duke dalë në një botë të re ashtu është edhe vdekja një ndërprerje e lidhjes me këtë botë për të rilindur në një botë tjetër.

Njeriu do të japë llogari për jetën në këtë botë dhe sipas saj ose do të hyjë në xhenet ose do të dënohet në xhehenem.

Pra njeriu në vend të përpjekjes për t'u larguar dhe harruar vdekjen duhet të përgatitet dhe punojë për botën tjetër.

Të gjithë peygamberët, sahabët dhe evlijatë kanë ditur ta bëjnë vdekjen të bukur, të ëmbël. Ata tani presin kijametin në varret e tyre të shndërruar nga bahçe të xhenetit.

Edhe ne duhet ta kalojmë jetën tonë të përkohshme të kësaj bote në përputhje me mësimet hyjnore në mënyrë që të fitojmë lumturinë e përhershme. Duhet të bëjmë vazhdimisht përpjekje për t'u përgatitur për vdekjen.

E lusim Allahun të na pajisi dhe zbukurojë jetën tonë me urtësi. E lusim Allahun të na bëjë prej njerëzve të mirë, prej atyre që synojnë botën tjetër dhe xhenetin e pafund të Allahut.


Amin...



MEVLANA رحمة الله عليه

-2-

Mirësitë e kësaj bote, për hir të së cilave përjetohen grindje të shumta, në të vërtetë janë si arra pa bukë. Kur njeriu zgjohet nga vdekja prej gjumit të kësaj jete kalimtare, do ta kuptojë se sa e shkurtër dhe e pavlerë ka qenë ajo. Ai do të pendohet për vuajtjet që ka hequr për hir të gjërave të kota në këtë botë të përkohshme. Sa mashtrim i hidhur është fakti që njerëzit hanë njëri-tjetrin në këtë botë për gjëra që do të bëhen pishman kur të shkojnë në varr!..







MEVLANA - 2

Mevlana thotë:

Fëmijët kur luajnë bëjnë dyqane dhe bëjnë sikur shesin mall dhe produkte të ndryshme në të, por ata nuk fitojnë asgjë nga kjo, kjo është vetëm për të kaluar kohën. Në darkë fëmija kthehet në shtëpi i uritur. E njëjta gjë është edhe me jetën e kësaj bote, kjo botë është një lojë.

Ebu Bekir Shibli një ditë ndërsa ishte duke ecur rrugës shikon dy fëmijë duke u zënë për një arrë.

Shibli e mori arrën dhe tha: duroni ta ndajmë në dy pjesë!..

Pasi e theu arrën, doli që arra kishte qenë bosh brenda, pa thelb.

Atëherë nga brenda një zë i tha:

Nëse me të vërtetë je prej atyre që mund të ndajnë kismet, urdhëro ndajë.

Pastaj Shibli tha:



E gjithë kjo zenkë ishte për një arrë bosh....

Mirësitë e kësaj bote, për hir të së cilave përjetohen grindje të shumta, në të vërtetë janë si arra pa bukë. Kur njeriu zgjohet nga vdekja prej gjumit të kësaj jete kalimtare, do ta kuptojë se sa e shkurtër dhe e pavlerë ka qenë ajo. Ai do të pendohet për vuajtjet që ka hequr për hir të gjërave të kota në këtë botë të përkohshme. Sa mashtrim i hidhur është fakti që njerëzit hanë njëri-tjetrin në këtë botë për gjëra që do të bëhen pishman kur të shkojnë në varr!..

Rrumiu ka thënë:

“Kjo botë nuk është tjetër, veçse një ëndërr. Të jesh i pasur në këtë botë, është si të gjesh një thesar në ëndërr. Pasuria e kësaj bote qëndron po në këtë botë duke u trashëguar nga brezi në brez.”

“Çfarë është ari, çfarë është jeta, çfarë është perla dhe merxhani, nëse nuk shpenzohen për dashurinë dhe nuk sakrifikohen për një Bukuri!”

Vlera e vetme e kësaj bote është se shërben për të ndërtuar botën tjetër. Pasuria dhe jeta e njeriut fitojnë vlerë nëse shpenzohen dhe sakrifikohen në rugën e Allahut.

Pasuritë dhe mirësitë e kësaj bote shprehin vlerë nëse shpenzohen për të gëzuar zemrën e një nevojtori dhe të vuajturi. Në të kundërt nuk janë gjë tjetër përveç se lodhje dhe barrë e rëndë në botën tjetër. Një person që e jeton jetën e kësaj bote neglizhent ndaj botës tjetër është si në një shkretëtirë e mbushur plot me mirazhe.

Prandaj besimtari duhet të përpiqet t'a shndërrojë pasurinë dhe mirësitë e kësaj botë në mjet lumturie për botën tjetër.



Besimtari që kërkon miqësinë me Allahun është i vetëdijshëm se gjithçka është një amanet i Allahut në këtë botë. Dhe ai në asnjë mënyrë nuk heziton të sakrifikojë çdo gjë në rrugën e Allahut.

Kurse ata që tregohen koprracë dhe hezitojnë të shpenzojnë në rrugën e Allahut përballen me qortimin e rëndë hyjnor:

Ata që grumbullojnë ar dhe argjend dhe nuk e shpenzojnë për hir të Allahut, paralajmëroji me dënim të dhembshëm.

(Teube, 34)

Rrumiu thotë:

“Ki mëshirë! Dashuria është diçka e mirë. Janë shprehjet tuaja të këqija ata që e dëmtojnë dashurinë. Ti e paske quajtur dashuri epshin. Ah sikur ta dije, sa shumë ndryshim ka midis dashurisë dhe epshit! Dashuria hyjnore e bën besimtarin vigjilent. Ndërsa dashuria e kësaj bote dhe epshi e bëjnë njeriun budalla dhe kokëtrashë”.

Burimi i dashurisë është Allahu. Ai ka vendosur në zemrën e njeriut farën e dashurisë. Prandaj nga kjo pikëpamje mjeti më i mirë për të fituar kënaqësinë e Allahut dhe për të vazhduar udhëtimin shpirtëror është dashuria.

Dashuria dhe pasioni që është kaplimi i të gjithë ekzistencës si shenjë e rritjes së dashurisë ndaj saj, ndahet në reale dhe alegorike. Pasioni real konsiston në dashurinë ndaj Zotit dhe është kapitali më i madh në rrugën e takimit me Të, ndërsa pasioni alegorik është dashuria dhe varësia ndaj krijesave. Dashuria alegorike e përjetuar brenda kritereve të pëlqimit hyjnor, është një shkallë drejt dashurisë reale dhe një lloj ushtrimi që rrit aftësinë e zemrës për të dashuruar.

Nuk duhet që dashuria të konsumohet në adresë të gabuar. Një dashuri e konsumuar në një vend të gabuar dhe të pamerituar është një shpërdorim. Dashuria për interes është si lulet që dalin buzë rrugë, të cilat herët ose vonë do të shkelen nga këmbët e kalimtarëve. Sa fatkeqësi është për një perlë që ka përfunduar në koshin e plehrave.

Prandaj dashurinë duhet të adresojmë Allahut. Sepse vetëm ajo dashuri është e përjetshme. Dashuria për çdo gjë tjetër rrjedh prej dashurisë që kemi për Krijuesin e krijesave.

Të dashurit e Allahut e kanë kultivuar dashurinë për Allahun në zemër duke e shndërruar atë në një bahçe plot me lule dhe pemë frutorë.

Ismail Ata e shpreh kështu shfaqjen e dashurisë:

Në diell bëhu hije, në mot të ftohtë bëhu mbulesë, në kohë urie bëhu bukë.

Rrumiu ka thënë:

“Frymët e profetëve ndikonin edhe mbi gurin. Fjalëve të tyre u përulleshin edhe malet. Mirëpo, mendjelehtët nuk i prek qoftë edhe një prej perlave të urtësive që shpërndanin ata!”

“Mendjelehti dëgjon vdekjen e të gjithëve, por vdekje e vet as që e çon nëpër mend...”

Këshilla për një që është zhytur në gjumin e thellë të neglizhencës dhe harresës është si një farë e mbjellë në tokë të thatë. Ose është sikur vadit shkretëtirën. Prandaj mos e harxhoni farën e urtësisë në vende të tilla.

Përpjekja për të t'i dhënë urtësi atij që nuk e meriton është padrejtësi ashtu siç është padrejtësi të privosh nga urtësia atë që e meriton. Prandaj besimtari duhet të komunikojë me njerëzit sipas



kapacitetit të tyre. Ai duhet të tregojë kujdes në komunikimin e tij me njerëzit. Në rast se këshilla vlen dhe ka dobi duhet të flasë në të kundërt duhet të heshtë.

Siç thotë ajeti kuranor:

Prandaj këshillo, nëse këshilla do të jetë e dobishme!

(Ala,9)

Nëse këshilla nuk ka dobi atëherë është më mirë heshtja. Rrumiu këtë të vërtetë e shpreh kështu:

Mos shit pasqyra në pazarin e të verbërve dhe mos këndo serenata të vendin e shurdhërve.

Pra dobia nga këshilla është mirësi e madhe prej së cilës nuk mund të përfitojnë të gjithë. Është kohë e humbur të angazhohesh për të këshilluar njerëz që e kanë të mbyllur derën e urtësisë.

Këtë gjendje e tregon shumë bukur ky tregim:

Isai a.s po largohej me shpejtësi sikur ta ndiqte një luan nga pas. I habitur nga kjo pamje, një burrë e ndjek nga pas dhe e pyet:

“-Nga kush po largohesh kështu si një zog i trembur? Askush nuk po të ndjek!”

Aq shpejt po vraponte saqë nga nxitimi Isai a.s nuk i ktheu dot përgjigje. Më në fund burri kureshtar u afrua dhe e pyeti përsëri:

“- O Ruhullah! (frymë e Allahut)! Ikja jote u bë mister për mua. Nga kush po largohesh?”

Isai a.s iu përgjigj:

“Po largohem nga mendjelehti, nga i pamendi...! Ik mos më pengo, më lër të shpëtoj veten!”

Këtë herë burri i përkujton mrekullitë (me të cilat ishte dërguar) dhe e pyet sërish për urtësinë e largimit: “A nuk je ti «Mesihu» që prej frymës tënde gjetën shërim të verbrit dhe të shurdhët?” Isai a.s iu përgjigj:

“Po, unë u lexova të shurdhëve dhe të verbërve emrin më të Madh të Allahut dhe ata gjetën shërim. U lexova të vdekurve dhe ata u ringjallën. Mirëpo kur i lexova mendjelehtit për të disatën herë me dhembshuri e mëshirë, ai përsëri nuk përfitoi. Mbeti si gur e prapë se prap nuk hoqi dorë nga mendjelehtësia. U kthye në rrëzë të thatë ku as bari s’mbiu”.

Pasi dëgjoji këto fjalë, kureshtja e burrit u shtua edhe më shumë dhe e pyeti përsëri:

“Meqë dua ja jote ka ndikim dhe shërim në shumë gjëra, si është e mundur të mos ketë ndikim tek mendjelehtësia? Ndërkohë që sëmundjet e tjera i shëron, përse këtë jo?”

Isai a.s u përgjigj:

“Mendjelehtësia është një sëmundje shkatërruese. Ndërsa të tjerat janë varësi që nuk kanë fituar zemërimin e Allahut. Edhe varësia është sëmundje por ajo ka ndikim vetëm tek i sëmuri. Ndërsa mendjelehtësia është një sëmundje e tillë që dëmton jo vetëm të sëmurin por edhe të tjerët përreth”.

Rrumiu thotë:

“Miu i fekaleve gjen rehat vetëm mes ndyrësive. Kështu edhe brumbulli, që bart gjithmonë pleh dhe pislleqe. Prandaj edhe u merren mendtë nga uji i trëndafilut. Ndërsa ilaçi i tyre, janë gjërat me aromë të keqe, sepse ata me ato janë mësuar.

Po ashtu edhe këshilluesit, dëshirojnë t’i mjekojnë zemrat e ngurtësuar të njerëzve me fjalë të urta, me aroma dhe ujë



trëndafili. Por, nëse këshilla dhe aroma e këndshme nuk bën dobi, patjetër që ai është mësuar me aroma të pista.

Prandaj edhe ti përfito prej dritës, këshillës, mirësisë dhe bukurisë!.. Mos e fut hundën në ndyrësira dhe mos u bëj si brumbulli! Bëhu njeri, bëhu njeri!..”

Ndërmjet specieve dhe mjediseve në të cilat ato gjenden në këtë botë gjithmonë ka një tërheqje apo joshje. Ndërkohë që bilbilit i pëlqejnë kopshtet me trëndafila e lule dhe burimet që burojnë pothuajse me melodi, ato që kanë natyrshmërinë e brumbullit kënaqen nga papastërtia, domethënë, nga imoraliteti, prishja dhe hipokrizia.

Një gonxhe e mrekullueshme e shpreh kështu këtë gjendje duke i thënë me gjuhën e tyre një brumbulli:

“O brumbull! Ti ikën nga bahcja e trëndafilave, por kjo urrejtja jote është argument për përsosmërinë e bahçes së trëndafilave!..”

Ndërkohë që njerëzit e këqij bëheshin armiq të peygamberëve kur ata i dërgoheshin ndonjë populli, njerëzit me moral dhe vlera të larta u besonin menjëherë dhe mbledheshin rreth të dërguarve të Zotit (xh.sh.). Nisur nga kjo urtësi, Hazreti Mevlana thotë:

“Allahu i Lartësuar ka dërguar peygamberë, në mënyrë që shpirtat e ndershëm dhe të pastër të ndahen prej shpirtave të ndyrë dhe të pisët.”

Është shumë e vështirë që një i marrë të vlerësojë urtësinë. Të përpiqesh t’i mësosh atyre urtësinë është një padrejtësi e madhe që i bëhet vetë padrejtësisë dhe një kohë e humbur. Ashtu si shiu i pranverës nuk ka asnjë dobi për shkëmbinjtë dhe shkretëtirën e thatë edhe urtësia nuk ka asnjë dobi për njerëz të tillë.

Rrumiu thotë:

Pranë injorantëve bëhu i heshtur si një libër.

Mos u përfshi në debate me injorantët, vetëm duke i qëndruar larg debatit, ata mund të përfitojnë. Kurse debati shndërrohet në garë për epërsi, gjë e cila nuk ka asnjë dobi për palët. Madje debati ndikon negativisht në pranimin dhe zbulimin e së vërtetës.

Njerëzit e urtë dinë ku duhet ta përçojnë urtësinë. Ata kanë vizionin dhe aftësinë e duhur për t'i përcjellë njerëzve të vërtetën në mënyrën e duhur. Ndonjëherë heshtja është shumë më kuptimplotë se sa shumë fjalë.

Rrumiu thotë:

Nëse dëshiron të miqësohesh me Allahun e Madhëruar, dije mirë se tek miqtë nuk shkohet duarbosh! Të shkosh duarbosh tek miqtë, është si të shkosh pa grurë në mulli.

Allahu i Madhëruar do t'i pyesë robërit e Tij në ditën e gjykimit:

«Çfarë dhurate keni sjellë për ditën e Kiametit?»

Pastaj do të thotë:

«Ju keni ardhur duarbosh, pa furnizim, të vetmuar dhe nevojtarë ashtu siç ju krijuam në fillim. Na tregoni çfarë dhurate keni sjellë për ditën e Kiametit? Apo ndoshta nuk shpresonit se do të ktheheshit nga dynjaja në ahiret e do të dilnit para Allahut? A mos ju duk kot lajmi i Kuranit në lidhje me Kiametin?»

O ahsen-i takuim, pra, o njeri që je krijuar me cilësitë më të bukura! Nëse nuk e mohon ditën e Kiametit, si shkel në derën e Atij Miku kështu, duarbosh? Pakësoje gjumin, ushqimin dhe pijen në këtë botë të përkohshme dhe përgatit një dhuratë për kohën kur do të takohesh me Allahun e Madhëruar!..”



Çdo njeri është një udhëtar drejt përjetësisë. Ashtu si një udhëtarë merr me vete zahire për udhëtimin, ashtu duhet të përgatitet udhëtari për udhëtimin e tij drejt përjetësisë.

Allahu thotë në Kuran:

Çdo vepër të mirë që bëni, Allahu e di. Pajisuni me gjërat që ju nevojiten për rrugë dhe dijeni se pajisja më e mirë është devotshmëria. Prandaj, kini frikë prej Meje, o njerëz të mençur! (Bekare, 197)

Nesër do të bëhemi pjesë e tokës mbi të cilën sot shkelim e kalojmë. Por, për të mos u dënuar nesër nën tokë, duhet të mos mashtrohemi sot mbi tokë prej madhështive të përkohshme që e joshin egon tonë. Në këtë botë, nuk duhet të shëtitim si vendas dhe nuk duhet të harrojmë se jemi udhëtarë drejt vdekjes, që mund t'u vijë ftesa në çdo moment. Po ashtu, nuk duhet të harrojmë edhe se kemi një takim të pashmangshëm me Azrailin, në një vend dhe një kohë të panjohur për ne.

Të mos harrojmë se as në këtë botë nuk ka kohë dhe vend ku mund t'i shpëtosh vdekjes, as në varr nuk ka ndonjë mundësi për t'u kthyer pas dhe as në ditën e kiametit nuk do të ketë vendstrehim prej tmerrit të asaj dite.

Rumiu thotë:

“Ndërkohë që përpiqemi të mbushim një çantë të kemi kujdes të mos e zbrazim nga vrimat poshtë saj.”

Në krye të zahireve për botën tjetër është besimi, pastaj vijnë ibadetit dhe veprat e mira. Por të gjitha këto duhen ruajtur nga veset dhe shfrenimet e egos pas kënaqësive të kësaj bote.

Një besimtar për të arritur pjekurinë dhe përsosmërinë duhet të pajiset me moral të bukur. modestia, thjeshtësia, drejtësia,

besnikëria, bujaria, mirësia, sinqeriteti, durimi dhe mëshira duhet të jenë pjesë e pandashme e moralit të tij.

Kurse duhet të qëndrojë larg veseve të tilla si: gënjeshtria, thashethemet, padrejtësia, urrejtja, babëzia, mendjemadhësia dhe mburrja.

Duhet të tregohet kujdes në mënyrë që namazi të mos cenohet nga neglizhenca, agjërimi nga thashethemet, sadakaja dhe zeqati nga përmendja e mirësisë. Ibadetit dhe mirësitë nuk duhet të jenë burim mburrje dhe krenarie. Besimtari duhet të qëndrojë larg çdo ndjenje që ndot sinqeritetin. Në të kundërt të gjitha veprat janë të pavlefshme.

Rrumiu thotë:

“Jusufit (a.s.), i vjen një mik i largët me zemrën e mbushur plot dashuri dhe i bëhet mysafir në shtëpi. Ata ishin miq të përziemërt që prej fëmijërisë. Pasi bisedoi me të për një farë kohe, Jusufi, që kishte një bukuri magjepsë, e pyet mikun e tij:

«Na thuaj miku im! Çfarë dhuratash na solle prej vendeve ku ke shkuar?»

Mysafiri, në fillim u hutua disi përballë kësaj pyetje. Por, më pas i shpreh kështu ndjenjat e tij:

«Pashë shumë gjëra në këtë botë të përkohshme, me qëllim që të zgjedh një dhuratë për ty. Mirëpo, asnjëra nuk më pëlqeu, sepse asnjëra nuk të kishte hije. E si mund ta çoj si dhuratë një thërrime floriri tek një lum me flori apo një pikë uji, tek një det? Cila farë mund të jetë e njëjtë me bukurinë tënde, të cilën mund ta gjejë në hambarët e Egjiptit? Dhurata që të ka hije ty, mund të jetë vetëm diçka e ngjashme me bukurinë tënde. Për këtë arsye, unë mendova të të sillja një pasqyrë të ndritshme e të pastër si drita e zemrës.



O Jusuf, që je drita e qiellit ashtu si dielli! Të kam sjellë një pasqyrë prej dritës së zemrës, me qëllim që sa herë që ta shohësh, të vësh bukurinë tënde e të mahnitesh. Dhe, sa herë që të shohësh bukurinë e fytyrës tënde, të vësh shfaqjet e bukurisë së Allahut tek ty dhe të më kujtosh mua.»

Allahu është krijuesi dhe zotëruesi i gjithçkaje. Për këtë arsye, Ai nuk ka nevojë për krijesat. Nuk ka asnjë lloj dhurate që mund t'i dërgohet, e që të mos gjendet në thesarin e Tij. Ai është buri-mi i të gjitha të mirave dhe bukurive. Për këtë arsye, gjëja më e bukur dhe më e vlefshme të krijesat, është një “zemër e pastër dhe e dëlirë”, e cila mund të bëhet pasqyrë e “esmau'l-husna”, pra, e emrave të bukur të Allahut. Për këtë arsye, dhurata më e përshtatshme që mund t'i paraqitet Zotit, është “zemra e pastër”, që Zoti i Madhërisëm kërkon prej nesh.

Një rob me zemër të pastër, është i sigurt nga turpërimi dhe poshtërimi në ditën e gjykimit, atëherë kur çdo gjë e fshehtë dhe e hapur do të dalë në shesh para Allahut, të Dërguarit të Tij (a.s.) dhe gjithë njerëzimit. Kështu, ai shpëton prej të gjitha vështirësive dhe vuajtjeve të asaj dite.

Allahu thotë në Kuran:

“Allahu i thërret njerëzit për në Shtëpinë e shpëtimit (Xhenet) dhe udhëzon kë të dojë në rrugën e drejtë.” (Junus, 25)

Çdo ftesë ka kushtin e pranimit dhe çdo mirësi ka koston e vet. Prandaj për të siguruar shpëtimin hyjnor, në këtë botë që është parapërgatitje për botën tjetër duhet kultivuar mirësia dhe morali i lartë.

Allahu thotë në Kuran:

“Në Ditën, kur askujt nuk do t'i bëjë dobi as pasuria, as

fëmijët, përveç atij që vjen me zemër të pastër tek Allahu!”

(88-89)

Zemra e pastër, është si një fener i kristaltë, brenda të cilit shkëlqen drita e besimit. Me këtë dritë në zemër, besimtari arrin të dallojë të vërtetën nga gënjeshtria, të drejtën nga e shtrembëta dhe hallallin nga harami.

Një zemër e pastër dhe e pa ndotur me gjynahe dhe lakmi, ka aftësinë të dallojë të vërtetën nga gënjeshtria dhe të mirën nga e keqja. Kjo, sepse zemra e pastër, është një busull e sigurt për të gjetur drejtimin. Gjërat që e ndotin dhe sëmurin atë, janë dëshirat e egos, indiferenca dhe gjynahet.

Vlera e të gjithave veprave është në raport të drejtë me pastërtinë e zemrës. Profeti (a.s.) këtë të vërtetë e shpreh kështu:

“Padyshim se Allahu i Madhëruar nuk sheh trupat dhe pamjet tuaja, por vetëm zemrat tuaja!” (Muslim, Birr, 33)

Rrumiu tregon:

“Një burrë e përkujtonte Allahun gjithmonë duke thënë: “Allah!.. Allah!..” Për shkak të këtij përkujtimi, goja i ëmbëlsohej sikur të kishte ngrënë mjaltë. Një ditë shejtani i shkoi pranë dhe i tha:

“Përse vazhdimisht thua “Allah!.. Allah!..” pa reshtur? A të ka thënë Allahu qoftë edhe një herë: “Lebbejk / urdhëro rob! Im, çfarë dëshiron?”, si shpërblim për fjalën “Allah” që e thua për kaq shumë kohë? A nuk ke aspak turp dhe a nuk bezdisesh? Deri kur do të thuash “Allah!.. Allah!..”

Nisur nga kjo, burri i cili e përkujtonte vazhdimisht Allahun Teala, u turpërua, u mërzit (e humbi shpresën) dhe e la përkujtimin e Allahut. Andaj u shtri me zemër të thyer dhe fjeti.



Në ëndërr pa Hizrin (a.s.). Hazreti Hizri e pyeti:

“Përse e le veprën e mirë që më parë e bëje? Përse e le përmendjen e Allahut?”

Burri iu përgjigj:

“Asgjë nuk mu dha si shpërblim për gjithë atë dhikër / përmendje që kam bërë. Nga Allahu nuk më erdhi zëri: “Lebbejk / urdhëro robi Im!” Andaj u frikësova se mos përzihem nga dera e Tij.”

Nisur nga kjo, Hizri (a.s.), i dha burrit këtë përgjigje të urtë:

“O rob i Allahut! Nëse ti thua: “Allah!..”, kjo domethënë se Allahu thotë: “Lebbejk / urdhëro robi Im!”

A ua mundëson të gjithëve Allahu që ta përmendin emrin e Tij?

Nëse ti arrin të thuash “Allah!..”, kjo është shenjë e dashurisë që Allahu Teala ka për ty.”

Sapo burri e dëgjoi këtë përgjigje të urtë, u ngrit, i kërkoi falje Allahut të Madhëruar dhe përsëri vazhdoi ta përmendte Allahun.”

Përmendja e Allahut dhe falënderimi dhe ibadeti ndaj Tij është një mirësi që kërkon falënderim në vetvete.

Adhurimi i gjithë krijesave as nuk i shton dhe as nuk i pakëson gjë Allahut. Po ashtu edhe nëse e mohojnë të gjitha krijesat përsëri tek Allahu nuk ka asnjë ndikim. Allahu nuk ka nevojë për asgjë, as për ibadetin tona. Ata që kanë nevojë jemi ne, ne kemi nevojë për ibadet ndaj Tij dhe për veprat e mira sepse vetëm në këtë mënyrë mund t'i afrohemi Atij.

Ego dhe shejtani për ta larguar njeriun nga ibadeti e frymëzon atë me gjithfarë lloj hilesh. Një nga hilet që ofron shejtani është edhe mendimi se ibadeti nuk më pranohet.

Mirëpo detyra e njeriut është të kryejë ibadetit në mënyrën më të mirë të mundshme, pranimi ose jo i tyre është në dorë të Allahut. I vetmi që mund të japë gjykim për ibadetin është Allahu. Gjykimi i njeriut për ibadetet është tejkalim i kufirit.

Ajo që na takon ne është të tregojmë përpjekjen maksimale për t'i kryer adhurimet në formën dhe mënyrë më të mirë dhe kërkimi i faljes për çdo mangësi që mund të kemi lënë. Detyra jonë është strehimi tek mëshira, bujaria dhe falja hyjnore. Në asnjë mënyrë nuk duhet të humbim shpresën prej Allahut. Besimtari gjithmonë duhet të jetë në një gjendje midis shpresës dhe frikës.

Nga ana tjetër të jesh i sigurtë në pranimin e adhurimeve nga ana e Allahut është një iluzion dhe gabim i madh. Detyra jonë është të bëjmë ibadet dhe falënderojmë Allahun vazhdimisht për mundësinë që na ka dhënë për ta adhuruar. Në fund të lutemi për falje dhe mëshirë nga ana e Allahut.

E lusim Allahun të na mundësojë një jetë plot adhurime dhe vepra të mira,

Amin...



MEVLANA رحمة الله عليه

-3-

Jeta e kësaj botë është si një lumë që rrjedh shpejt. Njeriut është dhënë një afat i caktuar në këtë botë. Ata që janë neglizhentë ndaj kësaj të vërtete mendojnë se është shumë e gjatë, por krahasuar me botën tjetër është shumë e shkurtër dhe e pavlerë.





MEVLANA - 3

Mevlana thotë:

“Kur ta shohësh lumin e jetës së pasosur, ujin që ke në enë, domethënë këtë jetë të shkurtër e të vdekshme, bashkoje me lumin e pavdekësisë! A ikën uji nga lumi?”

Kur uji në enë të përzihet me ujin e lumit, shpëton nga qenia e vet dhe bëhet ujë lumi! Atëherë, cilësitë e ujit të enës zhduken, por vetë mbetet dhe, pas kësaj, as pakësohet, as ndotet, e as merr erë!”

Interpretuesit e veprës së Rumiut në lidhje me këtë metaforë kanë thënë se lumi simbolizon jetën tjetër, kurse ena me ujë jetën e kësaj bote. Derdhja e enës me ujë në lumë është zbatim i fjalës: **“Vdisni para se të vdisni”** Pra siç do qenie e përkohshme në këtë botë besimtari para se t’i vijë vdekja duhet të mënjanojë të gjithë ambiciet e ulta të kësaj bote duke u shndërruar si një i vdekur ndaj tyre. Në këtë mënyrë ai përmes një bindje dhe nënshtrimi të plotë ndaj Allahut, të gjitha mirësitë e kësaj bote i ka për botën tjetër.



Jeta e kësaj botë është si një lumë që rrjedh shpejt. Njeriut është dhënë një afat i caktuar në këtë botë. Ata që janë neglizhentë ndaj kësaj të vërtete mendojnë se është shumë e gjatë, por krahasuar me botën tjetër është shumë e shkurtër dhe e pavlerë.

Profetit (a.s.) në një hadith thotë:

“Gjendja e kësaj bote në krahasim me botën tjetër, është sikur dikush prej jush të fusë gishtin në det dhe ta nxjerrë. Çfarë të nxjerrë gishti (nga deti), aq është edhe kjo botë (në krahasim me botën tjetër)”. (Hakim, Mustedrek, 4/319)

Të gjithë mirësitë si edhe jeta janë një dhuratë e Allahut për njeriun. Ato janë të vetëm kapitale për të fituar botën tjetër. Prandaj tregtia më fitimprurëse është të shesësh këtë botë për të fituar botën tjetër. Sidoqoftë ne një ditë me pahir apo pa hir do të rikthehemi tek Krijuesi. Ajo që është e rëndësishme të shkojmë me vepra dhe punë të mira.

Allahut thotë në Kuran:

Nga Allah vijmë dhe tek Ai do të kthehemi. (Bekare, 156)

Është mençuri të shpenzosh dhe sakrifikosh mirësitë e kësaj bote për botën tjetër. Në fakt thënë vdis para se të vdesësh nënkupton pikërisht këtë gjë.

Rrumiu thotë:

Sa mirë për atë që vdes para se të vdesë, ai e ka shijuar aromën e të vërtetës...

Nga ana tjetër ena mund të simbolizojë pozitën, forcën dhe prestigjin e njeriut në këtë botë. Kurse sundimi hyjnor është i pamatë dhe i pakrahasueshëm.



Po ashtu ena me ujë mund të simbolizojë diturinë që mund të arrijë njeriu krahasuar me diturinë hyjnore e cila është e pafundme.

Hadithi profetik e shpreh shumë bukur këtë të vërtetë:

Gjatë udhëtimit kur Hizri (a.s.) i tregoi Musait (a.s.) ngjarje të çuditshme me kuptim të fshehtë, një trumcak u ul në anë të anijes ku kishin hipur ata. Pastaj trumcaku mori ujë me sqep nga deti. Duke ia tërhequr vëmendjen mbi këtë veprim, Hizri (a.s.) i tha kështu Hz. Musait:

“Pranë dijes së Allahut, dija jote, ime dhe e të gjitha krijesave është sa uji që mori ky trumcak nga deti!” (Buhari, Tefsir, 18/4)

Ajo enë ujë gjithashtu mund të simbolizojë pasurinë dhe mirësitë që Allahu i ka dhënë njeriut në këtë botë.

Ajeti kuranor e shpreh kështu:

Allahut i përket sundimi i qiejve dhe i Tokës dhe (vetëm) Allahu është i Fuqishëm për çdo gjë. (Ali Imran, 189)

Ai ju jep gjithçka që i kërkon. Edhe nëse përpiqeni t'i numëroni dhuntitë e Allahut, nuk do të mund t'i numëroni dot. Njeriu është vërtet i padrejtë dhe mosmirënjohës. (Ibrahim, 34)

Të gjitha mirësitë që Allahu i ka dhënë njerëzimit nuk e pakësojnë aspak thesarin e Tij. Pra ajo enë mund të shprehë të gjithë mirësitë e kësaj botë që i janë dhuruar njeriut. Kurse lumi i jetës rrjedh drejt Allahut. Njeriu sa më shumë të derdhë pasuri, dituri, dhe çdo gjë tjetër që i shërben për botën tjetër aq më shumë grada të larta arrin.

Rumiu thotë:

A e braktis fëmija qepën pa parë mollën?

Fëmijët lozin dhe kënaqen me lodrat e tyre të thjeshta, por

kur rriten dhe zhvillohen ato lodra me të cilat janë kënaqur fillojnë të zhvlerësohen në syrin e tyre. Nuk mund të imagjinohet që me ato lodra të luaj një njeri i pjekur.

Allahu kërkon prej nesh pjekurinë shpirtërore duke u distancuar nga kënaqësitë e rëndomta të kësaj bote dhe duke synuar ahiretin dhe lumturinë e përhjetshme.

Ajeti kuranor thotë:

Jeta e kësaj bote, nuk është gjë tjetër, veçse argëtim dhe lojë. Ndërsa jeta e botës tjetër, pikërisht ajo është jeta e vërtetë. Veç sikur ta dinin! (Ankebut, 64)

Të mashtrohesh nga stolitë e pavërteta të kësaj dynjaje e, të shkatërrosh gradat dhe vlerat që ke tek Krijuesi yt, është si të shesësh një vazo ari me gurë të çmuar, në vleftën e një cope teneqeje, krejt të pavlerë.

Kush jep të përkohshmen dhe fiton të përhjetshmen, është i zgjuar. Ai që shet botën tjetër dhe mashtrohet me këtë botë, është mendjelehtë. Kurse ai që shet botën tjetër për interesat e dikujt tjetër në këtë botë, është i marrë!..

Allahu nuk i jep vlerë atij që e harron botën tjetër dhe zhytet në kënaqësitë e kësaj bote, e cila nuk vlen as sa krahu i një mize tek Allahu. Një namaz është më i mirë se gjithë bota dhe çfarë ajo ka brenda.

Por ata që jepen pas kënaqësive të kësaj bote janë të pavetëdijshëm për mirësitë e pafundme në botën tjetër duke e pandehur qepën si ushqimin më të shijshëm. Ata i kanë kthyer shpinën mirësive të pafundme dhe i kanë këmbyer ato me kënaqësitë e përkohshme dhe të rëndomta të kësaj bote.

Rrumiu thotë:



Njeriu e shiti lirë veten. Ai ishte si një pëlhurë e shtrenjtë atlas por shkoi e shpenzoi atë për një hirkë.

Njeriu në vend që të drejtohet drejt mirësive të pafundme që i ka premtuar Allahu, jepet pas kënaqësive të përkohshme të kësaj bote duke shkatërruar në këtë mënyrë lumturinë e përhershme në botën tjetër.

Malik Ibn Dinari e pyet Hasan Basriun se cila gjë është më e keqe në këtë botë?

Hasan Basriu i thotë:

“Vdekja e zemrës”

Përse vdes zemra? pyeti Malik ibn Dinari.

Zemra vdes nga dashuria që ka për botën. Nga rënia pas kënaqësive të kësaj bote.

Kurse një tjetër njeri i urtë e shpreh kështu:

Ata që duan fenë nuk kanë humbur asgjë nga kjo botë kurse ata që duan këtë botë kanë dalë prej feje.

Fetaria nuk konsiston në tërheqjen prej kësaj bote, në asketizmin e tepruar. Asketizmi është mos përfshirja e kësaj dynjaje në zemër. Ndërsa përfitojmë prej kësaj bote nuk duhet të bëhemi robër të saj. Nëse një zemër rrethohet nga kënaqësitë e kësaj bote, e ka shumë të vështirë të kuptojë të vërtetat dhe të marrë kënaqësi prej adhurimeve.

Për të mbrojtur zemrën nga sëmundja duhet me patjetër që zemra të thellohet në asketizëm dhe devotshmëri.

Rrumiu thotë:

Deti nuk ndotet sepse lëpiu në të qeni.

Ata që sulmojnë vlerat shpirtërore, fetare dhe gjërat e shenjta nuk shkaktojnë asnjë mangësi në madhështinë e këtyre vlerave. Atë vetëm sa shumëfishojnë dënimin në botën tjetër. Ata përgatisin me duart e vete dënimin e tmerrshëm në botën tjetër.

Nëse e duam Allahun dhe të Dërguarin e Tij, dashurinë dhe urrejtjen për hir të Allahut duhet ta kthejmë në cilësinë kryesore të karakterit dhe personalitetit tonë. Pra, duhet t'i duam ata që e meritojnë dhe t'i urrejmë armiqtë e Allahut, të Pejgamberit, të Islamit dhe myslimanëve.

Një nga shembujt më të gjallë të këtij fakti është edhe mallkimi nga ana e Allahut të Madhëruar në suren Tebbet, i Ebu Lehebit, për shkak të ashpërsisë dhe këmbënguljes së tij në mohim, megjithëse ai ishte xhaxhai i Pejgamberit(a.s.) Për atë që e meriton dashurinë duhet të ushqejmë dashuri dhe për atë që meriton urrejtje duhet të ushqejmë urrejtje.

Rrumiu thotë:

“O i gjorë që për një kafshatë buke e hedh tutje thesarin e imanit, e që shet një thesar të çmuar për një kokërr elbi!

Nemrudi nuk ia dha shpirtin Ibrahimit (a.s.) e përfundoi t'ia dorëzonte atë një mushkonje.”

Sa fatkeqësi e madhe është të shesësh botën tjetër për të përfituar disa kënaqësi të rëndomta të kësaj bote.

Një nga dijetarët e hershëm ka thënë:

Çdo mundësi që nuk të afron me Allahun është fatkeqësi.

Xhafer-i Sadik (Allahu e mëshiroftë), me anë të një ndodhie imagjinare, e shpreh kështu gjendjen e bijve të dynjasë dhe të atyre të ahiretit:

“Allahu i Madhëruar i drejtohet dynjasë dhe i thotë:

«O dynja! Shërbeji dhe ndihmoje atë që më shërben Mua (që përpiqet në rrugën e Zotit) dhe lodhe atë që të shërben ty (që përpiqet për kënaqësi të egos së vet)!»”

Robi duhet të jetë gjithmonë në gjendje meditimi, me qëllim që të mos e shpërdorojë mirësinë e jetës dhe ta përdorë atë me devotshmëri.

Koprracët të cilët janë bërë robër të dynjasë, dembelët që për të mos prish rehatinë e tyre nuk bëjnë asnjë përpjekje për ibadet dhe ata që janë indiferentë ndaj shërbimeve në rrugën e Allahut, një ditë të gjithë do të përballen me shpenzimin dhe shpërdorimin e pasurisë së tyre në qëllime shumë vulgare. Ata që nuk janë të gatshëm dhe guximtarë për të përballuar vështirësitë për qëllime të mëdha hyjnore, një ditë do të mbyten në një enë të vogël uji.

Nemruti i cili refuzoi besimin dhe bindjen ndaj Allahut duke iu nënshtruar djallit dhe pretendoi cilësi hyjnore për vete mbeti i pafuqishëm kur i erdhi caktimi hyjnorë përmes një mize.

Si çdo mendjemadh përfundimi i të cilit është i tmerrshëm edhe pasuria që lejnë pas nuk qan për por as atje në botën tjetër do t'i organizohet një pritje e frikshme. Historia është e mbushur plot me shembuj të tillë që kanë pasur një përfundim të tmerrshëm.

Lumturia e vërtetë është të shfrytëzohen të gjithë mundësitë e kësaj botë në rrugën e Allahut. Të pranojmë dobësinë tonë dhe të punojmë shumë për të fituar dashurinë e Allahut.

Profeti (a.s.) ka thënë:

“I mençur është ai që përmban veten dhe punon për jetën

mbas vdekjes, kurse mendjelehtë është ai që jepet mbas dëshirave dhe shpreson mëshirën e Allahut pa kurrfarë merite.”

(Tirmidhiu, Kijamet, 25/2459)

Nuk duhet harrojmë që lumturia dhe qetësia gjendet duke frenuar dëshirat dhe ambiciet e rëndomta dhe vrapimin pas shërbimit në rrugën e Allahut deri në frymën e fundit.

Imam Gazaliu thotë:

“Njeriu është kalorës i egos. Nëse njeriu i lëshon frenat egos duke e lënë në harbim e vet atë, mundësia e shkatërrimit është shumë e madhe. Prandaj mbajë fort frenat në mënyrë që të shkosh në destinacionin që duhet.”

Një besimtar që e mposht egon dhe pastron shpirtin gjithmonë do të jetë i fortë, i shëndetshëm dhe i qetë.

Pejgamberët, sahabët dhe njerëzit e dashur të Allahut janë mbrujtur me vështirësi dhe sprova të mëdha, por më gjithë sprovat dhe vështirësitë materiale shpirtërisht ata kanë arritur qetësinë maksimale.

Sekreti i lumturisë së besimtarit nuk është përmbushja dhe plotësimi i kënaqësive materiale por pastrimi dhe edukimi i egos sipas mësimet hyjnore.

Jusuf Has Haxhib thotë:

Mos u bëj rob i egos! Sepse nëse bëhesh rob i egos për të shpëtuar prej tij kërkon si shpagim fenë...

Rrumiu thotë:

Uria është nëna e ilaçeve. Mësohu të qëndrosh i uritur. Shumë sëmundje shërohen me uri. Edhe ushqimet e mira nuk shijojnë pa qenë i uritur.



Një person po hante gjithë oreks një butë të ndenjur.

Një burrë e pyeti se përse e hante me aq oreks atë bukë të ndenjur.

Personi i tha:

Në fund të durimit uria u dyfishua dhe kjo bukë e ndenjur mu bë më e ëmbël se një ëmbëlsirë.

Uria e pastron dhe ndriçon zemrën kurse ngopja e ashpërsion dhe errëson atë. Ndërsa uria e edukon dhe e nxit për punë të mira zemrën, ngopja e verbëron shpirtërisht dhe i bllokon dritaret e urtësisë.

Shejh Shibli në lidhje me këtë thotë:

Sa herë që kam qëndruar i uritur më është hapur një portë urtësie.

Ebu Sulejman Darani thotë:

Çdo gjë ndryshket. Ndryshku i zemrës është ngrënia e tepërt. Kush ha shumë përballet me këto gjashtë prova:

1. Nuk ndjen kënaqësi kur fal namazin.
2. Harron shpejt.
3. Nuk është i dhembshur për të tjerët.
4. Është dembel në adhurime.
5. E sundon epshi
6. Ndërsa muslimanët shkojnë në xhami ai shkon në banjë.

Prandaj për të siguruar një qetësi shpirtërore nuk duhet të mbi ngarkohemi me ushqim. Shumë njerëz të cilët jetojnë në mirëqeni materiale vuajnë nga shqetësime shpirtërore, stresi,

depresioni, pakënaqësi dhe indiferenca. Ndër shkaqet kryesore të kësaj sëmundje është edhe mbingopja e egos. Kurimi i kësaj sëmundje është distancimi nga gjërat haram dhe mjaftueshmëria.

Ata që durojnë dhe mbajnë fort frenat e egos mjaftohen edhe me pak ushqim dhe kjo gjë u jep qetësi në shpirt. Kurse ai që është i babëzitur nuk ngopet kurrë dhe nuk ia din vlerën asnjë mirësie. Pastaj fillon të mos marrë shije prej asnjë lloj ushqimi.

Prandaj të pasurit për të siguruar një qetësi shpirtërore duhet të kujdesen për të varfrit, të dobët dhe të vuajturit. Në të kundërt të pasurit do të harrojnë mëshirën dhe bamirësinë, gjë e cila shkakton katranosjen e zemrës.

Gjatë kohës kur në Egjipt kishte pllakosur zia e bukës, Jusufin (a.s.), e pyetën:

“Ti je një udhëheqës që menaxhon thesarin e shtetit. Përse e lë të uritur veten?”

Ai u përgjigj:

“Kam frikë se nuk do ta kuptoja gjendjen e të uriturve, nëse do të isha i ngopur!

I nderuari Shejh Sadi Shirazi, thellësinë dhe delikatesën e zemrës që duhet të zotërojnë një besimtar, e shpjegon me këtë tregim shumë domethënës:

“Një vit, në Sham ndodhi një zi aq e madhe, sa edhe të dashuruarit e harruan dashurinë. Nuk ra qoftë edhe një pikë ujë. Të mbjellat nuk lagën dot as buzët. Çdo burim u tha. Nuk ngeli asnjë pikë ujë përveç lotëve të të varfërve.

Në një gjendje të tillë, një ditë më erdhi një mik. Ai kish mbetur kockë e lëkurë, megjithëse ishte njeri i pasur, i fuqishëm, i famshëm, fisnik dhe trupmadh. Kur e pash në atë gjendje, u shushata. Më pas e pyeta:



«O miku im i mirë! Çfarë ka ndodhur, ç 'fatkeqësi të ka rënë? Më thuaj shkakun e kësaj gjendjeje të dobët, të këputur e të mjerë!..»

Miku im u mërzit nga fjalët e mia dhe i habitur tha:

«Miku im! Nëse nuk e di shkakun e gjendjes sime, atëherë ç'është ky indiferentizëm? Por, nëse e di, pse pyet? A nuk e sheh, fatkeqësia ka arritur kulmin! As nga qielli nuk zbret shi në tokë, e as nga toka nuk ngrihet në qiell rënkimi i atyre që vuajnë!»

I thashë:

«E di! Por pse ka ndikuar kaq shumë kjo fatkeqësi tek ty? Ti ke çdo gjë. Pse shqetësohesh për vuajtjet e të tjerëve?!»

Ndërsa ai mik i mirë, më pa në një mënyrë shumë domethënëse, si shikimi i një dijetari ndaj një të padituri dhe tha:

«A ka hidhërim në zemrën e një njeriu i cili gjendet në breg dhe është duke parë se miqtë e tij po mbyten në det? Fytyra ime, është zverdhur prej mjerimit të popullit. Gjendja e të vetmuarve dhe skamnorëve më ka bërë kështu si jam. Njeriu me ndërgjegje, ashtu sikur nuk dëshiron të shohë plagë në trupin e tij, nuk dëshiron të shohë as tek krijesat e tjera të Allahut. Shyqyr Zotit, unë nuk kam plagë, mirëpo vuajtja e të tjerëve ma bën ndërgjegjen të dridhet. A mund të jetë në qejf njeriu që ulet pranë një të sëmuri, edhe nëse vet është i shëndetshëm?

Sa herë që shoh gjendjen e pashpresë të të varfërve, çdo kafshatë që ha, më ngelet në fyt. Sikur gëlltit ndonjë helm. Si mund të argëtohet njeriu që sheh mjerimin e llojit të vet? Kur qan ndonjëri prej tyre, lagen edhe sytë e mi.»

Ne sot duhet të bëjmë një kritikë të fortë vetes për gjithçka që ndodh në botën islame. Ne duhet të kontrollojmë ndjeshmërinë

e zemrës sonë për padrejtësitë që po ndodhin në Siri, Palestinë, Afrikë dhe Arakan. Sepse kjo është një përgjegjësi ndaj vëllezërve të një besimi dhe një përgjegjësi e madhe në ditën e gjykimit.

Mos të harrojmë se një nga grupet që do të strehohet nën hijen Arshit në ditën e gjykimit do të jenë edhe ata që kanë dashur njëri-tjetrin për hir të Allahut.

Për t'i dhënë të drejtën që i takon vëllazërisë duhet të sakrifikojmë nga pasuria dhe rehatia jonë. Në pamundësi për të bërë diçka konkrete duhet së paku të mos mungojnë lutjet tona për ta.

E lusim Allahun të na bëjë të dobishëm për ymetin islam, për nevojtarët, të vuajturit dhe të varfërit. E lusim Allahun të na bëjë prej atyre që ndajnë hallet dhe problemet me vëllazërit besimtarë.

Amin!..



SHEJH SADIU رحمته الله

-1-

“Djalli ju frikëson me skamje e varfëri dhe ju urdhëron të bëni vepra të pamoralshme...” (Beqara, 268) Ajeti në fjalë shpjegon pikërisht këtë të vërtetë. Prandaj ata që e tejkalojnë frikën për e rënies në varfëri duke bërë bamirësi dhe duke shpenzuar në rrugë të Allahut janë njëkohësisht edhe guximtarë dhe trima. Bujari është shenjë e trimërisë dhe guximit.







SHEJH SADIU - 1

Shejh Sadiu është një poet dhe njeriu i urtë që ka jetuar në shekullin e 13. Megjithëse ka mbi njëzet vepra të shkruara është bërë i njohur me veprën e urtë Bostani dhe Gylistani. Shejh Sadiu pasi kaloi një jetë aktive me dituri, urtësie, ibadet dhe xhihad ndërroi jetë në vendlindjen e tij në Shiraz.

Për të treguar mënyrën e edukimit të tij është shumë domethënëse ky kujtim që ai transmeton vetë:

“Në fëmijëri isha shumë i dhënë pas jetës askete dhe namazit të natës. Një natë, kur po qëndroja me babanë duke lexuar Kuran, përreth kishte njerëz që po flinin. I thashë babait:

- Baba! Të gjithë po flenë, askush nuk ngrihet për të falur namaz nate, por flenë si të vdekur.

Babai u vërejt dhe tha:

- Biri im! Do ishte më mirë të flije edhe ti si ata, në vend që t'i përgojoje. Ata mund jenë të privuar nga mëshira hyjnore në këto momente, por në të njëjtën kohë në librin e tyre nuk shkruhen gjynahe. Kurse në librin tënd tashmë u shkrua një gjynah.”



I rritur dhe i edukuar në një frymë dhe atmosferë të tillë shpirtërore Shejh Shirazi me veprën e vet vazhdon sot e kësaj ditë të ndikojë dhe të jetë në shërbim të edukimit shpirtëror.

Të gjithë së bashku të përpiqemi të përfitojmë dhe shijojmë nga urtësitë dhe perlat e veprës së Sadi Shirazit.

Sadi Shirazi thotë:

Miq të Allahut më së shumti bëjnë tregti në dyqane ku nuk ka shkuar asnjë njeri.

Miq të Allahut janë bërë mbështetja e jetimëve dhe e njerëzve pa njerëz. Atyre nuk i gjente shpirti qetësi pa ngushëlluar, pa ja fshirë lotët, dhe pa ja kthyer buzëqeshjen atyre që kishin plagë në zemër. Ndjenja e tyre e përgjegjësisë arriti deri në atë shkallë sa ata ishin të angazhuar ditë e natë në zgjidhjen e problemeve të njerëzve. Ata i njihnin nevojtarët nga pamja e jashtme dhe vraponin për t'i ndihmuar pa qenë nevoja që ata të kërkonin ndihmë. Ata i vlerësuan në maksimum mundësitë për të fituar shpërblime dhe sevape shpirtërore.

Sadi Shirazi thotë:

E kishin pyetur një të urtë:

Cila është më e mirë bujaria apo trimëria?

I urti kishte dhënë këtë përgjigje:

Ai që është bujarë nuk ka nevojë për trimërinë.

Një nga shqetësimet më të mëdha të njeriut është frika se mbetet i varfër. Por pasuria në fakt është një amanet që i është dhënë njeriut si një pjesë e sprovës së kësaj bote. Allahu kërkon prej nesh që një pjesë të pasurisë ta shpenzojmë në bamirësi.

Kurse indiferenti ndaj kësaj harron që pasuria është një



sprovë dhe amanet në dorë të tij por e pandeh atë si pronë të tij. Në vend që të mbështet tek Sunduesi i gjithësisë dhe Zotëruesi i vërtetë i pasurisë ai mbështet tek pasuria dhe fuqia e saj relative.

Shejtani e frikëson njeriun gjithmonë me varfëri, në këtë mënyrë ai arrin ta pengojë njeriun të bëjë bamirësi. Allahu në Kuran thotë:

Djali ju frikëson me skamje e varfëri dhe ju urdhëron të bëni vepra të pamoralshme. Kurse Allahu ju premton faljen dhe mirësinë e Tij. Allahu është Mirëbërës i madh dhe i Gjithëdijshtëm. (Bekara, 268)

Ajeti në fjalë shpjegon pikërisht këtë të vërtetë. Prandaj ata që e tejkalojnë frikën për e rënies në varfëri duke bërë bamirësi dhe duke shpenzuar në rrugë të Allahut janë njëkohësisht edhe guximtarë dhe trima. Bujari është shenjë e trimërisë dhe guximit.

Hatixhja (r.a.) e shpenzoi gjithë pasurinë e saj në rrugën e Allahun në periudhën më të dobët dhe të brishtë të islamit. Në këtë mënyrë shfaqti madhështinë, trimërinë dhe guximin e saj.

Po ashtu edhe Ebu Bekri e ka shfaqur trimërinë dhe guximin duke e dhuruar gjithë pasurinë në rrugën e Allahut.

Ebu Bekri (r.a.) blatoi gjithë pasurinë e tij, prandaj kur Profeti e pyeti:

- Çfarë ke lënë për fëmijët dhe familjen tënde o Ebu Bekr?

Ebu Bekri u përgjigj me këtë përgjigje që i buronte nga besimi i tij i sinqertë:

- U kam lënë pas Allahun dhe të Dërguarin e Tij! (Tirmidhi, Menakib, 16/3675)

Një herë kur Profeti (a.s.) i tha:

- Feja islame nuk ka përfituar nga askush tjetër aq shumë sa ka përfituar nga pasuria e Ebu Bekrit...

Ebu Bekri i tha i mbytur në lot:

- A nuk të përkasim vetëm ty, unë dhe pasuria ime o i Dërguari i Allahut?!

Me këto fjalë ai rrëfente se ai personalisht me gjithçka që i perkiste atij i ishin kushtuar vetën Allahut dhe të Dërguarit të Tij.

Sahabët sakrifikuan gjithçka pa asnjë hezitim në rrugën e Allahut. Të gjitha mundësitë i ofruan në shërbim të islamit. Fjala e tyre e vetme ishte të qofshin falë baba, nëna dhe jeta jonë o i Dërguari i Allahut. Në këtë mënyrë ata u bënë yje që shkëlqejnë natën në qiell. Allahu qoftë i kënaqur me ta.

Sadi Shirazi thotë:

Jep zeqatin e pasurisë. Vreshtari kur i krasit hardhitë japin më shumë prodhim.

Kur dhuron pasuri në pamje duket sikur pakësohet për në të vërtetë ajo shumohet dhe bëhet më e begatë në këtë botë dhe në botën tjetër.

Hadithit profetik shprehet:

“Lëmosha nuk e pakëson pasurinë, kur një njeri e zgjat dorën për të dhënë sadaka, para se të bjerë në dorën e personit që merr sadakanë, kalon në dorën e Allahut...” (Ali el-Muttaki, VI, 377/16134)

“Çdo mëngjes zbresin dy engjëj. Njëri prej tyre lutet duke thënë: O Zot! Jepi atij që jep në emrin Tënd! Ndërsa tjetri lutet duke thënë: O Zot! Shkatërroja pasurinë atij që është koprrac!” (Buhari, Zekat, 27; Muslim, Zekat, 57.)



“Kush jep për bamirësi qoftë edhe një hurmë e vetme nga fitimi i pastër i pranueshëm nga Allahu, Allahu i Lartë do ta marrë dhe do ta shtojë, për të zotin, gjersa të bëhet sa një mal!” (Buhari, Zekat, 8)

Sadiu thotë:

“Njeriu koprrac mbledh para me vështirësi, i fsheh me përpikëri dhe ndërron jetë duke u mallëngjyer për to.

Njerëzit e mençur kanë thënë:

“Paraja e njeriut të keq;

Del nga toka pasi ai të hyjë në tokë.”

Njeriu kur vdes, në lidhje me pasurinë përballet me dy fatkeqësi të cilat nuk i ka imagjinuar kurrë më parë.

E para, humbet gjithë pasurinë dhe e dyta do të japë llogari për gjithë pasurinë megjithëse nuk e zotëron më.

Është fatkeqësi e madhe të japësh llogari për një pasuri që nuk të jep më asnjë dobi. Profeti (a.s.) në lidhje me këtë thotë:

“Turp, turp për atë njeri që u lë familjarëve të tij pasuri, ndërkohë që vetë do të dalë në audiencën e Zotit (xh.sh.), me të keqen (barrën e llogarisë së pasurisë që ka fituar).” (Sujuti, el-Xhamiu’s-Sagir, nr: 9693.)

Sa urtësi ka në këto fjalë të Ebu Dherrit r.a:

“Një mall ka tre ortakë. I pari është i zoti i mallit, pra, ti. I dyti është kaderi (caktimi). Se çfarë do të të sjellë (ai mall), mirësi apo fatkeqësi, nuk të pyet ty. Ndërsa i treti është trashëgimtari yt. Ai pret me padurim që ti ta vësh kokën në tokë (të vdesësh) dhe, pasi të kesh vdekur, ai merr mallin tënd, kurse ti jep llogari për të. Nëse ke mundësi, mos u bëj më i dobëti i këtyre tre ortakëve!..” (Ebu Nuajm, Hilje, I, 163)

Njerëzit e kamur që falimentojnë kur vdesin, e kujtojnë veten e tyre të pasur në këtë botë fantazish. Por kur zgjohen me vdekjen në mëngjesin e së vërtetës, shohin se nuk zotërojnë asgjë nga ato që kishin në këtë botë. Këta pra janë të varfrit e pafundësisë. Pasuria e vërtetë, është të mos falimentosh me ardhjen e vdekjes. Pra, të arrish pasurinë e përjetshme.

Sadi Shirazi thotë:

Nuk është ndonjë aftësi e madhe të përfitosh pasurinë e botës, aftësi është të fitosh një zemër.

Ky transmetim i Malik Ibn Dinarit e shpreh shumë bukur se ku mund ta gjejë besimtari dashurinë e Allahut:

Musai një ditë i bëri një dua të tillë Zotit:

- O Zot! Ku të kërkoj Ty? Allahu Teala iu përgjigj:

- Mua më kërko te ata që kanë zemrat e thyera. (Ebu Nuajm, Hilje, II 364)

Rrumiu thotë:

Ata që shkojnë në haxh le të kërkojnë të zotin e Qabes. Nëse arrijnë ta gjejnë Zotin e Qabes (nëse zemrën e kthejnë në vendstrehim të manifestimeve hyjnore), tanimë Qaben mund ta gjejnë kudo.”

Mjetet për të arritur tek Allahu janë të shumta, e rëndësishme është që njeriu të jetë në përpjekje të vazhdueshme për të arritur Allahun. Gjendja pranë të varfërve dhe të dobëtëve është një nga mënyrat më të mira për të fituar dashurinë e Allahut.

Molla Xhami e shpreh kështu këtë të vërtetë:

“Gëzo zemra, sepse ky është haxhi më i madh. Një zemër, është më me vlerë sesa mijëra Qabe. Qabeja është një ndërtesë



që e ka bërë Ibrahim, i biri i Azerit. Kurse zemra është vendshikimi i Allahut, i cili është Xhelil dhe Ekber.”

Sadi Shirazi thotë:

“Nëse nuk do të kesh zemër të shqetësuar, atëherë shpëto nga shqetësimet zemrat e shqetësuar!”

Lutjet e singerta të nevojtarëve janë shërim dhe zgjidhje për problemet e atyre që ndihmojnë. Shqetësimi më i madh i besimtarit është ahireti. Sa bukur e shpreh hadithi këtë rrugë të lumturisë dhe paqes:

“Nëse dikush ia lehtëson dikujt një shqetësim të kësaj bote, edhe Allahu ia lehtëson atij një shqetësim ditën e kiametit. Nëse dikush i sjell lehtësi dikujt që ndodhet në vështirësi, edhe Allahu i jep lehtësi atij në këtë botë e në ahiret. Nëse dikush ia mbulon një të metë një yslimani, edhe Allahu ia mbulon atij të metat në këtë botë dhe në ahiret. Për sa kohë që robi besimtar i shkon në ndihmë vëllait të fesë, edhe Allahu e ndihmon atë. Nëse dikush niset për rrugë për të marrë dituri, edhe Allahu ia lehtëson atij rrugën e xhennetit. Nëse një grup njerëzish (xhemaat) mblidhen në një shtëpi, lexojnë Librin e Allahut, diskutojnë mbi të mes tyre dhe përpiqen ta kuptojnë, mbi ta zbret qetësia dhe ata i mbështjell mëshira, i rrethojnë engjëjt dhe Allahu i Lartë i kujton ata mes atyre që ka përreth. Ai nuk e nxjerr në krye personin apo fisin që e lë pas puna e vet!” (Muslim, Dhikr, 38)

Sadiu thotë:

Mos i trego për nevojat tuaja një personi të vrenjtur, të vrazhdë dhe të ngrysur sepse mërzhitesh prej natyrës së tij. Nëse ke një problem tregoja një dashamirësi prej të cilit më së paku

mund të gjesh prehje dhe qetësi prej buzëqeshjes dhe mirëkuptimit të tij.

Nëse kërkon diçka prej njerëzve të ulët ndoshta fiton materialisht por humbet shpirtërisht.

Nëse kërkon diçka prej njerëzve me karakter të dobët për momentin mund të përfitosh por krenaria dhe personaliteti pësojnë rënie. Një person me karakter të dobët do ta përmendë mirësinë që të ka bërë në çdo moment dhe si përfundim do të bëhesh pishman për ndihmën që i kërrove.

Prandaj besimtari për të ruajtur nderin dhe personalitetin e tij nuk duhet t'i shtrijë dorën askujt. Por nëse detyrohet të bëjë një gjë të tillë nga kushtet e vështira atëherë të kërkojë prej një njeriu të mirë dhe të ndershëm.

Kur njeriu ka një nevojë, të cilën i duhet ta ndajë me dikë për ta zgjidhur, atëherë duhet ta ndajë me vepërmirët. Vazhdimisht i duhet bërë dua Allahut të Lartmadhëruar, që të mos na bëjë nevojtarë të njerëzve të këqij.

Kur Pejgamberi, (a.s.), u pyet në lidhje me të kërkuarit e diçkaje prej të tjerëve, ai u shpreh:

- Jo, mos kërko! Por, nëse je i detyruar për ta bërë këtë, kërko prej vepërmirëve!” (Ebu Davud, Zekat, 28)

Sepse njerëzit e mirë kur bëjnë një vepër të mirë përpiqen në maksimum të ruajnë personalitetin dhe nderin e njerëzve që ndihmojnë. Ata ndjejnë një kënaqësi të madhe kur ndihmojnë madje atë e konsiderojnë një mirësi të madhe nga Allahu mundësinë për të ndihmuar njerëzit.

Njeriu ndikohet nga mirësia. Njeriu është i prirur të ndjekë atë që i bën bamirësi. Prandaj besimtari nuk duhet të kërkojë prej njerëzve të shthurur dhe jobesimtarë.



Sadi Shirazi thotë:

Sikur njerëzit të mbështeteshin tek Allahu aq sa janë të lidhur pas sigurimit të jetesës, do të kalonin edhe engjëjt në grada të larta.

Njeriu ka ardhur në këtë botë për sprovë. Dhënia pas pasurisë së kësaj bote dhe vrapimi pas saj pa menduar se ajo është thjesht një arenë sprove dhe për më tepër duke harruar që Allahu është siguruksi i rizikut, nuk është gjë tjetër vetëm se rënie në një neglizhencë të madhe dhe shumë të rrezikshme.

Njeriu sa më shumë të zhytet në detin e harresës aq më shumë dobësohet shpirtërisht, madje ai mund të bjerë më poshtë se kafshët dhe sa më shumë ta pastrojë tisin e harresës aq më shumë lartësohet shpirtërisht.

Është krejt normal të merren masat dhe të plotësohen të gjithë kushte jo vetëm për sigurimin e jetës por për çdo punë por nuk duhet harrur kurrë që siguruksi i rizikut është vetëm Allahu.

Në ajetin kuranor thuhet:

“Sa krijesa ka që nuk e mbajnë dot veten me ushqim! Allahu u jep atyre dhe juve! Ai dëgjon dhe di gjithçka.” (Ankebut, 60)

Profeti (a.s.) thotë:

“Nëse do t’i mbështeteshit Allahut ashtu siç i takon t’i mbështetesh, (Allahu) do t’ju furnizonte siç furnizon zogjtë, të cilët në mëngjes dalin me barkun bosh dhe në mbrëmje kthehen të ngopur.” (Tirmidhi, Zuhd, 33.)

Prandaj dijetarët e kanë konsideruar shpërdorim të madh ngrënien e një ushqimi që të ka dhënë Allahu duke harruar Allahun.

Shejh Sadi thotë:

Kenani që refuzoi Nuhun (a.s.) ishte biri i Pejgamberit. Por kjo gjë nuk i solli asnjë dobi dhe nuk i rriti atij vlerën.

Mos u kap pas prejardhjes dhe sojit, nëse ke ndonjë aftësi tregojë. Trëndafili vjen prej gjembit dhe Ibrahim (a.s.) ka ardhur prej Azerit.

Kam dëgjuar një nomad duke i thënë të birit:

Bir! Në ditën e kijametit do të pyesin se çfarë ke fituar dhe jo çfarë prejardhje ke?

Pra do të pyesin për veprën jo kush është babai yt..

“...veprën që ka lënë personi pas nuk e kalon dot prejardhja”

(Muslim, dhikr, 38; Ibn-i Maxhe, Mukaddime, 17)

Profeti (a.s.) i ka tërhequr vëmendjen Ehli Bejtit dhe veçanërisht vajzës së tij të dashur Fatimes për kujdesin që duhet patur për të mos rënë në kurthin e dunjasë. Ai gjithmonë i ka urdhëruar ata për vepra të mirë dhe të dobishme. Madje edhe në frymën e fundit nuk harroi të këshillonte familjen e tij.

“O Fatime, bija e Muhamedit, të Dërguarit të Allahut! O (halla ime) Safije! Punoni vepra të mira e të pranuara tek Allahu! Sepse unë nuk mund t’ju shpëtoj nga dënimi i Allahut (nëse nuk keni kryer vepra të mira)!” (Ibn-i Sa’d, II, 256; Buhari, Menakib, 13-14; Muslim, Iman, 348-353.)

Ajo që do ta shpëtojë njeriun në ditën e kijametit nuk është prejardhja dhe pozita por veprat e mira dhe devotshmëria. Vetëm ndjekja e mësimave kuranore dhe profetike është rruga e vetme e shpëtimit.

Ebu Lehebi për nga prejardhja ishte shumë afër me Profetin



(a.s.) por ai nga që nuk i besoi Profetit (a.s.) u zhduk në errësirën e injorancës.

Nga ana tjetër kemi Selman Farisiun i cili nuk kishte asnjë lidhje gjaku me Profetin (a.s.) por me devotshmërinë fitoi nderin të konsiderohet prej familjes së Profetit (a.s.)

Profeti (a.s.) ka thënë:

“Selmani është prej nesh, prej ehli bejtit.” (Vakidi, II, 446-447; İbn-i Sa’d, IV, 83; Ahmed, II, 446-447; Hejthemi, VI, 130.)

Pra ajo që është e dobishme në ditën e gjykimit nuk është lidhja e gjakut por lidhja shpirtërore. Është pikërisht lidhja shpirtërore që i jep besimtarit personalitet në fe.

Sadi Shirazi thotë:

“Sado që të lexosh dhe sado që të marrësh dije, prapë se prapë je injorant nëse nuk sillesh siç i ka hije dijes (domethënë nëse nuk bën një jetë me devotshmëri).”

“A bëhet gomari dijetar me disa libra që i ngarkohen sipër? Ai i pa tru nuk e di madje se çfarë ka në kurriz, dru apo libra.”

Edukim i vërtetë nuk do të thotë të akumulosh dije në mendje. E rëndësishme është të shfaqim një personalitet dhe karakter në pjekurinë që kërkon dija. Në të kundërt, një dije që nuk u jep një drejtim të duhur sjelljeve, nuk është gjë tjetër përveçse një hamallëk i thatë dhe një lodhje e padobishme.

Nëse dituria e nxit njeriun për vepra të mirë, bamirësi dhe devotshmëri atëherë ajo dituri është e dobishme.

E vërteta e dijes zbulohet duke e praktikuar atë. Dijetari që nuk i praktikon dijet e tij, është një hamall pa qëllim, si **“gomari i ngarkuar me libra”**. Dija është dije atëherë kur ajo e shpie

njeriun drejt Zotit, drejt së vërtetës, drejt devotshmërisë dhe drejt veprave të mira. Përndryshe edhe shejtani kishte dituri, po ashtu edhe

Karuni ishte i ditur. Mirëpo, dituria ua ka ekzagjeruar egon, duke i çuar ata drejt një mendjemadhësie dhe mburrjeje të tmerrshme.


Nga kjo pikëpamje, nëse dija nuk përvetësohet siç duhet, nuk kthehet në vepra dhe nuk reflektohet në moral, do të thotë se të gjitha përpjekjet kanë shkuar dëm. Profeti a.s, ka kërkuar mbrojtje nga Allahu nga një dituri e tillë:

“Allahu im! Strehohem tek Ti, prej dijes së padobishme, zemrës së hallakatur, egos së pangopur dhe lutjes që nuk pranohet.” (Muslim, Dhikr, 73; Nesai, Istiadhe, 13, 65.)

Mundësia e vetme për të shpëtuar nga mbytja në vorbullën e gjynahut, është njohja e hallallit dhe haramit dhe zbatimi i tyre. Ja pra, vetëm një dituri e tillë na shpie në lumturinë e të dy botëve.

Lusim Allahun të na mundësojë të marrim dhe nxjerrim mësim nga urtësitë e të parëve tanë dhe të pasqyrojmë këto urtësi në sjelljet tona.

Amin!..



SHEJH SADIU رحمته الله

-2-

*Ekzistojnë dy faktorë të rëndësishëm që
ndikojnë në shpirtin e njeriut:*

- 1) Niveli i hallallit të kafshatës që kalon
fytin e tij.*
- 2) Gjendja shpirtërore e atyre me të cilët ai
shoqërohet.*



SHEJH SADIU - 2

Shejh Sadiu thotë:

E shikon popullin që përmallohet për mbulesën e Qabesë dhe e puth atë. Ajo mbulesë prej mëndafshi, nuk ka fituar vlerë për shkak se është bërë nga boça e krimbit të mëndafshit.

Por për një kohë, ajo qëndroi me diçka të shenjtë, dome-thënë, u gjend në murin e Qabesë dhe për shkak të kësaj, u bë e nderuar.

Afrimiteti me një qenie të dashur tek Allahu ndikon jo vetëm mbi qenien e gjallë por edhe mbi sendet. Kjo gjë është shumë më evidente tek njeriu i cili është krijesa më e lartë dhe e vyer në tokë.

Allahu thotë në Kuran: **O besimtarë! Frikësojuni Allahut dhe bëhuni me ata që janë të singërtë** (në fjalë dhe në vepra)!

(Teube, 119)

Njerëzit nga ana fizike pothuajse janë të gjithë njësoj. Bota e brendshme e tyre fiton formë sipas kushteve sociale dhe psiko-



logjike. Një person që qëndron me njerëz të mirë dhe të sinqertë fiton nga gjendja e tyre e cila pasqyrohet më vonë në personalitetin e vetë atij.

E kundërta ndodh nëse qëndron me njerëz të shthurur, në mënyrë të paevitueshme gjendja e tij negative do të ndikojë dhe do të pasqyrohet në personalitetin e personit që shoqërohet me të.

Midis krijesave dhe zemrave ndodh një shkëmbim energjie dhe gjendje e ndërsjellët prandaj duhet të bëjmë shumë kujdes me kë dhe ku qëndrojmë. Sepse kjo na ndihmon të fitojmë atmosferë shpirtërore ose të humbim.

Shejh Sadiu thotë:

“Një qen fitoi besueshmëri vetëm pse ruajti të devotshmit dhe meritoi të përmendej edhe në Kuran, ndërsa gratë e profetëve Nuh (a.s.) dhe Lut (a.s.) ranë në mohim dhe u bënë banore të Xhehenemit, sepse qëndronin me jobesimtarët dhe i përkrahnin ata (pra nuk u bëri dobi fakti se ishin gra të profetëve).”

Nuk duhet të harrojmë që dy faktorët që ndikojmë më shumë në shpirtin e njeriut janë:

- 1) Niveli i hallallit të kafshatës që kalon fytyrën e tij.
- 2) Gjendja shpirtërore e atyre me të cilët ai shoqërohet.

Njerëzit e devotshëm, pa mbetur të detyruar, nuk kanë preferuar të qëndrojnë as në hijen e vendeve ku janë zhvilluar harame. Sepse edhe aty ka rrezik të ndotjes së pastërtisë së zemrës. Kujdesi dhe qëndrimi larg këtyre vendeve është shenjë e devotshmërisë. Sepse hapi i parë për t'u mbrojtur nga mëkatet është qëndrimi larg tyre.

Gjatë kryerjes së haxhit, Profeti (a.s.), luginën e quajtur Batn-i



Muhassir mes Minasë dhe Muzdefiles, e kaloi me shpejtësi. Shokët e pyetën të habitur:

“O i Dërguari i Allahut, ç’ndodhi që u nxitove?”

Dhe Profeti iu përgjigj:

“Në këtë vend Zoti pati dërguar shpendët Ebabel dhe e pati ndëshkuar gjer në asgjësim ushtrinë e elefantëve të Ebrehesë. Shpejtova që të mos më bjerë pjesë nga ai mallkim!..” (Nevevi, Sherhu Muslim, XVIII, 111; Ibni Kajjim, II, 255-256)

Kështu, në haxh, në këtë zonë nuk bëhet vakfe.

Shfaqjet e mëshirës e të mallkimit disa herë reflektohen edhe në sendet jo të gjalla. Prandaj duhet përfutur prej ambienteve ku reflektohet mëshira, siç janë Qabeja, xhamitë, ku vendet e njerëzve të mirë, etj. Ndërkaq, u duhet shmangur vendeve të mëkatit ku është shfaqur mallkimi dhe ndëshkimi i Zotit.

Po ashtu Profeti (a.s.) në kthimin nga Tebuku tregoi një kujdes të madh për të kaluar shpejt nga vendi ku ishin dënuar populli i Themudit.

Edhe mbi jogjallesat vepron ligji i ndikueshmërisë reciproke. Kështu, trugu i hurmës mbi të cilin Profeti (s.a.s.) kishte mbajtur hutbe, ishte ndikuar dhe, pastaj, kur Profeti (s.a.s.) e kishte mbajtur hutben mbi një vend tjetër, kishte nisur të qajë. Hadithet që e përcjellin këtë ngjarje, vijnë si mutevatir, të përcjella gojë më gojë me miratim të përgjithshëm.

Pra gjendja pozitive ose negative ndikon edhe mbi sendet. Prandaj duhet të përfitojmë prej vendeve të shenjta si Qabja, xhamive dhe njerëzve të singertë dhe të qëndrojmë sa më larg njerëzve të shturur.

Shejh Sadiu thotë:

Fito zemrën e të varfërve, nevojtarëve dhe të vuajturve në ditë të mira. Sepse mirësia ndaj tyre është mburojë për fatkeqësitë e jetës. Nëse një nevojtar të kërkon diçka jepja mos hezito. Nëse nuk jep, një ditë do të dalë një tiran dhe do ta marrë prej teje me dhunë.

Në islam sundimi i përket vetëm Allahut. Çdo gjë që zotëron njeriu është një amanet i dhënë nga ana e Allahut. Por jobesimtarët dhe mëkatarët e harrojnë këtë të vërtetë duke pandehur pasurinë e tyre si pronë ekskluzive të tyre. Në këtë mënyrë ata bien preh e sprovës së pasurisë.

Allahu në Kuran thotë:

Për sa i përket njeriut, kur Zoti i tij e sprovon atë, duke e ngritur lart dhe duke i dhënë mirësi, ai thotë: “Zoti im më ka nderuar.” Por, kur e sprovon atë, duke ia ngushtuar mjetet e jetesës, ai thotë: “Zoti im më ka poshtëruar”. (Fexhr, 15-16)

Prandaj një besimtari kur është i pasur dhe zotëron mirësi materiale nuk i ka hije të mburret por të bëjë bamirësi dhe të falenderojë Allahun për mundësinë që i ka dhënë për të bërë bamirësi.

Besimtari kur të sprovohet me varfëri duhet të bëjë durim dhe jo të protestojë. Besimtari në çdo gjendje që ndodhet duhet t'i drejtohet Allahut me përulje dhe lutje.

Allahu në Kuran thotë:

Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai kënaqur me ty! (Fexhr, 28)

Sidomos në ditët tona ku çmenduria e shpenzimit ka arritur kulmin, besimtarët nuk duhet të harrojnë mirësitë dhe mundësitë që i ka dhënë Allahu. Nuk duhet të harrojmë kurrë që në pasurinë



dhe mirësitë që zotërojmë Allahu një pjesë e ka caktuar për të varfrit dhe nevojtarët. Nëse nuk e shpenzojmë për hir të Allahut, mbesim krejtësisht të pambrojtur kundër fatkeqësive. Prandaj bamirësia dhe shpenzimi në rrugën e Allahu është puna më e mençur që mund të bëhet.

Allahu thotë në Kuran:

Prandaj jepni prej atyre mirësive që ju kam dhënë Unë, para se t'i vijë vdekja ndonjërit, e ai të thotë: "O Zoti im, sikur të më kishe lënë edhe një kohë të shkurtër në jetë, do të kisha dhënë lëmoshë dhe do të bëhesha ndër të mirët!". Por Allahu nuk ia shtyn afatin asnjë shpirti, që i vjen koha (e vdekjes); Allahu e di mirë gjithçka që bëni ju. (Munafikun, 10-11)

Shejh Sadiu thotë:

E bukur është ajo që dashuron zemra.

Nëse një njeri nuk ushqen dashuri për dikënd duket e shëmtuar në syrin e tij edhe si kur të jetë i bukur si Jusufi (a.s.).

Ebu Bekri (r.a.) ushqente një mall dhe dashuri për Profetin (a.s.) aq të madhe sa që mallëngjehej për Të edhe kur e kishte pranë. Ebu Bekri nuk ngopej duke e parë Profetin (a.s.). Krejt e kundërta ndodhte me Ebu Xhehlin, zemra e të cilit është katrolosur dhe mbushur me armiqësi dhe urrejtje.

Pra ajo që shikon në të vërtetë është zemra. Dhe çdo gjë fiton bukuri dhe kuptim sipas syrit të zemrës.

Kur mbreti i asaj periudhe e pa Lejlën me të cilën ishte dashuruar Mexhnuni u habit. Dhe habinë e tij e shprehu kështu:

A ti je Lejla që ke marrë zemrën dhe mendjen e Mexhnunit? Ti nuk ke asnjë ndryshim nga gratë e tjera.

Lejla i thotë:

“Për të parë bukurinë time duhet të më shikosh me syrin e zemrës së Mexhnunit...”

Pra vetëm ata që mund ta shikojnë Lejlën nga syri i zemrës së Mexhnunit mund të shikojnë bukuritë e saj. Për të shikuar dashurinë e vërtetë duhet që madhështia hyjnore në univers të vëzhgohet përmes syrit të zemrës dhe besimit. Ata që janë të privuar nga dashuria e vërtetë, të bukurën e perceptojnë si të shëmtuar dhe lumturinë e vërtetë si mjerim.

Shejh Sadiu thotë:

Zhytësi nëse do të frikësohej nga krokodili në lumë dhe peshkaqeni në det nuk do ta arrinte kurrë perlën.

Vlera e një suksesi është në raport të drejtë me vështirësinë e kapërcyer për ta arritur atë. Besimtari për të fituar dashurinë e Allahut dhe Xhenetin duhet të kapërcejë pengesat e egos dhe shejtanit. Ai duhet të zhvillojë një luftë të ashpër kundër këtyre dy armiqve të përbetuar. Besimtari nuk duhet të hezitojë kur bëhet fjalë për zgjedhje midis asaj që kërkon Allahu dhe asaj që dëshiron egoja. Kërkesat dhe detyrat ndaj Allahut duhet të jenë gjithmonë në plan të parë. Çdo mirësi ka një kosto dhe imani si mirësia më e madhe ka një kosto që duhet paguar.

Kriteri i matjes së dashurisë është sakrifica. Sinqeriteti i dashurisë matet me rrezikun që merr dhe sakrificën që bën për të. Një besimtar që mbi të gjithë do Allahun duhet të jetë i gatshëm të sakrifikojë çdo gjë në rrugën e Tij.

Jeta e Profetit (a.s.) dhe sahabëve të tij është e mbushur plot me shembuj sakrifice.

Shejh Sadi duke e kategorizuar zemrën në tre kategori thotë:



1. Nëse dy njerëz të përkorë kanë midis tyre një lidhje të hollë sa një fije floku e ruajnë atë nga shkëputja.

2. Nëse nga dy njerëz njëri është i ashpër kurse tjetri i urtë ndodh po e njëjta gjë.

3. Nëse janë të dy injorantë edhe sikur midis tyre të ketë një zinxhir përsëri e këpusin dhe nuk e ruajnë lidhjen ndërmjet tyre.

Në një sofër hanë bukë dhjetë vetë kurse dy qenë hahen me njërit-tjetrit për një copë kërmë.

Një nga cilësitë e besimtarit të mirë është edhe komunikimi dhe mirësjellje me të tjerët. Profeti (a.s.) thotë:

“Besimtari shkon mirë me të tjerët dhe të tjerët shkojnë mirë me të. Nuk ka mirësi në atë që nuk shkon mirë me të tjerët dhe të tjerët nuk shkojnë mirë me të.” (Ahmed, II, 400, V, 335.)

Zoti kërkon nga besimtarët të jenë si dy duar që lajnë njëra-tjetrën. Pra të ndihmojnë dhe plotësojnë njëri-tjetrit, të ndajnë gëzimin dhe shqetësimet më njëri-tjetrit dhe të mbulojnë mangësitë dhe gabimet e njëri-tjetrit. Besimtarët duhet të këshillojnë njëri-tjetrit për mirësi dhe vepra të mira dhe ndihmojnë njëri-tjetrit për t’u distancuar nga punët e këqija. Besimtarët duhet të ruajnë vëllazërinë midis njëri-tjetrit. Në lidhje me këtë, ajeti kuranor është shumë i qartë.

“Frikësojuni Allahut, rregulloni marrëdhëniet midis jush dhe binduni Allahut dhe të Dërguarit të Tij, nëse jeni besimtarë të vërtetë”. (Enfal, 1)

Allahu i ka krijuar njerëzit me karaktere dhe personalitete të ndryshme. Prandaj në një grup njerëzish mendimi dhe pikëpamjet e ndryshme janë më se normale. E rëndësishme është që kjo mos të shkaktojë cenim të marrëdhënies vëllazërore midis besimtarëve.

Rritja e numrit të divorceve, zënkat, grindjet, përplasjet dhe debatet janë si pasojë e mungesës së cilësive si sakrifica, altruizmi dhe mungesa e njerëzve të zemrës. Kur mungon edukimi shpirtëror njerëzit bëhen egoistë dhe pragmatistë. Kjo gjë e rrënon lidhjen vëllazërore.

Shejh Sadiu thotë:

Deti i paanë nuk ndotet nga një gurë i pistë. Besimtari që lëndohet shpejt është akoma një besimtarë i papjekur shpirtërisht siç duhet.

Kurse një besimtarë i përkorë nuk lëndohet dhe zemërohet prej ofendimeve të injorantëve.

Një gurë mund ta thyjë një qyp me flori por as gurit nuk i rritet vlera dhe as floririt nuk i bie vlera.

Thashethemet për njerëzit e zemrës nuk u ulin vlerën atyre. Një pellg të vogël me ujë e ndot edhe një pisllek i vogël kurse një det nuk ndotet prej një sendi të ndotur madje ai e pastron edhe atë send nga pislleku. Fjalët e rënda të injorantëve nuk e lëkundin qetësinë e botës shpirtërore të njerëzve të dashur të Allahut.

Sa shembull i bukur është kjo ndodhi në lidhje me atë që përmendëm më lart:

Një ditë, Sulltan Ahmed Han i kishte dërguar një dhuratë të vlefshme edukatorit që e donte shumë, Hazretit Hydaji, por Hazreti Hydaji nuk e pranoi dhuratën. Në lidhje me këtë, për shkak se ndjente përgjegjësi për dhuratën, Sulltan Ahmed Hani ia dërgoi njërit prej shejhëve të asaj kohe, Hazretit Abdulmexhid Sivasi. Hazreti Abdulmexhid e pranoi dhuratën dhe gjatë një vizite Sulltani i tha:

“O Hazret i nderuar! Këtë dhuratë më parë ia pata dërguar Hazretit Hydaji. Ai nuk e pranoi, por ju e pranuat!”



Sivasi, i cili e kuptoi urtësinë në fjalë, dha këtë përgjigje kuptimplotë:

“O Sulltani im! Hazreti Hydaji është një njeri i përsosur dhe nuk ulet për gjëra të fulliqura!”

Sulltani u kënaq nga kjo përgjigje dhe pasi kaluan disa ditë, shkoi te Hazreti Hydaji. Edhe atij i tha:

“O i nderuar! Dhuratën që nuk e pranuat ju e pranoi Abdurmexhid Efendi.”

Edhe Hazreti Hydaji me një fytyrë të qeshur, tha:

“O Sulltani im! Abdurmexhid Efendi është si një det. Rënia e një pike të papastër në një det të madh, nuk e dëmton pastërtinë e tij!”

Sa edukatë e bukur Islame dhe sa shembull i një modestie të veçantë...

Profeti (a.s.) gjatë jetës është përballuar me shumë sulme nga ana e injorantëve. Por Ai asnjëherë nuk u zemërua me ta por ndjente keqardhje për gjendjen e tyre të mjerueshme.

Profeti (a.s.) u përball në jetë me sjelljet e trasha të sa e sa njerëzve injorantë dhe të paedukatë, por zemra e tij që ishte një det i paanë mëshire dhe dashurie, në vend që të fyhej prej tyre, mërzitej për sjelljen e ulët që ata njerëz nuk meritonin ta kishin. Profeti (a.s.) nuk u kushtoi rëndësi atyre çasteve të vështira që kalonte, pasi e dinte tashmë se Zoti ishte i kënaqur me të. Për profetin nuk kishin rëndësi lëvdatat dhe fjalët e mira apo përqeshjet dhe fyerjet e njerëzve kalimtarë në këtë jetë, por për të kishte rëndësi pëlqimi i Zotit. Për këtë arsye, në vend që të mallkonte banorët e Taifit që e gjuajtën me gurë dhe e bënë gjak, ai iu lut Zotit që t'i udhëzonte ata dhe t'i shpëtonte nga gjynahet.

Edhe besimtarët e drejtë dhe të mirë kanë përballuar sjelljet e këqija të injoranteve, madje i kanë falur për veprimet e këqija dhe janë lutur për ta.

Allahu i radhit kështu disa cilësi të besimtarëve të mirë:

“...të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në mirëqenie, edhe kur janë në vështirësi, e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. Allahu i do bamirësit.” (Ali Imran, 134)

“Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë dhe, kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen: “Paqe qoftë!” (Furkan, 63)

Ata që nuk tregojnë tolerancë por bien menjëherë preh e hakmarrjes janë njerëz që nuk e kanë arritur pjekurinë shpirtërore. Kur do të “mos lëndosh”, e bën gjuhën të hesht, mirëpo zemra vazhdon të ankohet në heshtje. Por, kur do të “mos lëndohesh”, bashkë me gjuhën, duhet të heshtësh edhe zemrën. Dhe, të arrish të heshtësh zemrën, është aftësi vetëm e besimtarëve të përsosur. Për rrjedhojë, nëse mos lëndimi i të tjerëve është fillimi i rrugës, mos lëndimi nga të tjerët, është fundi i saj. Mes këtyre të dyjave është një distancë e madhe që duhet kapërcyer.

Shkurtimisht, të bësh një jetë në paqe me adhurime dhe shërbime, duke shijuar kënaqësinë e madhe të besimit, pa lënduar askënd dhe pa u lënduar prej askujt, është një prej cilësive më të larta të moralit Islam.

Shejh Sadiu thotë:

Në Xhenet nuk hyhet me hile. Sepse atë ditë perdja në fytyrë do të hapet.

Fajtorët në këtë botë mund të arrijnë të fshehin fajet dhe hilet që kanë bërë gjatë jetës, por në ditën e gjykimit nuk do të



kenë asnjë mundësi të tillë përballë gjykimit suprem. Atë ditë të gjithë sekretet dhe të fshehtat do të dalin në shesh, askush nuk mund të fshehë gjë sepse kundër atyre atë ditë do të dëshmojnë edhe gjymtyrët e tyre.

Ajeti kuranor thotë:

“Ditën, kur do të zbulohen të fshehtat, kur njeriu nuk do të ketë as fuqi, as ndihmës.” (Tarik, 9-10)

Kur të vijnë afër zjarrit, kundër tyre do të dëshmojnë veshët, sytë dhe lëkurët e tyre për atë që kanë bërë. Ata do t’u thonë lëkurëve të veta: “Pse dëshmuat kundër nesh?” e ato do të përgjigjen: “Allahu, i Cili ia jep aftësinë e të folurit gjithçkaje, na ka bërë që të flasim. Ai ju ka krijuar për herë të parë dhe tek Ai do të ktheheni”. (Fussilet, 20-21)

Çdo njeriu ia kemi varur në qafë llogarinë për punën e tij dhe Ne, do t’ia paraqesim Ditën e Kiametit librin, që do ta gjejë të hapur (e do t’i themi): “Lexoje librin tënd! Ti mjafton sot si llogaritar kundër vetvetes!” (Isra, 13-14)

Dhe Libri (i veprave të tyre) do t’u vihet përpara, e do t’i shohësh gjynahqarët se si do të tmerrohen nga ato që gjenden në të dhe do të thonë: “Të mjerët ne! Çfarë është ky libër që nuk paska lënë asnjë vepër të madhe apo të vogël pa e shënuar atë”. Aty do të gjejnë të shënuar gjithçka që kanë punuar. Zoti yt nuk i bën padrejtësi askujt. (Kehf, 49)

Në botën tjetër të gjitha veprat tonë pa asnjë përjashtim, të gjitha mirësitë që kemi përjetuar në këtë botë, heshtja kur është dashur të flitej dhe të folurit kur është dashur të heshtej, të gjitha ibadetet sa të sinqerta dhe sa të jo të sinqertë, të gjitha do të shfaqen atë ditë. Atë ditë e gjithë bota jonë e brendshme do të shfaqet me gjithë qartësinë e saj.

Omeri (r.a.) thotë:

Gjykoni veten para se të gjykoheni. (Ibn Kethir, I, 27)

Edhe ne, para se të vijë ajo ditë e madhe duhet të kontrollojmë sinqeritetin dhe veprat tona. Duhet të kontrollojmë veprat e mirë në fletoren tonë të veprave. Sepse atë ditë nuk ka më mundësi për të kërkuar falje dhe bërë vepra të mira.

Shkurtimisht dita për të vepruar është kjo ditë, koha për të bërë vepra të mira është kjo kohë.

E lusim Allahut të na falë gabimet dhe të na bëjë prej atyre që e marrin fletoren në krahun e djathtë. E lusim Allahun të na lehtësojë rrugën për vepra të mira dhe të sinqerta.

Amin...



SHEJH SADIU رحمته الله

-3-

*Janë pikërisht dëshirat e njerëzve në këtë
botë ato që shndërrohen në gaca zjarri në
Ditën e Kiametit. Çdo gjë që dërgojmë në
botën tjetër është e jona, kurse çdo gjë që
lëmë këtu është e trashëgimtarëve.*



SHEJH SADIU - 3

Shejh Sadiu thotë:

Armiku pasi nuk arrin të mposhtë duke provuar të gjithë mënyrat dhe hilet fillon të afrohet përmes miqësisë. Pastaj nën emrin e miqësisë realizon gjëra të tilla që as një armik nuk i kishte arritur dot.

Njeriu ka dy armiq të mëdhenj të përbetuar. Njëri është Iblisi kurse tjetri është egoja. Allahu në Kuran thotë:

“Le të mos ju shmangë kurrsesi djalli! Ai është vërtet armiku juaj i hapët.” (Zuhruf, 62)

“Unë nuk e shfajësoj veten, sepse shpirti (i njeriut) është fort i prirur për të keqe, përveç atij që e mëshiron Zoti im. Me të vërtetë, Zoti im është Falës dhe Mëshirë-plotë”. (Jusuf, 53)

Egoja kur nuk arrin ta mashtrojë besimtarin për ta zhytur në mëkate duke e devijuar nga rruga e drejtë, ndryshon taktikë duke iu qasur përmes rrugës së drejtë. Në lidhje me këtë ajet kuranor shprehet kështu:



“Ai tha: “Për shkak se Ti më flake tej, unë do t’u zë pritë njerëzve në rrugën Tënde të drejtë.” (Araf, 16)

Për shembull kur nuk mundet ta pengojë një njeri për të bërë një xhami e nxit atë që xhamisë t’i vendosë emrin e vet. Në këtë mënyrë ndot sinqeritetin me syfaqësi, mburrje dhe famë.

E njëjta gjë ndodh edhe për namazin. Nëse nuk arrin ta pengojë nga falja e namazit, i thotë: Sa bukur e fal namazin ti! Nëse nuk do të pranohet namazi yt cili namaz do të pranohet? Shikojë të tjerët në çfarë gjendje janë... me vesvese të tilla përpjet të injektoj tek ai mendjemadhësi dhe mburrje.

Ose gjatë namazit e shpërqendron besimtarin përmes problemeve të kësaj bote duke e lënë të zhveshur namazin nga atmosfera shpirtërore, duke e shndërruar atë thjesht në formë. Ose e nxit të mendojë se namazi i tij nuk është pranuar duke e zhytur në këtë mënyrë në pesimizëm. Besimtari fillon të mendojë se është më mirë të mos falet fare sa të falë një namaz që nuk pranohet, një namaz të pavlefshëm. Në këtë mënyrë shejtani arrin ta largojë hap pas hapi nga ibadetet.

Hile të tilla egoja dhe shejtani kanë plot. Besimtari duhet të mbrohet nga këto kurthe duke kërkuar vazhdimisht ndihmën e Allahut. Nuk duhet të harrojmë që marrja e masave kundër një armiku të jashtëm janë shumë të lehta. E rëndësishme dhe jetike është të jesh vigjilent ndaj armikut të brendshëm.

Shejh Sadiu thotë:

Babai më la këto këshilla kur po jepte shpirtë:

Bir! Epshi është një zjarr, prandaj ruaju prej tij. Mos i fryj zjarrit të xhehenemit. Nëse nuk ke fuqi për ta përballuar zjarrin e xhehenemit atëherë hidhi ujë atij zjarri me durim.



Epshi shpreh të gjitha dëshirat dhe ambiciet e shfrenuara të njeriut. Pasuria, pozita, fama, emri, dhënia pas kënaqësive etj, të gjitha këto që numëruam janë të natyrës së epshit. Të gjitha këto janë dëshira që e largojnë njeriun nga qëllimi dhe rruga e drejtë. Dobësia dhe mungesa e durimit përballë këtyre dëshirave të zjarra nuk është gjë tjetër përveç se shndërrimi i botës tjetër në një vend dënimi dhe vuajtje.

Behlul Dana ishte një nga njerëzit më të urtë të kohës, i cili me urtësinë e tij këshillonte njerëzit. Herë pas here këshillonte edhe kalifen. Por edhe Harun Rashidi e respektonte.

U bë një kohë mjaft e gjatë që Behlul Dana nuk kishte shkuar te Haruni Rashidi. Harun Rashidi kur e takoi, e pyeti:

Behlul, ku ke qenë, u bën shumë kohë që nuk të shikoj?

- Vizitova Xhehenemin.

- Si hyre atje, a nuk te dogji zjarri?

Behlul Dana i dha këtë përgjigje mbresëlënëse:

- Jo nuk më dogji, aty nuk pashë fare zjarr, sepse të gjithë e sillnin zjarrin e vet nga kjo botë!..

Janë pikërisht dëshirat e njerëzve në këtë botë ato që shndërrohen në gaca zjarri në Ditën e Kiametit. Çdo gjë që dërgojmë në botën tjetër është e jona, kurse çdo gjë që lëmë këtu është e trashëgimtarëve.

Shejh Sadi thotë:

Tek çdo njeri shikon një formë dhe veshje. Humanizmi nuk qëndron tek ajo veshje dhe ajo formë por tek altruizmi dhe bujaria. Forma nuk është e mjaftueshme, thelbësore është bota shpirtërore.

Njeriu duhet të jetë modest, i virtytshëm, i urtë, i ditur, i mëshirshëm, bujarë dhe inteligjent. Nëse nuk gjinden këto cilësi atëherë duhet të quajmë njerëz edhe pikturat e njerëzve në mure.

Ajo që e bën njeriun njeri nuk është pamja e jashtme por personaliteti i pajisur me cilësi të virtytshme. Njeriu ka dalë mbi engjëjt jo përmes pamjes por përmes diturisë, njeriu në mungesë të virtyteve mund të bjerë edhe më poshtë se kafshët.

Hadithi shprehet kështu:

“Allahu i Madhëruar nuk shikon pamjen dhe pasurinë tuaj, por zemrat (sinqeritetin dhe devotshmërinë) dhe veprat tuaja.” (Muslim, Birr, 34)

Kurani e shpreh kështu vlerësimin sipas zemrës dhe jo sipas pamjes dhe formës:

“O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëritjetrin. Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshtëm dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë.” (Huxhurat, 13)

Devotshmëria është e lidhur me zemrën dhe jo me trupin. Prandaj nuk i duhet dhënë rëndësi e madhe pamjes, pasurisë, pozitës dhe famës sepse nuk është gjë tjetër veç se tërbim i egos. Njeriu fiton vlerë tek Allahu përmes botës shpirtërore, moralit, edukatës dhe mirësjelljes.

Junus Emre duke kritikuar atë që kapen vetëm pas pamjes pa u thelluar në thelbin e gjërave thotë:

Dervishin nuk e bën çallma dhe xhybja,

Kush bëhet dervish në zemër, s’ka nevojë për xhyben!



Shejh Sadiu thotë:

Sikur reja të lëshojë pika eliksiri përsëri nuk mund të hash gjë prej pemës së shëlgut sepse shëlgu nuk ka fruta. Mos qëndro me atë që e kanë syrin e zemrës të verbër sepse nuk mund të hash sheqer prej kallirit të kashtës.

Është e pamundur të përfitojë prej urtësisë një person që e ka syrin e zemrës të verbër. Ashtu si një person që ka mbyllur sytë nuk mund të shikojë asgjë edhe një person i cili është i kushtëzuar dhe fanatik nuk përfiton dot prej urtësive. Zemra e tij është shndërruar në një burg të errët, ai ka humbur të gjitha aftësitë e perceptimit shpirtëror.

Të fituar janë vetëm ata që nën dritën e të vërtetave hyjnore ndjekin rrugën e drejtë. Nëse prej qiellit do të binin pika eliksiri një personi të privuar nga bota shpirtërore nuk i bën asnjë dobi. Ashtu si një shkëmb nuk përfiton asgjë nga rënia e shiut.

Sejh Sadi ambicien e njeriut për përfitime materiale e shpreh kështu:

“Nëse zogu nuk do të ishte dhënë pas stomakut nuk do të binte në kurth”

Një nga fatkeqësitë më të madhe të njeriut është ambicia e shfrenuar.

Rrumiu shprehet kështu këtë:

“Sa shumë peshq ka në det, që, në vend që të jetojnë krejt rehat dhe të qetë, bien në grep prej ambicies për t’u ushqyer.”

Njeriu në këtë botë është përballë shumë karremave dhe kurtheve. Preh e këtyre karremave dhe kurtheve bien ata që janë të dhënë pas dëshirave dhe ambicies të shfrenuara. Ata janë si peshku që për një kënaqësi të çastit shkatërron veten. Të njëjtën

gjë mund të themi edhe për atë që bëhet rob nefsit të tij, duke harruar Krijuesin. Të mashtrohesh nga stolitë e pavërteta të kësaj dynjaje e, të shkatërrosh gradat dhe vlerat që ke tek Krijuesi yt, është si të shesësh një vazo ari me gurë të çmuar, në vleftën e një cope teneqeje.

Prandaj njeriu nuk duhet të përfshihet nga lakmia e kësaj botë duke harruar në këtë mënyrë botën tjetër. Nga që shpërblimi i veprave të mira në përgjithësi ndodh në botën tjetër, egoja dhe shejtani e mashtrojnë njeriun duke e zhytër në indiferencë totale ndaj veprave të mira.

Shejh Sadiu thotë:

Shija e rushit që sa po ka filluar të piqet është e athët, por sikur të durohet disa ditë rrushi do të ëmbëlsohet.

Durimi në fillim duket si një helm por kur bëhet pjesë e karakterit është më i ëmbël se mjalti.

Durimi është një aftësi e madhe dhe shumë e vyer. Nga aspekti i materiales durimi është i vështirë kurse në aspektin e botës tjetër durimi është i mbushur plot me shpërblime hyjnore. Allahu robërit e Tij që i do i kalon nëpër sitën e durimit. Të parët që kalojnë nëpër këtë sitë janë pejgamberët. Profeti (a.s.) thotë:

“...Në rrugën e Allahut jam sprovuar më shumë se askush tjetër me vuajtje e mundime.” (Tirmidhi, Kijamet, 34/2472)

Profeti (a.s.) ndërsa falte namaz në Qabe i hodhën në shpinë një plënc deveje, në Taif e gjuajtën me gurë, nga shtatë fëmijë gjashtë i vdiqën sa ishte gjallë, gjatë gjithë jetës u përballë me vështirësi dhe sprova të mëdha por gjithmonë tregoi durim duke u bërë një shembull ideal për ymetin.



Ai asnjëherë nuk u thye dhe nuk u mërzit nga vuajtjet dhe mundimet që hasi gjatë rrugës për të fituar pëlqimin e Allahut të Lartmadhëruar. Zemra e tij e ndjeshme dhe delikate vetëm këtë kërkonte. Nëse Ai shprehte pëlqimin ndaj tij, për të vuajtjet dhe mundimet që i sillnin gjërat e fundme kishin krejt pak rëndësi. asnjë vështirësi nuk ia ndali përpjekjet e nuk ia prishi ekuilibrin. Të gjitha këto, ai i priti me pjekuri dhe me një gjendje pëlqimi. Edhe pse zemra e tij përjetoi shumë hidhërime, buzëqeshja nuk i mungoi kurrë fytyrës së tij të trëndafiltë.

Shejh Sadit thotë:

Allahu nuk kënaqet me atë që nuk është i kënaqur me caktimin e tij.

Nëse duam të fitojmë dashurinë e Allahut sëpari duhet të jemi të kënaqur me caktimin e Tij për ne. Ne duhet të gjejmë qetësi dhe lumturi në afrimitetin me Allahut.

Sa bukur shprehet Ataullah Iskenderi:

“O Allah! Çfarë humbi ai që të gjeti Ty? Çfarë gjeti ai që të humbi Ty?”

- Adhurim i vërtetë është të jesh i kënaqur me caktimin e Allahut

- Adhurim i vërtetë është aftësia të qëndrosh mik i Allahu në çdo vend dhe në çdo kohë.

- Adhurim është aftësia të ruash ekuilibrin përballë ndryshimeve të kushteve dhe surprizave të jetës.

Ejubi i cili tregoi një durim madhështor ndaj sprovave fitoi konsideratën hyjnore: “ Sa njeri i mirë!”

Në ajet thuhet:

“Lufta është bërë detyrim për ju, ndonëse e urreni. Por mund ta urreni një gjë, ndërkohë që ajo është e mirë për ju e mund ta doni një gjë, ndërkohë që ajo është e dëmshme për ju. Allahu di, kurse ju nuk dini.” (Bekare, 216)

Të fshehtën e di vetëm Allahu. Ne nga që shikojmë vetëm anën sipërfaqësore të gjërave, shumë prej tyre na duken fatkeqësi, ajo që duhet të bëjë besimtari është të jetë i kënaqur me çfarë do lloj caktimi të Allahut. Sepse njerëzit e dashur të Allahut janë ata që janë të kënaqur me Allahun.

Profeti (a.s.) thotë:

“Kush thotë: “jam i kënaqur me Allahun si Zot, Islamin si fe dhe Muhamedin si Profet” është e drejtë e Allahut për ta bërë atë njeri të kënaqur.” (Tirmidhi, Deavat, 13/3389)

Shejh Sadiu thotë:

Mos u mërzi nga ofendimi apo dëmi të të bën një njeri i rëndomtë. Sepse ata nuk janë të aftë as të rëndojnë dhe as të lehtësojnë. Miqësinë e mikut dhe armiqësinë e armikut kërko ta gjesh tek Allahu. Sepse zemra e tyre është në dorë të Allahut. Njeriu i mençur kur i hidhet shigjeta shikon tek harkëtari jo te harku.

Një nga parimet e besimit është besimi se e mira dhe keqja është caktim i Allahut. Ata që janë besimtarë të sinqertë çdo fatkeqësi e konsiderojnë si provë hyjnore prej Allahut. Ata nuk lodhen duke u kapur pas shkaqeve. Por strehohen tek krijuesi i shkaqeve.

Në asnjë mënyrë nuk duhet të ankohemi nga caktimi hyjnor. Një besimtar i vërtetë nuk bie në pesimizëm përballë fatkeqësive dhe as nuk mburret dhe krenohet me mirësitë. Por në të dyja



rastet falënderon dhe tregon durim, duke shpresuar shpërblimin vetëm prej Allahut.

Profeti (a.s.) në situata të ndryshme përsëriste shpesh:

“Zoti im, jeta e vërtetë është jeta e Ahiretit.” (Buhari, Rikak, 1.)

Duke tërhequr vëmendjen vazhdimisht në botën tjetër.

Allahu thotë në Kuran:

“Me të vërtetë, pas vështirësisë - vjen lehtësimi! Me të vërtetë, pas vështirësisë - vjen lehtësimi.” (Inshirah, 5-9)

Profeti (a.s.) e këshillonte vajzën e dashur Fatimen në thjesh-tësi, modesti, devotshmëri dhe durim për të kapërcyer vështirësitë e kësaj bote dhe fituar lumturinë e përhershme në botën tjetër.

Edhe ne, në rast fatkeqësie duhet të themi: O Zot! Të gjitha sprovat janë prej Teje. Jeta e vërtetë është jeta e Ahiretit. Në këtë mënyrë të falënderojmë dhe të bëjmë durim në mënyrë që Allahu të jetë i kënaqur me ne.

Shejh Sadi thotë:

Bëni bamirësi por mos e përmendni atë. Në fakt mirësia që bën është një mirësi për veten tënde. Ai që do të përfitojë më shumë nga bamirësia je pikërisht ti vetë.

“Falënderoj Allahun, që të dha mundësi të bësh mirësi, sepse Ai nuk të privoi nga mirësia e Tij. Ai që i shërben padi-shahut, nuk mund të pretendojë mirënjohje prej tij. Përkundrazi, ti duhet t’i jesh mirënjohës atij që të mori në punë.”

Të gjitha mirësitë janë dhuratë e Allahut por shpenzimi i tyre në rrugë të Allahut është një mirësi në vete. Ata që bëjnë mirësi nuk duhet të harrojnë që çdo mirësi në fakt është në dobi të vetë atyre. Besimtari shërbimin në rrugën e Allahut duhet ta

konsiderojë një mirësi të madhe dhe duhet të falënderojë Allahun për këtë mundësi që i kanë dhënë.

Ali Ramiteni ka thënë:

“Ka shumë njerëz që shërbejnë duke pritur mirënjohje. Por janë të paktë ata që e konsiderojnë shërbimin si dhuratë. Nëse e konsideroni dhuratë mundësinë që keni për të shërbyer dhe u jeni mirënjohës atyre të cilëve u shërbeni, të gjithë do të jenë të kënaqur me ju dhe ankesat do të pakësohen...”

Ne e kemi për detyrë të vrapojmë në çdo mundësi shërbimi që na fal Allahu. Besimtari nuk duhet të kërkojë justifikime, përkundrazi duhet të përfitojë nga çdo mundësi shërbimi dhe duhet ta konsiderojë si dhuratë çdo lloj shërbimi.

Babai im i ndjerë, Musa Efendiu, i cili gjithë jetën e tij ia kushtoi ndihmës ndaj të gjitha krijesave, e shprehte kështu vlerën dhe rëndësinë e punës në rrugën e Allahut:

“Besimtari nuk duhet të shikojë se sa i madh apo i vogël është adhurimi, po kur t’i jepet rasti, duhet të përpiqet t’i bëjë të gjitha me sinqeritet. Sepse shumë njerëz që bëjnë punë të mëdha në shërbimin për hir të Allahut, nuk u japin rëndësi punëve që duken të vogla gjatë shërbimit. Ata nuk e dinë se në cilën prej tyre është kënaqësia e Allahut. Ne duhet të kuptojmë se jo gjithkujt i jepet mundësia të bëjë diçka në rrugën e Allahut. Ka shumë njerëz që, megjithëse janë të aftë të bëjnë shumë punë, nuk mund të shërbejnë për hir të Allahut, vetëm se nuk kanë kohë dhe vend të përshtatshëm. Ata që punojnë në rrugën e Allahut duke e njohur këtë punë si një mirësi, e shtojnë akoma më shumë përulësinë dhe falënderojnë pa fund ata të cilëve u shërbejnë, që u bënë shkak për këto mirësi.”



Shejh Sadiu thotë:

Që të mos privohesh nga bukuria e trëndafilut në pranverë mos e thyej degën e tij në vjeshtë.

Puna dhe përpjekja kanë një kohë të caktuar ashtu si edhe pushimi dhe gjumi kanë një kohë të caktuar. Ata që tregohen dembelë në kohën kur duhet punuar nuk mund të përparojnë dhe të kenë sukses në jetë. Në këtë pikëpamje jeta e kësaj bote është për punë dhe vepra, jo për rehati dhe dëfrime.

Ashtu si hambari i një bujku dembel qëndron bosh ashtu edhe dembelët që nuk mbjellin vepra të mira në këtë botë, në botën tjetër nuk kanë për të korrur asgjë. Prandaj të shërbejmë në rrugën e Allahut në këtë botë në mënyrë që të fitojmë hijen e Arshit në ditën e gjykimit.

Ata që harrojnë Allahun duke u preokupuar tërësisht me jetën e kësaj bote do të jenë të harruar dhe të privuar nga çdo lloj mirësie në ditën e gjykimit.


Allahu thotë në Kuran:

“Kushdo që i kthen shpinën Këshillës Sime, do të ketë jetë të mjeruar dhe Ne, në Ditën e Kiametit, do ta ringjallim të verbër. Ai do të thotë: “O Zoti im, përse më ringjalle të verbër, kur unë kisha shikuar më parë?” (Allahu) do t’i thotë: “Kështu të erdhën shenjat Tona dhe ti i harrove ato e po kështu sot do të jesh i harruar.” (Ta Ha, 124-126)

E lusim Allahun të na mbrojë nga neglizhenca dhe indiferenca ndaj adhurimeve dhe shërbimit në rrugë të Tij. E lusim Allahun të na mundësojë vepra të mira në këtë dhe të na japë lumturinë në botën tjetër.

Amin!..





SHAH NAKSHIBENDI

حَمْدُ اللَّهِ

-1-

Kur rritet afrimiteti me Allahun, besimtarit i shtohet dëshira për adhurim, falënderim dhe dhikër. Po ashtu i shtohet nevoja më tepër për të përmisuar veten e tij. Ata që mendojnë se nuk po e adhurojnë Allahun si duhet ata janë besimtarët me ibadetin më të mirë. Profeti (a.s.) i cili ka arritur majën më të lartë të adhurimit thotë:

“O Allah! Strehohem tek kënaqësia Jote, prej zemërimit Tënd; tek falja Jote, prej ndëshkimit Tënd; dhe tek Ty po prej Teje! Unë jam i pafuqishëm të të lavdëroj dhe të të falënderoj ashtu siç të takon! Ti je ashtu siç e lavdëruar dhe madhëruar Veten Tënde!”

(Muslim, Salat, 222.)





SHAH NAKSHIBENDI - 1

Muhammed Bahuddin Shah Nakshibendi është një nga njerëzit e urtë dhe miqtë e Allahut i brumosur me edukatën dhe botën shpirtërore të Profetit (a.s.).

Ai ka fituar një emër të madh në botën e atyre që dëshirojnë të udhëtojnë drejt Zotit. Ai ishte një mjek zemrash i cili ka gdhendur dashurinë hyjnore në shumë zemra.

Ai ka qenë një oqean i paanë në dituri dhe urtësi...

Ai ishte i zhveshur nga ego dhe ambicia materiale, ai ishte një fenomen i thjeshtësisë, altruizmit dhe dashurisë.

Të gjithë këto mirësi ishin dhuratë prej Allahut. Por edhe vullneti, bota shpirtërore dhe vendosmëria atij ishin në nivele shumë të larta.

Për të treguar vendosmërinë e tij të hekurt në udhëtimin shpirtëror, vlen të përmendim një ndodhi që ai e transmeton vetë:

Një ditë në rrugë po kaloja para një kumarhaneje. Aty pashë



një grup njerëzish që po luanin kumar gjithë ambicie dhe zell. Ishin aq të zhytur në lojë sa që ishin pothuajse të shkëputur nga realiteti përreth. Ata dukeshin sikur ishin të dehur nga kënaqësia e Kumarit.

Midis tyre dalloheshin dy veta që po luanin kundër njëri-tjetrit. Pas një kohë njëri prej tyre u mund. Sa më shumë luante aq më shumë humbiste deri sa humbi gjithçka që kishte. Megjithëse kishte humbur gjithçka kumarxhiu vazhdonte të luante me një vendosmëri të hekurt, sa më shumë humbiste aq më shumë i rritej ambicia për të luajtur. Në një moment i tha konkurrentit fitues:

Unë nuk heq dorë nga loja sikur, jo gjithë pasurinë por edhe kokën të lejë aty përsëri nuk heq dorë nga loja deri sa edhe ti të shijosh humbjen që po shijoj unë.

Kur pashë vendosmërinë, ambicien dhe guximin e kumarxhiut fillova të mendoj me vete:

A nuk duhet të jem edhe unë në rrugën e drejtë kaq durimtar, guximtar dhe i vendos sa ky kumarxhi që është në rrugën e gabuar. Qysh prej asaj ditë dëshira dhe ambicia ime në rrugëtimin shpirtëror u rrit. Dhe çdo ditë dëshira më rritet edhe më shumë.

Pra ai njeri zemrash ishte i aftë që nga një ngjarje negative të nxirrte mësim të çmuara dhe urtësi të vjera. Pra kur njeriu arrin një gjendje të tillë mund të mësojë edukatën edhe prej një personi të paedukatë. Një person i tillë mund të nxjerrë mësim në lidhje me vendosmërinë dhe përpjekjen e vazhdueshme edhe prej një kumarxhiu.

Shumë njerëz arrijnë të sakrifikojnë rehatinë, pasurinë, shë-



ndetin, madje edhe jetën e tyre për hir të ëndrrave boshe dhe dashurive kalimtare, ndërsa Ebu Xhehlët e kohës sonë bëjnë përpjekje dhe sakrifica titanike për të mbajtur gjallë kauzat e tyre të kota. Atëherë, si është e mundur që ne myslimanët, që jemi pjesëtarë të kauzës hyjnore, t'i konsiderojmë të mjaftueshme përpjekjet tona fetare? Si mund të dalim faqebardhë nga vetillogaria në këtë çështje?..

Çdo besimtarë duhet t'i përgjigjet këtyre pyetjeve dhe të punojë në rrugën e Allahut pa u lodhur dhe mërzhitur. Punën në rrugën e Allahut duhet ta konsiderojë një mirësi të madhe.

Zoti ynë nuk na ngarkon me përgjegjësi përtej mundësie tona. Mirëpo, kjo do të thotë se ne jemi përgjegjës për atë që kemi mundësi. Pra, ne do të japim llogari edhe për mirësitë që nuk i kemi vepruar edhe pse kemi pasur mundësi.

Cilësia dhe veçoria kryesore dalluese e personaliteteve që kanë kapërcyer hapa të rëndësishëm në udhëtimin e tyre shpirtëror, ka qenë shërbimi në rrugën e Allahut.

Shërbimin në rrugën e Allahut e vejmë re qysh në hapat e parë të rrugëtimit shpirtëror të Shah Nakshibendit. Shah Nakshibendi është prej atyre miqve të Allahut që dashuritë e tjera i bëri shkallë për te dashuria hyjnore, madje ai u bë një nga mjeshtrit më të shquar të këtij arti. Dashuria e tij është shërbimi.

Shah Nakshibendi u lartësua në rrugën shpirtërore me sugjerimin e mjeshtrit të tij, Emir Kulal:

“Përpiku të fitosh zemrën e njerëzve; shërbeju të paaftëve! Mburoi të dobët dhe zemërtëyerit! Ata janë të tillë që nuk presin gjë nga askush. Shumica e tyre jetojnë në prehje, modesti e butësi. Të tillët gjeji dhe shërbeju!”

Në vitet e para të rrugëtimit të tij shpirtëror, mbreti i arifëve, Nakshibendi ka pastruar rrugët për shtatë vite, pastroi rrugët ku kalonin njerëzit, u ka shërbyer të sëmurëve, të pafuqishmëve, madje edhe kafshëve të plagosura (që kishin ndonjë plagë në trup). Ai ka pohuar se shumë grada të larta shpirtërore i ka arritur gjatë kësaj rruge, duke u bërë hiç dhe duke kultivuar modestinë

“Shërbeva për një kohë të gjatë në rrugën që më urdhëroi mësuesi im. Egoja ime u bë e atillë, saqë duke ecur, ndaloja në vend përpara çdo krijese të Allahut dhe vazhdoja rrugën vetëm pasi kishte kaluar ajo. Shërbimi im vazhdoi shtatë vjet rresht. Si rezultat i kësaj, fillova të dëgjoja edhe zërat e trishtuar të krijesave që luteshin dhe kërkonin strehim tek Allahu”.

Për shpirtat e ndriçuar me urtësi, çdo gjë në univers shfaq dhe tregon fuqinë dhe madhështinë hyjnore. Për të arritur këtë gjendje, është kusht që shpirti të fitojë butësi dhe delikatesë me anë të edukimit shpirtëror dhe të marrë mësim prej shfaqjeve hyjnore, duke u thelluar në urtësi. Kjo, sepse shumë të fshehta nuk mund të konceptohen me mendje, por vetëm me urtësi. Të fshehtat shpirtërore nuk bëhen të qarta pa u thelluar në urtësi.

Edukata është kapitali më i çmuar i një udhëtari që ndodhet në rrugë të Allahut. Njeriu nuk mund të jetë edhe fetar, edhe i paedukuar, sepse thelbi i shpirtit islam në besim, është teuhidi, ndërsa në vepra është edukata dhe mëshira. Prandaj mund të thuhet se feja islame me të gjitha parimet e veta, fund e krye përbëhet nga mirësjellja, delikatesa dhe pastërtia.

Siç evidentohet lehtë për të hedhur hapa të rëndësishëm në udhëtimin shpirtëror nuk mjafton vetëm leximi i librave por zbatimi dhe ndjekja si një recetë e atyre që lexohen. Pra thënë



shkurt leximi duhet t'i shërbejë përpjekjes në rrugën e Allahut. Për të arritur grada të lartë shërbimi në rrugën e Allahut është i domosdoshëm.

Shah Nakshibendi thotë:

*Bota është grurë, e unë kashtë
Bota është e mirë, e unë i keq...*

Pra të gjithë janë të mirë kurse unë jam i keq. Ajo që i ka lartësuar miqtë e Allahut është pikërisht kjo.

Kjo është arsyeja pse miqtë e Hakut, që të mund të pastronin nefsin e tyre, janë zhveshur fillimisht nga petku i qenies dhe i unit, për të veshur më pas rrobën e hiçit e të mosqenies. Më pas kanë mundur të lartohen në majat e kuptimeve shpirtërore.

Për të arritur pjekurinë shpirtërore është e domosdoshme të mos zhvishet asnjëherë petku i modestisë. Një robëri pa modesti është robëri e mangët. Uni dhe mendjemadhësia janë armiqtë më të rrezikshëm të njeriut, sepse rrezikojnë ta çojnë atë deri në kufër (mosbesim).

Pasi e kanë shkrirë modestinë në jetën e tyre, miqtë e Hakut kanë arritur mirësitë e shumta të Allahut të Lartmadhëruar, kanë arritur të bëhen yje në qiejt shpirtëror, si dhe udhërrëfyes për të tjerët si në gjallje ashtu edhe pas vdekjes së tyre.

Shah Nakshibendi megjithëse arriti grada të larta shpirtërore gjithmonë e konsideroi veten fillestar në këtë rrugë. Allahu si pasojë e kësaj modestie e lartësoi duke e bërë udhëheqës shpirtëror dhe të dashur midis njerëzve.

Poeti e shpreh në këtë mënyrë rolin e modestisë në lartësimin e njerëzve:

“ Fara pa ra në tokë nuk mbin dhe nuk mund të rritet. Po

kështu është edhe për ata që janë modestë, ata i lartëson Allahu për shkak të modestisë së tyre.

Shah Nakshibendi thotë:

Me ndihmën e Allahut është shumë e lehtë refuzimi i kapriçove të egos për një person që njih kurthet e shejtanit dhe përpiket të pastrojë veten nga mëkatet.

Hapi i parë për të luftuar egon është ta njohësh mirë atë dhe kurthet e saj, vetëm në këtë mënyrë mund të fitohet lufta kundër këtij armiku të fshehtë. Ata që nuk i njohin kurthet e saj jo vetëm që nuk i ndejnë dëmet e saj por i konsiderojnë si kënaqësi dhe ëmbëlsi ato. Pra ata nuk e ndejnë rëndesën e madhe të dëmeve që shkakton egoja. Prandaj nuk bëjnë asnjë përpjekje për të përmisuar gjendjen.

Prandaj gjëja e parë që duhet të bëjë besimtari është të njohë egon e tij dhe të marrë masa kundër tij me vepra të mira dhe devotshmëri. Kjo është arsyeja që të urtët kanë thënë kush njih veten njih Zotin.

Shah Nakshibendi thotë:

Profeti në një hadith thotë: “Largoni pengesa nga rruga” pengesat në rrugë nënkuptojnë dëshirat e egos kurse rruga është rruga e vërtetë.

Shtyp egon dhe lartësohu! Nëse dëshiron të jesh afër me Allahun braktis dëshirat e egos.

Ego nuk e lejon njeriun të shikojë të vërtetën. Prandaj njeriu duhet të bëjë përpjekje të mëdha për të grisur perden që është midis robit dhe Krijuesit. Disiplinimi i saj arrihet përmes refuzimit të dëshirave dhe frenimit të egos. Ego duhet të shërbejë si një shkallë për t’u ngjitur lart.



Nëse egoja nuk disiplinohet dhe mësohet me vepra të mirë nuk ka asnjë ndryshim prej një kali të harbuar. Kali i harbuar nuk e çon kalorësin në destinacionin e duhur por e rrëzon dhe përmbys nëpër gremina. Kurse një kalë me frena dhe i disiplinuar e çon kalorësin në vendin e duhur edhe nëse rrugët janë të vështira.

Prandaj për të marrë udhë drejt Allahut duhet të kalohet përmes një discipline shpirtërore duke i shtypur dhe frenuar dëshirat e egos.

Prandaj kanë thënë të urtët kur të dalësh “ti” mbet aty(në zemër) Krijuesi.

Shah Nakshibendi thotë:

“Njerëzit e zemrës e perceptojnë si të pamjaftueshme veprën e mirë që bëjnë, ndihen hiç dhe të dobët, ata janë të vetëdijsëm për të metat e veprave dhe mangësitë e tyre. Nuk ka diçka tjetër më të dobishme për thyerjen e nefsit sesa të shikuarit e vetes si joperfekt. Një ndër urtësitë se pse edhe profetëve iu lejoheshin gabimet e vogla, ishte pikërisht fakti që as ata të mos mendonin se ishin të pagabueshëm.”

Një mëkatar që ndjen thellë mëkatin dhe është penduar për to është shumë më lart se një person i cili duke besuar në veprat e tij të mira është i pavetëdijsëm për mangësitë dhe gabimet e veta. Namazi, agjërimi dhe bamirësia janë vepra që të afrojnë tek Allahu. Por thelbësore është që gjatë realizimit të këtyre veprave të mira të mos e pandehim veten më lart se të tjerët. Çdo gjë duhet konsideruar si një mirësi e Allahut.

Sa bukur e shpreh Lukman Hakimi:

“Mos harro dy gjëra: Allahun e Lartësuar dhe vdekjen.

Harroji dy të tjera: Të mirën që i ke bërë dikujt dhe të keqen



që të ka bërë dikush”, deri sa zemra të zbutet, shpirti të mbushet me mirësi dhe emri yt të skalitet në regjistrin e të mirëve.

Për të mos u përfshirë nga mburra dhe vetëpëlqimi duhet që çdo punë të mirë që bëhet të harrohet menjëherë. Nëse gjatë namazit, agjërimi apo bamirësisë ndjejmë një vetëkënaqësi është e këshillueshme që eliminohet ky ves i keq i egos. Rruga për të shpëtuar prej kësaj është ibadeti me një zemër të ndjeshme e cila ndodhet midis shpresës dhe frikës.

Profeti (a.s.) i cili ka arritur majën më të lartë të adhurimit thotë:

“O Allah! Strehohem tek kënaqësia Jote, prej zemërimit Tënd; tek falja Jote, prej ndëshkimit Tënd; dhe tek Ty po prej Teje! Unë jam i pafuqishëm të të laudëroj dhe të të falënderoj ashtu siç të takon! Ti je ashtu siç e laudëruar dhe madhëruar Vetën Tëndë!” (Muslim, Salat, 222.)

Pra kur rritet afrimiteti me Allahun, besimtarit i shtohet dëshira për adhurim, falënderim dhe dhikër. Po ashtu i shtohet nevoja më tepër për të përmisuar veten e tij. Ata që mendojnë se nuk po e adhurojnë Allahun si duhet ata janë besimtarët me ibadetin më të mirë.

Shah Nakshibendi thotë:

Nëse një udhëtar shpirtëror nuk e konsideron egon e vet më të keq se egoja e Faronit, ai nuk mund të jetë pjesë e udhëtimit tonë. Të kalosh nga ekzistenca në hiç është një vepër kolosale. Nuk është e lehtë të kritikosh dhe poshtërosh egon. Por të pranosh dobësinë e egos është pikënisja për tek Allahu.

Unë e kam parë në këtë perspektivë egon time. Dhe nga evidentimi arrita në përfundim që çdo gjë që ekziston është më e mirë se egoja ime.



Pa dyshim, mohimi (kufr) është gabimi më i rëndë në ndjenjat dhe mendimet njerëzore. Meqë mundësia e shpëtimit edhe prej kësaj është më e madhe me anë të një stili të butë, kur Zoti e dërgoi Hz. Musain (a.s.) te Faraoni për t'ia sugjeruar besimin, e urdhëroi t'i fliste me "kavl-i lejjin", me fjalë të butë. Sepse suksesi në këtë rast i ftuesit, siç është shprehur edhe më lart, është një akt i mirë (ameli salih) që shërben si urë për tek fitimi më i madh. Allahu i Lartë jo se s'kishte dijeni mbi këmbënguljen e fuqishme të Faraonit në mohim! Prandaj, edhe sikur bashkëbiseduesi të jetë po aq i rëndë dhe këmbëngulës sa Faraoni në mohim (kufr), stili ynë i sugjerimit nuk duhet të jetë në trajtën e acarimit të ndjenjave, si fyerja dhe kërcënimi, por në kuadrin e porosisë hyjnore që e orienton fjalën kah serioziteti.

Në themel të padrejtësisë, tiranisë dhe ambicies qëndron vetëpëlqimi dhe konsiderimi i vetes mbi të tjerët. Ilaçi për të shëruar këtë sëmundje është ta shohim veten gjithmonë më ulët se të tjerët. Në këtë mënyrë nënshtrojmë harbinin e egos.

Transmetohet se Muhjidin Arabi, duke kaluar në një breg deti, shikon një të ri që po pinte verë. Po ky person po ngacmonte një grua që e kishte aty afër. Muhjidin Arabi mendoi me vete: - Njeriu duhet ta shohë veten më poshtë se krijesat e tjera, duhet të jetë modest, por unë me sa duket jam më lart se ky i ri. As nuk pi verë dhe as nuk bëj ndonjë gjë jo etike. Në atë çast u dëgjua një e bërtitur, që vinte nga deti:

- Ndhimë, po mbytemi! I riu, sapo dëgjoi këtë zë, hodhi mënjanë kupën e verës dhe u hodh në det të shpëtonte jetën e katër personave që po mbyteshin. Më pas, Ibn-i Arabi, i cili po shikonte më habi ato që po ndodhnin, u gjeti përgjigje mëdyshjeve të mëparshme që kishte sajuar në mendje. - Ja, ai djalosh i ri që

në fillim e nënvlerësove duke e cilësuar dhe gjynahbërës, shpëtoi katër vetë përnjëherë. Po ti ç'bëre? Nuk arrite të shpëtosh dot as edhe një njeri!

Siç kuptohet edhe nga kjo pjesë, tek disa njerëz, ku vëmë re disa sjellje jo të këndshme, mund të shohim edhe xhevahirë të aftësive të tyre. Askush nuk e ka garancinë e frymës së fundit, përveç Pejgamberëve. Mistikët i kanë pranuar robërit e Allahut si krijimi i zemrës.

Njeriu duhet të pranojë dhe njohë dobësinë e vet, vetëm në këtë mënyrë ai mund të arrijë shkallë të larta shpirtërore. Madje pranimi i dobësisë është guri themelor i edukimit shpirtëror. Robi në çfarë do grade qoftë duhet gjithmonë ta konsiderojë veten e tij të pamjaftueshëm në raport me adhurimin dhe veprat e mira. Robi i Allahut të mirat duhet t'ia atribuojë Allahut kurse të këqijat vetes.

Shah Nakshibendi që ishte edhe shembulli më i zgjedhur i hiçit, një ditë teksa po mbante një ligjëratë ndjekësve të tij, u tregoi edhe këtë ngjarje:

“Sipas transmetimeve një ditë Shejh Ebu'l-Abbas Kassâbin e pyetën:

«Gjatë ceremonisë së xhenazes tënde cilin ajet na sugjeron të këndojmë?»

Dijetari i nderuar u shpreh:

«Leximi i ajeteve u takon dijetarëve, ndërsa për ne lexoni këto vargje: Çfarë ka në këtë botë më të bukur se sa arritja e mikut tënd te më i Dashuri!»

Pasi Shah Nakshibendi u tregoi këtë ndodhi me modesti e përkorësi nxënësve të tij, u shpreh:

«Vargjet e mësipërme i meritojnë të mëdhenjtë. Në ceremoninë e xhenazes sime është e mjaftueshme të thoni: Erdhëm në



praninë Tënde si lypsarë të falimentuar! Pashë hatrin e dashurisë së Tënde na e bëj risk një grimcë të Bukurisë Tënde!»

Shah Nakshibendi që u përgatit për frymën e fundit me vetëdijen e robërisë ndaj Hakut e me dashurinë ndaj krijesave të Tij duke u bërë monument i modestisë dhe hiçit, në lidhje me frymën e fundit është shprehur:

“Shoqërohuni me atë me të cilin keni dëshirë të shoqëroheni në frymën e fundit.”

Pra ashtu siç dëshirojmë ta përjetojmë momentin e frymës së fundit duhet ta kalojmë edhe të gjithë jetën.

Që fryma e fundit të mund jetë momenti i arritjes së takimit me Zotin duhet që gjithë jetën ta kalojmë me dëshirën dhe mallin e takimit me Të.

Ajo çfarë do të na duhet në frymën e fundit është dëshmia e shehadeetit, përmendja e Zotit me zemrën e mbushur me iman e besim.

Prandaj është domosdoshmëri kalimi i një jetë të tërë me dhikër dhe larg harresës së Zotit të Lartmadhëruar, me vetëdijen se gjendemi vazhdimisht nën vëzhgimin e kamerave hyjnore.

Një ditë nxënësit kishin kërkuar keramet nga Hazreti Shah Nakshibend. Hazreti u tha atyre:

“Keramenti ynë është i qartë. Ja shikoni; edhe pse kemi shumë peshë mëkati mbi supe, akoma mund të qëndrojmë në këmbë dhe mund të ecim në tokë. A ka keramet më të madh se ky?”

Pastaj, duke ua kujtuar edhe një herë se çështja më rëndësishme në misticizëm nuk është keramenti por istikameti, tha:

“Nëse dikush hyn në një kopsht, dhe nëse dëgjon se çdo



gjethe e pemëve që është aty thotë, goftë haptas apo fshehtas: Tungjatjeta o miku i Allahut!, nuk duhet të gëzohet kurrë nga ky zë.”

Në lidhje me këtë, disa nxënës i thanë:

“O i Nderuar, sado që të fshiheni herë- herë kerameti shfaqet nga ju!..”

Ai monument i modestisë së madhe dhe miku i Zotit tha:

“Ajo që shikoni ju janë kerametet e nxënësve të mi.”, sepse ai ishte në një gjendje në të cilën donte ta fshihte gradën e tij shpirtërore.


Për këtë arsye, sa ishte në jetë, ai nuk i dha leje nxënësit të tij Husameddin Haxhe Jusufit, që ti shkruante fjalët dhe kerametet e tij.

Të mëdhenjtë e Islamit kanë arritur grada të larta në rrugën e Zotit, duke e bërë gjithmonë ligj për veten e tyre istikametin dhe jo kerametin. Ata kanë thënë se për shkak të kerametit nuk kanë fituar më shumë vlerë se sa zogu që fluturon në ajër dhe peshku që noton në ujë. Ata janë shprehur me çdo mënyrë se dija shpirtërore e vërtetë është të jetosh në istikamet me ndërgjegjen e një adhurimi të lartë, duke fituar kënaqësinë e Allahut dhe jo duke u drejtuar te imitimi i asaj që bën zogu dhe peshku.

Ngaqë janë të pastër nga shtirja, miqtë e Zotit nuk shfaqin keramet pa qënë shumë të detyruar. Ata shfaqen ndaj njerëzve me përsosmëritë e një morali njerëzor që mund të merret si shembull.

E lusim Allahun të na bëjë të mundur të ecim në rrugën e drejtë dhe të mbahemi fort pas Kuranit dhe Traditës profetike.

Amin...



SHAH NAKSHIBENDI

رحمۃ اللہ علیہ

-2-

Ata që merren dhe angazhohen vetëm me anën sipërfaqësore të fesa duke anashkëluar thelbin dhe qëllimin kryesor në fakt janë në një neglizhencë të madhe. Besimtari duhet të krijojë një ekuilibër midis trupin dhe shpirtit. Prandaj mistikët përveç anës sipërfaqësore i japin rëndësi të madhe anas shpirtërore. Ata adhurojnë Allahun në harmoni të plotë midis trupit dhe shpirtit.





SHAH NAKSHIBENDI - 2

Shah Nakshibendi thotë:

Evlijatë, kerametet e tyre shpirtërore i matin dhe vlerësojnë sipas kriterëve të Kuranit dhe traditës Profetike. Nëse këto gjendje të jashtëzakonshme përputhen me normat fetare i shfaqin dhe zbatojnë ato. Por nëse nuk përputhen me normat fetare atëherë nuk i marrin fare në konsideratë.

Një evlija thotë:

Nuk pranoj asnjë fjalë që më vjen nga zemra e kontrolluar me dy dëshmitarë si Kurani dhe Suneti.

Xhunejd Bagdati thotë:

Nëse shikoni një njeri duke fluturuar, jeta e të cilit nuk përputhet me mësimet Kuranore dhe profetike, ajo që bën ai nuk është keramet por magji.

Disa njerëz që pretendojnë se janë njerëz të afërt me Allahun shfaqin para njerëzve disa gjendje të jashtëzakonshme ndërkohë që jeta e tyre është në kundërshtim me Kuranin dhe Sunetin,



atëherë ajo që bëjnë ata nuk është keramet por magji ose disa gjendje që janë rezultat i ushtrimeve të caktuara. Pra disa gjendje të jashtëzakonshme mund të shfaqin edhe njerëzit që nuk janë evlija. Gjendjet që arrijnë mistikët hindu përmes ushtrimeve të disiplinuar janë shembuj tipik të këtij rasti. Shumë të tjerë e arrijnë këtë gjendje duke bashkëpunuar me xhinët ose duke krijuar iluzione magjepse.

Për të dalluar këto gjendje të rreme nga kerameti duhet dituri. Por siç thamë më lart në shumicën e rasteve njerëz të tillë bëjnë një jetë jaht kornizave të devotshmërisë. Këta njerëz kanë mangësi të theksuara në ndjekjen e Kuranit dhe Sunetit. Madje një pjesë e tyre janë krejtësisht jashtë islamit. Kjo është pika kryesore që duhet të shikojmë për dallimin e kerametit nga këto gjendje të jashtëzakonshme në dukje.

Pra një besimtar pavarësisht gjendjeve të zemrës me të cilat përballët duhet të vazhdojë rrugën e vet duke u kapur fort pas Kuranit dhe Sunetit. Kriteri i vetëm për të vlerësuar veten duhet të jetë Kurani dhe Suneti. Besimtari nuk duhet të heqë dorë kurrë nga përpjekja për të fituar dashurinë e Allahut deri në frymën e fundit. Besimtari të gjithë mendimet dhe pikëpamjet e tij duhet t'i vlerësojë sipas Kuranit dhe Sunetit, vetëm në këtë mënyrë mund të jemi të mbrojtur nga rënia në mjegullën dhe tisin e neglizhencës.

Ky ajet kuranor duhet të ngulitet fort në zemrat e besimtarëve:

“O ju që keni besuar! Mos nxitoni para (urdhrit të) Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe kjeni frikë Allahun! Vërtet, Allahu dëgjon gjithçka dhe është i Gjithëdijsëm.” (Huxhurat, 1)

Shah Nakshibendi thotë:



Qëndro bashkë me atë që depërtojnë thellë në çështjen e diturisë, mos shpenzo kohë me atë që qëndrojnë në sipërfaqe.

Ata që merren dhe angazhohen vetëm me anën sipërfaqësore të fesa duke anashkaluar thelbin dhe qëllimin kryesor në fakt janë në një neglizhencë të madhe. Besimtari duhet të krijojë një ekuilibër midis trupin dhe shpirtit. Prandaj mistikët përveç anës sipërfaqësore i japin rëndësi të madhe anas shpirtërore. Ata adhurojnë Allahun në harmoni të plotë midis trupit dhe shpirtit. Ata lexojnë Kuran dhe çdo gjë që e lexojnë e pasqyrojnë në sjellje.

Në fakt tasavufi synon zhvillimin vertikal, synon udhëtimin drejt zemrës për të arritur gradat e larta shpirtërore. Ata fenë asnjë herë nuk e kanë konsideruar si një tërësi rregullash të ngurta.

Junus Emre shprehet:

*Dituria është njohje
Dituria është njohja e vetes
Nëse ti nuk e njeh veten
Ç'të vlen kjo dituri?*

Të gjendur përballë këtyre rezultateve të trishtueshme duhet ta pyesim veten:

*Ç'është ky edukim, ç'është kjo dituri?
Ç'është ky edukim fetar pa asnjë hapësirë
praktike apo përjetimi shpirtëror?*

Le të pyesim në mënyrë që të arrijmë kuptimin e vërtetë të edukimit si bartës të një qytetërimi që ka gdhendur personalitete të larta njerëzore.

Qëllimi kryesor i diturisë është njohja e Allahut. Pra të njohësh Allahun shpirtërisht. Ta konsiderosh diturinë si një shkallë

për të arritur njohjen e Krijuesit është kushti kryesor për përsosjen e besimit. Në jetën e ibadetit është kusht ekuilibri midis zemrës dhe mendjes, midis shpirtit dhe trupit.

Një person që qëndron në namaz vetëm në formë pa arritur të realizojë miraxhin e shpirtit, ai namaz e ka humbur thelbin duke u shndërruar në shprehi. Ata që nuk janë për të përqendruar dhe të thelluar në namaz janë në një neglizhencë të madhe. Allahu në lidhje me këtë thotë:

“Mjerë për ata, të cilët kur falen, janë të pakujdesshëm për namazet.” (Maun, 4-5)

“Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët, të cilët janë të përlulur në namazin e tyre.” (Muminun, 1-2)

Përderisa ekziston një qortim kaq i rëndë për ata që e falin namin në shkujdesje, imagjinoni si është gjendja për ata që janë plotësisht larg namazit.

Nga ana tjetër ata që angazhohen vetëm me anën shpirtërore të adhurimit duke anashkaluar formën bien në të njëjtin gabim si të parët. Sepse namaz dhe agjërim pa formë nuk mund të ketë, po ashtu pa shpenzuar pasuri nuk mund të konsiderohet bamirësi. Edhe imani që është një term shumë abstrakt ka dy aspekte, aspektin shpirtëror pra pranimin me zemër dhe aspektin formal; artikullimin me gojë.

Ajeti kuranor e shpreh në këtë mënyrë këtë gjë:

“Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë “Ne besojmë”, pa u vënë në provë?!” (Ankebut,2)

Pra edhe imani bëhet i realizueshëm së bashku me të dyja aspektet. Kur shikojmë jetën e sahabëve të cilët janë kritere praktike për ne, nuk kanë qëndruar vetëm në fjalë por kanë zbatuar mësimet hyjnore dhe kanë sakrifikuar për ta.



Pra duhet të bashkërendohen trupi dhe shpirti. Është shumë e rëndësishme që këta të mos kenë kapërcime të njëri-tjetrit.

Sa e rëndësishme është kjo ndodhi që hedh dritë në lidhje me këtë të vërtetë:

Siç tregohet, një ditë Ibrahim bin Ed'hemit i qëlloi të kalonte pranë Hazretit Imam Azam. Nxënësit që ishin pranë Ebu Hanifes e panë Ibrahim bin Ed'hemin me sy të përçmues dhe mospërfillës. Imam Azami e vuri re këtë dhe i thirri Ibrahim bin Ed'hemit:

“Urdhëroni i nderuar, na e nderuat kuvendin!”

Duke u ndjerë me turp, Ibrahim bin Ed'hemi dha selam dhe kaloi. Pasi u largua Ibrahim bin Ed'hemi, nxënësit e pyetën Imam Azamin:

“Nga cili aspekt e meriton ky njeri cilësinë e nderimit? Si ka mundësi që një njeri si ju t'i thotë atij i nderuar?”

Në lidhje me këtë, Imam Azam dha këtë përgjigje që shprehte ndjenjën e respektit që kishte për miqtë e Allahut dhe në të njëjtën kohë modestinë e tij të lartë:

“Ai gjithmonë është i përkushtuar ndaj Allahut në një lloj mënyre, ndërsa ne jemi të përkushtuar ndaj punës...”

Imam Ebu Hanife shfaqti një gjest edukimi për nxënësit dhe shprehu një shenjë modestie për vete. Ebu Hanife megjithëse se merrej me dituritë ekzoterike, në jetën rituale karakterizohej nga sinqeriteti dhe devotshmëria. Sipas transmetimeve të ndryshme në dy rekat namaz këndonte gjithë Kuranin. Ai i kishte përvetësuar dituritë në thellësi dhe predikimin e bënte përmes sjelljes dhe zbatimit të mësimave.

Shah Nakshibendi thotë:

*Bëhu si qiri,
që drita jote të ndriçojë të tjerët.
Mos u bëj si qiri,
të ndriçosh të tjerët dhe të mbetesh në errësi.*

Qiriu për të ndriçuar mjedisin përreth sakrifikon veten duke u shkrirë në rrugën për ndriçimin e të tjerëve. Kjo është cilësi e besimtarëve që në rrugën e shërbimit ndaj Allahut nuk kursejnë asgjë madje as jetën e tyre, por çdo gjë e vejnë në dispozicion të fesë. Në këtë aspekt përngjasimi me qiriun është një virtyt.

Kurse nga ana tjetër qiriu nuk ndriçon veten. Nga ky aspekt nuk duhet në asnjë mënyrë të ngjasojmë me qiriun. Ndërsa përpiqemi të udhëzojmë të tjerët harrojmë veten, ndërsa përpiqemi të ndalojmë të tjerët në rënie në mëkate biem vetë në mëkate, ndërsa të tjerëve u ndalojmë haramet vetë i shkelim, këto janë cilësi të njerëzve neglizhentë. Këta janë njerëz të cilëve pjesa e jashtë nuk u përputhet me pjesën e brendshme.

Në lidhje me këtë Allahu në Kuran thotë:

“Allahun e përleëvdon gjithëçka, që gjendet në qiej dhe në Tokë. Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti! O besimtarë, përse thoni atë që nuk e bëni?” (Saff, 1-2)

Shah Nakshibendi thotë:

“Të jesh musliman, do të thotë të jesh i lidhur pas konkluzioneve të legjislacionit kanunik, të jesh i devotshëm, të adhurosh dhe vepros me vendosmëri si dhe të ruhesh me të gjitha mundësitë prej lejimeve përjashtimore; të jesh musliman është tërësisht dritë e bukuri, kënaqësi dhe mëshirë!”

Të gjithë këto janë mjete për të arritur grada të larta shpirtërore. Evlijatë përmes këtyre cilësive arrijnë shkallën e lartë të veliut.



Devocioni dhe adhurimi ndaj Zotit janë pika e fundit e thjesh-tësisë dhe përlusësisë ndaj Tij. Devocion dhe adhurim ndaj Zotit do të thotë bindje me një nënshtrim të plotë ndaj Tij, zbatim me rreptësi i urdhrave dhe ndalimeve të Tij dhe shmangia nga kundërshtimi ndaj Tij. Devocioni dhe adhurimi ndaj Zotit janë shkaku i krijimit të njeriut dhe kryhen vetëm ndaj Allahut të Lartë i cili është zotëruesi i vërtetë i të mirave dhe dhuntive, i cili i fal njeriut jetë dhe, pastaj, i jep mundësi për të përfituar nga të mirat dhe dhuntitë e tjera. T'i bëhesh rob Allahut, domethënë, të mbash qëndrim të devotshëm ndaj tij dhe ta adhurosh Atë me devotshmëri, do të thotë të shpallësh lirinë e njeriut ndaj të gjitha qenieve të tjera veç Tij. Prandaj, pozita e njeriut si rob i Zotit nuk është një atribut që e robëron ose e skllavëron njeriun, që ia kufizon fuqitë, aftësitë dhe mundësitë, por një veçanti që e bën njeriun epror mbi të gjitha qeniet e tjera.

Në lidhje me adhurimin prejardhja dhe pozita nuk kanë asnjë vlerë. E vetmi kusht për të fituar vlerë është devotshmëria dhe veprat e mira. Kush ka më shumë devotshmëri dhe vepra të mira ai është më i vyer.

Në lidhje ke këtë Kurani shprehet kështu:

“...dhe se njeriu do të ketë vetëm atë për të cilën ka punuar.” (Nexhm, 39)

Suksesi është për ata që tregojnë durim dhe vendosmëri në këtë rrugë. Mirësia dhe begatia do të jetë për ata që tregojnë përpjekje këmbëngulëse për të fituar dashurinë e Allahut.

Shah Nakshibendi thotë:

Nuk e kapin të gjithë prehën në gjueti duke vrapuar. Prehën e kap ai që e ndjek atë vazhdimisht. Për këtë duhet të ndiqet gjithmonë dhe vazhdimisht rruga e drejtë.

Ata që e fillojnë një punë me entuziazëm të madh në fillim, lodhen shumë shpejt dhe në shumicën e rasteve e braktisin pa përfunduar. Nga që nuk e kanë arritur qëllimin humbin durimin dhe entuziazmin për punë të tjera.

Profeti (a.s.) thotë:

“Akti më i pëlqyeshëm te Allahu është adhurimi i rregullt dhe i vijueshëm qoftë edhe i pakët. Bëni adhurime (suplemente) aq sa të keni mundësi!” (Buhari, Rikak, 18)

Adhurimi nuk është për një afat të caktuar, ai është pjesë e pandashme e gjithë jetës deri në vdekje. Për të siguruar vazhdimësinë e adhurimit duhet një ekuilibër.

Aishja (r.a.) ka thënë:

“Vepra e të Dërguarit të Allahut, ishte si shiu që bie lehtë dhe vazhdueshëm...” (Buhari, Saum, 64. Rikak 18; Muslim, Musafirin, 217)

Me këtë, ajo na ka bërë të ditur se i Dërguari i Allahut e fillonte një adhurim dhe e bënte vazhdimisht dhe pa e braktisur.

Adhurimi i pakët por i vazhdueshëm, edhe nëse në shikim të parë duket i thjeshtë dhe i pamjaftueshëm, nëse ai vazhdohet me durim dhe qëndrueshmëri, patjetër që në fund do të sjellë shpërblime të shumta. Duhet menduar se, ajo që i bën detet dete, janë vazhdimësia e pikave të shiut. Pikë, pikë bëhet oqeani.

Nisur nga kjo, adhurimi vetëm në ditët dhe netët e bekuara, duke i neglizhuar ato edhe gjatë ditëve të tjera kur është mundësia, është një humbje e madhe.

Nga ana tjetër, nëse njeriu jeton gjithë jetës me entuziazmin e adhurimit me aq sa ka mundësi, kjo tregon vendosmërinë dhe qëllimin e tij në vazhdueshmërinë e adhurimeve. Për këtë arsye, edhe Allahu i Madhëruar, do t'i japë shpërblime të përzetshme.



Madje, nëse robi nuk arrin ta kryejë një adhurim për shkaqe që nuk varen nga ai, si respekt ndaj dëshirës së adhurimit që ai ka në zemër, Allahu i Madhëruar do ta shpërblejë atë sikur e ka kryer adhurimin.

Për këtë arsye, duhet ta konsiderojmë mirësi të madhe kryerjen e veprave të mira dhe bërjen zakon të tyre, sa jemi ende në kohë dhe kemi mundësi.

Nga ana tjetër, edhe urdhrat rreth adhurimeve në Kuranin Fisnik, bartin kuptimin e vazhdimësisë. Pra, urdhrat hyjnorë shprehin se, adhurimet nuk duhen kufizuar në kohë të caktuara, por duhen kryer gjatë gjithë jetës në mënyrë të vazhdueshme.

Profeti (a.s.) bënte shumë adhurime në kohë të caktuara vetëm për të. Ai e vazhdonte adhurimin e natës me devotshmëri dhe i mbytur në lot, derisa i ënjteshin këmbët, zemrën e kishte gjithmonë të zgjuar, edhe nëse sytë e tij flinin dhe, nuk qëndronte asnjëherë larg përmendjes së Allahut, meditimit dhe vetëkontrollit. Por kur vinte çështja tek ymeti ai zgjidhte rrugën e mesme. Sepse ajo që siguron vazhdimësinë e një punë është maturia dhe ndjekja e rrugës së mesme, qëndrimi larg ekstremeve.

Lidhur me këtë çështje, ky hadith është shumë domethënës: *“Janë shkatërruar ata që e teprojnë me fjalë dhe vepra!”* (Muslim, Ilim, 7.) Shkurtimisht, një mysliman duhet të jetë i ekuilibruar në ndjenja, fjalë dhe sjellje.

Madje as në ibadete nuk duhet të shkojmë drejt ekstremit. Sa bukur e shpreh ky hadith domosdoshmërinë për t’u ruajtur nga ekstremit qoftë ky edhe ibadet.

“Nga adhurimet që nuk janë farz, bëni aq sa të keni mundësi. Sepse më i dobishmi i adhurimeve është adhurimi

i vazhdueshëm qoftë edhe i pakët!” (Ibni Maxhe, Zuhd, 28)

Vazhdimësia në ibadete dhe sinqeriteti në zemër duhet bërë pjesë e vetëdijes sonë. Pasi të arrihet kjo gjendje, edhe në adhurimet- përveç detyrimeve- që nuk mund të kryhen për shkak të arsyejeve të forta si sëmundja apo plakja Allahu na lajmëron se do të kemi shpërblim pa ndërprerje.

“Përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira: ata do të kenë shpërblime të pandërprera.” (Tin, 6)

Neglizhenca ndaj adhurimeve e ekspozon njeriun përballë një gjendje shumë të vështira në ditën e gjykimit, por edhe teprimi në adhurime mund të sjellë lodhje dhe velje. Allahu na ruajtë. Prandaj është shumë e rëndësishme të ndjekim një rrugë të mesme por të vazhdueshme. Teprimi në ibadetet individuale duke lënë pas dore shërbimet sociale në rrugën e Allahut bie në kundërshtim me vullnetin hyjnorë.

Allahu na fton të jemi të mëshirshëm dhe të dhembshur me njerëzit. Fruti i parë i besimit është mëshira dhe shfaqja më e brilante e mëshirës ndodh në shërbimin për hir të Allahut.

Shah Nakshibendi thotë:

Kerameti nuk konsiston në gjendje të jashtëzakonshme si përshembull duke fluturuar në ajër. A nuk e shikoni se një gjë të tillë e bëjnë qenie më të ulta se njeriu. Njeriu është krijesa më lartë dhe më e përsosur në univers. Duke qenë krijesa më e përsosur normalisht që është mbi çdo krijesë tjetër. Prandaj fluturimi i një personi në ajër nuk duhet të konsiderohet si një ngjarje e jashtëzakonshme. Keramete të tilla nuk kanë vlerë në syrin e njerëzve të dashur të Allahut.

Kerametet janë gjendje të jashtëzakonshme, të pashpje-



gueshme nga ana shkencore, të cilat u jepen dhuratë evlijave si pasojë e besimit të përsosur dhe devotshmërisë së lartë.

Kerametet janë dy lloje:

Keramete formale: këto lloj kerametesësh konsistojnë në gjendje të jashtëzakonshme në botën fizike siç është udhëtimi në kohë apo në distancë, nënshtrimi i kafshëve të egra apo lëvizjen e sendeve të ndryshme.

Evlijatë këtyre lloj kerameteve nuk i japin shumë rëndësi dhe vlerë. Sepse keramete të tilla tërheqin vëmendjen e njerëzve, gjë e cila është e padëshiruar nga evlijatë. Injorantët fillojnë të shpresojnë çdo gjë prej evlijave, kjo gjë sjell mbjelljen e helmit të mburrjes dhe famës në zemrën e tyre. Prandaj evlijatë përpiqen sa të munden për t'i mbajtur të fshehura keramete të tilla.

Keramete shpirtërore: Këto keramete konsistojnë në dituri, moral, ibadet dhe devotshmëri. Ata që zotërojnë keramete të tilla janë vazhdimisht nën udhëheqjen e ajetit: **“Prandaj qëndro i patundur në udhën e drejtë, ashtu siç je i urdhëruar.”** (Hud, 112)

Sa do që njerëzit preferojnë kerametin e parë, në sytë e evlijavë vlerë ka lloji i dytë i kerametit. Sepse evlijatë kanë rënë dakort se kerameti më i madh është qëndrimi në rrugë të drejtë duke përballuar gjithfarë lloj vështirësie.

Në lidhje me këtë Halid Bagdati thotë:

“Qëndrimi në rrugë të drejtë dhe puna, janë më të mira se keshfi dhe kerameti. Përveç kësaj, duhet të dihet se nëse keshfi dhe kerameti nuk e shtojnë respektin ndaj urdhrave të fesë, nuk janë gjë tjetër veçse shkatërrim e fatkeqësi.”

E rëndësishme është jeta sipas Kuranit dhe Sunetit. Sepse njeriu edhe nëse zotëron keramet nuk ka siguri nëse do të jetë

i shpëtuar apo jo. Prandaj sahabët kanë jetuar gjithmonë më shqetësimin e përfundimit. Kjo ndodhi me Selman Farisiun është shumë domethënëse në lidhje me këtë:

Njëherë, dy persona shkuan tek sahabi Selman Farisiu r.a dhe pasi e përshëndetën me selam, e pyetën:

“A je prej sahabëve të Profetit a.s?”

“Nuk e di!” - u përgjigj ai.

“Mos vallë kemi ardhur gabim?” - thanë ata duke ngurruar.

Mirëpo, edhe pse ishte përgëzuar nga vetë Profeti a.s, me fjalët: “Selmani është prej nesh, prej Ehl-i Bejtit”⁵ dhe gëzonte virtyte të larta, ky sahab i bekuar nuk i quante asnjëherë të mjaftueshme përpjekjet e tij fetare dhe, me zemrën që i dridhej midis ndjenjave të “frikës” dhe “shpresës”, ai u shpreh me këto fjalë:

“Po, unë e kam parë të Dërguarin e Allahut a.s, dhe jam gjendur në tubimet e tij. Por sahabi i vërtet i të Dërguarit të Allahut a.s, është ai që arrin të hyjë së bashku me të në Xhenet.” (Hejthemi, VIII, 40-41; Dhehebi, Sijer, I, 549)

Halid Bagdadi, i njohur si “dielli i diejve” në dituri dhe njohje, në letrat që i ka shkruar nxënësve të tij, ka kërkuar duanë e dorëzimit të frymës së fundit me iman (“husn-i hatime”). Në letrën që i shkroi vëllait

të tij e shprehu këtë ndjenjë duke thënë:

“Betohem në Krijuesin e Gjithësisë se që nga dita që më lindi nëna e deri më sot nuk besoj të kem punuar qoftë edhe një punë të vetme të pranuar e të vyeshme tek Allahu për të cilën nuk do jap llogari...



Nëse nuk e konsideron veten tënde të dështuar sa i takon krejt punëve të mira, ta dish që ky është kulmi i injorancës. Nëse e konsideron veten të dështuar, prapë se prapë mos i humb shpresat nga mëshira e Allahut. Sepse bujaria dhe mirësia e Allahut janë më të dobishme për njeriun se gjithë punët e mira të njerëzve dhe xhindëve.”


Kjo do të thotë që sa i takon shpëtimit të përjetshëm, është i panjohur si fundi i muridit ashtu edhe i murshidit... Të jetosh një jetë larg devotshmërisë dhe përkushtimit e të gjesht ngushëllim duke pritur se “Shejhu do më shpëtojë”, është një shkujdesje dhe injorancë që nuk mund të pranohet nga Tasavvufi.

Pra nuk është e rëndësishme pozita dhe pozicioni por arritja deri në frymën e fundit me besim dhe dalja para Allahut si besimtarë.

E lusim Allahun të na mbrojë nga çdo pengesë e mundshme në rrugën e adhurimit dhe arritjes së synimeve tona të krijimit. E lusim Allahun të na zgjerojë zemrat dhe të na japë urtësi dhe mirësi në çdo gjë.

Amin!..





SHAH NAKSHIBENDI

حَمْدُ اللَّهِ

-3-

*Zemra e besimtarit duhet të jetë aq e ndjeshme dhe vigjilente, sa të arrijë ta kuptojë gjendjen e vëllait të tij që ka përballë, si një radiografi shpirtërore, dhe ta ndjejë veten përgjegjës për plotësimin e nevojave të tij. Duke na bërë të ditur se zemrat e besimtarëve duhet ta fitojnë këtë ndjesi ndaj nevojtarëve. Dielli nuk pret përgjërimit e atyre që duan të përfitojnë prej ngrohtësisë dhe dritës së tij. **“Do t’i njohësh nga pamja e tyre...”** (Bekare, 273)*





SHAH NAKSHIBENDI - 3

Shah Nakshibendi thotë: Ai që fiton duke punuar është prej njerëzve të dashur të Allahut. Në fakt rob i dashur i Allahut është ai që punon për të fituar dashurinë e Allahut, jo ai që punon vetëm për të mbledhur pasuri të kësaj bote.

Besimtari në çdo çështje duhet të synojë dashurinë e Allahut. Besimtari duhet të punojë dhe përpiqet vetë pa i shtrirë dorën askujt përveç Allahut. Ai duhet të bëjë përpjekje të jetë gjithmonë dorë që jep dhe jo dorë që merr. Në njeri që e fokuson qëllimin dhe synimin e vet në këtë mënyrë fiton dashurinë e Allahut.

“Allahu i Madhëruar e do robin e tij që lodhet duke vrapuar pas hallallit.” (Sujuti, el-Xhamiu’s-Sagir, I, 65)

Kur filluan të shpallen ajetet e zeqatit dhe bamirësisë sahabët e varfër që nuk kishin çfarë të dhuronin, shkuan në mal, prenë dru për t’i shitur dhe bërë bamirësi me fitimet nga shitja e drurëve. Në këtë mënyrë ata i vunë menjëherë në zbatim ajetet kuranore dhe u bënë predikues praktik të mësimëve hyjnore. Ata u përpoqën të ishin si një Kuran i gjallë mbi tokë.



Nga ana tjetër është e domosdoshme të kujdesemi dhe ndihmojmë ata që nuk mund të sigurojnë të ardhurat e mjaftueshme për familjen e tyre.

Shejh Sadiu thotë:

Bëhu i mëshirshëm dhe i dhembshur, ec në rrugën e njerëzve të mirë! nëse je në këmbë kape për dore dhe ngrije atë që ka rënë!

Ndihma e vëllezërve është detyrim i çdo besimtari. Allahu në Kuran thotë:

“(Lëmosha) u takon të varfërve, të cilët kanë hyrë në rrugën e Zotit e nuk janë në gjendje të udhëtojnë (për të fituar). Kush nuk i njeh ata, kujton se janë të kamur, për shkak se ata nuk lypin. Do t’i njohësh nga pamja e tyre. Ata nuk i mërzhisin njerëzit duke lypur. E çdo gjë që shpenzoni prej të mirave, Allahu i di ato.” (Bekare, 273)

Zemra e besimtarit duhet të jetë aq e ndjeshme dhe vigjilente, sa të arrijë ta kuptojë gjendjen e vëllait të tij që ka përballë, si një radiografi shpirtërore, dhe ta ndjejë veten përgjegjës për plotësimin e nevojave të tij. Duke na bërë të ditur se zemrat e besimtarëve duhet ta fitojnë këtë ndjesi ndaj nevojtarëve. Dielli nuk pret përgjërimet e atyre që duan të përfitojnë prej ngrohtësisë dhe dritës së tij. Kështu, edhe një besimtar i mençur e bën vet atë që pritet prej tij, pa pritur t’ia thonë.

Kush punon për të siguruar jetesën e familjes dhe shpenzon për të ndihmuar shërbimin në rrugën e Allahut është prej njerëzve të dashur të Allahut. Qëllimi i besimtarit nuk duhet të jetë thjesht të mbledhë pasuri për të arritur mirëqenien materiale në këtë botë.



Në kushtet e ditëve tona, është e domosdoshme të kujtojmë se, dhembshuria ndaj të dobëtëve, të varfërve, të vetmuarve dhe atyre që jetojnë në vuajtje, duhet të jetë ndjesi e zemrës së çdo njeriu të ndërgjegjshëm dhe të mëshirshëm.

Nga ana tjetër mëshira si fruti i parë i besimit nuk konsiston vetëm në ndihëm e të varfërve dhe nevojtareve.

Në këtë botë në fakt ata që janë për t'u mëshiruar janë pronarët të cilët të përfshirë nga ambicia për të fituar më shumë shtypin punëtorin dhe shkelin të drejtat e blerësit. Zemra e tyre ka arritur një gradë të tillë vrazhdësie që nuk ndjen më dhimbjen e tjetrit. Mjeranët e vërtetë për të cilët duhet ndjerë dhembshuri, janë ndërgjegjshëm e zullumqarëve, shpirtrat e atyre që jetojnë në luks, ndërkohë që janë robër të egos dhe zemrat e pista të të pasurve që grabisin në këtë sistem kapitalist, i cili është një regjim abuziv. Këta mjeranë të vërtetë, kanë më tepër nevojë për mëshirë. Kjo dhembshuri e mëshirë, bëhet në emër të shpëtimit të tyre nga gjendja e keqe ku kanë rënë dhe të udhëzimit në rrugën e drejtë.

Myslimani duhet ta ruaj veten nga çdo e keqe e kapitalizmit. Ai duhet të ruhet nga kthimi i parasë në një lakmi dhe ambicie dhe, në çfarëdo situatë të jetë, ai duhet të zotërojë cilësitë si, frika ndaj Allahut, kërkimi i kënaqësisë së Tij, mëshirë ndaj shoqërisë, moralin Islam, respektin ndaj të drejtave të njeriut, mos shkeljen e kufijve të haramit dhe hallallit me asnjë lloj preteksti dhe shumë cilësi të tjera që duhet të gjenden tek një besimtar i sinqertë.

Është detyrë e çdo muslimani të pengojë padrejtësitë dhe të lartësojë të vërtetën. Besimtarët duhet t'i këshillojnë me fjalë të buta njerëzit që kanë humbur rrugën. Të pasurit që shkelin kufijtë hyjnorë për të arritur pasuri dhe mirëqenie materiale në ditën e gjykimit do të jenë të mjerë dhe të varfër.

Në lidhje me njerëz të tillë Kurani thotë:

“O besimtarë! Në të vërtetë, shumë priftërinj dhe murgj përlajnë pasurinë e njerëzve pa të drejtë dhe i largojnë ata nga rruga e Allahut. Ata që grumbullojnë ar dhe argjend dhe nuk e shpenzojnë për hir të Allahut, paralajmëroji me dënim të dhembshëm.” (Teube, 34)

“Mjerë për çdo përqeshës - shpifës, që grumbullon pasuri dhe e ruan, duke menduar se ajo pasuri do ta bëjë të pavdekshëm! Jo, aspak! Në të vërtetë, ai do të hidhet në torturën shkatërruese. E kush mund të ta shpjegojë ty se çfarë është tortura shkatërruese? Ajo është zjarri i Allahut i ndezur fort, i cili depërton deri në zemrën e njeriut.” (Humeze, 1-7)

Shah Nakshibendi:

Shkaku që njerëzit janë larg Allahut është neglizhenca dhe harresa të cilat nga ana e vet vijnë si pasojë e prirjes së theksuar ndaj kënaqësive të kësaj bote.

Sejjid Emir Kulal tregonte këtë shembull gjithmonë:

Nëse nuk bëhet përpjekje për të shpëtuar nga dashuria për dunjanë ena prej dheu (trupi) nuk ka ndonjë vlerë. Për të pjekur enën e dheut e fusin në furrë. Enët e dheut që hyjnë në furrën shpirtërore disa dalin të forta disa të tjera dalin të thyera... Ne shpresojmë dhe jemi optimistë edhe për enët e thyera. Sepse ato riciklohen për t'u pjekur përsëri në furrë deri sa të dalin të forta.

Shkaku kryesor i neglizhencës së njeriut është dhëna pas bukurive dhe kënaqësive të kësaj bote. Por Allahu na i ka dhënë këto mirësi në këtë botë në mënyrë që t'i përdorim ato si një mjet për të fituar lumturinë në botën tjetër dhe jo për t'i shndërruar ato në qëllim në vetvete duke kënaqur egon e babëzitur.



Jeta e kësaj bote është një udhëtim me pengesa të cilat duhet të kapërcehen sepse fundja kjo botë është vend sprove dhe jo rehatie. Një person që harron rrugën se për ku është nisur është i destinuar të humbasë dhe të mbetet pa zahirë. Një udhëtar që nisët për në një destinacion nuk humbet kohë me gjëra të pavlefshme rrugës por përgatitet seriozisht për të arritur sa më i sigurt dhe shëndoshë e mirë në destinacionin e duhur.

Pengesa më e madhe që e largon njeriun nga Allahu janë kënaqësitë e kësaj bote, përpjekja e kotë për të përmbushur dëshirat e egos.

Kjo ndodhi e shpjegon shumë bukur këtë të vërtetë:

Një ditë Hazreti Omeri (r.a.) , qau kur në trupin e profetit vërejti shenjat e rrëkosës mbi të cilën Ai flinte. Kur atë e pyeti Resulullahu (a.s.) për arsyen e përlojtjes ai u përgjigj:

“- O i Dërguari i Allahut! Ne e dimë se çfarë ke hequr në Kisra dhe Kajser! Ndërkaq Ti je i Dërguari i Allahut!”

I Dashuri i Allahut (a.s.) u shpreh:

“O Omer! A nuk dëshiron që dynjaja të jetë e atyre dhe ahireti i joni?” (Muslim, Talak, 31)

Në kohën e Omerit si halife janë ngadhënjyer Siria, Iraku, Palestina, Egjipti si dhe u përfshinë të gjitha tokat e Iranit në kufijtë e shtetit Islam. Thesaret e pasura shtetërore të Bizantit dhe Iranit filluan të orientoheshin nga arka e thesarit të Medines së Përndritur. Niveli i mirëqenies së shoqërisë u rrit, por Halifi i myslimanëve qëndroi i përjashtuar nga ky vërshim bollëku dhe pasurie. Ai vazhdonte të jepte hutbet (ligjeratat) me rroba të arnuara edhe pse arka shtetit ishte e pasur. Për të ruajtur egon (nefsin) e tij nga fama e postit Ai ndiqte një jetë krejt modeste. Gjatë udhëtimit me hyzmetqarin e tij për në Sham Ai i tha atij:

“-Erdhi rratha jote tani, hajde hyp në devenë time!”

Hyzmetqari i tij edhe pse e refuzoi duke i thënë:

“O halife, tashpo kujtojnë se jam unë halifja i tyre!, Ai e hypi në deve, dhe ashtu duke qenë në këmbë hyri në Sham. E kështu ai la një kujtim dhe një shembull të pashoq të vllazërimit islam që kapërceu shekujt.

Ai e shtyu jetën me vështirësi shumë të mëdha, shpesh merrte edhe borxh për nevojat e Tij themelore.

Nga thesari i shtetit ai pranoi të merrte një pagë minimale me të cilën zor mbahej. Ato që nuk e njihnin nuk arrinin ta dallonin atë si halife në mesin e të tjerëve sepse ai ndiqte një jetë krejt modeste.

Paria e sahabeve nuk e duruan këtë gjendje dhe kërkuar t’ia rrisnin pagën Atij. E patën të vështirë që këtë mesele ta ndanin direkt me Hazreti Omerin prandaj shkuan tek bashkëshortja e Pejgamberit që ishte vajza Hazreti Osmanit, pra tek nëna jonë Hafsa. Asaj i kërkuar të shkonte tek babai i saj me propozimin që kishin menduar. Hazreti Hafsa e ndau me babain e saj këtë propozim. Hazreti Omeri (r.a.) i cili kishte qenë dëshmitarë i ditëve aq të vështira për Resulullahun në të cilat Pejgamberi nuk gjente as edhe një hurm për të shuar urinë e tij shkatërruese, e pyeti vajzën e tij Hafsa:

“-O vajza ime! A e din sesi Profeti (a.s.) ushqehet dhe vishej?”

“-Aq sa t’i mjaftonte!” – iu përgjigj Hafsa.

Atëherë Hazreti Omeri (r.a.) iu drejtua vajzës së tij të dashur duke i thënë:

“-Dy miqtë (Hazreti Pejgamberi me Ebu Bekrin) dhe unë



ngjajmë me udhëtarët e së njëjtës rrugë. I pari jonë (Hazreti Pejgamberi) arriti në destinacion. Tjetri, pra Ebu Bekri duke ecur në të njëjtën rrugë e arriti të parin. Unë si i treti i tyre përpiqem të arrij shokët e mi. Në qoftë se nisem me shumë ngarkesë nuk do të mund t'i arrij ato! Apo ti nuk dëshiron që unë të jem i treti i kësaj rruge?

Qëllimi e vetëm i Omerit (r.a.) ishte të fitonte kënaqësinë e Allahut. Ai i ishte përkushtuar kaq shumë këtij qëllimi sa që të gjitha pengesat dhe vështirësitë ishin një hiç në sytë e tij. Ai kishte fuqi t'i përballonte ato me durim, pëlqim dhe dorëzim tek Allahu. Ai ndoqi një jetë shumë të disiplinuar edhe pse Hazreti Pejgamberi (a.s.) e kishte sihariquar disa herë me xhenet.

Disiplina shpirtërore në rrugën e përsosjes synon pikërisht arritjen e një gjendje dhe pjekurie të tillë. Të jesh në gjendje të vazhdosësh udhëtimin shpirtëror pa u ndikuar nga mirësitë dhe kënaqësitë e kësaj botë.

Sipas një transmetimi, një mbret kishte ndërtuar një saraj të mrekullueshëm e përrallor, aq sa çdo dhomë e tij ishte një ekspozitë e veçantë bukurie dhe çdo cep ishte punuar me një art të jashtëzakonshëm zbukurimi. Dyert ishin punuar me modelet më të rralla të basorelievit, ndërsa muret ishin të mbushura me forma kaligrafie të bukura, që të ledhatonin shpirtin. Me një fjalë, nuk ishte e mundur t'i përshkruaje në pak kohë të gjitha veçoritë e atij saraji.

Një ditë, mbreti ftoi në pallat një të dashur të Allahut. Pasi e shëtiti në pallat me një respekt të jashtëzakonshëm këtë njeri të bekuar, që i ishte përgjigjur ftesës që i kishte bërë, filloi t'i tregonte qëllimin për të cilën e kishte ftuar:

"I nderuar! Si ju duk saraji? Desha të dija mendimin tuaj."

I dashuri i Allahut, iu përgjigj me këto fjalë:

“Madhështia materiale e sarajit të verbon sytë, sepse arkitektët dhe artistët që e kanë ndërtuar këtë, kanë përdorur të gjitha aftësitë e tyre. Me një fjalë, çdo gjë është e përsosur!”
Pastaj shtoi:

“Por ka vetëm një të metë!”

Mbreti, i cili nuk e priste këtë përgjigje, u çudit dhe me habi të madhe, pyeti:

“Allah Allah! I nderuar, cila është e meta e këtij saraji?”

I dashuri i Allahut i dha një përgjigje shumë kuptimplote që e zhyt njeriun në oqeanin e medimitit dhe që vlen për krejt gjithësinë:

“Nuk është e përhershme!..”

“Nuk është e përhershme!..” Një shprehje e shkurtër dhe e përmbledhur, që mund të thuhet për çdo krijesë, e cila ndodhet në këtë gjithësi dhe që një ditë do të zhduket. Por njëkohësisht, është edhe një shprehje e cila përmban kuptim të gjerë.

Shah Nakshibendi thotë:

Njerëzit mendojnë se në rrugën tonë nuk ka disiplinë shpirtërore. Por a ka disiplinë dhe ushtrim më të madh se të ndër-presësh çdo lidhje me çdo gjë përveç Allahut.

Të gjitha gjendjet e dukshme dhe të padukshme peshoji me peshoren e Kuranit dhe Sunetit. Kundërshto egon, edhe nëse duket si diçka e vogël udhëtari në këtë rrugë duhet ta vlerësojë shumë këtë gjë. Nëse udhëtari sundon egon duhet të falenderojë Allahun për këtë gjë.

Disiplina shpirtërore konsiston në reduktimin minimal të



përmbushjes së dëshirave të egos. Bota e brendshëm e njeriut është si një peshore me dy krahë. Pa ulur dëshirat egos nuk lartësohen aftësitë shpirtërore.

Qëllimi i privimit të egos nga përmbushja e disa dëshirave është arritja e përkorës shpirtërore. Gjithë çështja është që ego t'i nënshtrohet të vërtetës dhe të veprojë sipas mësimave hyjnore.

Qëllimi është t'i japë njeriut vetëdijen se ndodhet gjithmonë nën vëzhgimin e kamerave hyjnore, duke e pastruar atë prej cilësive primitive, për ta ngritur në nivelin e “njeriut të përsosur”, që është edhe tipi ideal për Islamin. Përveç kësaj, disiplina shpirtërore ka për qëllim të qëndisë në esencën njerëzore në mënyrë të natyrshme cilësitë e larta si mirësjellja, delikatesa, edukata, turpi, bujaria, dhembshuria dhe mëshira. Nga kjo pikëpamje, disiplina shpirtërore është një pjesë e pandarë e rrugëtimit shpirtëror.

Shah Nakshibendi thotë:

Ai që mbështet tek Allahu nuk duhet të veprojë sipas dëshirave të egos dhe tevekulin duhet ta mbajë të fshehur duke punuar.

Besimtari i vërtetë mbështet dhe strehohet vetëm tek Allahu, vetëm prej Tij kërkon ndihmë dhe forcë. Besimtari përballë caktimit hyjnor e shikon vetën një “hiç”

Por në të njëjtë kohë ai duke qenë pjesë e kësaj bote nuk mbetet mbas në marrjen e masave dhe plotësimin e kushteve që duhet për të realizuar jetën në këtë botë. kur sinqeriteti është i pastër dhe përpjekja jonë është e lartë, ndihma e Allahut për të arritur suksesin është e sigurtë.

Nga ana tjetër nëse caktimi i Allahut është ndryshe nga ajo që



synojmë ne edhe sikur të mblidhet e gjithë bota për të ndihmuar nuk do të ketë kurrë sukses në realizim e synimit.

Ajo që i ka hije besimtarit është të plotësojë të gjitha kush-tet dhe përfundimin dhe rezultatin ta shpresojë prej Allahut. Nëse nuk e arrin në fund atë që synonte, nuk bie në pesimizëm dhe nuk ankohet por e pranon si caktim hyjnor përballë të cilit duhet të dorëzohemi. Nëse arrin sukses në përfundim nuk për-fshihet nga mburraja dhe mendjemadhësia. Suksesin nuk duhet t'ia atribuojmë asnjë herë vetes por Allahut dhe për këtë duhet ta falënderojmë Atë pafund.

Të gjitha pritshmëritë e besimtarëve të vërtetë janë prej Allahut. Ata e fshehin tevekulin përmes punës dhe kjo bëhet për të vetmen arsyeje që adhurimi të jetë i pranueshëm dhe të ruajnë gjendjen e modestisë dhe thjeshtësisë. Mbështetja e vetme e besimtarëve është Allahu, suktesi dhe fitorja janë vetëm prej Tij.

Allahu thotë në Kuran:

“Mbështetu në të Gjithëjetshmin, i Cili nuk vdes dhe madhëroje Atë me falënderim! Ai i di mjaft mirë gjynahet e robërve të Vet.” (Furkan, 58)

Fjala popullore: “Mos u mbështet tek njeriu sepse vdes dhe mos u mbështet tek muri sepse shembet” shpreh pikërisht mbështetjen vetëm tek Allahu.

Kompetenti i vetëm të cilit mund t'i besohet në çdo çështje, duhet të jetë patjetër i pavdekshëm, i përhershëm, i aftë dhe absolut. Në të kundërt, mbështetje nuk ka kuptim

“Besimtarët le të mbështeten vetëm tek Allahu.” (Ibrahim, 11)

“Allahu i mjafton kujt do që mbështetet tek Ai.” (Talak, 3)



Kurse Profeti (a.s.) thotë:

“Sikur t’i mbështeteni Allahut plotësisht, Ai do t’ju furnizonte ashtu siç furnizon zogjtë, të cilët dalin të uritur në mëngjes dhe kthehen të ngopur në mbrëmje!” (Tirmidhi, Zuhd, 33/2344; Ibn maxhe, Zuhd, 14)

Nga ana tjetër tevekuli i saktë është kur merren edhe masat njëkohësisht. Pra një tevekul i vërtetë konsiston në marrjen masave dhe plotësimin e gjithë kushteve për arritjen e synimit. Një tevekul pa plotësuar kushtet është një tevekul i gabuar.

Kjo ndodhi e shpreh shumë bukur këtë gjë:

Një bedevi e pyeti të Dërguarin e Allahut:

“O i Dërguari i Allahut! A t’i mbështetem Allahut pasi ta lidh kafshën, apo t’i mbështetem pa e lidhur?”. Pejgamberi ynë i Nderuar sallallahu alejhi ue sellem u përgjigj:

“Së pari lidhe, atëherë mbështetju Allahut!” (Tirmidhi, Kijamet, 60/2517)

Një grup pelegrinësh nga Jemeni rugës për në haxh nuk kishin marrë ushqime dhe ujë duke pretenduar:

“Ne po shkojmë të vizitojmë shtëpinë e Allahut, a nuk na furnizon ai ne?”. Kur shkonin në Mekke detyroheshin të lypnin. Në lidhje me këtë zbriti ajeti: **“...Merreni ushqimin e rrugës me vete...”** (Bekara, 197)

Omeri (r.a.) i ka qortuar kështu njerëzit që nuk përpiqen, që përtojnë dhe që pastaj thonë: “Ne i jemi mbështetur Allahut”: “Ju nuk i besoni Allahut, por jeni njerëz që hani dhe i besoni mallit të huaj. Mbështetësi i vërtetë është ai njeri që e mbjell farën, pastaj mbështetet te Allahu.” (Ibn Rexheb el-Hanbeli, Xhamiu’l-Ulum ve’l-Hikem, Amman 1990, fq.650)

Shah Nakshibendi thotë:

Po qe se një ushqim çfarëdo është përgatitur dhe përftuar me indiferentizëm, zemërim ose pa dëshirë, në të nuk ka të mirë dhe begati, sepse në të ka gjetur rrugë nefsi (egoja) dhe shejtani (djalli). Te personi që e ha këtë ushqim, patjetër do të shfaqet një rezultat që e prish begatinë dhe kënaqësinë. Nga ushqimet hallall (legjitime, të lejuara e të bekuara) dhe të pastra të përgatitura pa u kredhur në indiferentizëm dhe duke e menduar Allahun e Lartë, shfaqet e mira. Shkaku që njerëzit nuk arrijnë dot të kryejnë akte dhe punë të pastra e të mira, është se nuk tregojnë kujdes për t'u ruajtur nga harami (gjërat jolegjitime, të palejuara e të pabekuara), nga gjërat e dyshimta dhe nga shkelja e të drejtave të personit. Pavarësisht nga kushtet, mundësia veçanërisht për të qenë i përsëpirtshëm dhe i qetë në namaz dhe për ta falur namazin me kënaqësi e duke derdhur lot, varet nga ngrënia e gjërave hallall, nga përgatitja e ushqimit duke e kujtuar Allahun e Lartë dhe duke e ngrënë atë sikur të ishe në prani të Tij! Personi i cili e ka ushqyer trupin me kafshatë haram, nuk mund të ndjejë kënaqësi në namaz!

Sipas transmetimeve Shah Nakshibendi e përgatiste vetë ushqimin dhe e shtronte vetë në sofër. Kur hanin bukë gjithmonë i këshillonte nxënësit:

Qëndroni në sofër sikur jeni para Allahut, mos harroni kurrë që ajo që hani është mirësi e Allahut.

Nëse njëri nga ata që ishin ulur për të ngrënë hante ushqimin në gjendje neglizhence, Shah Nakshibendi në mënyrë intuitive e kuptonte dhe e qortonte duke i thënë: mos mendo gjë tjetër përveç Allahut, mendo vetëm Atë që është më afër teje se vetja jote.

Këto këshilla qortuese janë një kujtesë se në çdo gjendje dhe



situatë përmendja e Allahut nuk duhet harruar. Të jesh indiferent dhe neglizhent ndaj Allahut në momentin që po përfiton prej mirësive të Tij, është një dobësi e madhe në syrin e mistikëve. Sipas edukatës islame ngrënia e ushqimit fillohet me emrin e Allahut dhe përfundon me falënderimin e Tij.

Nakshibendi gjithashtu nuk hante vetë dhe nuk lejonte as nxënësit të hanin një ushqim që ishte përgatitur me zemrërim dhe padëshirë.

Kur njëherë një mik i ofrojë ushqim për të ngrënë ai e refuzoi duke thënë:

Ky ushqim nuk është i përshtatshëm për ne. Sepse është përgatitur me zemërim.

Kërkimet e fundit shkencore kanë zbuluar se gjendjet shpirtërore kanë një ndikim mbi sendet fizike. Për shembull nëse ujit i flasim me fjalë të bukura kristalet e tij janë më të rregullta, e kundërta ndodh kur i themi fjalë të pahijshme, kristalet në këtë rast janë të çrregullta.

Përveç kriterit hallall-haram të ushqimit, në gjendjen shpirtërore të njeriut, në veprat dhe në adhurimet e tij, ndikon edhe atmosfera shpirtërore në të cilën janë gatuar ato. Kjo gjë e tregon qartë qëndrimin që duhet të mbajmë ndaj ushqimeve. Në përgjithësi, në ditët tona për fat të keq, nuk mendohet aspak për dëmet që i shkaktojnë anës sonë shpirtërore ushqimet që shiten në vende të hapura, pa u kujdesur për të drejtën e syrit të shumë nevojtarëve dhe për të cilat nuk dihet se si janë gatuar. Prandaj, nuk duhet të harrojmë se gjendja shpirtërore në sigurimin e ushqimit ndikon shumë edhe në ndjenjat tona.


Abdulkadir Gejlani (Allahu e mëshiroftë), thotë:



“Ushqimi haram e vret zemrën. Ndërsa ushqimi hallall, e ngjall atë. Ka kafshata që të lidhin me këtë botë, ka kafshata që të lidhin me botën tjetër. Po ashtu, ka edhe kafshata që të bëjnë të dashur tek Allahu Te-ala.”

E lusim Allahun të na mundësojë t’i kuptojmë siç duhet këto të vërteta. E lusim Allahun të na bëjë prej njerëzve të devotshëm, të singertë dhe vepërmirë.

Amin...



SHAH NAKSHIBENDI

حَمْدُ اللَّهِ

-4-

Një trup që është ushqyer me ushqim hallall zotëron energjinë pozitive për të kryer një abdest dhe namaz sipas kushteve të duhura. Të falësh një namaz pa përgatitje formale dhe shpirtërore është një mangësi e madhe në realizimin e miraxhit të besimtarit. Prandaj qysh në tekbinin e fillestar duhet të pastrojmë mendjen dhe zemrën nga çdo gjë tjetër përveç Allahut. Gjatë namazit besimtari duhet të jetë i përqendruar tërësisht në atmosferën shpirtërore të namazit. Nuk duhet të harrojmë që kështu e trupit në namaz është Qabja kurse kështu e zemrës është Allahu.





SHAH NAKSHIBENDI - 4

Shah Nakshibendi thotë:

Një rob, qetësinë në namaz mund ta arrijë përmes katër gjërave:

1. Duke pasur kujdes të ushqehet vetëm me ushqim hallall dhe gjatë ushqimit të jetë në gjendje të zgjuar shpirtërore.
2. Gjatë abdestit të jetë i përqendruar në plotësimin e tij.
3. Kur të marrë tekbirin e parë ta konsiderojë veten para Allahut.
4. Jashtë namazit mos ta harrojë kurrë Allahun.

Allahut thotë në Kuran:

“Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët, të cilët janë të përlurur në namazin e tyre.” (Muminun, 1-2)

“Mjerë për ata, të cilët kur falen, janë të pakujdesshëm për namazet.” (Maun, 4-5)

Një namaz kur respektohet të gjithë kushtet formale dhe



shpirtërore largon prej zemrës perden e harresës dhe e pastron atë nga çdo gjë tjetër përveç Allahut.

Besimtari me mendimin dhe ndjenjën se “Namazi është miraxhi i besimtarit” (Sujuti, Sherhu İbn-i Mâce, I, 313.) përjeton një qetësi shpirtërore të papërkufizueshme. Por për të arritur këtë gjendje duhet një përgatitje fizike dhe shpirtërore.

Një trup që është ushqyer me ushqim hallall zotëron energjinë pozitive për të kryer një abdest dhe namaz sipas kushteve të duhura. Të falësh një namaz pa përgatitje formale dhe shpirtërore është një mangësi e madhe në realizimin e miraxhit të besimtarit. Prandaj qysh në tekbinin e fillestar duhet të pastrojmë mendjen dhe zemrën nga çdo gjë tjetër përveç Allahut. Gjatë namazit besimtari duhet të jetë i përqendruar tërësisht në atmosferën shpirtërore të namazit. Nuk duhet të harrojmë që kibra e trupit në namaz është Qabja kurse kibra e zemrës është Allahu.

Besimtari, në namaz duhet të ndjejë madhësinë e Allahut dhe dobësinë dhe nevojën e vet për Allahun. Besimtari gjatë namazit është në një botë tjetër, në një atmosferë të pa përshkrueshme nga fjalët. Sigurisht që gjendjen më të lartë shpirtërore në namaz e ka arritur Profeti (a.s.).

Aishe (r.a.) shprehet:

“Kur Resulullahu (a.s.) qëndronte në namaz, herëpashere nga gjoksi i tij dëgjoheshin zëra si të valimit të ujit në kazan.”

(Ebu Davud, Salat, 157; Nesai, Sehv, 18)

Hazreti Aliu (r.a.), gjatë adhurimeve të ndryshme, hynte në një gjendje qetësie shpirtërore të pashembullt. Njëherë, gjatë një beteje i hyri në këmbë një shigjetë. Shokët e tij u munduan t’ia hiqnin, por nga dhembja që ndiente, nuk mundën t’ia nxirrnin.

Hazreti Aliu u drejtua nga shokët dhe i tha:



- Unë po fal një namaz, e ndërkohë ju ma hiqni shtizën!”

Shokët e tij bënë ashtu siç u tha ai. Ata arritën t’ia nxirrnin shtizën pa as më të voglën vështirësi. Hazreti Aliu (r.a.), pasi dha selam i pyeti shokët:

- Çfarë bëtë?

Ata u përgjigjën:

- E hoqëm!

Vëreni përqëndrimet dhe përjetimet shpirtërore të atyre që janë së bashku me Zotin.

Sigurisht, maijjeti, pra vetëdija e të qenit së bashku me Zotin, nuk lidhet vetëm me adhurimet. Ky koncept është një nivel i lartë shpirtëror që formëson gjithë jetën e besimtarit. Është një ndjeshmëri që sa zbukuron jetën tonë të adhurimeve, aq e organizon dhe përmirëson jetën tonë familjare, shoqërore, ekonomike dhe të gjithë aktivitetet tona njerëzore.

“Përrjashtim bëjnë ata që falen, e që janë të vazhdueshëm në faljet e tyre.” (Mearixh, 22-23)

“...Ata që besojnë në jetën e ardhshme, besojnë edhe në të (Kuran) dhe kujdesen për kryerjen e namazit të tyre.”
(En’am, 92)

Nga ajetet kuranore kuptojmë që respektimi i kushteve formale të namazit e përgatit besimtarin për të fituar ndjesinë dhe vetëdijen se gjatë namazit ndodhet para Allahut.

Kjo është arsyeja që besimtarët që respektojnë të gjitha kushtet e namazit deri në frymën e fundit, janë në gjendje namazi gjatë gjithë jetës. Namazi i besimtarëve të vërtetë është i përhershëm. Balli i tyre është në sexhde edhe gjatë namazit edhe

jashtë namazit. Ata janë gjithmonë në gjendje ibadeti, nuk mund të imagjinohet që gjendje e ibadetit të tyre të përfundojë apo ndërpritet.

Shah Nakshibendit thotë:

Baza e rrugës sonë është: Në dukje me për me dhe për popullin kurse në të vërtetë për dhe me Allahun. Në Kuran thuhet: **“njerëz, të cilët shitblerja nuk i pengon për të përmendur Allahut dhe të cilët falin namazin dhe japin zeqatin dhe të cilët kanë frikë nga Dita (e Kiametit), kur zemrat dhe shikimet do të jenë të shqetësuara.** (Nur, 37)

Kur udhëtari i rrugës sonë arrin pjekurinë e duhur, midis gjuhës dhe zemrës së tij nuk ka më asnjë dallim. Pra preokupimet e kësaj bote nuk e pengojnë zemrën nga përmendja dhe ibadeti. Po ashtu punët shpirtërore nuk janë pengesë për punët e kësaj bote.

Në rrugën e edukimit shpirtëror shkëputja prej njerëzve dhe vetmia janë konsideruar si mënyrë efikase për t'u thelluar në botën shpirtërore, për të pastruar zemrën dhe rifreskuar aftësitë shpirtërore.

Musai (a.s.) para se t'i shpallej Teurat në Turi Sina ka mbajtur 40 ditë agjërim pandërprerje, Isai (a.s.) para se t'i shpallej fjala e parë prej Inxhilit ka qëndruar 40 ditë i uritur dhe i etur në malin Sair. Profeti(a.s.) ka qëndruar në vetmi në shpellën Hira para se t'i shpalleshin ajete e para të Kuranit.

Të gjitha këto përbëjnë një para përgatitje shpirtërore. Por në islam përgjithësimi i jetës së vetmuar është e ndaluar. Në islam thelbësore është jeta sociale dhe përpjekja për ta ndryshuar gjendjen. Pikërisht këtë gjë thekson edhe Shah Nakshibendi. Njerëzit e

përkore duhet të jenë gjithëmonë në gjendje vetmie me Allahun por pa u shkëputur nga shoqëria. Problet dhe vështirësitë sacialet ata nuk i pengojnë nga adhurime dhe vetmia me Allahun.

Hazreti Muhamed Parisa, një nga velitë e mëdhenj që ka dalë nga duart e Hazreti Shah Nakshibendiut, gjatë rrugës për në haxh sheh rastësisht një argjendar të ri me fytyrë të nurtë. Mërzitet, duke menduar se ky i ri po e harxhon rininë e tij duke u dhënë shumë pas punës dhe dynjallëkut, dhe thotë me vete:

- Sa keq! Në moshën më të përshtatshme për adhurim, ky djalë, qenka dhënë me kaq tepri e ambicie pas botës materiale! Në atë çast, atij iu shfaq në vegimin gjendja e atij djali. Ai pa se djali, pavarësisht ngarkesës së tij të punës, zemrën e kishte vazhdimisht me Zotin e Lartmadhëruar. I kënaqur, ai tha:

- Mashallah! Dorën e paska në qar e shpirtin në Yar...!

Kur mbërriti në Hixhaz, Muhamed Parisa vërejti një të mos-huar mjekërbardhë, i cili e kishte rrokur mbulesën e Qabes dhe po qante me gjithë shpirt. Duke gjykuar nisur nga ajo që shihte nga jashtë, tha me zili:

- Ah sikur t'i kërkoja mbështetje dhe strehim Zotit tim edhe unë kështu, duke qarë!". Më pas, atij iu shfaq sekreti i të qarave të këtij njeriu dhe kuptoi se i moshuari po qante për plotësimin e një nevoje të kësaj bote. Për këtë arsye, zemra e tij e ndjeshme u mërzit shumë.

Shah Nakshibendi thotë: hadithi profetik urdhëron: atë që nuk dëshiron ta dinë njerëzit mos e bëj as në vetmi!² Atë që Allahu kërkon të mos e veprosh, mos e vepro kur je vetëm.³

2. İbn-i Haxher, el-Metalib, XI, 440/2575.

3. İbn-i Hibban, Sahih, II, 130/403

Këto hadithe janë shumë të nevojshëm për asketët. Për asketët edhe vendet e vetmuara janë plot. Asketët atë që bëjnë midis njerëzve bëjnë edhe në vende të fshehura.

Për një jetë të pranuar me ibadete është i domosdoshëm udhëtimi nga imani në Ihsan. Asketët për asnjë moment nuk janë indiferentë nga vëzhgimi hyjnorë. Ata kanë fituar një gjendje të tillë që gjërat që nuk i bëjnë në syrin e njerëzve nuk i bëjnë as në vende të fshehta apo kur janë në vetmi.

Hadithi profetik shpreh domosdoshmërinë dhe ndjeshmërinë që duhet të ketë besimtari në lidhje me këtë që përmendëm:

Një ditë Profeti (a.s.) shkoi në vendin ku ishin delet e mbledhura për zekat. Për delet kujdesej një çoban me pagesë.

Kur profeti e pa çobanin gjysëm të zhveshur e thirri dhe i tha:

Sa ditë ke punuar për ne? Dhe sa të detyrohemi?

Çobani e kuptoi që pyetja tregonte ndërprerjen e punës.

A nuk e kam bërë punën siç duhet o i Dërguar i Allahut? pyeti çobani.

Profeti (a.s.) tha:

“Jo se nuk e ke bërë mirë por dëshiroj që një person që punon për ne të turpërohet edhe kur është vetëm nga Allahu. Nuk e dua një punë nga një person që kur është vetëm nuk turpërohet prej Allahut.” (Bejhaki, Shuab, X, 196/7370; Mervezi, Tathimu Kadri's-Salah, II, 836)

Kurse ndodhia e një çobani tjetër, zemra e të cilit është plot me dashurinë dhe frikën për Allahun, është shumë domethënëse dhe mbresëlënëse:



Abdullah ibn Umeri r.a kishte dalë së bashku me shokët e tij në një lagje periferike të Medinës. Shokët e tij i bënë gati një sofër për të ngrënë. Ndërkohë, një bari delesh kaloi pranë tyre dhe u dha salam. Ibn Umeri i tha:

- Eja, o bari dhe urdhëro në sofrën tonë!

Bari u përgjigj:

- Unë sot kam agjëruar.

Ibn Umeri u çudit dhe tha:

- Në gjithë këtë të nxehtë përvëlues, ti edhe agjëron, edhe kullot delet, duke qenë agjërueshëm?

Për të kuptuar nivelin shpirtëror të zemrës së bariut, i propozoi këtë gjë:

- Pse nuk na shet një dele nga kjo kope? T'i paguajmë paratë menjëherë, madje e therim tani dhe të japim edhe ty mish që të bësh yftar?

Bari u përgjigj:

- Kjo nuk është kopeja ime. Këto janë delet e zotërisë.

Atëherë Ibn Umeri r.a i bëri një pyetje tjetër, për ta vënë në provë:

- Po thuaji zotërisë tënd se njëra dele të humbi, se mos ka nga ta marrë vesh të vërtetën ai.

Bari i hoqi sytë nga Ibn Umeri dhe, duke ngritur gishtin e dorës lart, tha:

- Po Allahu, ku është?!

Ibn Umeri r.a u prek shumë nga ky ndërgjegjësim që kishte bariu, në lidhje me devocionin dhe me ihsanin. Ra në mendi-

me përsëriste me vete: “Ku është Allahu? Bariu tha: Ku është Allahu?” Kur mbërritën brenda në Medine, puna e parë që bëri ishte dërgimi i një përfaqësuesi tek zotëria i bariut, që t’ia blinte me çdo çmim kopenë dhe bariun. Pasi i bleu, i fali lirinë bariut dhe ia dhuroi atij kopenë. (Ibn Ethir, Usdul-gabe, III, 341)

Kur shpërblimi i ndjenjës së mbikëqyrjes hyjnorë është kaq i begatë në këtë botë kush e di sa madhështor do të jetë shpërblimi në ditën e gjykimit.

Nga ana tjetër ne jemi çobanë për ata që kemi nën përgjegjësi, duke filluar nga vetja dhe familja. Një çoban i mirë delen e sëmure nuk e le në mëshirë të fatit por e ndihmon që të arrijë kopenë. Po ashtu edhe prindërit gjatë rritjes së fëmijës duhet të përballojnë disa vështirë.

Një çoban i mirë e ruan tufën nga rreziqet e ndryshme. Në ditët tona fatkeqësisht televizioni, rrjetet sociale dhe në përgjithësi media është duke i orientuar fëmijët në rrugë dhe vende të gabuara. Ata janë duke u shndërruar në një burim i rrezikshëm i helmimit shpirtëror. Kapitalizmi dhe globalizmi materialist nxitin egoizmin dhe individualizmin e theksuar duke i shndërruar njerëzit në makineri konsumi. Në këtë pikëpamje ego e njeriut i ngjason natyrës së kecit i cili kullot në vende të rrezikshme. Në këto kushte të vështira dhe negative është më e rëndësishme se kurrë të tregohet kujdes dhe përpjekje për edukimin e brezave.

Ne jemi përgjegjës për të orientuar ata që kemi nën përgjegjësi drejt rrugës së drejtë dhe të vërtetë duke i mbrojtur ata në këtë mënyrë nga rënia në kurthet e shejtanit të cilat të çojnë të gjitha në mjerim në këtë botë dhe dënim në botën tjetër.

Ajeti kuranor shprehet kështu:



“O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë e mbikëqyrin engjëj të fuqishëm e të ashpër, të cilët kurrë nuk i kundërshtojnë urdhrat e Allahut, por i zbatojnë menjëherë ato.” (Tahrim, 6)

Kurse hadithi e shpjegon kështu ajetin kuranor:

“Urdhërojini ata të bëhen robër të Allahut, të jenë të bindur dhe të kryejnë adhurimet. Pengojini ata nga mosbindja ndaj Allahut dhe bërja e gjynaheve. Kjo pra do të thotë t'i ruash ata nga Xhehenemi.” (Alusi, XXVIII, 156.)

Në asnjë mënyrë nuk duhet të harrojmë mbikëqyrjen hyjnore, në asnjë mënyrë nuk duhet ta humbasim vëmendjen nga ndjenja dhe vetëdija se çdo lëvizje e jona është nën mbikëqyrjen e kamerave hyjnore.

Të distancohesh nga mëkatet edhe kur je larg njerëzve dhe në vetmi të plotë është shenjë e besimit të sigurtë dhe shenjë e vetëdijes se Allahu na shikon dhe mbikëqyr në çdo moment dhe vend. Të dashurit e Allahut kanë bërë përpjekje të mëdha për t'i edukuar nxënësit e tyre me këtë frymë dhe ndjenjë.

Shah Nakshibendi thotë:

Profeti (a.s.) ka thënë: Kush ka dy ditë të njëjta është në humbje, është mallkuar ai që të nesërmen e ka më të keqe se të djeshmen. Kush nuk punon për të shtuar veprat e mira duke qëndruar në të njëjtin vend është në humbje. Për atë që është në humbje vdekja është më e mirë.⁴

Shprehja “Dy ditë të njëjta” nuk duhet keqkuptuar. Kjo shprehja nuk ka kuptimin që në çdo ditë të re të bëjmë vepra të

4. Axhluni, Keshfu'l-Hafa, nr: 2406.

mira më shumë se ditën paraardhëse. Sepse po të vazhdonim në këtë mënyrë nuk do të mjaftonte koha.

Kuptimi i shprehjes është që duke vazhduar çdo ditë me vepra të mira, besimtari çdo ditë shton në librin e tij të veprave shpërblime, shtimi i veprave të mira për besimtarin ndërpritet vetëm kur vdes. Prandaj besimtarët përpiqen që pas vdekjes të lenë sadaka të vazhdueshme në mënyrë që veprat e mira të tyre të vazhdojnë edhe pas vdekjes.

Përgjegjësia e besimtarit për të përparuar çdo ditë nuk konsiston vetëm në ibadete por përfshin gjithë aspektet e jetës së njeriut. Besimtari duhet të përpiqet çdo ditë të hapur dritare dhe horizonte të reja shpirtërore. Në këtë mënyrë e forcon çdo ditë e më shumë besimin dhe bindjen e tij.

Profeti (a.s.) megjithëse i ishte i mbrojtur nga mëkatet çdo ditë i kërkonte falje Allahut.

“O njerëz! Pendohuni tek Allahu dhe kërkoni falje prej Tij, sepse unë pendohem njëqind herë në ditë.” (Muslim, Dhikr, 42)

Kërkimi i faljes vjen nga shqetësimi për mos falënderimin si duhet ndaj Allahut ose për të rritur bindjen.

Shah Nakshibendi thotë:

Asketët nuk e lenë punën e sotme për nesër, prandaj janë quajtur edhe “njerëzit e ditës”.

Jeta i është dhënë njeriut vetëm njëherë, afati i saj është i kufizuar dhe i panjohur. Një moment i saj është i mjaftueshëm për ta dërguar njeriun në lumturinë e përjetshme ashtu siç është i mjaftueshëm për të dërguar në dënim të përherëshëm. Besimtari çdo moment të jetës e vlerëson nën këtë perspektivë. Ai çdo ditë e vlerëson si një kapital dhe pasuri të çmuar për jetën e përjet-



shme. Besimtari ditën e sotme e vlerëson si një mirësi e madhe për të siguruar zahire për ditën e gjykimit, ai në asnjë mënyrë nuk neglizhon punën e sotme duke e shtyrë për nesër.

Allahu në lidhje me këtë na qorton në këtë mënyrë në Kuran:

“O besimtarë, mos lejoni që pasuria dhe fëmijët tuaj t’ju largojnë nga të përmendurit e Allahut. Ata që e bëjnë këtë, do të humbin. Prandaj jepni prej atyre mirësive që ju kam dhënë Unë, para se t’i vijë vdekja ndonjërit, e ai të thotë: “O Zoti im, sikur të më kishe lënë edhe një kohë të shkurtër në jetë, do të kisha dhënë lëmoshë dhe do të bëhesha ndër të mirët!” Por Allahu nuk ia shtyn afatin asnjë shpirti, që i vjen koha (e vdekjes); Allahu e di mirë gjithçka që bëni ju.”

(Munafikun, 9-11)

Sipas një transmetimi, kur Iljasi r.a, takohet me melekun që merr shpirtat, rrëqet-thet paksa. Për këtë arsye, Azraili , thotë:

“Ti je një profet, o Iljas! U frikësove nga vdekja?”

Iljasi r.a, përgjigjet:

“Jo, nuk u frikësova nga vdekja. Por u hidhërova nga fakti se më mbaroi jeta. Unë e kam kaluar jetën time duke bërë adhurime e duke ligjëruar dhe ndjeja ëmbëlsi të madhe prej të qenit rob i Allahut. Mirëpo tani do të jem peng në varr deri në Ditën e Kiametit. Për këtë arsye u pikëllova”.

Kjo botë është vendi ku punohet për të fituar, ndërsa bota tjetër është vendi i shpërblimeve. Në botën tjetër nuk ka punë. E për rrjedhojë s’ka as fitime dhe as humbje. Prandaj dhe koha në këtë botë ka vlerë shumë të madhe.

Besimtari që dëshiron të mbushë librin e veprave me punë të

mira dhe të arrijë një shkallë të lartë në Xhenet duhet të nxitojë dhe ta vlerësojë mirë kohën. Ai duhet të përpiqet të bëjë vepra të mira sa të ketë mundësi. Mirëpo, ndërkohë që garon për punë të mira, nuk duhet të nxitojë e t'i bëjë punët me mangësi dhe të meta, sepse Allahu i Madhëruar, dëshiron që çdo punë të bëhet me rregull dhe cilësi.

Njëherë i Dërguari i Allahut (a.s.), duke dashur të na tërheqë vëmendjen neve, umetit të tij, tha:

“Nuk do të ketë asnjë person që do të vdesë, e nuk do të ndjejë pendesë.”

Kur sahabët e pyetën:

“Për çfarë do të pendohet o i Dërguar i Allahut?”, ai u përgjigj:

“Nëse (i vdekuri) është njeri i mirë, do të pendohet se nuk ka shtuar dot më tepër mirësitë e tij (duke përfutur më shumë prej mirësisë të jetës). Por nëse (i vdekuri) është njeri negativ, do të bëhet pishman se përse nuk ka hequr dorë nga veprat e këqija dhe nuk ka përmirësuar veten.” (Tirmidhi, Zuhd, 59/2403)

Jeta e një besimtari duhet të jetë e mbushur me aktivitete të vlefshme që e gjallërojnë ditën e tij dhe që shërbejnë për ta jetuar Islamin dhe mbajtur gjallë atë.

I Dërguari i Allahut i nxiste në këtë mënyrë në vepra të mira shokët e tij fisnikë:

“A keni përkëdhelur sot kokën e një jetimi?”

“A keni vizituar sot një të sëmurë?”

“A keni ushqyer sot një të uritur?”



“A keni përcjellur sot një xhenaze (një të vdekur)?” (Shih, Muslim, Fedailu’s-Sahabe, 12)

Pra kur të kryejmë një vepër të mirë menjëherë të ndjekim veprën tjetër, nuk duhet të kalojmë asnjë moment të jetës pa gjendje ibadeti dhe vepre. Ajetin kuranor:

“Prandaj, kur të çlirohesh (nga punët e ndryshme), përpiqu fort (në adhurim) dhe vetëm ndaj Zotit tënd përkushtohu!”
(Inshirah, 7-8) duhet ta marrim seriozisht në çdo aspekt të jetës.

E lusim Allahun të na mbrojë nga neglizhenca dhe indiferenca ndaj veprave të mirë në këtë botë të përkohshme. E lusim Allahun të na bëjë të mundur vetëdijesimin e plotë se në këtë botë jemi udhëtar për në botën tjetër. E lusim Allahun të na mundësojë vepra dhe adhurime të pranuar në këtë botë. E Lusim Allahun të na përgatisë për botën drejt së cilës po afrohem dhe jo drejt asaj prej së cilës po largohemi.

Amin!..



PËRMBAJTJA

Parathënie.....	5
Lukman Hakimi - 1.....	13
Lukman Hakimi - 2.....	27
Lukman Hakimi - 3.....	45
Lukman Hakimi - 4.....	61
Lukman Hakimi - 5.....	75
Ebu'l-Hasan Harakani - 1.....	91
Ebu'l-Hasan Harakani - 2.....	105
Ebu'l Hasan Harakani - 3.....	123
Ebu'l Hasan Harakani - 4.....	137
Mevlana - 1.....	153
Mevlana - 2.....	165
Mevlana - 3.....	181
Shejh Sadiu - 1	195
Shejh Sadiu - 2	209
Shejh Sadiu - 3	223
Shah Nakshibendi - 1.....	237
Shah Nakshibendi - 2.....	251
Shah Nakshibendi - 3.....	267
Shah Nakshibendi - 4.....	283

